

STUDIM BAZË I LEGJISLACIONIT, POLITIKAVE DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MJEDISIN NË EVROPËN JUGLINDORE



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

STUDIM BAZË I LEGJISLACIONIT, POLITIKAVE DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE MJEDISIN NË EVROPËN JUGLINDORE

Përgatitur nga

Gita Parihar, Juriste për Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut

Erjon Muharremaj, Zëvendësdekan i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Sanja Ramić, Juriste për të Drejtat e Njeriut dhe Specialiste e të Drejtës Mjedisore

Dr. Venera Kabashi, Juriste për të Drejtat e Njeriut

Snežana Armenko, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi

Zharko Hadji-Zafirov, Avokat

Prof. Dr Mirjana Drenovak-Ivanović, Profesor i Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Beogradit, Jean Monnet Chair në të Drejtën Evropiane për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike

Ky botim është përgatitur në kuadër të Projektit Rajonal të Këshillit të Evropës për “Të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore”, financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF)*.

Këshilli i Evropës

* Shtetet anëtare të HRTF-së: Finlandë, Gjermani, Irlandë, Luksemburg, Holandë, Norvegji, Zvicër, Mbretëri e Bashkuar.

Edicioni francez: *Etude de base de législation, de la politique et de la pratique judiciaire en matière de droit humains et d'environnement en Europe du Sud-est*

Opinionet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e autorit/autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, me përjashtim të qëllimeve tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmenti nuk përdoret jashtë kontekstit, nuk jep informacion të paplotë ose nuk e keqorienton lexuesin për sa i përket natyrës, fushëveprimit ose përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si më poshtë “© Këshilli i Evropës, viti i botimit”.

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë ose një pjese të dokumentit, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshillit të Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publicing@coe.int).

E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë dokument duhet t'i drejtohet Departamentit për Zbatimin e të Drejtave të Njeriut, Drejtësisë dhe Standardeve të Bashkëpunimit Ligjor, Këshilli i Evropës, F-67075 Strasbourg Cedex, E-maili: dgi-coordination@coe.int

Dizajni dhe faqosja e kopertinës: Grafika Šaran

Foto: @Shutterstock

Ky botim nuk është redaktuar nga njësia editoriale e SPDP-së për të korrigjuar gabimet tipografike dhe gramatikore.

© Këshilli i Evropës, mars 2025

Përmbajtja

Mbrojtja e mjedisit dhe e të drejtave të njeriut sipas Kornizave Ndërkombëtare dhe Evropiane **11**

1. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e mjedisit në nivelin ndërkombëtar	11
1.1. Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe forumet ndërkombëtare	11
1.2. Mbrojtja në nivelin rajonal dhe kombëtar	13
2. Këshilli i Evropës	13
2.1. Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut	13
2.2. Zhvillimi i Kornizës së të Drejtave të Njeriut dhe Mjedisit të Këshillit të Evropës	15
2.2.1. E drejta për një mjedis të shëndetshëm	15
2.2.2. Mbrojtja e Mjedisit sipas Legjislacionit Penal Evropian	16
2.2.3. Biznesi dhe të drejtat e njeriut	16
3. Korniza të tjera kyçe në nivelin rajonal evropian	16
3.1. Bashkimi Evropian	16
3.2. Konventa e Aarhusit	18

Shqipëri: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **19**

1. Hyrje	19
2. E drejta materiale dhe praktika	19
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	19
2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare	19
2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit	20
2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare	22
2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin.	23
2.2.1. Analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese	23
2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore	23
2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	24
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	25
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	25
3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor	25
3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes	25
3.1.3. Të drejtat e tubimit dhe protestës	27
3.2. Të drejtat e Qasjes në Drejtësi, Mjetet Juridike dhe Efektiviteti i tyre	28
3.2.1. Qasja në Drejtësi	28
3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë	29

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	30
4.1. Shqetësimet kryesore kombëtare	30
4.2. Incidente ose aksidente të mëdha mjedisore	31
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	32
6. Shtojcë	33

Bosnjë e Hercegovinë: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **37**

1. Hyrje	37
2. E drejta materiale dhe praktika	37
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	37
2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare	37
2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit	38
2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare	39
2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin	39
2.2.1. Praktika dhe vendimet gjyqësore	40
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	42
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	42
3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor	42
3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes	43
3.1.3. Të drejtat e tubimit dhe protestës	45
3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre	46
3.2.1. Qasja në drejtësi	46
4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	50
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	52
6. Shtojcë	55

Kosovë*: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **58**

1. Hyrje	58
2. E drejta materiale dhe praktika	58
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	58
2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare	58
2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit	58
2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare	59
2.2. Si zbatohet në praktikë Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin	59
2.2.1. Analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese	59
2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore	60

2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	61
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	62
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	62
3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor	62
3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes	63
3.1.3. Të drejtat e Tubimit dhe Protestës	64
3.2. E drejta e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre	65
3.2.1. Qasja në drejtësi	65
3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë	66
4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	68
4.1. Shqetësimet kryesore kombëtare	68
4.2. Incidente ose aksidente të mëdha mjedisore	68
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	69

Mal i Zi: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **73**

1. Hyrje	73
2. E drejta materiale dhe praktika	73
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	73
2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare	73
2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit:	74
2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare	74
2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin	75
2.2.1. Analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese	75
2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore	75
2.2.3. Mekanizmi për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	76
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	77
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	77
3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor	77
3.1.2. E drejta e tubimit dhe protestës	79
3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre	79
3.2.1. Qasja në drejtësi	79
3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë	80
4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	84
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	85
6. Shtojcë	86

Maqedoni e Veriut: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **96**

1. Hyrje	96
2. E drejta materiale dhe praktika	97
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	97
2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin	100
2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	104
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	105
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	105
3.1.1. Të drejtat e tubimit dhe protestës	106
3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre	106
3.2.1. Qasja në drejtësi	106
3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë	107
4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	108
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	108
6. Shtojcë	110

Serbi: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin **114**

1. Hyrje	114
2. E drejta materiale dhe praktika	114
2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis	114
2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare	114
2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit	115
2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare	116
2.2. Legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin i zbatuar në praktikë	116
2.2.1. Një analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese	116
2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore	119
2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve	121
3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore	121
3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes	121
3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor	121
3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes	122
3.1.3. Të drejtat e tubimit dhe protestës	124
3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre	125
3.2.1. Qasja në drejtësi: legjitimimi dhe qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë	125

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar	127
5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet	128
6. Shtojcë	130
Rekomandimet e përgjithshme	137
1. Përmbledhje e pozicionit në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore, bazuar në studimet bazë kombëtare	137
2. Rekomandime të përgjithshme	138
2.1. Mbrojtja thelbësore	138
2.2. Të drejtat procedurale	138
2.2.1. Qasja në informacion	139
2.2.2. Pjesëmarrja e publikut	139
2.2.3. Qasja në drejtësi dhe mjete juridike	139
2.3. Kapaciteti institucional	140

Përmbledhje ekzekutive

Ndotja në shkallë të gjerë, humbja e biodiversitetit, ndryshimet klimatike dhe dëme të tjera mjedisore kanë ndikim negativ në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë dhe në mbarë planetin tonë. Për pasojë, sot ka një interes të shtuar për mënyrën se si kuadri ligjor i të drejtave të njeriut mund të mbështesë një botë ku lulëzon natyra, ekosistemet dhe njerëzit në përgjithësi. Ky studim, pjesë e projektit rajonal të Këshillit të Evropës mbi "Të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore", vendos bazat për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut në Evropën Juglindore.

Në korrik të vitit 2022, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së njohu të drejtat e njeriut për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, pas njohjes që ju bë këtyre të drejtave nga Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në tetor të vitit 2021. Të drejtat e njeriut për një mjedis të shëndetshëm parashikohen gjithashtu në një sërë traktatesh rajonale për të drejtat e njeriut, marrëveshesh dhe kushtetutash kombëtare në mbarë botën. Këshilli i Evropës i jep përparësi mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut dhe ka miratuar disa instrumente ligjore për mbrojtjen e mjedisit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka gjykuar mbi 300 çështje mjedisore për një gamë të gjerë problemesh, duke filluar nga aktivitetet industriale deri te ndryshimet klimatike, si dhe çështje procedurale si aksesin në informacionin mjedisor dhe regjistrimi i një shoqate mjedisore.

Ky studim bazë, i bazuar në gjashtë raporte me një metodologji të përbashkët, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të legjislacioneve vendase, praktikave gjyqësore dhe politikave në lidhje me të drejtat e njeriut dhe çështjet mjedisore në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Të gjashtë juridiksionet kërkojnë anëtarësimin e tyre në BE dhe janë në procesin e harmonizimit të legjislacionit të tyre mjedisor në përputhje me standardet e BE-së. Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe të të drejtave të njeriut në të gjithë rajonin, studimi bazë thekson praktikën e mira, identifikon sfidat dhe ofron rekomandime specifike për përmirësim si brenda çdo juridiksioni, ashtu edhe në të gjithë rajonin në tërësi.

Sfidat e zakonshme mjedisore të identifikuar në të gjithë rajonin përfshijnë ndotjen e ajrit dhe ujit, hidrocentralet, zhvillimin në zonat e mbrojtura, kërkimin e mineraleve dhe krimin mjedisor. Në përgjithësi, kuadri ligjor duket se mbron mjedisin dhe të drejtat e njeriut në të gjitha juridiksionet, por zbatimi i legjislacionit duhet të forcohet më tej dhe të zbatohet në praktikë. Në disa juridiksione, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është përdorur për të forcuar rezultatet mjedisore në procedurat ligjore. Megjithatë, në juridiksione të tjera, njohja e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është e kufizuar dhe/ose vendimet e gjykatës nuk janë të harmonizuara. Për më tepër, ndërkohë që disa juridiksione respektojnë dhe zbatojnë të drejtat që lidhen me protestat dhe tubimet mjedisore, të tjera përballen me kufizime në rritje ose kanë ndërgjegjësim të pamjaftueshëm të publikut për çështjet mjedisore, duke penguar ushtrimin e këtyre të drejtave. Gjithashtu marrja e informacioneve të përshtatshme mbetet një sfidë për problemet mjedisore dhe proceset e vendimmarrjes. Për më tepër, në disa juridiksione ka shqetësime në rritje për dobësimin e mbrojtjes së mjedisit, për shembull, në lidhje me legjislacionin për zonat e mbrojtura dhe ligjet që rregullojnë pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e kërkimit të mineraleve. Së fundi, gjetjet tregojnë se krimet mjedisore nuk janë raportuar dhe ndjekur penalisht. Sfidat e përbashkëta të identifikuar në të gjithë rajonin nënvizojnë nevojën për një përgjigje të koordinuar, duke përfshirë mësimin dhe shkëmbimet nga kolegët, si brenda rajonit të Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Studimi bazë ofron rekomandime të përgjithshme për rajonin bazuar në përfundimet e raporteve individuale në çdo juridiksion. Këto rekomandime përfshijnë kërkesat që e drejta për një mjedis të shëndetshëm të mbrohet në mënyrë të shprehur brenda kushtetutave vendase dhe legjislacionit mbështetës, me mbikëqyrjen e zbatimit të tij nga Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, rekomandohet që ligjet e ndryshme kombëtare që janë kontradiktore të harmonizohen në favor të rezultateve më të forta mjedisore dhe të të drejtave të njeriut. Më tej, rekomandimet e

* Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst do të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Bashkuar Kombëtar dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës.

përgjithshme nënvizojnë rëndësinë e aksesit në kohë dhe efektiv të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në çështjet mjedisore, duke sugjeruar që lista kontrolli t'u ofrohen institucioneve publike për të kontrolluar zbatimin e të drejtave në këto fusha. Për të mbështetur të drejtën e aksesit në drejtësi dhe mjete juridike, rekomandimet e përgjithshme theksojnë nevojën për një përkufizim të gjerë të statusit, masa për të mbrojtur kundër kostove të tepërta ligjore, hetim të plotë të rasteve mjedisore dhe përgatitjen e vendimeve të arsyetuara mirë. Ata gjithashtu theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut në Mjedis dhe ofrimit të mjeteve juridike efektive për dëmtimin mjedisor. Së fundi, rekomandimet theksojnë rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve institucionale, duke përfshirë koordinimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve qeveritare, si dhe ndërmjet niveleve qendrore dhe vendore të qeverisjes. Krahas kësaj, si rekomandime të përgjithshme theksohen trajnimet e duhura ligjore, fushatat e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me të drejtat mjedisore dhe financimi i mjaftueshëm i organeve publike mjedisore.

Megjithëse studimi fokusohet në Evropën Juglindore, sfidat dhe rekomandimet e identifikuara mund të jenë të rëndësishme përtej rajonit. Duke theksuar vlerën dhe efektivitetin e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, shpresohet se gjetjet e tij do të mbështesin përmirësimet konkrete mjedisore në terren.

Mbrojtja e mjedisit dhe e të drejtave të njeriut sipas Kornizave Ndërkombëtare dhe Evropiane

Ndotja, humbja e biodiversitetit, ndryshimet klimatike dhe faktorë të tjerë mjedisorë kanë ndikim të konsiderueshëm në gëzimin e të drejtave të njeriut në Evropë dhe në mbarë botën. Ky seksion shqyrton mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtave të njeriut në nivelin ndërkombëtar, përpara se të vazhdojë të eksplorojë kuadrin evropian dhe propozimet për një instrument të ri të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin.

1. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e mjedisit në nivelin ndërkombëtar

1.1. Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe forumet ndërkombëtare

Lidhjet midis mjedisit dhe të drejtave të njeriut janë krijuar për mjaft kohë në traktatet dhe praktikën ndërkombëtare dhe vazhdojnë të zhvillohen me shpejtësi.¹ Më 8 tetor 2021, Këshilli për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) njohu të drejtën e njeriut për «mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm» (DMSH) si dhe implikimet e dëmtimit mjedisor për gëzimin e të drejtave të njeriut.² Kjo u pasua me një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila gjithashtu njeh DMSH-në në kushte të ngjashme, me 161 shtete që votuan pro (përfshirë të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës) dhe asnjë nuk votoi kundër.³ Kohët e fundit, KDNJ-ja ka miratuar një rezolutë të mëtejshme për DMSH-në, duke u bërë thirrje shteteve të miratojnë dhe zbatojnë ligje për qasjen në informacionin mjedisor dhe pjesëmarrjen, si dhe qasjen në drejtësi dhe mjete juridike, duke siguruar gjithashtu një kuadër ligjor efektiv për zbatimin e DMSH-së.⁴

Përveç kësaj, lidhjet ndërmjet të drejtave të njeriut dhe mjedisit reflektohen në kornizat ligjore mjedisore. Për shembull, Marrëveshja e Parisit, e miratuar në COP 21 të Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), përcakton në preambulën e saj se «[p]alët duhet, kur ndërmarrin veprime për të adresuar ndryshimet klimatike, të respektojnë, promovojnë dhe marrin parasysh detyrimet e tyre përkatëse për të drejtat e njeriut».⁵ Kuadri Botëror i Biodiversitetit Kunming-Montreal (GBF), i miratuar në COP 15 të Konventës për Diversitetin Biologjik, njeh DMSH-në dhe parashikon që palët duhet të ndjekin një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, «duke respektuar, mbrojtur dhe përbushur të drejtat e njeriut» në zbatimin e GBF-së.⁶

Procedurat e Posaçme janë përdorur në shqyrtimin e gjerë të përmbajtjes së DMSH-së. Në vitin 2018, Raportuesi Special i OKB-së për të Drejtat e Njeriut për një Mjedis të Shëndetshëm prezantoi Parimet Kuadër për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin, të cilat përmbajnë njohuritë e Raportuesit Special për “detyrimet themelore të shteteve sipas legjislationit të të drejtave të njeriut, që lidhen me gëzimin e një mjedisi të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm”⁷ Përveç kësaj,

1 Shih për shembull Deklaratën e Stokholmit të vitit 1972 <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/nl7/300/05/pdf/nl730005.pdf?token=9IQbR9u3VNKNZeoAvz&fe=true> dhe Deklaratën e Rios në Samitin për Tokën e vitit 1992 https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/generalassembly/docs/globalcompact/A_CONF.151_26_Vol.I_Declaration.pdf

2 Rezoluta e OKB-së për KDNJ, E drejta e njeriut për mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, 4 prill 2023 A/HRC/48/13

3 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, E drejta e njeriut për mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, 26 korrik 2022, A/RES/76/300.

4 Rezoluta e OKB-së për KDNJ, E drejta e njeriut për mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, 4 prill 2023, A/HRC/52/7.

5 Marrëveshja e Parisit për Konventën Kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, 12 dhjetor 2015, T.I.A.S. Nr. 16-1104, Preambulë

6 Vendimi 1/COP.15: Kuadri Global i Biodiversitetit Kunming-Montreal, CBD/COP/15/L.25 Seksioni C 7(g)

7 Raporti i Raportuesit Special për çështjen e detyrimeve të të drejtave të njeriut në lidhje me gëzimin e një mjedisi të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, dok. i OKB-së A/HRC/37/59 (2018), parag. 1.

në një raport mbi praktikën e mira, Raportuesi Special ka përcaktuar komponentët e DMSH-së.⁸ Elementët thelbësorë përfshijnë ajrin e pastër, një klimë të sigurt dhe të qëndrueshme, qasjen në ujë të sigurt dhe kanalizime të përshtatshme, ushqim të shëndetshëm dhe të prodhuar në mënyrë të qëndrueshme; mjedisë jo toksike në të cilat mund të jetohet, punohet dhe luhet; dhe biodiversitet dhe ekosisteme të shëndetshme. Për më tepër, DMSH-ja mbulon komponentët proceduralë të qasjes në informacion, pjesëmarrjes, qasjes në drejtësi dhe mjeteve juridike efektive - duke përfshirë të qenit i lirë nga hakmarrja dhe ndëshkimi në ushtrimin e të drejtave të tjera.

Përveç kësaj, organet e Traktatit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut janë angazhuar në ekzaminime të shumta dhe të hollësishme të marrëdhënies ndërmjet të drejtave të njeriut dhe çështjeve mjedisore. Kjo ka përfshirë dëgjimin e një sërë ankesash për çështje që nga spërkatja toksike e agrokimikateve deri te ndikimet e ndryshimeve klimatike te popujt indigjenë.⁹ Organet e traktatit kanë elaboruar gjithashtu këtë marrëdhënie në Komentet e Përgjithshme. Për shembull, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës ka gjetur se "[f]ëmijët kanë të drejtë për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm".¹⁰ Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se, për të mbrojtur të drejtën për jetë, shtetet duhet të ndërmarrin masa «për të ruajtur mjedisin dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi, ndotja dhe ndryshimet klimatike të shkaktuara nga aktorët publikë dhe privatë».¹¹ Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 26 mbi të Drejtat e Tokës, Eekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 2022, Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vendosi se "përdorimi i qëndrueshëm i tokës është thelbësor për të garantuar të drejtën për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm dhe për të promovuar të drejtën për zhvillim, ndër të drejtat e tjera". Po kështu, Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave publikoi Rekomandimin e tij të Përgjithshëm nr. 39 në vitin 2022, duke rekomanduar që shtetet "të [m]iratojnë legjislacionin për të garantuar plotësisht të drejtat e grave dhe vajzave indigjene për tokë, ujë dhe burime të tjera natyrore, duke përfshirë të drejtën e tyre për mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm."

Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (UNGP) ofrojnë udhëzime kyçe mbi përgjegjësitë e bizneseve për të drejtat e njeriut. Këto fokusohen në 1) përgjegjësinë shtetërore për të mbrojtur të drejtat e njeriut, 2) përgjegjësinë e korporatës për të mbrojtur të drejtat e njeriut (përfshirë përmes kujdesit të duhur) dhe 3) përgjegjësinë shtetërore dhe të korporatës për të ofruar qasje në mjete juridike. Më tej, udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për Ndërmarrjet Shumëkombëshe për Biznes të Përgjegjshëm trajtojnë rëndësinë e kujdesit të duhur për të vlerësuar ndikimet mjedisore dhe të të drejtave të njeriut që lidhen me operacionet, produktet dhe shërbimet. Shtetet që i përmbahen udhëzimeve u kërkohet të krijojnë Pika Kombëtare të Kontaktit si mekanizma (jo gjyqësore) ankesash.

Marrëdhënia ndërmjet të drejtave të njeriut dhe detyrimeve mjedisore po shqyrtohet gjithashtu në mënyrë aktive nga forumet gjyqësore ndërkombëtare. Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit dha kohët e fundit një opinion këshillues duke vënë në dukje se ndryshimi i klimës «përbën kërcënim ekzistencial dhe ngre shqetësime për të drejtat e njeriut».¹² Në një kërkesë për një opinion këshillues nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i është kërkuar gjithashtu të marrë në konsideratë detyrimet e të drejtave të njeriut në kontekstin e ndryshimeve klimatike.¹³

8 David Boyd (Raportuesi Special për çështjen e detyrimeve të të drejtave të njeriut në lidhje me gëzimin e një mjedisi të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm), *E drejta për një mjedis të shëndetshëm: praktika të mira*, dok. i OKB-së A/HRC/43/53, 30 dhjetor 2019, paragraf. 8-18 <https://www.ohchr.org/en/special-procedures/sr-environment/good-practices-right-healthy-environment>

9 Shih paragraf. 45 të raportit të KDDNJ-së për një përmbledhje të këtyre ankesave.

10 Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 26 mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Mjedisin.

11 Shih Komentin e Përgjithshëm Nr. 36 të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, paragraf. 62.

12 Tribunali Ndërkombëtar për të Drejtën e Detit, Opinion Këshillues, 21 maj 2024, https://www.itlos.org/fileadmin/itlos/documents/cases/31/Advisory_Opinion/C31_Adv_Op_21.05.2024_orig.pdf

13 Shih rezolutën A/77/276, të miratuar me konsensus <https://documents.un.org/doc/undoc/ltid/n23/094/52/pdf/n2309452.pdf?token=dhVrmVpLUBCTH5Yczm&fe=true>

1.2. Mbrojtja në nivelin rajonal dhe kombëtar

Në nivelin rajonal, traktatet që njohin DMSH-në përfshijnë Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve; Karta Arabe për të Drejtat e Njeriut; Konventa për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Konventa e Aarhusit); Protokollin e San Salvadorit për Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut; dhe Marrëveshja Escazú. Gjithashtu, DMSH-ja është marrë parasysh nga organet gjyqësore të këtyre traktateve; për shembull, Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (GJNADNJ) ka vendosur se e drejta është e drejtë «autonome» dhe kështu «mbron përbërësit e mjedisit, si pyjet, lumenjtë dhe detet, si interesa ligjore në vetvete, edhe në mungesë të sigurisë ose provave të një rreziku për individët».¹⁴ GJNADNJ-ja pritet gjithashtu të japë një opinion këshillues mbi ndryshimet klimatike dhe detyrat e të drejtave të njeriut gjatë vitit 2025.¹⁵

Në nivelin kombëtar, 156 vende ose 80% e shteteve anëtare të OKB-së, e kanë njohur gjithashtu DMSH-në përmes kornizave ligjore kombëtare dhe rajonale. Kjo përfshin shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, disa prej të cilave e kanë njohur DMSH-në në nivel kushtetues.

Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (nëntor 2020) përcakton gjithashtu një Agjendë të Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, që mbulon ndryshimet klimatike, ekonominë qarkore, ndotjen, bujqësinë dhe biodiversitetin.¹⁶

2. Këshilli i Evropës

Mbrojtja e mjedisit dhe e të drejtave të njeriut është prioritet kyç për Këshillin e Evropës, i cili ka miratuar disa instrumente ligjore për mbrojtjen e mjedisit. Këto përfshijnë Konventën e vitit 1979 për Ruajtjen e Kafshëve të Egra Evropiane dhe Habiteteve Natyrore (Konventa e Bernës), Konventën e Peizazhit të vitit 2008, Konventën e vitit 1993 mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet që vijnë nga Aktivitetet e Rrezikshme për Mjedisin.¹⁷ Përveç këtyre, Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsø) është i vetmi instrument ligjor ndërkombëtar për të garantuar të drejtën e përgjithshme për të pasur qasje në dokumentet zyrtare të mbajtura nga autoritetet publike, duke përfshirë çështjet mjedisore.¹⁸

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ishte konventa e parë e Këshillit të Evropës, e cila është e detyrueshme për tu ratifikuar që t'i bashkohesh organizatës. As KEDNJ dhe as Karta Sociale Evropiane (KSE) nuk përmbajnë parashikime specifike për mbrojtjen mjedisore. Megjithatë, konkluzionet e Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale (KEDS) dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) kanë trajtuar ndikimin që dëmi dhe dëmtimi i mjedisit kanë në të drejtat e njeriut.

2.1. Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

GJEDNJ ka dëgjuar mbi 300 raste në lidhje me çështjet mjedisore.¹⁹

- Aktivitetet e rrezikshme industriale, rrezatimi bërthamor dhe fatkeqësitë natyrore janë tra-

14 Opinion Këshillues OC-23/17 ('Mjedisi dhe të Drejtat e Njeriut'), Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut Seria A nr. 23, 15 nëntor 2017, paragrafi 62 https://www.corteidh.or.cr/docs/opiniones/seriea_23_ing.pdf

15 Kërkesë për një opinion këshillues mbi Emergjencën Klimatike dhe të Drejtat e Njeriut dorëzuar në Gjykatën Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut nga Republika e Kolumbisë dhe Republika e Kilit, https://www.corteidh.or.cr/docs/opiniones/soc_1_2023_en.pdf, dhe seancat dëgjimore publike: <https://www.youtube.com/watch?v=t6D9LyXKSOE>

16 Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, 10 nëntor 2020, <https://www.rcc.int/docs/546/sofia-declaration-on-the-green-agenda-for-the-western-balkans-rn>

17 ETS nr. 104; 176, 102 dhe 150 respektivisht, shih më tej paragrafin 3 të projektraportit të rishikuar të KDDNJ-së mbi nevojën dhe fizibilitetin e një instrumenti ose instrumentesh të mëtejshme për të drejtat e njeriut dhe mjedisin ('raport i KDDNJ-së') <https://rm.coe.int/steering-committee-for-human-rights-cddh-drafting-group-on-human-right/1680afa8ee>

18 CETS nr. 205, Konventa aktualisht ka 15 palë.

19 Shih https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Environment_ENG për detaje të mëtejshme.

Ashtu si KEDNJ, KSE-ja konsiderohet gjithashtu instrument i gjallë, që do të thotë se KEDS-ja, ngjashëm me GJEDNJ-në, mund t'i përgjigjet sfidave të reja nëpërmjet interpretimit të saj. Sipas KSE-së, të drejtat e konsideruara në lidhje me DMSH-në përfshijnë të drejtat për kushte të drejta pune dhe kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune, si dhe mbrojtje të shëndetit dhe banimit. KEDS-ja ka konstatuar se sistemet e shëndetit publik duhet t'i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme rreziqeve që mund të kontrollohen nga veprimet njerëzore, duke përfshirë kërcënimet mjedisore.

Për të mbështetur të kuptuarit e zhvillimeve në këtë fushë, vendimet dhe konkluzionet sipas KEDNJ-së dhe KSE-së konsiderohen në detaje në një Manual të krijuar nga Këshilli i Evropës.²⁸ Udhëzuesi i praktikës gjyqësore të Gjykatës për mjedisin përditësohet çdo vit dhe kursi i Edukimit për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP) për mjedisin dhe të drejtat e njeriut, ka filluar që nga viti 2021.²⁹

2.2. Zhvillimi i Kornizës së të Drejtave të Njeriut dhe Mjedisit të Këshillit të Evropës

2.2.1. E drejta për një mjedis të shëndetshëm

Këshilli i Evropës nuk e ka njohur DMSH-në. Megjithatë, presidencat e Komitetit të Ministrave dhe organet e tjera brenda Këshillit të Evropës kanë kërkuar forcimin e mjeteve për të trajtuar dëmet mjedisore. Që nga viti 1970, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka bërë një sërë përpjekjesh për të propozuar një Protokoll Shtesë ndaj KEDNJ-së për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin.³⁰ Në rekomandimin CM/Rec(2022)20, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës u bën thirrje shteteve anëtare të «reflektojnë mbi natyrën, përmbajtjen dhe implikimet» e DMSH-së dhe, mbi këtë bazë, të konsiderojnë në mënyrë aktive njohjen e saj në nivel kombëtar «si një e drejtë e njeriut që është e rëndësishme për gëzimin e të drejtave të njeriut dhe lidhet me të drejtat e tjera dhe të drejtën ndërkombëtare ekzistuese».³¹ Pas këtyre përpjekjeve, Komiteti i Ministrave i kërkoi Komitetit Drejtues për të Drejtat e Njeriut (KDDNJ) të shqyrtojë nevojën dhe realizueshmërinë e një instrumenti ose instrumentesh të mëtejshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe mjedisit. Studimi i KDDNJ³² në këtë fushë u finalizua në nëntor 2024.

Këshilli i Evropës ka dhënë gjithashtu rekomandime për tema specifike që përfshihen në ombrellën e ndryshimeve klimatike dhe të drejtave të njeriut. Për shembull, rekomandimi CM/Rec(2024)2 për kundërshtimin/luftën e përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes së Publikut (PSKPP) përcakton një listë jo shteruese të treguesve për të identifikuar PSKPP-të, si dhe përcakton masat mbrojtëse ligjore dhe të politikave dhe mjetet juridike në këtë fushë.³³ Rekomandimi CM/Rec (2024)6, lidhur me të rinjtë dhe veprimin ndaj klimës, është teksti i parë ndërkombëtar i natyrës së tij. Ai synon të mbrojë të drejtat e të rinjve dhe mbrojtësve të rinj të mjedisit për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe aktivizmit të lidhura me klimën, si dhe të kenë qasje në

28 Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (KDDNJ), Manuali për të Drejtat e Njeriut dhe Mjedisin (botimi i 3-të), shkurt 2022, <https://www.coe.int/en/web/human-rights-intergovernmental-cooperation/-/manual-on-human-rights-and-the-environment>

29 Kursi HELP për Mjedisin dhe të Drejtat e Njeriut, <https://help.elearning.ext.coe.int/enrol/index.php?id=6264>

30 Përpjekje të mëvonshme u bënë në vitet 1990, 1999, 2003 dhe 2009 dhe të tjera kohët e fundit. Shih PACE. 1999. Rekomandimi 1431: Veprimi i ardhshëm që do të ndërmerret nga Këshilli i Evropës në fushën e mbrojtjes së mjedisit; PACE. 2003. Rekomandimi 1614: Mjedis dhe të drejtat e njeriut; PACE 2009. Rekomandimi 1885: Hartimi i një protokollit shtesë për KEDNJ lidhur me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm; Rekomandimi i PACE 2211 (2021): Përcaktimi/Themelimi i të drejtave për mjedis të shëndetshëm: Nevoja për veprim të zgjeruar nga Këshilli i Evropës.

31 Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/Rec(2022)20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit*, 27 shtator 2022, <https://rm.coe.int/0900001680a83df1>

32 Studimi i KDDNJ mbi nevojën dhe realizueshmërinë e një instrumenti ose instrumentesh të mëtejshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe mjedisit, Shtojca 2, KDDNJ(2024)R101, 29/11/2024, <https://rm.coe.int/steering-committee-for-human-rights-cddh-cddh-study-on-the-need-for-an/1680b2b196>

33 Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Luftën/ Kundërshtimin e Përdorimit të Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes së Publikut (PSKPP)*, 5 prill 2024, <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/-/council-of-europe-adopts-recommendation-on-countering-the-use-of-slapps>

edukimin për klimën dhe punët e gjelbra, mes çështjeve të tjera.³⁴

2.2.2. Mbrojtja e Mjedisit sipas Legjislacionit Penal Evropian

Krimi mjedisor po rritet me 2-3 herë më shumë se ritmi i ekonomisë globale, me ndikime negative në shëndet, mirëqenie dhe sigurinë ushqimore. Ai krijon ndotje dhe dëme industriale, duke kontribuar në degradimin e burimeve natyrore dhe në prishjen e klimës. Duke pasur dimensione globale dhe sistematike, ai është i lidhur me krime të tjera të rënda si trafikimi i njerëzve dhe drogës, falsifikimi, krimi kibernetik, korrupsioni dhe financimi i terrorizmit.

Si përgjigje, një Komitet Ekspertësh për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Legjislacionit Penal (PC-ENV) është ngritur dhe është ngarkuar me zhvillimin e një Konvente për Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet Legjislacionit Penal, për t'u zbatuar si një Kuadër Pan-Evropian.³⁵ Konventa e re do të jetë një instrument ligjor i detyrueshëm, që synon të kontribuojë në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe ndotjes, si dhe të mbështesë biodiversitetin dhe ekosistemet. Krahas kësaj, Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë ka miratuar Opininion nr. 17 (Opinion) për rolin e prokurorëve në mbrojtjen e mjedisit.

Opinionit thekson rolin kyç të prokurorëve në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë publike, duke përcaktuar udhëzime dhe rekomandime për veprim në procedura penale, administrative dhe civile në çështjet mjedisore. Ai thekson nevojën për të forcuar kornizën ligjore kombëtare përkatëse, për shembull duke përfshirë përfshirjen e krimit të organizuar ose korrupsionit si një rrethanë rënduese në veprat penale. Opinioni mbulon hetimet dhe ndjekjet penale, aspektet institucionale dhe bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet disiplinave dhe strukturave. Theksohet gjithashtu rëndësia e grupeve joqeveritare të interesit dhe të shoqërisë civile. Më tej, Opinioni thekson se lidhja e krimeve mjedisore me çdo vepër penale të lidhur me pastrimin e parave mund të jetë një mjet efektiv për të identifikuar rrjetet më të mëdha kriminale dhe për të kufizuar përfitimin nga krime të tilla. Për më tepër, ai bën thirrje që kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar për çështje mjedisore t'u jepet i njëjti prioritet dhe vëmendje si çështjeve kombëtare, duke vënë në dukje rëndësinë e krijimit të mekanizmave dhe procedurave për të mundësuar kryerjen e hetimeve ndërkufitare.

2.2.3. Biznesi dhe të drejtat e njeriut

Duke u mbështetur në UNGP, rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec (2016) për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut synon të ofrojë udhëzime për shtetet anëtare për parandalimin dhe korrigjimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut nga sipërmarrjet e biznesit dhe masat për të inkurajuar bizneset të respektojnë të drejtat e njeriut.³⁶ Rekomandimi shtjellon të drejtën për mejte juridike efektive dhe thekson mbrojtjen shpesh të nevojshme për punëtorët, fëmijët, popujt indigjenë dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

3. Korniza të tjera kyçe në nivelin rajonal evropian

3.1. Bashkimi Evropian

Mbi gjysma e anëtarëve të Këshillit të Evropës janë gjithashtu anëtarë të Bashkimit Evropian

34 Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/Rec(2024)6 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për të rinjtë dhe veprimin ndaj klimës*, 23 tetor 2024, <https://www.coe.int/en/web/portal/-/council-of-europe-urges-measures-for-young-people-and-climate-action-investing-in-green-jobs-and-skills-addressing-eco-anxiety-access-to-rights-for-vulnerable-groups>

35 Ndonëse Këshilli i Evropës përgatiti një instrument ligjor në këtë fushë: Konventën e vitit 1998 për Mbrojtjen e Mjedisit Përmes Legjislacionit Penal, kjo nuk ka hyrë në fuqi dhe do të zëvendësohet nga Konventa që po përgatitet aktualisht.

36 Këshilli i Evropës, *Rekomandimi CM/Rec(2016)3 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për të drejtat e njeriut dhe biznesin*, 2 mars 2016, <https://search.coe.int/cm?i=09000016805c1ad4>

(BE). Megjithëse asnjë nga juridiksionet në këtë studim nuk është ende anëtare e BE-së, ato janë të gjitha kandidatë për anëtarësim dhe për rrjedhojë janë në proces të harmonizimit të legjislacionit të tyre mjedisor me atë të BE-së, si pjesë e procesit të anëtarësimit.

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton një sërë parimesh dhe objektivash mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe Karta e të Drejtave Themelore të BE-së thotë se një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit duhet të integrohet në politikat në nivel të BE-së.³⁷ Gjykata e Drejtësisë e BE-së ka vendosur për rreth 50 raste që kanë të bëjnë me qasjen në drejtësi në çështjet mjedisore, duke përfshirë konfirmimin se OJQ-të duhet të kenë legjitimitet për të vepruar në çështjet mjedisore. Ajo gjithashtu ka miratuar një gamë të gjerë legjislacionesh mjedisore, duke përfshirë direktivat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor, të cilat paraqesin konsultimin publik si një aspekt qendror.³⁸ BE-ja miratoi së fundi një Rregullore për Restaurimin e Natyrës me objektiva për të mbuluar të paktën 20% të zonave tokësore dhe detare të BE-së deri në vitin 2030 dhe të gjitha ekosistemet që kanë nevojë për restaurim deri në vitin 2050.³⁹

Direktiva e BE-së për Raportimin Jo-Financiar kërkon që kompanitë të ofrojnë informacione jo-financiare, duke përfshirë mjedisin dhe të drejtat e njeriut, në raportet e tyre financiare ose në dosje të veçanta. Në janar 2023 hyri në fuqi Direktiva e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSRD), duke forcuar rregullat për raportimin mjedisor dhe social dhe duke i zbatuar ato në një gamë më të gjerë kompanish.⁴⁰ Në maj 2024, hyri në fuqi Direktiva e Kujdesit të Duhur të Qëndrueshmërisë së Korporatave (CSDD). Kjo paraqet detyrime për kompanitë në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe përgjegjësinë për shkëlqjen e këtyre detyrimeve, duke përfshirë filialet e kompanive dhe partnerët e biznesit.⁴¹

Direktivat e BE-së gjithashtu mbrojnë mjedisin përmes legjislacionit penal.⁴² Në mars 2024, Këshilli i BE-së miratoi zyrtarisht një direktivë të re për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, duke vendosur rregullat minimale të BE-së për përcaktimin e krimeve dhe dënimeve mjedisore.⁴³ Direktiva prezanton vepra të reja penale të lidhura me mjedisin, me kërkesa të detajuara për sanksionet si për individët ashtu edhe për kompanitë dhe masat që duhen marrë për të parandaluar ose ndjekur penalisht në mënyrë efektive veprat penale. Ajo parashikon shkëlqje më të rënda në rastin e «Ekocidit».⁴⁴

37 Shih për shembull. Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian neni 191 dhe neni 37 i Kartës së të Drejtave Themelore

38 Shih <https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/71/environment-policy-general-principles-and-basic-framework#:~:text=Legal%20basis,waste%20management%20and%20climate%20change> për një përshkrim të përgjithshëm të kornizës mjedisore të BE-së.

39 Bashkimi Evropian, Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për restaurimin e natyrës dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2022/869, 15 mars 2024, <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-74-INIT/enpdf>

40 Direktiva (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 dhjetor 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 537/2014, Direktiva 2004/109/EC, Direktiva 2006/43/EC dhe Direktiva 2013/34/EU, në lidhje me raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave (Tekst me rëndësi për ZEE), L 322/15, 16.12.2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32022L2464>

41 Rastet kundër kompanive gjithashtu kanë filluar të ngrihen brenda rajonit të BE-së, për shembull Royal Dutch Shell aktualisht po apelon një vendim nga një gjykatë holandeze se kontributi i saj në ndryshimin klimatik po shkel detyrimet e saj për të drejtat e njeriut dhe detyrën e kujdesit sipas ligjit holandez <https://climatecasechart.com/non-us-case/milieudefensie-et-al-v-royal-dutch-shell-plc/>

42 Shih për shembull Direktivën 2008/99/EC, Direktivën 2005/33/EC, Rregulloren (EC) nr. 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2006 mbi dërgesat e mbetjeve

43 Direktiva (BE) 2024/1203 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 prill 2024 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal dhe që zëvendëson Direktivat 2008/99/EC dhe 2009/123/EC, OJ L, 2024/1203, 30.4.2024 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32024L1203>

44 Ekocidi përkufizohet si "(a) shkatërrimi ose dëmtimi i përhapur dhe sistematik, i cili është ose i pakthyeshëm ose afatgjatë për një ekosistem me përmasa të konsiderueshme ose vlerë mjedisore ose një habitat brenda një zone të mbrojtur, ose (b) dëmtimi i përhapur dhe i konsiderueshëm që zgjat gjatë në cilësinë e ajrit, tokës ose ujit"

3.2. Konventa e Aarhusit⁴⁵

Palët në Konventën e Aarhusit përfshijnë 41 nga 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa e Aarhusit lidh të drejtat mjedisore dhe të njeriut duke mbrojtur të drejtat për të pasur qasje në informacionin mjedisor, për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore dhe për të pasur qasur në drejtësinë në çështjet mjedisore dhe duke vendosur standarde minimale në këto fusha. Konventa e Aarhusit ishte traktati i parë ndërkombëtar që njohu të drejtat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm për një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre.⁴⁶ Ishte gjithashtu marrëveshja e parë shumëpalëshe mjedisore që i dha publikut të drejtën për të paraqitur ankesa përpara Komitetit të tij të Përputhshmërisë dhe gjithashtu ka krijuar mekanizmin e parë të reagimit të shpejtë në botë për të mbrojtur mbrojtësit e mjedisit.⁴⁷ Konventa e Aarhusit ishte një frymëzim për Marrëveshjen Escazú në Amerikën Latine dhe Karaibe.⁴⁸

45 Aktualisht, palët në Konventën e Aarhusit janë kryesisht nga rajoni evropian dhe i Azisë Qendrore, por tani ajo është e hapur për ratifikimin nga të gjitha shtetet dhe është ratifikuar nga Guinea-Bissau.

46 Shih nenin 1.

47 Komiteti i Pajtushmërisë ka marrë 200 komunikime nga publiku, një shenjë e fortë e angazhimit të publikut.

48 Marrëveshja Rajonale për Qasje në Informacion, Pjesëmarrje të Publikut dhe Drejtësi në Çështjet Mjedisore në Amerikën Latine dhe Karaibe, Escazú, 4 mars 2018, <https://www.cepal.org/en/escazuagreement>

Shqipëri: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

1. Hyrje

Shqipëria u anëtarësua në Këshillin e Evropës më 13 korrik 1995, ndërsa KEDNJ hyri në fuqi në Shqipëri më 2 tetor 1996. Aktualisht, Shqipëria e konsideron anëtarësimin në BE si objektivin kryesor të politikës së saj të jashtme. Në fazën aktuale të procesit të integritimit, në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), detyrimet e Shqipërisë në lidhje me mjedisin përcaktohen në nenin 108 të saj, i cili parashikon se *“Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në detyrën jetike të luftës kundër degradimit mjedisor, me synimin e promovimit të qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e mjedisit.”*⁴⁹

Këshilli i BE-së përshëndeti progresin e Shqipërisë në sundimin e ligjit dhe zbatimin e vazhdueshëm të reformave në sistemin e drejtësisë dhe administratën publike, si dhe progresin e bërë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke nënvizuar nevojën për të forcuar më tej mbrojtjen e të drejtave themelore.⁵⁰ Vlerësimi i Kapitullit 27 mbi “Mjedisin dhe ndryshimet klimatike” tregoi se Shqipëria duhet ende të shtojë përpjekjet e saj për të arritur harmonizimin dhe zbatimin e plotë në shumicën e fushave. Proceset e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) duhet të përmirësohen ndjeshëm, ndërkohë që rekomandimet nga VNM-të zbatohen rrallë dhe ato duhet të zbatohen dhe më pas të monitorohen. Pjesëmarrja e publikut dhe konsultimi në vendimmarrje duhet të përmirësohet. Për më tepër, inspektimet dhe kapacitetet e zbatimit duhet të forcohen, veçanërisht për të trajtuar në mënyrë më efektive krimet mjedisore.⁵¹

2. E drejta materiale dhe praktika

2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis

2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare

Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 miratoi parimin themelor të së drejtës së qasjes së publikut në informacion, për çështje që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij, por nuk përfshiu të drejtat e pjesëmarrjes dhe qasjes në drejtësi nga Konventa e Aarhusit. E drejta për mjedis të shëndetshëm nuk parashikohet si e drejtë më vete, në kuptimin përmbajtësor. Neni 56 i Kushtetutës së Shqipërisë përmban vetëm një të drejtë procedurale dhe garanton të drejtën e informimit mjedisor, ndërsa

49 Neni 108, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, dhe Republikës së Shqipërisë, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, L 107/166, 28 prill 2009, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A22009A0428%2802%29>.

50 Raporti i Komisionit Evropian, *Shqipëri 2024*, Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, 30 tetor 2024, SWD(2024) 690 final, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

51 Dokument pune i stafit të Komisionit, Raporti Shqipëri 2023, f.119. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

neni 59 përcakton objektivat shoqërore.⁵² Kjo do të thotë se këto objektiva duhet të pasqyrohen në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit përkatës, por nuk janë të zbatueshme në gjykatë, sepse paragrafi i dytë i nenit 59 parashikon “2. Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.”

Për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut, neni 17 i Kushtetutës e bën KEDNJ-në pjesë të legjislacionit të brendshëm shqiptar dhe e konsideron nivelin e mbrojtjes që ofron, si standardin minimal të garantuar nga legjislacioni shqiptar.⁵³ Kjo duhet lexuar bashkë me nenin 122 të Kushtetutës, i cili parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk përputhen me to.⁵⁴

2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit

Në lidhje me të drejtën e informimit, kuadri ligjor në përgjithësi është i plotë, duke përfshirë informacionin për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra. Ky kuadër ligjor përbëhet nga Ligji nr. 10431, datë 9 qershor 2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili përcakton të drejtën për t’u informuar në kohë për gjendjen e mjedisit, dispozitat për sistemin e informacionit mjedisor, informimin e publikut për çështjet mjedisore, të drejtën e informacionit mjedisor;⁵⁵ të drejtën për të ndërmarrë veprime juridike në gjykatë kundër autoritetit publik ose personit fizik ose juridik, që i ka shkaktuar dëm mjedisit ose rrezikon ta dëmtojë atë;⁵⁶ parashikon përgjegjësinë për dëmin mjedisor dhe kompensimin për dëmin mjedisor.⁵⁷ Së bashku me Ligjin nr. 119/2014, datë 18 shtator 2014, “Për të drejtën e informimit”,⁵⁸ ato garantojnë shtyllën e parë të Konventës së Aarhusit në lidhje me qasjen në informacionin mjedisor.

Shtylla e dytë e Konventës së Aarhusit në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, garantohet me disa ligje. Ligji nr. 10440, datë 7 korrik 2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (Ligji për VNM) synon të garantojë një proces të hapur vendimmarrjeje dhe përfshirjen e të gjithë palëve të interesit në proces; duke përfshirë publikun dhe organizatat jofitimprurëse. Ai detyron Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të organizojë seanca dëgjimore me publikun dhe OJQ-të e interesuara, për të marrë mendimin e tyre si pjesë e procesit të vendimmarrjes.⁵⁹ Rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore përcaktohen

52 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nen. 56: “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”. Nen. 59: “Shteti, brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon të plotësojë iniciativën dhe përgjegjësinë private me: një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dhe shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.” https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download_send&id=178&catid=9&m=0

53 Po aty, nen. 17: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

54 Po aty, nen. 122: “1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë. 2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. 3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”

55 Ligji nr. 10431, datë 9 qershor 2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”. https://akm.gov.al/ova_doc/ligji-10431-date-9-6-2011-per-mbrojtjen-e-mjedisit/

56 Po aty, neni 48.

57 Po aty, neni 50-52.

58 Ligji nr. 119/2014, datë 18 shtator 2014, “Për të drejtën e informimit”. https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download_send&id=165&catid=55&m=0

59 Ligji nr. 10440, datë 7 korrik 2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. https://akm.gov.al/ova_doc/ligjit-nr-10440-date-07-07-2011-per-vleresimin-e-ndikimit-ne-mjedis/

me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 247, datë 30.04.2014.⁶⁰ Megjithatë, në Ligjin për VNM-në nuk parashikohet një kërkesë e qartë që lejet e zhvillimit për projektet të përfshijnë konkluzionet e VNM-së, kushtet mjedisore, si dhe masat shoqëruese dhe protokollet e monitorimit. Mungon legjislacioni dytësor i nevojshëm për zbatimin e duhur të VNM-së,⁶¹ pavarësisht miratimit të një akti nënligjor për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe afateve për procedurën e VNM-së.⁶² Ligji për VNM, së bashku me ligjin nr. 146/2014, datë 30 tetor 2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, garantojnë shtyllën e dytë të Konventës së Aarhusit. Ligji nr. 146/2014 rregullon procesin e njoftimit të publikut për projektligjet dhe dokumentet e tjera strategjike kombëtare dhe lokale. Komisioneri për të Drejtën e Informimit pranon ankesat për refuzimin e qasjes në informacion, ndërkohë që në çdo institucion publik ekziston një Koordinator për Konsultim Publik. Një regjistër elektronik përfshin informacion për të gjitha aktet e planifikuara dhe dokumentet përkatëse për seancat e planifikuara publike.⁶³

Ligji nr. 91/2013, datë 28 shkurt 2013, “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” (Ligji për VSM) ndjek të njëjtin model si ligji për VNM. Autoriteti propozues, përpara se të nisë hartimin e raportit të VNM-së, ndër të tjera, duhet të konsultohet me OJQ-të mjedisore.⁶⁴

Gjithashtu, Ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” është miratuar me qëllim që t'i shërbejë shtyllës së parë dhe të dytë të Konventës së Aarhusit, *d.m.th.*, duke informuar publikun dhe duke e bërë atë pjesë të procesit të vendimmarrjes mjedisore nëpërmjet konsultimeve për projektligjet dhe dokumente të tjera strategjike kombëtare dhe lokale. Informacioni për të gjitha aktet e planifikuara dhe dokumentet përkatëse për seancat e planifikuara publike përfshihen në regjistrin elektronik. Aktualisht ka njoftime për konsultime publike për projektvendimet e Këshillit të Ministrave për shpalljen e disa zonave “Peizazhe të Mbrojtura”,⁶⁵ pas ndryshimit të Ligjit nr. 18/2017, “Për zonat e mbrojtura” në shkurt 2024.

Shtylla e tretë e Konventës së Aarhusit, qasja në drejtësi, garantohej nga legjislacioni i posaçëm mjedisor, si dhe me Ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.⁶⁶

Ekziston një ligj specifik për përgjegjësinë penale të korporatave, i cili përfshin edhe rastet e krimeve kundër mjedisit.⁶⁷ Ligji parashikon që një person juridik përgjigjet për veprat penale të kryera: (a) në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij; (b) nga një person që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik; (c) në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit ose mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik. Si i tillë, ky ligj mund të përdoret për ndjekjen penale

60 VKM nr. 247, datë 30 prill 2014, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”. https://akm.gov.al/ova_doc/vkm-nr-247-dt-30-04-2014-per-percaktimin-e-rregullave-te-posacme-per-informimin-dhe-perfshirjen-e-publikut-ne-vendimmarrjen-mjedisore/.

61 Raporti Shtetëror i Komunitetit të Energjisë, Shqipëri, 2023, f. 23. <https://www.energy-community.org/implementation/report/Albania.html>

62 VKM nr. 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”. <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/VKM-686-2015-Procedurat-e-VNM.pdf>

63 Regjistri Publik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Qytetar>

64 Ligji 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, neni 2 dhe neni 9. <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2013/11/LIGJ-91-2013-Per-vleresimin-strategjik-mjedisor.pdf>

65 Projektvendim i KM-ve “Për shpalljen “Peizazh i mbrojtur Bredhi i Drenovës - Sinicë”, Kategoria V”. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/757> ; Projektvendim i KM-ve “Për shpalljen “Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor Rrushkull”, Kategoria V”. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/756> ; Projektvendim i KM-ve “Për shpalljen “Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor “Lumi Buna - Velipojë”, Kategoria V”. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/755> ; Projektvendim i KM-ve “Për shpalljen “Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor Liqeni i Pogradecit”, Kategoria V”. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/753> ; Projektvendim i KM-ve “Për shpalljen “Peizazh i mbrojtur Kukurman – Qafë Bushi”, Kategoria V”. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/752> .

66 Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” https://ild.al/wp-content/uploads/2021/07/Ligj_49_03052012_perditesuar_2018.pdf

67 Ligji nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”. https://www.pp.gov.al/rc/doc/ligj_pergjegjesia_penale_e_personave_juridike_38.pdf

të shoqërive në rastet e veprave penale të kryera kundër mjedisit, në zbatim të dispozitave të Kodit Penal të Shqipërisë.

Disa nga pjesët e legjislacionet më të debatuar lidhen me Zonat e Mbrojtura, të cilat përfshijnë disa VKM,⁶⁸ dhe Ligjin nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", i cili parashikon ndryshimin e statusit të zonës së mbrojtur nëse ndryshon gjendja e saj.⁶⁹ Ky ndryshim i fundit i shkurtit 2024 hap mundësinë që projekte – si Aeroporti i Vlorës – të kryhen në zonat e mbrojtura. Një nga dispozitat e tij më të debatuar është futja e "Parimit të përshtatshmërisë",⁷⁰ i cili nuk gjendet zakonisht në legjislacionin mjedisor të ndonjë vendi tjetër, apo në ndonjë traktat ndërkombëtar mjedisor. Amendamenti i jep Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT),⁷¹ autoritet të konsiderueshëm mbi zonat e mbrojtura. Lexuar së bashku me Ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë",⁷² duket se vendimmarrja më e rëndësishme për objektet e mëdha infrastrukturore (ato me ndikimin më të madh të mundshëm mjedisor), i është lënë të njëjtit grup njerëzish, Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), me një përbërje thuajse të njëjtë si KKT. Ajo shpërfill vullnetin e të zgjedhurve lokalë, duke deklaruar se KIS "...mund të ftojë në mbledhje krerët e njësive të qeverisjes lokale, por pa të drejtë vote".⁷³

2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare

Nenet 122(3) dhe 123 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktojnë përparësinë e normave që rrjedhin nga një organizatë ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme, në rast konflikti midis këtyre normave, dhe kalimin e kompetencave shtetërore te organizatat ndërkombëtare, për çështje të caktuara, në zbatim të marrëveshjeve me këto organizata. Në funksion të këtyre dispozitave kushtetuese, BE-ja ka statusin e një organizate më të lartë.

Kuadri ligjor shqiptar është përgjithësisht i harmonizuar me legjislacionin përkatës të BE-së, pasi mbështetet në të njëjtat parime në të cilat mbështetet legjislacioni mjedisor evropian. Ai është hartuar me ndihmën e ekspertëve të huaj dhe në përgjithësi pasqyron kërkesat e konventave ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë. Ndër këto mund të përmenden Konventa e Aarhusit, Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumente Zyrtare (Konventa e Tromsø),⁷⁴ Konventa e Këshillit të Evropës për Ruajtjen e Kafshëve të Egra dhe Habitave Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës), Konventa Kuadër e OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Konventa e OKB-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar (Konventa e Espoo), Protokollin e Kiotos, Konventa për Mbrojtjen e Mesdheut nga Ndotja (Konventa e Barcelonës), Konventa për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (Konventa e Ujit), Konventa për Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale, Protokollin e Montrealit për Substancat që Hullojnë Shtresën e Ozonit etj. Së fundmi, në qershor 2024 Shqipëria iu bashkua Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (UNRN) si anëtar i ri i tij.⁷⁵

68 VKM nr. 59 dhe nr. 60, datë 26 janar 2022, për ndryshimet në statusin e sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura. [Shtojca I, f. 38.]

69 Ligji nr. 21/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura": <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/50/5bdc6cdb-3e60-4dbb-b62d-78f08ab4df6e>.

70 Po aty, neni 2: "d) "Parimi i përshtatshmërisë". *Kategoria e një zone të mbrojtur duhet të ndryshohet nëse nga vlerësimi i saj në një kohë të dhënë rezultojnë karakteristikat dhe objektivat për të cilat zona e mbrojtur është shpallur nuk përputhen me ato të kategorisë së caktuar.* Në praktikë, kjo dispozitë rrezikon të shkaktojë efekte të konsiderueshme negative në zonat e mbrojtura. Në vend që të shërbejë për të mbrojtur zona të caktuara si habitate për florën dhe faunën, kjo dispozitë mund të inkurajojë "kriminelët e mjedisit" dhe/ose zhvilluesit e fuqishëm që t'i shkatërrojnë ato. Për rrjedhojë, këto zona mund të shpallen si mjedise "të papërshtatshme" dhe të hiqen nga kategoria "të mbrojtura". Kjo, nga ana tjetër, mund të hapë rrugën për zhvillim, i cili përndryshe nuk do të lejohej në këto zona.

71 Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit": <https://planifikimi.gov.al/index.php?elID=dumpFile&t=f&f=6004&token=8a49182e9a8fd4b738deb28f07e2a7d41f729f14>

72 Ligji nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë": <https://www.eurailus.eu/index.php/en/library/property-legislation/laws?task=download.send&id=43&catid=117&m=0>

73 Po aty, neni 9(1) dhe neni 9(2).

74 Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare ka hyrë në fuqi në Shqipëri në nëntor 2022. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=205>.

75 <https://www.iucn.org/press-release/202406/albania-joins-iucn-its-newest-state-member>.

2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin.

2.2.1. Analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese

Siç u diskutua më lart, e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm lidhet me objektivat sociale të parashikuara nga neni 59 i Kushtetutës së Shqipërisë. Në vendimin e saj nr. 3, datë 30 janar 2024⁷⁶, Gjykata Kushtetuese vendosi se e drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtja e tij garantohet drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Megjithatë, edhe pse e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm janë të lidhura me objektivat sociale të parashikuara nga neni 59 i Kushtetutës, Gjykata i vlerësoi ato në dritën e së drejtës ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese theksoi se edhe GJEDNJ-ja nuk i ka konsideruar si të drejta të veçanta, por ato janë trajtuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si të lidhura me të drejtat e tjera të përcaktuara në KEDNJ.⁷⁷

Në fund, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkesëpadia e kërkuarve për shkeljen e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij ishte e mirë argumentuar. Megjithatë, duke marrë parasysh nenin 56 të Kushtetutës dhe Konventën e Aarhusit, ajo konstatoi se shkeljet e ndodhura gjatë fazës para miratimit të Ligjit nr. 38/2021 mund të riparoheshin ende nëpërmjet përfshirjes së publikut në aktivitete dhe informimin në lidhje me fazat e ndryshme të zhvillimit dhe zbatimit të projektit, si dhe në vendimmarrje,⁷⁸ Si rrjedhojë, Gjykata e vlerësoi si të pabazuar kërkesën për shfuqizimin e Ligjit 38/2021 bazuar në interpretimin e saj të Konventës së Aarhusit.

Roli i gjyqësorit është të mbrojë interesin publik, të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, duke kufizuar punën që çon në shkatërrimin e zonave të mbrojtura dhe të vlerave të pazëvendësueshme natyrore që ato zotërojnë, veçanërisht në rastet kur interesa të konsiderueshme financiare mund të krijojnë presione të jashtme. Gjykata Kushtetuese luan një rol vendimtar në këtë drejtim.

2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore

Gjyqtarët shqiptarë i referohen gjerësisht KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Më e rëndësishmja është Gjykata e Lartë e Shqipërisë, vendimet e së cilës janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta. Një nga rastet më pozitive mjedisore është Vendimi nr. 00 – 2021 – 1177, datë 21.07.2021, në të cilin paditësit – 27 banorë dhe një OJQ mjedisore – ngritën një padi për pezullimin e ndërtimit të dy digave në lumin Drin në Shqipërinë Verilindore. Gjykata e Lartë vendosi se bazuar në interpretimin sistematik të dispozitave dhe standardeve të Konventës së Aarhusit, konkretisht të nenit 9 të saj, si dhe të dispozitave të ligjit shqiptar për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, shoqatat dhe grupet e interesit, gëzojnë legjitimitet aktiv në ngritjen e padive mjedisore, për sa kohë që në çështjen specifike provohet një "interes i mjaftueshëm".⁷⁹

Brenda nëntë ditësh, Gjykata e Lartë nxori një tjetër vendim që pranoi *locus standi* te një OJQ, krahas banorëve që u ndikuan nga një vendim për të lejuar ndërtimin e një thertoreje në pyllin që ata kishin mbjellë. Ajo u shpreh se e drejta për t'u drejtuar gjykatës për shoqatat mjedisore dhe grupet e interesit meriton vëmendje të veçantë duke garantuar të drejtat procedurale të këtyre subjekteve në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Ata gëzojnë *locus standi* në ngritjen e padive lidhur me çështjet mjedisore, për sa kohë që në rastin konkret provohet një "interes i mjaftueshëm".⁸⁰

Megjithatë, disa sfida vazhdojnë brenda gjyqësorit shqiptar në lidhje me qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore. Për shembull, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 30 janar 2024, i

76 Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 3, datë 30 janar 2024, parag. 61 dhe 64. https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php [Shtojca II, f. 32].

77 Po aty., parag. 22.

78 Po aty., parag. 64.

79 Vendim i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 00 – 2021 – 1177, datë 21 korrik 2021. [Shtojca III, f. 33].

80 Vendim i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 00 – 2021 – 1259, datë 30 korrik 2021, parag. 21.

treguar në pjesën 2.2.1 më sipër, ngre shqetësime për efektivitetin e mjetit juridik në dispozicion, për sa i përket të drejtave të paditësve. Një tjetër rast i tillë është ai i Aeroportit të Vlorës. Ka një varg vendimesh nga qeveria që krijon mundësi për të vazhduar me projektin edhe pse ishte brenda zonës së mbrojtur. Kufijtë e Zonave të Mbrojtura ishin përcaktuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.⁸¹ Më pas, zona e mbrojtur u reduktua me Vendim të Këshillit të Ministrave.⁸² Kështu, konfigurimi i kuadrit ligjor kishte përfunduar, që punimet e ndërtimit të fillonin. Këto akte ligjore u kundërshtuan në Gjykatën Administrative të Apelit nga dy OJQ mjedisore në dhjetor 2022. Deri në shkrimin e këtij raporti në janar 2025, gjykimi i themelit nuk ka filluar ende, pasi gjykatat duhet të vendosin ende, së pari, për *locus standi* të dy OJQ-ve,⁸³ dhe më pas, për kërkesën për masa të përkohshme.⁸⁴

Rasti i Aeroportit të Vlorës është në kontrast të plotë me atë të Aeroportit të Lisbonës, ku qeveria portugeze shfuqizoi planin për të ndërtuar aeroportin në një zonë të mbrojtur.⁸⁵

2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

Ekziston një ligj i veçantë për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ku përfshihen mosmarrëveshje në fushën civile, tregtare, të punës, familjare, të pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorit dhe mosmarrëveshje ndërmjet organeve të administratës publike dhe subjekteve private.⁸⁶ Për më tepër, Kodi i Procedurës Civile parashikon detyrimin e gjykatës që fillimisht të tentojë zgjidhjen e çështjes me pajtim, duke u ofruar palëve ndërgjyqëse mundësinë për të zgjidhur çështjen me ndërmjetësim. Pavarësisht këtij kuadri ligjor dhe faktit që ligji i posaçëm për ndërmjetësimin ka më shumë se një dekadë në fuqi, ai nuk ka pasur asnjë ndikim real në praktikë. Aq më tepër, në fushën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mjedisore, ku mjetet për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve nuk gjejnë zbatim. Ka disa arsye për këtë, duke përfshirë mungesën e traditës institucionale, kulturës, mentalitetit, interesave ekonomike (avokatët mbrojtës këshillojnë klientët e tyre të mos pranojnë ndërmjetësimin, pasi tarifat e tyre do të jenë më të ulëta), mungesa e përvojës, etj. Ndryshime ligjore mund të ndihmojnë në mbështetjen e ndërmjetësimit, për shembull, duke i detyruar noterët publikë të përfshijnë ndërmjetësimin, krahas gjyqimit, si një metodë për zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve në kontratat që ata hartojnë.⁸⁷

81 Vendimi Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 10, datë 28 dhjetor 2020, "Përmiratimin e kufijve të zonave të mbrojtura": <https://planifikimi.gov.al/index.php?elD=dumpFile&t=f&f=6099&token=cc165dfe23b6652028a4de33944dee2fca23bd8f>

82 VKM nr. 694, datë 26 tetor 2022, "Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro-Nartë" nga "Rezervat natyror i menaxhuar" në "Peizazh i mbrojtur" dhe heqjen e statusit "Zonë e mbrojtur" të sipërfaqes së pakësuar. <https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/vendim-2022-10-26-694-1.pdf>

83 OJQ-ve iu mohua locus standi me vendimin nr. 80-2022-3301, datë 02 dhjetor 2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. [Shtojca, f. 35].

84 Paditësit kanë bërë padi në Gjykatën Administrative të Apelit, kërkesë për marrjen e masës së përkohshme për pezullimin e punimeve për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës, për shkak të dëmit të pariparueshëm në Zonën e Mbrojtur. Gjykata Administrative e Apelit në Vendimin e saj nr. 49, datë 22 qershor 2023, deklaroi mungesën e kompetencës për masën e përkohshme dhe dërgoi çështjen për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dërgoi çështjen në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi në vendimin e saj nr. 00-2023-3466, datë 31 korrik 2023 se gjykata kompetente për masën e përkohshme është Gjykata Administrative e Apelit. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nr. 3, datë 16.01.2024 ka refuzuar marrjen e masës së përkohshme.

85 ClientEarth, "Portugalia braktis planet për të ndërtuar aeroport të ri në rezervatin natyror pas padisë", 16 maj 2024. https://www.clientearth.org/latest/press-office/press/portugal-abandons-plans-to-build-new-airport-on-nature-reserve-following-lawsuit/?utm_source=uk_newsletter&utm_medium=email&utm_campaign=6-month-2026&utm_term=uk&utm_content=hyperlink

86 Ligji nr. 10 385, datë 24.02.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", neni 2. https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Ligj_10385_04022011_perditesuar_2018.pdf

87 Intervistë me z. Artion Beqiraj, ndërmjetës, 10 korrik 2024.

3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore

3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes

3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor

Ndërsa ndryshimet në Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" kanë sjellë ndryshime pozitive, ka ende mundësi për të rritur më tej zbatimin e tij.⁸⁸ Për shembull, ndonjëherë është e vështirë të sigurohet informacioni i kërkuar në çështjet mjedisore nga autoritetet publike (p.sh. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Studimi i Fizibilitetit për projektin e Kalivaçit në lumin Vjosa), edhe kur ky informacion kërkohej zyrtarisht.⁸⁹ Kjo, nga ana tjetër, minon efektivitetin e së drejtës për ankimim.

3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes

Në përputhje me dispozitat ligjore të diskutuara në seksionin 2.1.2 më sipër, publiku dhe palët e interesuara është e nevojshme të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve dhe programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësve të mjedisit.

Në këtë kontekst, ka ende mungesë të legjislacionit dytësor thelbësor që kërkohej për zbatimin e duhur të VNM-së. Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" rregullon procesin e njoftimit të publikut për projektaktet ligjore dhe dokumente të tjera strategjike kombëtare dhe lokale. Regjistri elektronik përfshin informacion për të gjitha aktet e planifikuara dhe dokumentet përkatëse për seancat e planifikuara publike. Megjithatë, publiku i gjerë duhet të kontrollojë në mënyrë specifike faqen e internetit për një akt të caktuar, diçka që nuk ndodh realisht në praktikë. Ekziston nevoja për të miratuar një qasje më proaktive për të drejtën e informacionit mjedisor. Më e rëndësishmja, autoritetet publike nuk marrin pjesë në procedurat e konsultimit kur bëhet fjalë për punë të mëdha publike, të tilla si ndërtimi i HEC-it mbi lumin Vjosa.⁹⁰ Sfidat në lidhje me cilësinë e procesit legjislativ përfshijnë efektivitetin e kufizuar të konsultimeve publike.⁹¹

Një rast i tillë është rasti Petrolifera, në të cilin publiku i interesuar nuk u njoftua ose nuk u konsultua në vendimmarrjen për planifikimin e një parku industrial që përfshin tubacionet e naftës dhe gazit, instalimet për depozitim të naftës, tre termocentrale dhe një rafineri, në zonën e mbrojtur pranë lagunës së Nartës, në afërsi të qytetit bregdetar të Vlorës në jugperëndim të Shqipërisë. Me gjithë protestat masive të banorëve të Vlorës në favor të ruajtjes së një zone të shpallur ligjorisht të mbrojtur,⁹² u realizua ndërtimi i parkut industrial, duke rezultuar në shpyllëzimin e një sipërfaqe

88 Komisioni Evropian, "Raporti i vitit 2024 i Shtetit Ligjor, Kapitulli për gjendjen e shtetit të së drejtës në Shqipëri", 24 korrik 2024, f.1. https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf

89 Raporti i paditësit, "Ndikimi negativ i supozuar i zhvillimit të hidrocentralit në lumin Vjosë në Shqipëri", takimi i 38-të i Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës, 27-30 nëntor 2018. <https://rm.coe.int/other-complaints-albania-presumed-negative-impact-of-hydro-power-plant/168079284a>

90 Procedura të tilla konsultimi janë kundërshtuar me sukses në Vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1240, datë 27 qershor 2024, f. 65. Gjykata Administrative e Apelit la në fuqi vendimin nr. 1813, datë 2 maj 2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili shpalli të pavlefshëm Deklaratën Mjedisore të Ministrit të Mjedisit për ndërtimin e Hidrocentralit në Poçem, mbi lumin Vjosa, dhe aktet e mëvonshme përkatëse të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, përfshirë kontratën koncesionare për ndërtimin e HEC-it. Gjykata vendosi se "Referuar provave të paraqitura në dosjen gjyqësore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe njësitë e qeverisjes vendore të vendndodhjes së ndërtimit të HEC-it, nuk kishin përmbushur detyrat e tyre ligjore në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis, në asnjë nga fazat e VNM-së, si në drejtim të informimit të publikut, ashtu edhe në marrjen e vendimit mjedisor."

91 Më lart, shënimi 60

92 Lindita Arapi, "Vlora, qytet naftë apo turizmi?", 29 janar 2008. <https://www.dw.com/sq/vlora-qytet-naphtha-apo-tourism/a-3095063>

prej 500 hektarësh tokë dhe prerjen e mijëra pishave. Si rezultat i veprimeve të ndërmarra nga një sërë OJQ-sh mjedisore përpara Komitetit të Përputhshmërisë të Konventës së Aarhusit, Komiteti rekomandoi që Shqipëria duhet "... të marrë masat e nevojshme legjislative, rregullatore, administrative dhe të tjera për të siguruar që: a) të krijohet një kuadër i qartë, transparent dhe konsistent për zbatimin e dispozitave të Konventës në legjislacionin shqiptar, duke përfshirë një skemë më të qartë dhe më efektive të përgjegjësisë brenda administratës qeveritare..."⁹³

Në letër, aktet ligjore janë miratuar, por në praktikë nuk ka pasur përmirësime të dukshme, siç tregohet nga rasti i Aeroportit të Vlorës. Në të njëjtin qytet, VNM për Aeroportin e Vlorës është kritikuar gjerësisht nga shoqëria civile dhe aktorë të tjerë. Një nga çështjet e ngritura ishte mungesa e marrjes parasysh të statusit «zonë e mbrojtur» të zonës së zgjedhur.⁹⁴ Në vitin 2016, një ankesë zyrtare iu dorëzua Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës, për ndikimin e supozuar negativ të zhvillimeve në lumin Vjosë, duke përfshirë zhvillimin e hidrocentralit dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.⁹⁵ Menaxhimi dhe mbrojtja e ligatinave Ramsar, e cila është me rëndësi ndërkombëtare,⁹⁶ dhe Zonës së Mbrojtur Vjosa-Nartë, mbetet e pazgjidhur, së bashku me projekte infrastrukturore që vazhdojnë brenda zonës.⁹⁷

Në prill 2023, Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernës i kërkoi qeverisë shqiptare të pezullojë punimet e ndërtimit për aeroportin e Vlorës brenda zonës së mbrojtur të lagunës së Nartës dhe deltës së Vjosës. Gjithashtu, Parlamenti Evropian i kërkoi qeverisë shqiptare të ndalojë projektet që rrezikojnë të shkelin normat kombëtare dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së biodiversitetit, si Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës, dhe të ndalojë zhvillimin e hidrocentraleve në zonat e mbrojtura.⁹⁸ Në shtator 2023, Komiteti i Përhershëm i Konventës së Bernës nxori Rekomandimin nr. 219 (2023), i cili u rishikua në dhjetor 2023, mbi ndikimin e mundshëm të zhvillimeve të infrastrukturës dhe urbanizimit, veçanërisht Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, në Zonën e Mbrojtur Vjosë-Nartë. Ai i rekomandoi Qeverisë së Shqipërisë pezullimin e ndërtimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës derisa të kryhet një procedurë e re dhe e mjaftueshme e VNM-së, si dhe një vlerësim i Duhur/i Përshtatshëm; për të iniciuar një Program gjithëpërfshirës të Monitorimit të Jetës së Egër; për të miratuar dhe zbatuar një qasje të ekosistemit, siç mbështetet nga Konventa për Diversitetin Biologjik (KDB); për të filluar një program intensiv për ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës dhe ruajtjen e biodiversitetit; për të ndërtuar një bashkëpunim më të thellë me me të gjithë grupet e interesit të cilët mund të angazhohen në një mënyrë informative, konsultative ose bashkëpunuese në projektet e zhvillimit të infrastrukturës; dhe për të iniciuar bashkëpunime me OJQ-të më të rëndësishme, duke përdorur ekspertizën e tyre për të përmbushur nevojat dhe detyrimet për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri.⁹⁹

93 Komunikimi i Komitetit të Pajtuëshmërisë me Konventën e Aarhusit ACCC/C/2005/12 Shqipëri. Konstatimet e miratuara më 15 qershor 2007 – U konstatua një mospërputhje. https://unece.org/env/pp/cc/accc.c.2005.12_albania

94 Më lart, shënimi 51.

95 Ndikimi negativ i supozuar i zhvillimeve në lumin Vjosë, përfshirë zhvillimin e hidrocentralit dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, Rasti 2016/5. <https://www.coe.int/en/web/bern-convention/-/2016-5-albania-presumed-negative-impact-of-hydro-central-development-on-the-vjosa-river>.

96 Edhe pse nuk është e lidhur drejtpërdrejt në kontekstin ekologjik me ekosistemin e lumit të ujërave të ëmbla të grykëderdhjes së lumit Vjosa, laguna e njelmët e Nartës ka një vlerë të konsiderueshme konservimi në shkallë kombëtare dhe madje globale. Laguna bregdetare shtrihet në një sipërfaqe prej 59 km². Vlera e saj e ruajtjes kombëtare u njoh që në vitin 2004, kur zona u bë pjesë e Peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë. Potenciali i saj evropian i ruajtjes reflektohet në përfshirjen e zonës në listën e mundshme të ardhshme të Natura 2000. Laguna e Nartës është një zonë kyçe e biodiversitetit (ZKB), si një zonë me vlerë ruajtjeje ndërkombëtare. Dr. Andrej Sovinc, "Studimi i mbrojtjes së luginës së lumit Vjosa bazuar në standardet e zonës së mbrojtur të UNRN-së", f. 21. <https://portals.iucn.org/library/sites/library/files/documents/2021-011-En.pdf> Në një ditë të vetme rreth 5000 flamingo ishin të pranishëm në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë. <https://www.balkanweb.com/foto-mbi-5000-flamingo-pushtojne-lagunen-e-nartes-dhe-peisazhin-e-mbrojtur-vjose-narte/#gsc.tab=0>.

97 Më lart, shënimi 61

98 Rezoluta e Parlamentit Evropian për Raportin e Komisionit të vitit 2022 për Shqipërinë, 12 korrik 2023, parag. 84. https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0285_EN.html

99 Rekomandimi nr. 219 (2023) i Komitetit të Përhershëm, miratuar më 5 shtator 2023 dhe rishikuar më 1 dhjetor 2023, për ndikimet e mundshme të zhvillimeve të infrastrukturës dhe urbanizimit, veçanërisht Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, në zonën e mbrojtur Vjosë-Nartë (Shqipëri). <https://rm.coe.int/2023-rec-219e-rev-vlora-airport/1680ad922d>.

Nuk janë futur mekanizma të rinj për të përmirësuar procesin e konsultimit me OJQ-të.¹⁰⁰ Informacioni përkatës për vendimmarrjen mjedisore është publikuar në regjistrin mjedisor dhe ka një projektvendim të KM-së "Për shpalljen 'Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor' Pishë Poro-Nartë, Kategoria V". Megjithatë, në praktikë, këto akte nuk kanë asnjë ndikim kuptimplotë për mbrojtjen e mjedisit, pasi kjo zonë ndodhet në të njëjtën zonë ku po ndërtohet edhe Aeroporti i Vlorës.¹⁰¹ Neni 5 i projektvendimit të lartpërmendur të KM-së lejon, *ndër të tjera*, ndërtimin e autostradave brenda saj.¹⁰²

Në përgjithësi, pjesëmarrja e publikut dhe konsultimi në procesin e vendimmarrjes mjedisore mund të forcohet më tej. Kjo mund, *ndër të tjera*, të sigurohet jo vetëm duke ftuar aktorët përkatës për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, por edhe duke ofruar argumente të detajuara dhe të arsyetuara që shpjegojnë pse disa kërkesa, propozime ose kundërshtime nuk janë marrë parasysh. Kjo qasje siguron që procesi i vendimmarrjes të përfitojë nga kontributi i vërtetë dhe kuptimplotë i anëtarëve përkatës të shoqërisë, duke nxitur besim dhe transparencë më të madhe.

3.1.3. Të drejtat e tubimit dhe protestës

Liria për të marrë pjesë në tubime paqësore dhe të pa armë garantohet në Kushtetutë, duke iu nënshtruar procedurave të parashikuara me ligj në lidhje me tubimet në sheshet publike dhe në vendet e kalimit publik.¹⁰³ Ligji specifik që garanton lirinë e tubimit paqësor për të gjithë u miratua në vitin 2001, tre vjet pas Kushtetutës.¹⁰⁴ Protestat mjedisore nuk ndryshojnë dhe atyre u garantohet i njëjti nivel mbrojtjeje si çdo protestë tjetër.

Megjithatë, përveç protestave në lidhje me aeroportin e Vlorës të trajtuara më sipër, protestat mjedisore në Shqipëri ose janë të rralla, për shkak të nivelit të ulët të ndërgjegjësimit të popullatës, ose nuk bëhen publicitet nga media, për disa faktorë.

Së pari, në fazën aktuale të zhvillimit ekonomik dhe social shqiptar, mbrojtjes së mjedisit duket se i jepet më pak prioritet në krahasim me zhvillimin ekonomik. Edhe kuadri institucional e reflekton këtë. Ministria përgjegjëse për mjedisin quhet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ku turizmi dhe të ardhurat e krijuara prej tij konsiderohen si prioritet. Në përgjithësi, edhe mjedisi portretizohet si një atraksion turistik, një mall për t'u shfrytëzuar, për të gjeneruar të ardhura nga bizneset. Ky është një rast i qartë i papajtueshmërisë institucionale brenda të njëjtit institucion të qeverisë qendrore. Prandaj rekomandohet që një Ministri e Mjedisit të shkëputet nga ajo e turizmit.

Së dyti, biznesi i madh zotëron kanalet e medias, gjë që ka një ndikim negativ në lirinë e shtypit dhe pavarësinë e medias, të cilat kërcënohen nga konfliktet e interesit midis botës së biznesit dhe asaj politike, një kuadër ligjor me të meta dhe rregullime partiake. Janë shumë të pakta mediat që e përqendrojnë vëmendjen e tyre në problemet mjedisore, duke çuar në një nivel shumë të ulët të ndërgjegjësimit mjedisor te popullata. Edhe kur mbahen protesta mjedisore, ato tërheqin pak pjesëmarrës, zakonisht banorët lokalë që vuajnë ndikimin e menjëhershëm të investimeve të bëra në lagjen e tyre, dhe ndoshta një numër OJQ-sh që i mbështesin ato. Ndër të tjera, indiferenca e medias çon në indiferencë/ndjenjë të pafuqisë së publikut.

100 Më lart, shënimi 61

101 Shtojca IV.

102 Projektvendimi i KM-së "Për shpalljen 'Peizazh i mbrojtur ujor/tokësor' Pishë Poro-Nartë, Kategoria V". Sipas nenit 5, aktivitetet e lejuara përfshijnë ndër të tjera: dh) veprimtaritë e zhvilluara në strukturat akomoduese të agroturizmit dhe çdo aktivitet/infrastrukturë tjetër mbështetëse; ë) instalime të energjisë së ripërtëritshme; ll) veprimtari të tilla si ndërtime, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i kanaleve lundruese, autostradave, zonave urbane, si dhe veprimtari të ngjashme me këto, në rastet kur subjekti pajiset me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Prandaj, pas lejimit të ndërtimit të Aeroportit të Vlorës, Këshilli Kombëtar i Territorit mund të vijojë përfundimin e infrastrukturës duke lejuar ndërtimin e autostradave dhe zonave urbane, brenda një zone me habitate unike që aktualisht është ende shtëpia e breshkave të detit, shpendëve të detit dhe gjitarëve. <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/754>

103 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 47.

104 Ligji nr. 8773, datë 23 prill 2001 "Për tubimet". <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2001/04/23/8773>

Nuk ka mbrojtje specifike ligjore për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në mjedis, vetëm masa mbrojtëse të përgjithshme të ofruara nga legjislacioni për të drejtat e njeriut. Nuk ka pasur raste të raportuara të dëmtimit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në mjedis në Shqipëri, sipas Mekanizmit të Reagimit të Shpejtë të Konventës së Aarhusit,¹⁰⁵ por paditë kundër gazetarëve investigativë janë përdorur për t'i dekurajuar ata (efekti drithërues), siç tregohet në pjesën 3.2.2, më poshtë.

3.2. Të drejtat e Qasjes në Drejtësi, Mjetet Juridike dhe Efektiviteti i tyre

3.2.1. Qasja në Drejtësi

Rregullat për të drejtën ligjore të OJQ-ve përcaktohen në Ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i cili parashikon se e drejta për të ngritur padi i takon, ndër të tjera, çdo shoqate ose grupi interesi që pretendon se është cenuar një interes publik legjitim nga një akt normativ ose nga akt administrativ, në rast se ligji i njej një të drejtë të tillë.¹⁰⁶ Kjo do të thotë se një OJQ që ka përfshirë mbrojtjen e mjedisit në statutin e saj mund të ngrejë padi kundër një akti të administratës publike që mund të ketë pasoja për mjedisin.

Megjithatë, siç tregohet në pjesën 2.2.2 më sipër, praktika gjyqësore nuk është konsistente në lidhje me *locus standi* të OJQ-ve mjedisore. Prandaj, ekziston nevoja për një vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, i cili do të jetë i detyrueshëm për gjykatat më të ulëta.

E drejta e qasjes në gjykatë cenohet kur rregullat pushojnë së shërbyeri qëllimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe formojnë një lloj pengese që e pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të shqyrtohet në themel nga gjykata kompetente.¹⁰⁷ Në rastin e Shqipërisë, ekzistojnë disa pengesa në lidhje me qasjen në gjykata, p.sh. pengesa financiare etj. Për grupet e cënueshme dhe ata që nuk kanë mundësi financiare, Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" siguron qasje në gjykata duke i përjashtuar ato nga pagesa e tarifave të përgjithshme ose të veçanta, shpenzimet gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët etj.) dhe tarifën për ekzekutimin e vendimit.¹⁰⁸ Megjithatë, rastet mjedisore përfshijnë zakonisht nevojën për të angazhuar ekspertë në një sërë fushash si flora, fauna, jeta e egër, peshkimi, pylltaria, vlerësimi i ndikimit, etj. Shpesh, nevojitet më shumë se një ekspert i tillë, gjë që i bën kostot të konsiderueshme. Përveç kësaj, janë kostot e këshillimit ligjor dhe tarifave gjyqësore. Në përgjithësi, tarifën gjyqësore në vetvete nuk janë të larta, por kostot e tjera, për avokatët dhe ekspertët, janë të konsiderueshme.¹⁰⁹

Kodi i Procedurave Administrative parashikon se, në parim, palët e interesuara mund të ngrenë padi vetëm pasi të kenë shteruar procesin e ankimit administrativ.¹¹⁰ Ligji nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", parashikon që grupet e interesuara, përfshirë publikun, mund të bëjnë ankim administrativ kundër vendimit të ministrit brenda 30 ditëve.¹¹¹ Është e mundur që komunitetet dhe individët të çojnë në gjykatë aktorët industrialë dhe të korporatave për dëmtim mjedisor. Kjo parashikohet në Kodin Civil, i cili thotë se personi që ka cenuar mjedisin me faj, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin

105 Komisioni Ekonomik për Evropë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, "Shënim informacioni mbi situatën në lidhje me mbrojtësit e mjedisit në Palët e Konventës së Aarhusit nga viti 2017 deri më sot", Takimi i njëzetekatërt në Gjenevë, 1-3 korrik 2020. https://unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/wgp/WGP_24/Inf.16_Situation_of_environmental_defenders_in_Parties_to_the_Convention.pdf

106 Më lart, shënimi 66, neni 15.

107 GJEDNJ: *Kart k. Turqisë*, nr. 8917/05, paragrafi 79, GJEDNJ 2009; *Arrozpide Sarasola dhe të tjerët k. Spanjës*, nr. 65101/16 dhe 2 të tjerë, paragrafi 98.

108 Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/LIGJ-nr.-111-2017-date-14.12.2017.pdf>

109 Tarifën e avokatëve dhe ekspertëve varen nga lloji i çështjes, por ato rrallë janë nën 1000 euro secila, në një vend ku paga minimale është 400 euro/muaj. P.sh., në vendimin nr. 20, datë 05.03.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, shpenzimet e bëra ishin: Taksa gjyqësore 30 euro + tarifa e ekspertimit 1,400 euro, gjithsej 1,430 euro.

110 Kodi i Procedurave Administrative, neni 137 (3). https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_i_Procedurave_Administrative-1.pdf

111 Ligji nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", neni 14.

e shkaktuar.¹¹² Ka edhe dispozita të Kodit Penal për veprat penale kundër mjedisit që përfshijnë ndotjen e ajrit, transportimin e mbeturinave toksike, ndotjen e ujit, peshkimin e paligjshëm, prerjet e paligjshme e pyjeve, zjarrvënien në pyje dhe shkeljen e karantinës për bimët dhe kafshët.¹¹³

Pavarësisht kuadrit ligjor, situata aktuale në lidhje me qasjen e përgjithshme në gjykatat në Shqipëri, si dhe për çështjet mjedisore ka vend për përmirësim. Për shkak të reformës së vazhdueshme në drejtësi dhe procesit të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, institucionet shqiptare të drejtësisë po përjetojnë mungesa kritike të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe po funksionojnë me gjysmën e kapacitetit. Ka një grumbull të madh çështjesh gjyqësore në gjykatat shqiptare, që shkakton vonesa të mëdha në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përfshirë ato mjedisore. Përgjithësisht ato gjykohen në gjykatat administrative, ku situata është akute. Në Gjykatën Administrative të Apelit, vendimet e së cilës janë të detyrueshme, ndërsa në vitin 2014 numri i çështjeve të prapambetura ishte afërsisht 6,000 çështje, në vitin 2023 arriti në 23,056 çështje. Me shkallën aktuale të gjykimit, një çështje do të zgjaste mesatarisht 5,326 ditë (14.6 vjet).¹¹⁴ Respektimi i së drejtës për qasje në drejtësi dhe përshtatshmëria e infrastrukturës së gjykatave mbetet e pamjaftueshme, më seriozisht në Gjykatën e Apelit.¹¹⁵

3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë

Ekzistojnë mjete juridike të disponueshme për ligjet mjedisore/të drejtat e njeriut, duke përfshirë shkeljet e të drejtave procedurale. Shkeljet e të drejtave procedurale mund të shkaktojnë anulimin e një akti, sepse ato konsiderohen nga Kodi i Procedurave Administrative si një nga elementët thelbësorë të vlefshmërisë së aktit administrativ, krahas kompetencës së autoritetit lëshues dhe respektimit të qëllimeve dhe objektivave të ligjit.¹¹⁶ Vendimet e marra nga organet publike mund të anulohen nga një organ publik epror ose në rast të kundërt nga gjykatat. Prandaj, si shqyrtimi administrativ ashtu edhe ai gjyqësor janë të disponueshëm, por jo plotësisht efektivë në praktikë.

Mjetet juridike civile janë gjithashtu të disponueshme, të cilat përfshijnë shpërblimin e dëmit, urdhra gjyqësorë, urdhra për rivendosje, si dhe urdhra që mbajnë përgjegjës aktorët e korporatave ose industrisë për dëmtimin e mjedisit. Siç tregohet në pjesën 3.2.1 më sipër, Kodi Civil i lejon komunitetet dhe individët të çojnë në gjykatë aktorët industrialë dhe të korporatave për dëmtim mjedisor, duke parashikuar që personi që ka cenuar mjedisin me faj, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, është i detyruar të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Megjithatë, këto dispozita nuk kanë qenë plotësisht efektive në praktikë. Në praktikën gjyqësore të gjykatave shqiptare ka një numër të kufizuar çështjesh, nga të cilat vetëm një ka pasur sukses në shkallën e parë dhe tani është ankimuar.¹¹⁷

Përgjegjësia penale për krimet dhe kundërvajtjet mjedisore përfshin gjobat dhe dënimin me burgim, sipas Kodit Penal, si dhe gjobat dhe mbarimin e personit juridik, si sanksione të përgjegjësisë penale të korporatës.¹¹⁸ Megjithatë, këto dispozita nuk kanë qenë plotësisht efektive në praktikë. Sipas statistikave të fundit, ka pasur një ulje prej 20% të procedurave penale mjedisore dhe një ulje

112 Kodi Civil, neni 624. https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download_send&id=231&catid=71&m=0.

113 Kodi Penal, nenet, 201-207. https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download_send&id=11&catid=10&m=0

114 Këshilli i Lartë Gjyqësor, «Strategjia Kombëtare e Uljes së Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024-2027», f. 11.

115 Më lart, shënimi 60

116 Kodi i Procedurave Administrative - elementet e vlefshmërisë së një akti administrativ: (i) kompetenca (nenet 21 e vijues të KPA-së); (ii) procedura (neni 46 e vijues i KPA-së); (iii) përputhja e aktit me përmbajtjen e ligjit (neni 9 i KPA-së); (iv) përputhja e aktit me qëllimet dhe objektivat e ligjit (neni 107 i KPA-së).

117 Tri çështje janë gjykuar nga gjykatat e shkallës së parë Fier, Kurbin, Tiranë dhe nga Gjykata e Lartë. Rasti i vetëm i suksesshëm është vendimi nr. 363, datë 03 mars 2021 në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, në të cilën një fermeri iu dha një dëmshpërblim prej rreth 13,000 eurosh për dëmin e shkaktuar në ullishtet e tij nga shkarkimet e një kompanie karburantesh.

118 Ligji nr. 9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", neni 9. https://www.pp.gov.al/rc/doc/ligj_perjegjesia_penale_e_personave_juridike_38.pdf

me 33% të numrit të të akuzuarve për krime mjedisore, krahasuar me vitin 2022.¹¹⁹

Njësia e posaçme e krimit mjedisor në Prokurorinë e Tiranës, që çoi në identifikimin e pastrimit të parave, është një model pozitiv që duhet të përsëritet edhe në prokurori të tjera.

Nuk ka grupe që janë veçanërisht të marginalizuara gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, në kuptimin e të drejtave mjedisore. Nga natyra e tyre, efektet e degradimit të mjedisit kanë një ndikim negativ për të gjithë, por për ato kategori që janë të cenueshme, mbështetja e disponueshme është ajo që jep Ligji nr. 111/207 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, siç tregohet në pjesën 3.2.1 më sipër.

Një kontribut mjaft pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mjedisit japin OJQ-të mjedisore, të cilat kanë mbajtur një profil të lartë duke shprehur shqetësimet e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe kanë çuar çështjet më të rëndësishme para gjykatave.¹²⁰ Megjithatë, ka nevojë për institucione më të fuqishme për të mbështetur sundimin e ligjit dhe një sistem të fortë gjyqësor për të siguruar mjete juridike të disponueshme dhe efektive në praktikë. Administrata publike mjedisore nuk rekrutohet vazhdimisht mbi procese të bazuara në merita.¹²¹ Kjo ndikon në të gjithë procesin e vendimmarrjes mjedisore. Një shembull është miratimi i Ligjit nr. 21/2024 “Për zonat e mbrojtura” (siç tregohet në pjesën 2.1.2 më sipër),¹²² i cili u fut me nxitim në komisionin e Kuvendit në shtatë minuta, në një seancë dëgjimore online, pa asnjë debat të vetëm, ndërsa kishte një fushatë të fortë të shoqërisë civile kundër tij.¹²³ Zhvillime pozitive në praktikën gjyqësore janë vendimet e Gjykatës së Lartë të Shqipërisë që la në fuqi zgjerimin e Parkut Kombëtar “Mali i Tomorrit”, pavarësisht kundërshtimeve të kompanive minerare.^{124 125 126}

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar

Ky seksion eksploron se si zbatohen të drejtat e njeriut në kontekstin e çështjeve thelbësore mjedisore që ndeshen në kontekstin kombëtar.

4.1. Shqetësimet kryesore kombëtare

Një sfidë e vazhdueshme në Shqipëri lidhet me zbatimin e dobët të legjislationit mjedisor dhe të të drejtave të njeriut në praktikë, siç tregohet ndër të tjera nga rastet e Petrolifera të analizuar në pjesën 3.1.2, më sipër.

Lejet e ndërtimit jepen për zhvillime brenda zonave të mbrojtura, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Rasti më i fundit është ndërtimi brenda Parkut të Butrintit, një zonë e trashëgimisë kulturore e UNESCO-s.¹²⁷

Sfidë tjetër janë kompetencat e paqarta të autoriteteve shtetërore në rastet e dëmtimit të mjedisit. Rasti më i fundit është shqetësimi mjedisor i shkaktuar nga numri i madh i peshqve të

119 Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme i vitit 2023, f. 35. https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_1_PP_2023_date_28_03_2024_7383.pdf

120 OJQ-të më aktive, *ndër të tjera*, përfshijnë: Res Publica <https://www.respublica.org.al/>; EcoAlbania <https://ecoalbania.org/?lang=en>; Shoqëria Ornitologjike Shqiptare <https://aos-alb.org/>; Mbrojtja dhe Ruajtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) <https://ppnea.org/?lang=en>; Qendra Burimore Mjedisore në Shqipëri (REC Albania) <https://www.recshqiperi.org/>

121 Më lart, shënim 51

122 Ligji nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”. <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/50/5bdc6cdb-3e60-4dbb-b62d-78f08ab4df6e>

123 Deklarata e Përbashkët e Shtypit e OJQ-ve Mjedisore, 16 shkurt 2024. <https://www.recshqiperi.org/news.php?id=91>

124 Vendimi i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 322 – 2021, datë 21 korrik 2021. [Shtojca IV, f. 34].

125 Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 20, datë 05 mars 2024. [Shtojca, f. 35].

126 Në këtë rast, palë paditëse kanë qenë Shoqata e Shoqërive të Veprimtarisë Minerare të qytetit të Beratit, biznese që janë prekur nga zgjerimi i Parkut Kombëtar “Mali i Tomorrit”, nëpërmjet VKM-së nr. 611, datë 11 shtator 2019 “Për zgjerimin e sipërfaqes së parkut kombëtar “Mali i Tomorrit”. Gjykata vendosi në plan të parë interesin publik, duke hedhur poshtë padinë, duke lënë në fuqi Vendimin e Këshillit të Ministrave.

127 Auron Tare, “Nis ndërtimi brenda zonës së mbrojtur të Parkut të Butrintit”, 28 qershor 2024. <https://www.balkanweb.com/auron-tare-nis-ndertimi-nr-2-brenda-zones-se-mbrojtur-te-parkut-te-butrintit-dy-gardianet/#gsc.tab=0>

ngordhur në një rezervuar në qytetin e Fierit, në jugperëndim të Shqipërisë, i cili nuk është trajtuar nga asnjë autoritet. Ankimet janë transferuar ndërmjet Bashkisë Fier, Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.¹²⁸

Riciklimi është elementar, pothuajse inekzistent, sepse fokusi është vënë në ndërtimin e tre inceneratorëve në një vend me më pak se tre milionë banorë. Vetëm 65% e mbetjeve grumbullohen dhe nuk ka riciklim të mbetjeve të prishjes së ndërtimeve. Instrumentet ekonomike për të promovuar grumbullimin e veçuar, riciklimin dhe parandalimin e gjenerimit të mbetjeve mbeten të kufizuara. Inceneratorët paraqesin shqetësime për sa i përket përputhshmërisë me Direktivat e BE-së për Mbetjet, parimin e hierarkisë së mbetjeve me djegien si opsionin më pak të preferuar të menaxhimit të mbetjeve dhe me objektivat e BE-së për riciklimin.¹²⁹

Së fundi, në këtë fazë të zhvillimit të saj ekonomik dhe social, korrupsioni vazhdon të jetë një sfidë në Shqipëri.¹³⁰ Disa biznese mund të shfrytëzojnë mangësitë në proceset e vendimmarrjes për të ndikuar në menaxhimin e burimeve natyrore dhe për të siguruar përfitime ekonomike. Shqipëria përmendet në raportet ndërkombëtare për pastrim parash përmes korrupsionit dhe ndërtimit. Aktualisht, industria e ndërtimit po lulëzon në Shqipëri, duke përfshirë ndërtimin e hidrocentraleve dhe resorteve bregdetare,¹³¹ me një ndikim të madh mjedisor. Një skemë e madhe korrupsioni u zbulua nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pas hetimeve fillestare mediatike,¹³² që përfshin trajtimin e mbetjeve përmes inceneratorëve në tre qytete shqiptare, në Elbasan në 2021, në Fier në 2022 dhe në Tiranë në 2023.¹³³ Prokuroria e Posaçme ka bërë të ditur se hetimet për inceneratorin e Tiranës kishin zbuluar një skemë pastrimi parash.¹³⁴ Ish-ministri i Mjedisit dhe ish Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit janë burgosur dhe zyrtarë të tjerë janë nën hetim.¹³⁵

Sfida e vazhdueshme mbetet zbatimi i ligjit në praktikë, ku gjykatat kanë një rol vendimtar, si barriera e fundit e mbrojtjes së mjedisit.

4.2. Incidente ose aksidente të mëdha mjedisore

Kanë ndodhur aksidente, ku nafta është derdhur në det nga depozitat e kompanive të naftës. Pavarësisht kuadrin ligjor ekzistues për përgjegjësinë civile dhe penale të personave juridikë (siç tregohet në pjesën 2.1.2 më sipër), asnjë veprim nuk është ndërmarrë kundër tyre.¹³⁶ Për shembull, në një çështje të fundit gjyqësore u zbulua se pronari i kompanisë së naftës që shkaktoi derdhjen ishte sponsor i një pushimi të kushtueshëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), organi përgjegjës për kryerjen e verifikimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri.¹³⁷ Shqetësimet më urgjente përfshijnë ndërtimin e aeroportit të Vlorës, resorteve turistike dhe

128 Balkanweb, "Mbi pesë tonë peshk i ngordhur pushton brigjet e rezervuarit të Petovës në Fier, burim për infeksione", 1 korrik 2024. <https://www.balkanweb.com/mbi-5-tone-peshk-i-ngordhur-pushton-brigjet-e-rezervuarit-te-petoves-ne-fier-burim-per-infeksione/#gsc.tab=0>

129 SHTOJCA IV e Vendimit Zbatues të Komisionit për financimin e planit vjetor të veprimit për Shqipërinë për vitin 2021, f. 4. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/7d8e1f37-e937-46ea-9b23-60e9fec169e4_en

130 Transparency International, Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, 2023. <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

131 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, "Rrjedhat e paligjshme financiare. Gjaku i krimit dhe korrupsionit", korrik 2021. https://www.osce.org/files/f/documents/2/1/505096_0.pdf

132 Aleksandra Bogdani dhe Besar Likmeta, "Politika pas plehrave: Kush është biznesmeni në hije i monopolit të inceneratorëve", 17.09.2020. <https://www.reporter.al/2020/09/17/politika-pas-plehrave-kush-eshte-biznesmeni-ne-hije-i-monopolit-te-inceneratorëve/>

133 Euronews Albania, "Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit sekuestron inceneratorin dhe landfillin e Tiranës", 01 gusht 2023. <https://euronews.al/en/spak-sequesters-tirana-incinerator-and-landfill/>

134 CNA: "VOA: Mbi 20 milionë euro të pastruara nga grupi i strukturuar kriminal i inceneratorit të Tiranës", 16 korrik 2024. <https://www.cna.al/english/aktualitet/voa-mbi-20-milione-euro-te-pastruara-nga-grupi-i-strukturuar-inal-i403600>

135 Njoftim për shtyp i Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, 19 dhjetor 2022. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-10/>; Euronews Albania, Arkivi i Inceneratorit. <https://euronews.al/en/tag/incinerator/>

136 Euronews Albania, "Ndotja në Porto Romano, ekspert mjedisor: Pasojat do të jenë të rënda." 27.04.2020. <https://euronews.al/ndotja-ne-porto-romano-eksperti-i-mjedisit-pasojat-do-te-jene-te-renda/>

137 Edmond Hoxhaj, "Sponsori "sekret" i KPK-së është kompania e sigurimeve e Shefqet Kastriotit", 19 korrik 2024. <https://www.reporter.al/2024/07/19/sponsori-sekret-i-kpk-eshte-kompania-e-sigurimeve-e-shefqet-kastriotit/>

hydrocentraleve brenda zonave të mbrojtura, të lejuara sipas ligjit të debatuar nr. 21/2024; aktiviteti i kompanive të nxjerrjes së naftës që kanë detyruar edhe evakuimin e banorëve,¹³⁸ dhe vazhdimin e shkarkimit të mbetjeve të naftës në lumenj; mungesa e landfillleve sanitare; mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza urbane; dhe ekzistenca e landfillleve ilegale dhe josanitare përgjatë brigjeve të lumenjve.¹³⁹

5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet

Shqipëria është bërë palë e të gjitha traktateve kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mjedisit. Në përgjithësi, kuadri legjislativ dhe institucional i saj është përshtatur në mënyrë që vendi të fitojë kapacitetet për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga traktate të tilla. Megjithatë, mbeten disa sfida për zbatimin e tyre në praktikë.

Rekomandime

- o Amendimi i nenit 59(2) të Kushtetutës, në mënyrë që “e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm, duke përfshirë të drejtat procedurale mjedisore të pjesëmarrjes së publikut dhe qasjen në drejtësi” të bëhet e zbatueshme në gjykatë.
- o Përmirësimi i procesit legjislativ mjedisor nëpërmjet rritjes së efektivitetit të konsultimeve publike dhe respektimit të parimit të parandalimit. Ligjvënësi duhet t’i japë një rol të spikatur ekspertizës mjedisore. Një akt i propozuar nuk duhet të miratohet kur ekspertiza është kundër tij, apo edhe e paqartë.
- o Anulimi i Ligjit nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, për shkak të mospërputhjes së tij me Konventën e Aarhusit, pjesë e rendit juridik shqiptar.
- o Përmirësimi i pjesëmarrjes dhe konsultimit publik në procesin e vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe strategjik të projekteve, planeve dhe programeve. Pjesëmarrja e publikut dhe konsultimi në procesin e vendimmarrjes mjedisore nuk duhet të kufizohet në ftesën formale të aktorëve përkatës në procesin e vendimmarrjes. Për të siguruar një kontribut real dhe kuptimplotë, aktorët përkatës duhet të përfshihen që në fazat e hershme të procesit të konsultimit. Publikut dhe OJQ-ve duhet t’u sigurohen vendime të detajuara dhe të arsyetuara që shpjegojnë se si janë marrë parasysh përfaqësimet e tyre.
- o Forcimi i administratës publike mjedisore, pranë qeverisjes qendrore dhe vendore, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme mbi ligjin dhe politikat mjedisore. Më e rëndësishmja, eliminimi i papajtueshmërisë institucionale duke rithemeluar Ministrinë e Mjedisit, të ndarë nga Ministria e Turizmit.
- o Të forcohen inspektimet dhe kapacitetet e zbatimit, në mënyrë që krimi mjedisor të luftohet në mënyrë më efektive.
- o Rritja e financimit publik për mbrojtjen e mjedisit.
- o Rritja e financimit publik për OJQ-të mjedisore.
- o Të forcohet lufta kundër krimit mjedisor dhe përpjekjet e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, përmes:
 - përmirësimit të kurrikulave për parandalimin dhe hetimin e krimit mjedisor në Akademinë e Policisë
 - përmirësimit të kurrikulave dhe forcimit të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve në legjisacionin për mbrojtjen e mjedisit

138 Gjergj Erebara, “Fshati i Marinzës evakuohet pas shpërthimit të gazit”, 1 prill 2015. <https://balkaninsight.com/2015/04/01/albania-village-evacuated-after-gas-explosion-at-oil-field/>.

139 Westminster Foundation for Democracy “Hartë e çështjeve mjedisore përgjatë bregdetit shqiptar”, 2021. <https://www.wfd.org/sites/default/files/2021-12/Mapping-of-Environmental-issues-along-the-Albanian-coastline.pdf>.

- krijimit të njësive të krimit mjedisor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe në Prokurori
- ngritjes së oficerëve ndërlidhës të policisë gjyqësore për krimet mjedisore për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë, me qëllim rritjen e efikasitetit në hetim dhe ndjekje penale
- trajnimit të zyrtarëve të administratës publike në nivel qendror dhe vendor për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, të ndarë nga konsideratat turistike
- o Ndryshimi i Ligjit nr. 107/2014 dhe VKM-së nr. 519/2017 për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit – mazhorancën ta kenë ekspertë të pavarur mjedisor
- o Gjykata e Lartë duhet të unifikojë praktikën gjyqësore jokonsistente në lidhje me *locus standi* të OJQ-ve mjedisore. Ekziston nevoja për një vendim njehësues që duhet të jetë i detyrueshëm për gjykatat më të ulëta
- o T’i jepet prioritet qasjes në drejtësi në aktivitetet e planifikuara në zonat e mbrojtura përmes një procedure më të shpejtë, të dalluar nga aktivitetet në zonat e tjera
- o Përforcimi i mbështetjes për mediat që përqendrojnë vëmendjen e tyre në problemet mjedisore, krahas veprimeve të bashkërenduara për të rritur nivelin e ulët të ndërgjegjësimit mjedisor te popullata. Kjo duhet të fillojë me të gjithë sistemin arsimor, duke përfshirë shkollat fillore dhe universitetet, administratën publike të institucioneve të pushtetit vendor dhe qendror, OJQ-të, Avokatin e Popullit dhe të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë institucionet e forta të drejtësisë që garantojnë mbrojtjen gjyqësore të mjedisit
- o Ndryshimi ligjor për të forcuar ndërmjetësimin, duke detyruar noterët që të përfshijnë ndërmjetësimin, krahas gjykimit, si një metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve në kontratat që hartojnë.
- o Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të bashkërendojë përpjekjet me median për prodhimin e programeve speciale që do të transmetohen rregullisht, në mënyrë që të ndërgjegjësohet popullata për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

6. Shtojcë

Shtojca I

[Vendimet e Këshillit të Ministrave për Zonat e Mbrojtura]

VKM nr. 59, datë 26 janar 2022, “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore: https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/VKM-59_compressed.pdf.

Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë ka depozituar një kërkesëpadi kundër kësaj VKM-je, pranë Gjykatës Administrative të Apelit me çështjen administrative nr. 97 (31155-00284-86-2023), datë 02.01.2023.

VKM nr. 60, datë 26 janar 2022, “Për shpalljen e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhuar/ park natyror (kategoria IV), si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie”: https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/e-plote-tex-tabela-VKM-nr.60-date-26.1.2022.doc.-1_compressed.pdf.

Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë ka depozituar një kërkesëpadi kundër kësaj VKM-je, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me çështjen administrative nr. 90 (31155-00323-86-2023), datë 8 shkurt 2023.

VKM nr. 694, datë 26 tetor 2022, “Për ndryshimin e statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemit natyror/ ligatinor “Pishë Poro–Nartë” nga “Rezervat natyror i menaxhuar” në “Peizazh i mbrojtur” dhe

heqjen e statusit “Zonë e mbrojtur” të sipërfaqes së pakësuar. <https://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/vendim-2022-10-26-694-1.pdf>.

Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë ka depozituar një kërkesëpadi kundër kësaj VKM-je, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me çështjen administrative nr. 188 (31155-03563-86-2022), datë 20.12.2022 .

Shtojca II

[Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, nr. 3, datë 30 janar 2024]

Në çështjen e një Hidrocentrali të planifikuar (HEC) të gjykuar nga Gjykata Kushtetuese, kërkuessit (OJQ mjedisore dhe të të drejtave të njeriut) pretenduan shkelje të së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, të parashikuar nga neni 56 i Kushtetutës, Konventa e Aarhusit, si dhe ligjet për mbrojtjen e mjedisit, sepse aktet e kontestuara ishin miratuar pa transparencë, pa informimin apo konsultimin publik në lidhje me dobinë e investimit, kufizimet e mundshme të të drejtave dhe ndikimin e ligjit mbi to, avantazhet, disavantazhet dhe pasojat që ai sjell për ekonominë, shëndetin e popullatës etj., dhe pa përfshirjen e publikut në vendimmarrje.

Po kështu aktet u miratuan pa përgatitur raportin e VNM-së të projektit për ndërtimin e HEC-it të Skavicës, i cili supozohej të ishte gati për opinione dhe komente publike në tremujorin e tretë të vitit 2022. Ata pretenduan gjithashtu shkeljen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm, të parashikuar nga neni 59 i Kushtetutës, pasi realizimi i projektit do të krijonte një mikroklimë të rajonit të karakterizuar nga lagështia e lartë në ajër, mjegulla e shtuar, ndikimi negativ i rrezatimit dhe treguesve të tjerë meteorologjikë, rritja e nivelit të karbonit në ajër si pasojë e përmbajtjes së pyjeve, gjë që do të bënte më pak të shëndetshme jetën e banorëve të pellgut. Në funksion të detyrimeve që neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit u vendos autoriteteve shtetërore përpara se të ndërmarrin aktivitete apo projekte që kanë ndikim në mjedis dhe të drejta të tjera themelore që lidhen me të, Gjykata vendosi pranimin e kërkesëpadive e kërkuessve për shkelje të së drejtës për informim publik. Kjo pasi standardet ndërkombëtare kërkojnë konsultim publik në fazat e hershme të ndërmarrjes së aktiviteteve apo aktiviteteve me ndikim në mjedis, gjë që në këtë rast nuk kishte ndodhur. Prandaj, procedura e miratimit të Ligjit nr. 38/2021 është bërë në kundërshtim me të drejtën e informimit për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij.

Gjithashtu, Gjykata konstatoi se procedura për miratimin e Ligjit nr. 38/2021 është kryer pa konsultime publike, pa dëgjuar opinionin e komunitetit të zonës, me statusin e publikut të prekur, si dhe pa vlerësuar ndikimin e projektit në mjedis dhe të drejta të tjera të lidhura me to. Megjithatë, duke pasur parasysh se projekti është ende në fazën fillestare të zbatimit, Gjykata nëpërmjet interpretimit të saj të Konventës së Aarhusit vendosi që në përputhje me detyrimet e nenit 56 të Kushtetutës dhe të Konventës së Aarhusit, shkeljet e konstatuara gjatë fazës para miratimit të Ligjit nr. 38/2021 ende mund të riparohen nëpërmjet përfshirjes së publikut në aktivitetet pas fazave të ndryshme të zhvillimit dhe zbatimit të projektit, si dhe në vendimmarrje.

Në fund, Gjykata vlerësoi se kërkesëpadija e kërkuessve për shkeljen e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij ishte e mirë argumentuar. Megjithatë, duke marrë parasysh se shkelja është e riparueshme, Gjykata vlerësoi se nuk ka vend për shfuqizimin e Ligjit nr. 38/2021.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese do të thotë se ndërtimi i HEC-it mund të vazhdojë, duke e bërë atë një mjet juridik joefektiv për sa i përket të drejtave të paditësve.

Shtojca III

[Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00 – 2021 – 1177, datë 21 korrik 2021]

Paditësit ishin një komunitet prej 27 banorësh të fshatit Margegaj në veri të Shqipërisë dhe shoqata “Toka”, një OJQ në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit. Paditësit paditën ndër të

tjera Ministrinë e Energjisë, Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe kompanitë që kishin marrë lejet, me pretendimin se ndërtimi dhe funksionimi i hidrocentraleve në zonën e Luginës së Valbonës mund të dëmtojë rëndë mjedisin e Parkut Kombëtar të Valbonës.

Lidhur me *locus standi* të paditësve, Gjykata e Lartë vendosi se rreziku i dëmtimit serioz të pakthyeshem në mjedis ofronte shkaqe të arsyeshme për dhënien e masave të përkohshme, duke i dhënë *locus standi* paditësve. Duke interpretuar standardet e përcaktuara në Konventën e Aarhusit dhe në legjislacionin shqiptar, Gjykata vendosi se e drejta për qasje në drejtësi për çështjet mjedisore ndryshon nga rastet e tjera, ku palët kishin kërkuar të kishin qasje në drejtësinë për të rikuperuar një të drejtë të shkelur.

Çështjet mjedisore janë të natyrës policentrike, larg aspektit kundërshtues formal të një gjykimi normal civil/administrativ. Sipas kontratës koncesionare, projekti "HEC Dragobia" ndodhet brenda territorit të Luginës së Valbonës, i cili në vitin 1996 u shpall "Park Kombëtar", Zonë e Mbrojtur e Kategorisë II. Zonat e mbrojtura krijohen për të siguruar ruajtjen dhe rinovimin e habitateve natyrore, specieve, rezervave dhe peizazheve natyrore. Si e tillë, gjykata vendosi se dëmi që do të shkakohej nga vazhdimi i ndërtimit të digës do të ishte i rëndë, i pakthyeshem dhe i menjehershëm, pasi mund të dëmtonte mjedisin, pikërisht në një zonë me një ndjeshmëri të lartë mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Për më tepër, gjykata vendosi se "...vlerëson praktikën gjyqësore të GJEDNJ), e cila ka trajtuar çështje mjedisore që lidhen me zbatimin e nenit 8 të KEDNJ-së, duke theksuar se në çështjet mjedisore, shtetet kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi dhe se në këto raste së pari duhet të shqyrtohet thelbi i vendimmarrjes publike dhe së dyti duhet të shqyrtohet procesi i vendimmarrjes, në mënyrë që të sigurohet që interesave individuale t'u jepet pesha e duhur.

GJEDNJ-ja ka vlerësuar se procesi i vendimmarrjes në lidhje me çështje komplekse mjedisore dhe ekonomike duhet të përfshijë para së gjithash hetimet dhe studimet e duhura për efektet paraprake që mund të kenë në dëmtimin e mjedisit dhe shkeljen e të drejtave individuale, në mënyrë që të arrihet një ekuilibër i drejtë midis të drejtave në konflikt. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se individët e interesuar duhet të jenë në gjendje të ankimojnë në rrugë gjyqësore vendimet, veprimet/mosveprimet kur vlerësojnë se interesave apo komenteve të tyre nuk u është dhënë pesha e duhur në procesin e vendimmarrjes. (Shih Giacomelli k. Italisë, 2006, parag. 83)." [Paragrafi 51 i Vendimit nr. 00 – 2021 – 1177, datë 21 korrik 2021, i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë]. Megjithatë, më e rëndësishmja, Gjykata e Lartë rrëzoi vendimet e dy gjykatave më të ulëta që i kishin dhënë përparësi një interesi tjetër publik, prodhimit të energjisë, duke deklaruar se "gjykatat duhet të kishin analizuar mbizotërimin e një interesi më të madh publik, atë të mbrojtjes së mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit. Mjedisit është një koncept ekstraterritorial, i cili shkon përtej kufijve të një vendi. Mbrojtja e mjedisit është një kusht themelor për sigurimin e zhvillimit të shoqërisë dhe është një prioritet kombëtar, i cili synon të kalojë një mjedis të padëmtuar ndër breza." [Paragrafi 52].

Shtojca IV

[Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 80-2022-3301, datë 2 dhjetor 2022]

OJQ-ve iu mohua *locus standi*. Gjyqtari vendosi se "...paditësit, në cilësinë e OJQ-ve, nuk po kundërshtojnë një akt normativ... sepse nuk jemi në rastin e një vullneti të shprehur të autoritetit publik, në ushtrimin e detyrës së tij publike, që rregullon disa marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke përcaktuar rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe që nuk shteron zbatimin e tij. Gjithashtu, palët nuk mund të ngrejne padi administrative, sepse kjo e drejtë nuk është parashikuar në Ligjin 107/2014 "Për planifikimin e territorit", në bazë të të cilit është shpallur vendimi nr. 4, datë 24.11.2021 i Këshillit Kombëtar të Territorit." [parag. 17 i vendimit]. Më tej gjyqtari u shpreh se "Gjithashtu, paditësit nuk posedojnë *locus standi* sepse asnjë nga interesat e tyre legjitime dhe faktike nuk janë cenuar nga veprimtaria administrative e të paditurve. Ky konkluzion bazohet edhe në Konventën e Aarhusit, e cila është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me Ligjin nr. 8672, datë 26 tetor 2000, dhe për rrjedhojë është e detyrueshme dhe e zbatueshme drejtpërdrejt." [parag. 18 i vendimit]. "Konventa e Aarhusit u jep paditësve qasje në

gjykatë vetëm për: 1. Çështje që kanë të bëjnë me qasjen në informacion; 2. Pjesëmarrje në vendimmarrje për aktivitete të caktuara të renditura në Shtojcën 1. Në Shtojcën 1 të Konventës së Aarhusit nuk është renditur ndërtimi i hidrocentraleve.” [parag. 24 i vendimit].

Ky vendim është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Apelit, por jo për interpretimin e *locus standi*, por sepse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë nga një gjyqtar i vetëm, ndërsa është dashur të merret nga trupi gjykues prej tre gjyqtarësh. [Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 484, datë 22.06.2023].

Paditësit kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar marrjen si masë të përkohshme, pezullimin e punimeve për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës, për shkak të dëmit të pariparueshëm në Zonën e Mbrojtur. Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nr. 49, datë 22 qershor 2023, deklaroi mungesën e kompetencës për masën e përkohshme dhe dërgoi çështjen për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dërgoi çështjen në Gjykatën e Lartë, e cila vendosi në vendimin e saj nr. 00-2023-3466, datë 31 qershor 2023 se gjykata kompetente për masën e përkohshme është Gjykata Administrative e Apelit. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj nr. 3, datë 16 janar 2024 refuzoi të urdhëronte marrjen e masës së përkohshme (në momentin e vendimit rreth 30% e punimeve të ndërtimit kishte përfunduar në Aeroportin e Vlorës).

Me ankimim të posaçëm të Avokatit të Shtetit, çështja është dërguar në Gjykatën e Lartë më 23 tetor 2023.

Gjykatës së Lartë iu deshën pesë muaj pas regjistrimit të çështjes dhe nëntë muaj pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, për të vendosur përmes vendimit nr. 31003-00443-00-2023, datë 11 mars 2024 për: «*anulim të vendimit nr. 484 (86-2023-691), datë 22.06.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të kthejë çështjen për tu gjykuar nga i njëjti kolegji*».

Deri në dorëzimin e këtij raporti, vendimi i Gjykatës së Lartë të marsit 2024 ende nuk është zbardhur. Ndaj, dosja ende nuk është dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, për vazhdimin e gjykimit, ndërkohë që ndërtimi i aeroportit po i afrohet përfundimit.

Shtojca V

[Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 20, datë 05 mars 2024]

Paditëse, “Ayen-Alb”, ka qenë shoqëria koncesionare që ka lidhur një kontratë koncesionare me Ministrinë e Energjisë për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit në lumin Vjosa. Koncesionarit iu kërkuar të merrte lejet dhe licencat e nevojshme, duke përfshirë deklaratën mjedisore, aktin administrativ të nxjerrë nga Ministria e Mjedisit që përcakton ndikimin mjedisor të projektit të synuar. Ministria e Mjedisit, bazuar në propozimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kishte nxjerrë një deklaratë negative mjedisore për ndërtimin e hidrocentralit. Projekti u kundërshtua ashpër edhe nga shoqëria civile, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kërkuar anulimin e projektit. Paditësi ka bërë ankimim administrativ dhe më pas padi për anulimin e deklaratës mjedisore me argumentin se ishte e paligjshme. Paditësi pretendoi se ndikimi në mjedis nuk do të ishte negativ dhe kërkoi vazhdimin e projektit, si fitues i kontratës koncesionare. Në gjykatë ndërhyjnë OJQ-të “Eco Albania”, “EuroNatur” dhe “Riverwatch”, si dhe 39 banorë të Kalivaçit.

Gjykata Administrative ka vendosur në favor të tyre, me argumentin se janë palë të interesuara në procesin e vendimmarrjes mjedisore. Referuar legjislacionit shqiptar dhe Konventës së Aarhusit, ata kanë të drejtë të jenë palë në procedurat gjyqësore, duke pasur të drejtën të dëgohen dhe të paraqesin pretendimet e tyre. Sa i përket themelit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka rrëzuar kërkesëpadinë, duke vendosur se Deklarata Mjedisore është lëshuar në përputhje me ligjin. Gjykata theksoi se ky akt administrativ ofron të gjitha argumentet që kanë shtyrë organin kompetent të lëshojë një deklaratë negative mjedisore dhe nuk ka asnjë arsye që ky akt të shpallet i pavlefshëm. Gjithashtu u vu re se në momentin e gjykimit lumi Vjosa u shpall park kombëtar/rezervat natyror i menaxhuar me një rëndësi të madhe.

Bosnjë e Hercegovinë: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

1. Hyrje

Nënshkrimi i Marrëveshjeve së Paqes së Dejtonit shënoi një pikë kthese vendimtare për Bosnje dhe Hercegovinën (BiH), duke i dhënë fund një kapitulli të dhunshëm në historinë e saj moderne. Shtojca IV e këtyre marrëveshjeve përcaktoi kushtetutën e BiH-së. Kjo kushtetutë krijoi një strukturë të decentralizuar qeverisëse ku, administrativisht, BiH përbëhet nga dy entitete: Federata e BiH-së (FBiH) dhe Republika Srpska (RS), Distrikti Brčko i BiH-së (BDBiH) dhe 10 kantone brenda FBiH-së. Çdo nivel qeveritar ka kushtetutën e vet, qeverinë, asamblenë parlamentare dhe gjyqësorin, të cilat funksionojnë me autonomi të konsiderueshme. Në përgjithësi, BiH ka 14 kushtetuta, 4 sisteme ligjore dhe më shumë se 150 ministri.¹⁴⁰

Duke pasur parasysh kompleksitetin e strukturës qeverisëse të BiH-së, çdo nivel i qeverisjes ka autoritetet e veta legjislative dhe ekzekutive. Kjo përfshin legjislacionin që rregullon mbrojtjen e mjedisit. Ngjashëm, autoriteti gjyqësor është krijuar si një autoritet i veçantë në nivele të ndryshme.

Pranimi i BiH-së në Këshillin e Evropës në vitin 2002 dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE) në vitin 2008 shënuan momente të rëndësishme në aspiratën e saj për t'u bërë një vend anëtar i BE-së. Si një vend kandidat i njohur që nga viti 2016, përpjekjet e BiH-së për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së kanë qenë një nga forcat kryesore shtytëse pas reformave të mbrojtjes së mjedisit dhe të të drejtave të njeriut. Megjithatë, sistemi kompleks dhe i fragmentuar i qeverisjes së BiH-së ka penguar zbatimin efektiv të këtyre reformave dhe ka ngadalësuar përparimin e saj drejt pranimit në BE.

2. E drejta materiale dhe praktika

2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis

2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare

Dispozitat kushtetuese në BiH nuk i kanë kushtuar vëmendje të tepruar rregullimit të të drejtave ekologjike, pra të drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe përfshirjes së tij në korpusin e të drejtave themelore kushtetuese. Vetëm Kushtetuta e Republikës Srpska ofron një përkufizim konkret të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm,¹⁴¹ ndërsa në tekste të tjera kushtetuese kjo nuk është bërë, dhe çështjet mjedisore përmenden brenda fushëveprimit të juridiksionit.¹⁴²

140 UNDP, Bosnja dhe Hercegovina dhe Korniza e Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm e Organizatës së Kombeve të Bashkuara 2021-2025, Partneritet për Zhvillim të Qëndrueshëm. Gjetet në: <https://is.gd/zRLktq>.

141 Kushtetuta e Republikës Srpska thotë shprehimisht se "një person ka të drejtë për një mjedis të shëndetshëm" dhe se çdokush ka për detyrë, në përputhje me ligjin dhe brenda mundësive të tij, të mbrojë dhe përmirësojë mjedisin.

142 Kushtetuta e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës ("Gazeta Zyrtare e FBiH-së", nr. 1/94, 13/97, 16/02, 22/02, 52/02, 60/02, 18/03, 63/03, 9/04, 20/04, 33/04, 71/05, 72/05 dhe 88/08), nuk e përmend shprehimisht të drejtën për mjedisin apo të drejtat e lidhura me to. Megjithatë, ajo thotë brenda Kushtetutës se garantimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e mjedisit njerëzor bien nën juridiksionin e përbashkët të FBiH-së dhe kantoneve (II/A/neni 2, III/neni 2/a, c.). Për shembull, Kushtetuta e Kantonit të Sarajevës thotë se brenda kornizës së juridiksionit të përbashkët me FBiH-në, Kantoni i Sarajevës në mënyrë të pavarur ose në koordinim me autoritetet federale garanton dhe zbaton të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit njerëzor. Kjo parashikohet ngjashëm në kushtetutat e Kantonit Una-Sana, Kantonit Tuzla, Kantonit Zenica-Doboj, Kantonit Hercegovina-Neretva, Kantonit Qendror të Bosnjës dhe Kantonit Boshnjak-Podrinje Gorazde. Kushtetutat e Kantonit të Posavinës, Kantonit 10 dhe Kantonit të Hercegovinës Perëndimore nuk e përmenden në mënyrë eksplicite të drejtën për një mjedis të shëndetshëm.

Neni II i Kushtetutës së BiH-së garanton të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë të drejtën për jetën private dhe familjare, që ndikon indirekt në çështjet mjedisore, lidhur me një mjedis të shëndetshëm jetese.¹⁴³ E drejta për një mjedis të shëndetshëm bie nën konceptin e së drejtës për jetë dhe është pjesë përbërëse e kësaj të drejte, si një e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Kushtetutë për të gjithë qytetarët. Rrjedhimisht, mbrojtja e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm si e drejtë e njeriut është e mundur përmes mjeteve të ndryshme juridike në fushën e së drejtës administrative, së drejtës penale dhe drejtës civile.

Të drejtat e njeriut në BiH duhet të mbrohen nga autoritetet publike vendase, duke përfshirë të gjitha entitetet brenda entiteteve dhe Distriktit Brčko, si dhe kantonet, komunat dhe vetë shtetin.¹⁴⁴ Mbrojtja mund të kërkohej para gjykatave vendase, por qytetarët kanë gjithashtu të drejtë të paraqesin shkelje të të drejtave të tyre themelore para organeve në procedurat administrative, civile dhe penale. Individët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Kushtetuese pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike. KEDNJ-ja është drejtpërdrejt e zbatueshme, duke zëvendësuar ligjet vendase dhe duke siguruar që individët të mund të pretendojnë të drejtat e tyre përpara gjykatave vendase dhe Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, ekziston institucioni i Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut, i cili merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut si të personave fizikë ashtu edhe atyre juridikë në përputhje me garancitë e dhëna me Kushtetutën e BiH-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare të aneksuara në Kushtetutë.

2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit

Korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit në BiH është i strukturuar në nivele të ndryshme të qeverisjes, duke pasqyruar strukturën komplekse administrative të vendit. Sipas kompetencave të saj kushtetuese, mbrojtja e mjedisit në BiH është e fragmentuar në sisteme të shumta ligjore dhe nivele administrative, pa ligj mjedisor të unifikuar në nivel shtetëror. Kompetencat kushtetuese të shtetit në këtë fushë janë të kufizuara;¹⁴⁵ prandaj, legjislacioni përfshin kryesisht legjislacionin e entitetit,¹⁴⁶ atë kantonal dhe të Distriktit Brčko.¹⁴⁷

Të dy entitetet dhe BDBiH kanë një grup ligjesh gjithëpërfshirëse që trajtojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë ligjet për mbrojtjen e natyrës, mbetjet dhe menaxhimin e ujrave. Këto ligje ofrojnë një kornizë për rregullimin e aktiviteteve mjedisore dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Çdo ent fokusohet në përmirësimin e standardeve mjedisore dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së për të përmirësuar menaxhimin dhe shërbimet mjedisore.

Një pjesë e legjislacionit synon drejtpërdrejt mbrojtjen e mjedisit dhe trajton çështje që lidhen me mjedisin njerëzor, ndërsa shumë ligje të tjera prekin pjesërisht çështjet mjedisore dhe mbrojtjen e tyre.

Të gjitha ligjet për mbrojtjen e mjedisit¹⁴⁸ në BiH vendosin kornizën për mbrojtjen e mjedisit. Këto ligje kërkojnë që çdo individ dhe organizatë t'u përmbahet standardeve mjedisore dhe t'i

143 Kushtetuta e Bosnjë dhe Hercegovinës, gjendet në: <https://www.ustavnisud.ba/>.

144 Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët e BiH-së mbikëqyr të drejtat e njeriut në nivel kombëtar, ndërsa njësitë, rrethet dhe kantonet mbajnë ministrinë dhe departamentet e tyre të dedikuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të përforcuara nga agjenci të ndryshme të ngarkuara me monitorimin dhe zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut. Në të gjitha nivelet e qeverisjes në BiH, komisionet dhe komitetet parlamentare trajtojnë në mënyrë aktive çështjet e të drejtave të njeriut, duke nënvizuar angazhimin e BiH-së për të mbrojtur liritë dhe për të mbështetur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në mes të strukturës së saj komplekse qeverisëse dhe përpjekjeve të vazhdueshme për integrim në BE.

145 Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike e BiH-së mbikëqyr koordinimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel shtetëror, duke punuar me entitete të ndryshme, institucione dhe organe ndërkombëtare.

146 Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, Republika Srpska dhe Distrikti Brčko i BiH-së kanë krijuar institucionet e tyre për menaxhimin e mjedisit. Në Federatë, përgjegjësitë mjedisore menaxhohen nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, ndërsa në Republika Srpska, ato bien nën Ministrinë e Planifikimit të Territorit, Inxhinierisë Civile dhe Ekologjisë.

147 Detyrat mjedisore të Distriktit Brčko trajtohen nga Nën-Departamenti për Lëshimin e Lejeve të Ndërtimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit brenda Departamentit për Planifikim e Territorit dhe Çështje Pronësore.

148 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e FBiH-së", nr. 15/21); Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e Republikës Srpska", nr. 71/12, 79/15 dhe 70/20); Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ("Gazeta Zyrtare e Distriktit Brčko të BiH-së", nr. 24/04, 1/05, 19/07 dhe 9/09).

mbajë ata përgjegjës për çdo dëm mjedisor. Ato përfshijnë dispozita për vlerësimet e ndikimit në mjedis (VNM), të cilat duhet të marrin në konsideratë ndikimet e mundshme të të drejtave të njeriut. Kompanitë duhet të kryejnë VNM për projektet që mund të ndikojnë në mjedis dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e VNM-së është e detyrueshme,¹⁴⁹ duke siguruar që komunitetet e prekura potencialisht nga aktivitetet e korporatës të kenë fjalën e tyre. Dënimet për mospërputhje përfshijnë gjambat dhe riparimin e detyrueshëm të dëmit mjedisor.¹⁵⁰ Për t'i dhënë dëmshpërblim ose për të marrë mbrojtje ligjore, çdo palë e interesuar ka të drejtë të kërkojë mbrojtje në procedurat administrative dhe gjyqësore. Çdo individ ka gjithashtu të drejtën e qasjes së barabartë në informacionin mjedisor, pavarësisht nga gjinia, mosha, përkatësia fetare dhe racore. Gjithashtu, ligjet për mbrojtjen e natyrës përfshijnë dispozita që kufizojnë aktivitetet që mund të dëmtojnë zonat e mbrojtura dhe kërkojnë restaurim dhe kompensim në rastet e dëmtimit mjedisor të shkaktuar nga veprimet e korporatave.¹⁵¹

Megjithatë, progresi në përafrimin e legjislacionit mjedisor me direktivat e BE-së për VNM, VSM, përgjegjësinë mjedisore dhe krimin mjedisor mbetet i kufizuar, duke penguar zbatimin efektiv të standardeve të mbrojtjes së mjedisit në mbarë vendin.¹⁵²

2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare

BiH ka nënshkruar dhe ratifikuar shumicën e traktateve kryesore ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, duke reflektuar angazhimin e saj ndaj standardeve ndërkombëtare,¹⁵³ duke përfshirë Konventën e Aarhusit dhe Konventën e Tromsø.¹⁵⁴ Duke adoptuar një qasje moniste, BiH lejon që traktatet ndërkombëtare të zbatohen drejtpërdrejt brenda sistemit të saj ligjor kombëtar pa pasur nevojë për legjislacion shtesë.¹⁵⁵

2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

Siç u tha më parë, dispozitat kushtetuese të BiH-së nuk trajtojnë në mënyrë eksplicite të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Megjithatë, kushtetuta ofron një kornizë për të drejtat e njeriut, nga e cila mund të nxirren të drejtat mjedisore. Kjo mbrojtje më e gjerë e të drejtave të njeriut mund të përdoret për të adresuar çështjet mjedisore nëpërmjet interpretimit gjyqësor dhe zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Gjykata Kushtetuese e BiH-së ka zhvilluar një jurisprudencë të fortë në fushën e të drejtave të njeriut, duke zbatuar standardet e zhvilluara nga GJEDNJ duke u bërë një arbitër i çështjeve kryesore kushtetuese që zhvillon një jurisprudencë të përshtatshme për këtë çështje. GJEDNJ ka ndikuar ndjeshëm në vendimet gjyqësore në BiH, veçanërisht në vendosjen e standardeve për një gjykim të drejtë dhe të drejtën për një mjedis të shëndetshëm brenda kornizës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

149 Nenet 35., 36., dhe 59. të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit të BDBiH-së, gjendet në: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/bih131214.pdf>; neni 40 i Ligjit Federal për Mbrojtjen e Mjedisit, gjendet në: <https://rb.gy/phpjdx>. Neni 39. i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit të Republikës Srpska, gjendet në: <https://rb.gy/3nmoop>.

150 Nenet 99.-107. të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit të BDBiH-së; neni 142 i Ligjit Federal për Mbrojtjen e Mjedisit; neni 132. i Ligjit të Republikës Srpska për Mbrojtjen e Mjedisit.

151 Ligji për mbrojtjen e natyrës i Federatës së BiH-së ("Gazeta Zyrtare e FBIH-së", nr. 66/13) gjendet në: <https://is.gd/Qh3jnG>; Ligji për mbrojtjen e natyrës të Republikës Srpska ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 49/04), gjendet në: <https://is.gd/2Jh0bM>; Ligji për mbrojtjen e natyrës i Distriktit Brčko i BiH-së ("Gazeta Zyrtare e BD i BiH-së", nr. 24/04, 1/05, 19/07 dhe 9/09), gjendet në: <https://rb.gy/e9b9v8>.

152 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2024, f. 84 gjendet në: <https://tinyurl.com/4nnmk5dy>.

153 Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike të BiH-së, Një listë e konventave dhe marrëveshjeve të nënshkruara për mbrojtjen e mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/69O3wc>.

154 Një përmbledhje e konventave dhe protokolleve të tjera të ratifikuara në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, marrëveshjeve dypalëshe dhe mekanizmave të krijuar me qëllim zbatimin e marrëveshjeve/traktateve/konventave ndërkombëtare të ratifikuara është në dispozicion këtu: <https://is.gd/R0ssPs>. f. 9-12.

155 Vehabović, F. 2006. Marrëdhënia ndërmjet Kushtetutës së Bosnjë-Hercegovinës dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, f. 50. Gjendet në: <https://rb.gy/z8z59f>.

Sipas juridiksionit të saj apelues siç përcaktohet në Kushtetutë,¹⁵⁶ Gjykata ka trajtuar çështje që lidhen me zbatimin e ligjeve mjedisore. Megjithatë, raste të tilla janë relativisht të pakta për shkak të zhvillimit të kufizuar të praktikës gjyqësore mjedisore në BiH. Megjithatë, vendimet e Gjykatës formojnë kolektivisht një kornizë themelore për interpretimin dhe zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit në BiH, duke i përafëruar ato me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁵⁷ Megjithatë, efektiviteti i disa vendimeve shpesh minohet nga mekanizmat e papërshtatshëm të zbatimit. Edhe pse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme,¹⁵⁸ ndërhyrja politike e ndërlikon më tej aplikimin e vazhdueshëm,¹⁵⁹ duke çuar në zbatimin jokonsistent të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Raportet tregojnë se shumë autoritete publike nuk respektojnë vendimet e Gjykatës, duke theksuar nevojën për masa më të forta përmbarimore.¹⁶⁰

2.2.1. Praktika dhe vendimet gjyqësore

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BiH-së theksojnë nevojën për vendime gjyqësore të dhëna në kohë, zbatimin e rregulloreve mjedisore,¹⁶¹ dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve në

156 Neni VI/3. b) i Kushtetutës së Bosnjë dhe Hercegovinës. Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës ka juridiksion apelues mbi çështjet kushtetuese që dalin nga çdo vendim gjykatë brenda vendit. Ankesat shqyrtohen vetëm nëse të gjitha mjetet juridike efektive janë shteruar dhe nëse janë depozituar brenda 60 ditëve nga vendimi përfundimtar. Përfundimisht, Gjykata mund t'i shqyrtojë ankesat pa një vendim paraprak të gjykatës nëse ato pretendojnë shkelje të rënda të të drejtave kushtetuese ose dokumenteve përkatëse ndërkombëtare. Gjykata shërben si autoriteti përfundimtar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive kushtetuese, me kompetencën për të anuluar vendimet dhe për të urdhëruar rigjykim. Për më tepër, ai mund të vlerësojë përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, KEDNJ-në ose të drejtën ndërkombëtare publike, siç referohet nga çdo gjykatë në Bosnje dhe Hercegovinë.

157 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit.

158 Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sanksionohet sipas nenit 239. të Kodit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës ("Gazeta Zyrtare e BiH", nr. 3/2003, 32/2003 - ispr., 37/2003, 54/2004, 61/2004, 30/2005, 53/2006, 55/2006, 8/2010, 47/2014, 22/2015, 40/2015, 35/2018, 46/2021, 31/2023 i 47/2023) gjendet në: <https://is.gd/MFpTEs>.

159 Gjykata Kushtetuese e Bosnje dhe Hercegovinës ka nxjerrë disa vendime për mbrojtjen e mjedisit dhe rregullimin e menaxhimit të burimeve natyrore, por këto vendime shpesh injorohen ose zbatohen në mënyrë joadekuate nga njësitë dhe autoritetet vendore. Ndërhyrjet politike dhe konfliktet e interesit, veçanërisht në dhënie të koncesioneve për hidrocentralet, minierat dhe pyjet, shpesh i minojnë këto vendime. Janë dhënë koncesione në zonat e mbrojtura pavarësisht urdhrave të gjykatës për të ndaluar, duke çuar në degradim mjedisor dhe dëmtim të komuniteteve vendore. Problemi përkeqësohet nga mungesa e transparencës, me ligje të shumta (14 ligje të ndryshme) që rregullojnë koncesionet, por pak qasje publike në informacion, duke rritur rrezikun e korrupsionit dhe duke kufizuar aftësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje. *Shih:* Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të BiH-së në lidhje me çështjen e pronës shtetërore në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjenden në: <https://is.gd/sdjMrV>; Transparency International BiH, 14 nivele të mostransparencës: Informacionet për koncesionet janë të fshehura nga publiku, pasojat janë korrupsioni dhe shkatërrimi i mjedisit, gjenden në: <https://is.gd/JXxwZl>.

160 Raporti përmbledhës mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, gjendet në: <https://is.gd/QuESvh>. Edhe pse mosrespektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të BiH-së është vepër penale, mekanizmat e zbatimit nuk funksionojnë në mënyrë efektive. Në mënyrë të veçantë, raporti thekson se Zyra e Prokurorit të BiH-së shpesh ka dështuar të veprojë në rastet e moszbatimit. Në shumë raste, hetimet ose nuk u kryen ose u pezulluan pa arsytim të mjaftueshëm. Kjo tregon se, pavarësisht kuadrit ligjor në fuqi, ka një boshllëk thelbësor në zbatimin aktual, kryesisht për shkak të mosveprimit ose joefikasitetit të prokurorisë. Kjo mungesë zbatimi shoqërohet me ndërhyrje politike, ku subjektet politike mund të ndikojnë ose të bëjnë presion mbi proceset gjyqësore, duke çuar në një situatë ku vendimet që duhet të jenë ligjërisht të detyrueshme nuk zbatohen. Problemi nuk është vetëm te ekzistenca e ligjeve dhe mekanizmave zbatues, por tek zbatimi i tyre, i cili shpeshherë pengohet nga faktorë politikë dhe institucionalë.

161 Vendim nr. AP-1170/14, datë 15 shkurt 2017. Apeli i bërë nga JP "EP BiH" u rrëzua, me gjykatën që pohoi detyrimin për të paguar tarifat për ndotjen e ajrit sipas parashikimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kantonit të Tuzlës. Çështja përfshinte mosmarrëveshje mbi zbatueshmërinë e ligjeve të vjetra pas miratimit të legjislacionit të ri mjedisor në vitin 2003. Gjykata pohoi zbatimin e rregulloreve ekzistuese mjedisore, të tilla si detyrimi për të paguar tarifat për ndotjen e ajrit, edhe në mes të ndryshimeve legjislative. Ky vendim nënvizoi vazhdimësinë dhe zbatueshmërinë e ligjeve mjedisore, duke siguruar që ndotësit të mbeten përgjegjës për ndikimet e tyre mjedisore. *Shih:* <https://is.gd/R0ssPs>.

kontekstin e dëmtimit mjedisor.¹⁶² Për shembull, në rastin AP-2941/22,¹⁶³ Gjykata njohu rëndësinë e vendimeve gjyqësore në kohë, veçanërisht në çështjet mjedisore që prekin shëndetin e njeriut. Ajo theksoi se vonesat cenojnë të drejtën për qasje efektive në drejtësi, duke theksuar ndërlidhjen e efikasitetit gjyqësor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese shpesh e lidh mbrojtjen e mjedisit me të drejtat themelore të njeriut në vendimet e saj. Për shembull, në rastet në lidhje me lejet mjedisore dhe implikimet e tyre për shëndetin publik dhe të drejtat e pronësisë, Gjykata ka mbështetur të drejtat e garantuara si nga Kushtetuta e BiH-së ashtu edhe nga KEDNJ. Kjo tregon një njohje të domosdoshmërisë për të integruar konsideratat mjedisore në kuadrin më të gjerë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Gjykata gjithashtu shpesh i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së kur interpreton të drejtat. Për shembull, në rastin AP-3016/17,¹⁶⁴ Gjykata Kushtetuese vlerësoi ndotjen akustike kundrejt kufijve të përcaktuar ligjorë. Kjo tregon një angazhim për të përafuar praktikën e brendshme gjyqësore me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke siguruar që interpretimet e brendshme të të drejtave të pasqyrojnë jurisprudencën e vendosur evropiane.

Pavarësisht numrit relativisht të ulët të rasteve që trajtojnë në mënyrë specifike legjislacionin mjedisor, vendimet ekzistuese ofrojnë njohuri të rëndësishme në qasjet gjyqësore për balancimin e shqetësimeve mjedisore me të drejtat e njeriut. Këto njohuri tregojnë se gjykatat njohin dhe zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa e Aarhusit, që mbrojnë të drejtën për të pasur qasje në informacionin mjedisor, inkurajojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe sigurojnë qasje në drejtësi.¹⁶⁵ OJQ-të për mbrojtjen e mjedisit dhe organizatat e tjera qytetare luajnë një rol jetik në rritjen e cilësisë së paraqitjes së çështjeve para gjykatave. Përfshirja e tyre, së bashku me konsultimet me profesionistët përkatës, siguron përdorimin efektiv të mjeteve juridike të disponueshme dhe përmirëson ndjeshëm cilësinë e vendimeve gjyqësore në lidhje me të drejtat mjedisore.¹⁶⁶ Për më tepër, ligjet vendase në lidhje me mbrojtjen e mjedisit interpretohen dhe zbatohen në përputhje me standardet e përcaktuara nga GJEDNJ dhe KEDNJ. Në BiH, mbrojtja gjyqësore e të drejtës për

162 Vendim nr. AP-3016/17, datë 17 korrik 2019. Ankesa në lidhje me zhurmën e tepërt dhe mbeturinat nga një kënd lojërash u rrëzua. Gjykata nuk konstatoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë ose të drejtës së pronësisë, duke vënë në dukje se asnjë matje zyrtare nuk konfirmoi nivele të tepërta zhurmash dhe mbetjeve përtej kufijve ligjorë. Gjykata kërkoi prova konkrete për të mbështetur pretendimet për dëmtim mjedisor. Kjo qasje siguron që vendimet janë të bazuara në të dhëna të verifikueshme, duke reflektuar standardet e KEDNJ-së për gjykim të drejtë dhe mbrojtjen e pronësisë. Shih: <https://is.gd/R0ssPs>.

163 Në vendimin nr. AP-2941/22, datë 18 tetor 2022, gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit II/3. e të Kushtetutës së BiH-së dhe nenit 6(1) të KEDNJ. Dështimi i Gjykatës kantonale në Sarajevë për të zgjidhur një ankesë në lidhje me anulimin e një vendimi për lejen mjedisore brenda dhjetë muajve u vlerësua si shkelje e së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, veçanërisht duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Gjykata nënvizoi nevojën për zgjidhje të menjëhershme të mosmarrëveshjeve mjedisore që përfshijnë interesin publik. Shih: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>.

164 Në vendimin AP3016/17 (17 korrik 2019), Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë një poshtë ankesë kundër Gjykatës së Lartë të FBiH-së dhe Gjykatës Kantonale në Goražde, duke mos gjetur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, pronësisë apo banesës. Gjykatat vendosën se zhurma dhe mbetjet nga një kënd lojërash nuk i kalonin kufijtë ligjorë dhe ishin të pranueshme duke pasur parasysh kontekstin urban, duke iu referuar standardeve të GJEDNJ-së për emetimet e dëmshme, duke përfshirë Fadeyeva k. Rusicë. Shih: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>.

165 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit; Shih: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>; Portali i Praktikës Gjyqësore të Bosnje dhe Hercegovinës (Portal sudske prakse u Bosni i Hercegovine) gjendet në: <https://sudskapraksa.pravosudje.ba/>

166 Vendimi i Gjykatës së Lartë të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Numri i çështjes: 09 0 U 027991 20 Uvp i datës 9 dhjetor 2021. Në këtë rast është përfshirë OJQ-ja "EKOTIM" nga Sarajeva, ku gjykata konfirmoi të drejtën e OJQ-së për të marrë pjesë në procesin ligjor lidhur me lejet mjedisore. OJQ-ja dha informacione të rëndësishme teknike dhe vlerësime të detajuara mjedisore që sfiduan përshtatshmërinë e lejes mjedisore për Termocentralin e Tuzlës. Gjykata pranoi në mënyrë eksplicite kontributin e OJQ-së në sigurimin e të dhënave të rëndësishme mjedisore dhe informacionit teknik, i cili ishte vendimtar në vlerësimin e përshtatshmërisë së lejes mjedisore. Gjithashtu, Vendimi i Gjykatës së Lartë të Republikës Srpska: Numri i çështjes: 15 0 U 004076 19 Uvp i datës 3 mars 2021. Ky rast kishte të bënte me dhënien e lejes për ndërtimin e një mini hidrocentrali, ku gjykata njohu interesin dhe të drejtat e OJQ-së në procedurat administrative. Kuptimi i OJQ-së për ligjin mjedisor u mundësoi atyre të kundërshtonin me sukses lejen mbi baza ligjore që mund të ishin anashkaluar nga palët më pak të ditura.

një mjedis të shëndetshëm bazohet kryesisht në parime të tilla si ligjshmëria, qasja në drejtësi dhe rishikimi gjyqësor. Gjykata Kushtetuese ka treguar gatishmëri për të siguruar që kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit të zbatohet në përputhje me normat ndërkombëtare, duke treguar një qëndrim proaktiv.¹⁶⁷

Në përgjithësi, analiza e praktikës gjyqësore të disponueshme nga gjykatat e BiH tregon se ato përgjithësisht interpretojnë ligjet ekzistuese për të mbështetur standardet mjedisore, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit si një imperativ ligjor. Gjykatat e BiH-së i kanë marrë seriozisht detyrat e tyre për ruajtjen e mjedisit, duke zbatuar ligjet në përputhje me konventat ndërkombëtare si Konventa e Aarhusit dhe KEDNJ-së. Ata kanë theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit. Megjithatë, ka edhe sfida, veçanërisht në lidhje me konsistencën dhe zbatimin e praktikave gjyqësore në mbrojtjen e mjedisit. Disa raste janë minuar nga gabime procedurale ose prova të pamjaftueshme,¹⁶⁸ ku kërkesat për dëmshpërblime u janë rrëzuar pavarësisht njohjes së shkeljeve mjedisore. Këto raste ilustrjnë sfidat e vazhdueshme lidhur me konsistencën procedurale dhe barrën e provës në proceset gjyqësore mjedisore, edhe kur gjykatat pranojnë shkelje të standardeve mjedisore.

3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore

3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes

3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor

Qasja në informacion në BiH, duke përfshirë informacionin mjedisor, mbështetet përmes ligjeve për lirinë e qasjes në informacion.¹⁶⁹ Këto ligje kërkojnë që autoritetet publike duhet të ofrojnë qasje në informacion sipas kërkesës dhe të publikojnë në mënyrë proaktive informacione me interes publik. Për më tepër, çdo person ka të drejtën e qasjes në informacionin e mbajtur nga

167 Në Vendimin AP-2941/22 (tetor 2022), Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë për shkak të vonesës në trajtimin e çështjes së një leje mjedisore, duke theksuar nevojën për urgjencë në çështje të tilla, veçanërisht ato që prekin shëndetin e njeriut dhe mjedisin, duke nënvizuar angazhimin e saj për të respektuar KEDNJ, veçanërisht nenin 6, i cili garanton qasjen në drejtësi. Ngjashëm, në Vendimin AP 1170/14, Gjykata mbështeti zbatimin e një detyrimi financiar në lidhje me ndotjen e mjedisit, në përputhje me standardet vendase dhe ndërkombëtare si Konventa e Aarhusit. Gjykatat në BiH zbatojnë gjithnjë e më shumë standardet ndërkombëtare, si nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së, veçanërisht në rastet që përfshijnë aktivitete të rrezikshme. Vendimet e dukshme përfshijnë Gjykatën Kantonale në Sarajevë që anulon një leje për Hidrocentralin Rama për shkak të pjesëmarrjes joadekuate të publikut (Vendimi i Gjykatës Kantonale në Sarajevë, numër: 09 0 U 005987 10 i datës 11 mars 2014.), dhe gjykatat e Tuzlës që mbajnë përgjegjësi publike për ndotjen e ajrit nga termocentralet (Vendimi i Gjykatës Supreme të Federatës, numër: 32 0 Ps 132251 12 Rish., i datës 26 dhjetor 2013.). Këto raste nxjerrin në pah angazhimin e gjyqësorit për zbatimin e ligjeve mjedisore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

168 Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Zenicë, numër: 43 0 P 137327 16 P, i datës 25 mars 2022. Rasti përfshinte paditësit H.E. dhe H.R. kundër kompanisë së prodhimit të çelikut "AM" d.o.o. Zenicë. Paditësit kërkuan dëmshpërblim për dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar nga aktivitetet e prodhimit të çelikut të kompanisë, të cilat çuan në ndotje të konsiderueshme. Gjykata konstatoi se paditësit kishin vërtetuar një lidhje shkakësore midis dëmit që pësuan dhe moszbatimit të masave të mbrojtjes së mjedisit nga ana e të paditurit të kërkuara nga një leje mjedisore e integruar. Konkretisht, nga 195 masat e kërkuara, vetëm 152 u zbatuan, dhe edhe atëherë, ato reduktuan vetëm emetimet me 5-10%. Pavarësisht se paditësit provonin bazën ligjore për kompensimin, kërkesëpadia u rrëzua përfundimisht për shkak të mungesës së provave për shumën e saktë të dëmit, veçanërisht në lidhje me dëmin jomaterial që lidhet me efektet e shëndetit mendor të shkaktuar nga ndotja.

Një rast tjetër përfshinte projektin e gurores së Mostarit (Vendim AP-2941/22, datë 18 tetor 2022), ku Gjykata Kushtetuese pranoi shkeljet procedurale, por nuk vlerësoi themelin e shqetësimeve mjedisore. Këtu, mungesa e përfshirjes së publikut dhe e trajtimit të duhur procedural çoi në anulimin e një leje mjedisore pa marrë parasysh drejtpërdrejt ndikimin thelbësor mjedisor.

169 Me përjashtim të nivelit kantonal, çdo nivel i qeverisjes në BiH ka miratuar Ligjin e vet për Lirinë e Qasjes në Informacion ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 20/01, "Gazeta Zyrtare e FBiH-së", nr. 32/01, 48/11 "Gazeta Zyrtare e BiH-së", nr. 61/23).

një organ publik.¹⁷⁰ Ligjet për Mbrojtjen e Mjedisit,¹⁷¹ e përforcojnë këtë të drejtë, veçanërisht në lidhje me informacionin mjedisor. Autoritetet publike janë të detyruara, me iniciativën e tyre, të nxjerrin informacione të caktuara mjedisore dhe të japin informacion në përgjigje të kërkesave të paraqitura për qasje në informacion. Kufizimet¹⁷² për të drejtën e qasjes në informacion përcaktohen nga të dy ligjet.¹⁷³

Megjithatë, në praktikë zbatimi i ligjeve të lartpërmendura po përballet me sfida. Raportet¹⁷⁴ tregojnë se shumë organe publike ose nuk u përgjigjen kërkesave për informacion në kohën e duhur ose nuk përgjigjen fare.¹⁷⁵ Autoritetet publike shpesh dështojnë të publikojnë rregullisht informacionin thelbësor mjedisor. Në shumë raste, informacioni është i disponueshëm vetëm mbi bazën e kërkesës, ose lëshohet në formate që janë të vështira për t'u kuptuar. Për më tepër, të dhënat zyrtare statistikore shpesh nuk mblidhen.¹⁷⁶ Më tej, Avokati i Popullit i të Drejtave të Njeriut në BiH thekson se numri i ankesave në lidhje me lirinë e qasjes në informacion është vazhdimisht në rritje, siç është edhe numri i rekomandimeve të lëshuara nga Avokati i Popullit. Megjithatë, numri i rasteve në të cilat autoritetet respektojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit është shumë i ulët, vetëm 30% e totalit.¹⁷⁷

3.1.2. Të drejtat e pjesëmarrjes

Shtylla II e Konventës së Aarhusit është integruar në ligjet e mbrojtjes mjedisore të BiH, duke i dhënë publikut të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore. Në praktikë, kjo do të thotë se autoriteteve kompetente u kërkohet të sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në të gjitha procedurat që lidhen me vendimmarrjen mjedisore.¹⁷⁸ Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore zbatohet nga autoritetet sipas ligjeve për mbrojtjen e mjedisit në entitete dhe BDBiH, dhe pjesëmarrja e publikut parashikohet në fazat e hershme të VNM-ve dhe në proceset e miratimit të VNM-ve, dhënies së lejeve mjedisore dhe në të gjitha vendimet e tjera në lidhje me aktivitetet e propozuara që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedis.¹⁷⁹

170 Sa i përket procedurës, ligjet për Lirinë e Qasjes në Informacion parashikojnë si më poshtë: kur paraqitet një kërkesë për informacion, niset një procedurë administrative për të dhënë informacion sipas afateve në varësi të dispozitave specifike. Afatet i lejojnë kërkuesit të kenë qasje në të drejtën e tij për drejtësi nëse kërkesa refuzohet ose përgjigja është e pakënaqshme. Procedurat për mosmarrëveshjet administrative rregullohen nga ligjet për mosmarrëveshjet administrative për të dy subjektet dhe Distriktin Brčko.

171 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, nenet 64 dhe 80 ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 71/12, 79/15); neni 36 ("Gazeta Zyrtare e FBiH" nr. 15/21); ("Gazeta Zyrtare e BDBiH", nr. 24/04, 1/05, 19/07, dhe 9/09).

172 Një nga kufizimet që lejon ligji në nivel shtetëror është kufizimi i qasjes në informacion nëse është e arsyeshme të pritet që lejimi i qasjes në informacione të caktuara do të shkaktonte dëm serioz në mjedis. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile e perceptojnë këtë kufizim si mungesë të zbatimit të parimit të transparencës në çështjet që kanë të bëjnë me BiH dhe natyrën e saj dhe se lejon krijimin e një terreni të favorshëm për shkatërrim të mëtejshëm nga projekte të dëmshme pa dijeninë dhe informimin e publikut. *Shih*: Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, f. 20, gjendet në: <https://is.gd/u6FFnx>.

173 Disa përjashtime ndryshojnë midis Ligjeve për Lirinë e Qasjes në Informacion dhe Ligjeve për Mbrojtjen e Mjedisit. Përveç përjashtimeve të përgjithshme si ato për funksionet e autoritetit publik, konfidencialitetin tregtar dhe privatësinë, kjo e fundit përfshin përjashtime për tregtinë, konfidencialitetin e industrisë dhe informacionin e lidhur me emetimet, veçanërisht kur bëhet fjalë për interesat ekonomike dhe të pronësisë intelektuale. Autoritetet publike duhet të kryejnë një test të interesit publik kur shqyrtojnë këto përjashtime.

174 Zbatimi i Konventës së Aarhusit në BiH monitorohet rregullisht nga ministritë përkatëse përmes raporteve të zbatimit publik, si dhe nga sektori joqeveritar përmes raporteve hije.

175 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, f. 23, gjendet në: <https://is.gd/u6FFnx>.

176 Po aty, f. 48.

177 Rrjeti Hetimor Ballkanik i Bosnjë dhe Hercegovinës (BIRN BiH), <https://is.gd/S3mE6N>.

178 Kjo përfshin inspektimin publik dhe dëgjimet publike gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe dhënies së lejeve mjedisore. Inspektimi publik lejon publikun e interesuar të paraqesë vërejtje, informacione, analiza ose opinione të rëndësishme për miratimin e një aktiviteti të caktuar. Dëgjimet publike ofrojnë një forum për të gjitha palët e interesuara për të paraqitur verbalisht opinione të tyre dhe për të diskutuar çështje të rëndësishme për vendimmarrje.

179 Neni 39. i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit të Republikës Srpska; neni 40 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit të FBiH; neni 35 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit të Distriktit Brčko.

Megjithatë, intervistat me palët e interesuara dhe raportet e ndryshme tregojnë se ekzistenca e ligjeve nuk tregon domosdoshmërisht zbatim efektiv në praktikë, pasi boshllëqet legjislativë dhe stafi i patrajnuar mjaftueshëm në të gjitha nivelet e pengojnë procesin.¹⁸⁰ Organizatat e shoqërisë civile në BiH përballen me sfida të rëndësishme në pjesëmarrjen dhe angazhimin në proceset e vendimmarrjes mjedisore.¹⁸¹ Shumë mendojnë se konsultimet publike shpesh kryhen thjesht si një formalitet.¹⁸²

Ka sfida shtesë lidhur me zbatimin, duke përfshirë mungesën e kapaciteteve të enteve shtetërore në procedurat e shkëmbimit të informacionit, reklamimin e pamjaftueshëm të proceseve të auditimit publik, procedurat e stërzgjatura gjyqësore dhe administrative dhe koordinimin e dobët ndërmjet niveleve të ndryshme të autoriteteve.¹⁸³ Adresimi i boshllëqeve legjislativë dhe përmirësimi i kornizave procedurale, veçanërisht duke i përafuar ato me direktivat e BE-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor, mbetet një hap kritik drejt zbatimit efektiv.¹⁸⁴

Ndryshimet e fundit në Ligjin për Kërkimet Gjeologjike në Republikën Srpska¹⁸⁵, që përjashtojnë nevojën për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe pjesëmarrjen e komunitetit në studimet gjeologjike të burimeve minerale, pengojnë aktivistët mjedisorë dhe shkelin konventat ndërkombëtare. Kjo shkel Konventën e Aarhusit dhe Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.¹⁸⁶

Hapësira qytetare për angazhimin mjedisor në BiH duhet të analizohet nën ombrellën e hapësirës për angazhimin e përgjithshëm të qytetarëve në BiH. Raporte të shumta tregojnë se hapësira qytetare në BiH është nën presion për shkak të ligjeve kufizuese dhe rritjes së ngacmimit të aktorëve qytetarë. Ndërsa ka shembuj pozitivë të veprimeve të suksesshme qytetare, ngacmimet në rritje dhe masat kufizuese janë shqetësuese. Kuadri ligjor mbështet pjesëmarrjen e publikut, por zbatimi dhe mbrojtja praktike e këtyre të drejtave është thelbësore për të siguruar një hapësirë të shëndetshme qytetare.¹⁸⁷ Trendet e fundit legjislativë në vend tregojnë një lëvizje drejt kufizimeve dhe kontrollit më të madh, duke ngushtuar më tej hapësirën për OSHC-të.¹⁸⁸

Korniza ligjore brenda të cilit veprojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut është e fragmentuar, duke çuar në të drejta dhe qasje të pabarabarta në burime. Këto korniza nuk përmendin në mënyrë eksplicite mbrojtësit e të drejtave të njeriut në mjedis, ato ofrojnë një shtesë të përgjithshme mbrojtjeje. Aktivistët shpesh mbështeten në këto dispozita më të gjera për të drejtat e njeriut për të mbrojtur aktivitetet e tyre dhe për të kërkuar mjete juridike kundër kërcënimeve ose ngacmimeve.¹⁸⁹

180 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, fq. 22 dhe 23, gjendet në: <https://is.gd/u6FFnx>.

181 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2024, f. 25 gjendet në: <https://tinyurl.com/4nnmk5dy>.

182 Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së: Konsultimet publike caktohen herë pas here në kohë dhe vende të papërshtatshme dhe organizatat e shoqërisë civile shpesh kanë vështirësi për të pasur qasje në dokumente specifike.

183 Pilipović, R. (2021). Demokracia mjedisore në Bosnje dhe Hercegovinë: Raporti i zbatimit në hije i Konventës së Aarhusit 2021. Gjendet në: <https://is.gd/ler2IH>.

184 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2024, f. 84 gjendet në: <https://tinyurl.com/4nnmk5dy>.

185 Ligji për kërkimet gjeologjike në Republikën Srpska ("Gazeta Zyrtare e Republikës Srpska" nr. 64/2022 dhe 63/2024) gjendet në: <https://is.gd/fyXP2F>. Ndryshimet në ligj specifikojnë se autoriteti për të dhënë miratimin do t'i mbetet vetëm ministrisë kompetente në RS. Komunitetet lokale do të kenë të drejtën të paraqesin mendimet e tyre brenda shtatë ditëve, në vend që të japin miratimin zyrtar.

186 Qendra e Hapur e Sarajevës, 2024. Dorëzim i përbashkët i Iniciativës së Shoqërisë Civile të BiH për UPR për Rishikimin e 4-të Periodik Universal mbi Gjendjen e të Drejtave të Njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://is.gd/rBbPJ9>.

187 Raportuesi Special i OKB-së për të drejtat e lirisë së tubimit paqësor dhe organizimit në vizitën e fundit në BiH në prill 2024 ka deklaruar se përkeqësimi i pjesëmarrjes qytetare, ndër të tjera, është ndikuar nga mungesa e mundësive për të ndikuar pozitivisht në të ardhmen e vendit të tyre. Shih më shumë <https://is.gd/b9E8dh>.

188 Legjislacioni i fundit, duke përfshirë amendamentet në Kodin Penal të Republikës Srpska që rifusin veprën e shpifjes, përbën kërcënim të rëndë për aktivitetet e shoqërisë civile. Shih: <https://is.gd/CSENYI>.

189 Shih raportin "Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut në BiH - të drejtat, pozicioni dhe pengesat". Shtëpia e të Drejtave të Njeriut Banja Llukë (2023). Gjendet në: <https://shorturl.at/dqxHL>

Aktivistët në BiH po përballen me beteja të rëndësishme ligjore. Vendi ka parë një rritje shqetësuese të padive PSKPP kundër aktivistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut,¹⁹⁰ duke e vendosur BiH-në në dhjetë vendet e para në vitin 2023 për numrin më të madh të rasteve të regjistruara për 100,000 njerëz.¹⁹¹ Në përgjigje të rritjes së padive PSKPP kundër aktivistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në BiH, Dhoma e Përfaqësuesve e Parlamentit të FBiH-së miratoi Projektligjin për Nismën Qytetare dhe Mbrojtjen e Qytetarëve dhe Aktivistëve në qershor 2024. Ky ligj parashikon mekanizma për të mbrojtur qytetarët dhe aktivistët nga veprimet ligjore që synojnë të shtypin pjesëmarrjen e publikut, veçanërisht në kontekstin e mbrojtjes së mjedisit. Ai mundëson refuzimin e parakohshëm të rasteve PSKPP, në mënyrë që pjesëmarrja e publikut të mos pengohet nga paditë abuzive.¹⁹²

3.1.3. Të drejtat e tubimit dhe protestës

Për shkak të sistemit shumështrësor dhe kompleks të qeverisjes, e drejta e lirisë së tubimit paqësor rregullohet me 12 ligje.¹⁹³ Kjo mori ligjesh ka rezultuar në mungesë të harmonizimit dhe konsistencës në legjislacion. Kjo çështje theksohet nga raporte të ndryshme që theksojnë nevojën për harmonizimin mbarëkombëtar të rregulloreve të tubimit me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, veçanërisht në lidhje me kufizimet dhe përgjegjësitë e organizatorit.¹⁹⁴

Kritika përqendrohet në kufizimet e tubimit në Republikën Srpska, por edhe në nevojën për miratimin e një ligji të unifikuar në Federatën e BiH që do të harmonizonte rregulloret e ndryshme dhe shpesh kontradiktore ndërmjet njësisë dhe kantoneve për të kapërcyer diskriminimin aktual me të cilin përballen qytetarët e BiH-së.¹⁹⁵ Ligjet kantonale nuk janë plotësisht të harmonizuara me njëra-tjetrën ose me standardet ndërkombëtare.¹⁹⁶ Veprimet e autoriteteve, veçanërisht në Republikën Srpska, si dhe propozimet kufizuese legjislative, vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në BiH. Ligjet për lirinë e tubimit dhe organizimit paqësor në shumë pjesë të vendit janë vetëm pjesërisht në përputhje me standardet mbizotëruese ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka një qasje diskriminuese nga autoritetet në zbatimin e rregulloreve të tilla. Ligjet në përgjithësi përshkruhen si kufizuese dhe pengesat administrative mund të pengojnë të drejtën për të protestuar.¹⁹⁷ Gjithashtu, janë raportuar incidente të dhunës

190 Për shembull, kundërshtimi ndaj ndërtimit të mini-hidrocentraleve në lumin Kasindolska çoi në sfida të shumta ligjore dhe protesta publike. Dy aktiviste të reja mjedisore, Sunčica Kovačević dhe Sara Tushevljak, u përballën me padi për shpifje nga BUK, një kompani e BiH në pronësi të firmës belge Green Invest. Ata kritikuan publikisht ndikimet mjedisore të projekteve hidroenergjetike të kompanisë në lumin Kasindolska, duke theksuar veçanërisht çështje të tilla si shpyllëzimi dhe erozioni i tokës.

191 Koalicioni Kundër PSKPP-ve në Evropë, A 2023. Raporti, gjendet në: <https://is.gd/uJBDbe>.

192 Shih Shtojcën II për detaje të mëtejshme.

193 Ligji për Tubime Publike i Republikës Srpska rregullon të drejtën për tubim, duke përfshirë rregulloret se si duhet të zhvillohen dhe menaxhohen protestat. Çdo kanton brenda FBiH-së ka rregulloret e veta specifike. Këto ligje zakonisht përfshijnë dispozita për njoftimin, kufizimet e vendndodhjes dhe përgjegjësitë e organizatorëve. Gjithashtu, neni II/2 dhe II/3 i Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës; neni 30 i Kushtetutës së Republikës Srpska; neni 2 i Kushtetutës së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

194 Komisioni i Venecias, OSBE/ODIHR, 2019, Bosnjë dhe Hercegovinë Projekt-opinion i Përbashkët mbi kornizën ligjore që rregullon lirinë e tubimit paqësor në Bosnjë dhe Hercegovinë, në dy entitetet e saj dhe në Distriktin Brčko, gjendet në: <https://is.gd/FelfsQ>; Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë i vitit 2024, gjendet në: <https://tinyurl.com/4nnmk5dy>.

195 Raportuesi Special i OKB-së për të drejtat e lirisë së tubimit dhe organizimit paqësor, shih: <https://is.gd/Ughdg5>. Shtatë ligje kantonale dhe ligje të RS-së janë vlerësuar si shumë kufizuese.

196 Vetëm ligjet për tubime paqësore të Kantonit Zenica-Doboj, Kantonit Una-Sana dhe Kantonit 10 vlerësohen si të harmonizuara me standardet e BE-së dhe rregullojnë vetëm tubimet publike, ndërsa performanca publike do të rregullohet me ligje specifike. Ligje të tilla lejojnë organizatorët të njoftojnë në mënyrë elektronike autoritetet përkatëse për tubimet e planifikuara, nuk përjashtojnë automatikisht vende të caktuara dhe nuk imponojnë detyrime për organizatorët për të rregulluar dhe paguar shërbimet e sigurisë dhe emergjencave. Shih Nyaletsossi Voule, Clément. Vërejtje paraprake e Raportuesit Special për të Drejtat për Lirinë e Tubimit Paqësor dhe Organizimit. Sarajevë, 2024, f. 7, paragraf. 38. Gjendet në: <https://is.gd/b9E8dh>.

197 Qendra e Hapur e Sarajevës, 2024. Dorëzim i përbashkët i Iniciativës së Shoqërisë Civile të BiH për UPR për Rishikimin e 4-të Periodik Universal mbi Gjendjen e të Drejtave të Njeriut në Bosnje dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://is.gd/rBbPJ9>.

policore dhe ngacmimeve ndaj protestuesve, duke cenuar ushtrimin efektiv të këtyre të drejtave.¹⁹⁸

Praktika në Brčko konsiderohet më pozitive në BiH. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për BiH thekson se ligji i Distriktit Brčko,¹⁹⁹ duke u përafuar me standardet evropiane, duhet të shërbejë si model për nivelet e tjera të qeverisjes. Sipas këtij ligji, tubimet paqësore mund të mbahen në çdo vend që nuk rrezikon të drejtat e të tjerëve, moralin publik, sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, apo sigurinë e pasurisë. Qytetarët e Distriktit Brčko dhe organizatorët e tubimeve paqësore duhet të njoftojnë policinë për mbajtjen e një tubimi paqësor, ndërsa qytetarët në shumicën e kantoneve duhet të raportojnë zyrtarisht tubimet e tyre. Megjithatë nuk ka raporte të publikuara zyrtarisht për zbatimin e ligjit, vëzhgimet tregojnë se ai është zbatuar në mënyrë adekuate në praktikë.²⁰⁰ Disa tubime të monitoruara nuk kanë treguar shkelje të ligjit dhe zbatimi i tij është konsideruar i përshtatshëm.

3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre

3.2.1. Qasja në drejtësi

BiH-ja ka krijuar një kuadër ligjor që lejon individët dhe grupet e shoqërisë civile, të drejtat e të cilëve janë shkelur, ose që kanë një interes ligjor për të kundërshtuar vendime të caktuara, të paraqesin kërkesëpadi mjedisore në gjykata. Kjo përfshin gjithashtu mundësinë për të paraqitur ankesa kundër vendimeve, veprimeve ose mosveprimeve të organeve publike. Struktura ligjore në fuqi, duke përfshirë Ligjet për Detyrimet (LiD)²⁰¹ dhe ligjet e përmendura më parë për mbrojtjen e mjedisit,²⁰² synon të sigurojë që ata që janë prekur nga dëmtimi mjedisor mund të kërkojnë dëmshpërblim.

Prandaj, mbrojtja civile e mjedisit në BiH i shërben funksionit parandalues dhe restaurues. Masat parandaluese arrihen nëpërmjet veprimeve të ndryshme ligjore, të tilla si ankesat për emetimet e dëmshme,²⁰³ shkeljen dhe ankesat mjedisore, të gjitha të krijuara për të parandaluar dëmtimin mjedisor. Funkzioni restaurues përfshin rregullimin e përgjegjësisë për dëmin mjedisor, i

198 BIRN BiH raportoi për shënjestrimin e aktivistëve në Banja Llukë për gjoja shkelje të Ligjit për Tubime Publike, të cilin gjykatat më vonë refuzuan ta konfirmonin. Tubimet spontane më shpesh pengohen në komunitetet më të vogla brenda Federatës, ku njerëzit në tubime nuk kanë qasje në media dhe institucione. Pjesëmarrësit dhe organizatorët e tubimeve të tilla përballen me gjoja, akuza për kundërvajtje, frikësim, madje edhe dhunë, siç ishte rasti me protestat në Krushçicë. Presione të tilla më së shpeshti ushtrohen te njerëzit që protestojnë për mbrojtjen e mjedisit, por edhe te protestat më të vogla të punëtorëve, siç janë ato të punëtorëve të Fortuna-s nga Graçanica. Shih: <https://is.gd/8ChYFS>.

199 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë i vitit 2023, f.42, gjendet në: <https://is.gd/4aSCpf>; Në vitin 2020, Kuvendi i Distriktit Brčko miratoi Ligjin për Tubime Paqësore. Gjendet në: <https://is.gd/lfidWF>.

200 Intervistë me një përfaqësues nga një organizatë ndërqeveritare, mandati i së cilës mbulon fusha të tilla si promovimi i të drejtave të njeriut, liria e shtypit dhe zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

201 Ligjet për Detyrimet RS ("Gazeta Zyrtare SFRJ" nr. 29/78, 39/85, 45/1989 dhe 57/89, "Gazeta Zyrtare RS", nr. 17/93, 3/96, 37/01, 39/03 dhe 74/04; Ligjet për Detyrimet FBiH ("Gazeta Zyrtare SFRJ" nr. 29/78, 39/85, 45/1989 dhe 57/89, "Fletorja Zyrtare e Republikës së BiH", nr. 2/92, 13/93 dhe 13/94 dhe "Gazeta e FBiH", nr. 29/03 dhe 42/11. Shih Shtojcën I. për detaje të mëtejshme.

202 Ligji i FBiH-së, veçanërisht neni 43., siguron që "përfaqësuesit e publikut" kanë të drejtë të nisin procedurat ligjore për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të marrin pjesë në proceset e dhënies së lejeve dhe vlerësimit e ndikimit në mjedis. Kjo përfshin të drejtën për të apeluar vendimet nga procedurat administrative dhe për të iniciuar konflikte administrative kur është e nevojshme. Ngjashëm, Ligji i RS (neni 42.) dhe Ligji i BDBiH (neni 37.) garantojnë të drejtën për mbrojtje ligjore dhe apelime për ata, të drejtat e të cilëve për informacion ose pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse janë shkelur.

203 Shih: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>. Mbrojtja kundër emetimeve të dëmshme sipas ligjit të pronësisë zbatohet nëpërmjet një *actio negatoria*, duke i lejuar pronarët e pronave ose personat e autorizuar të padisin pronarin ose poseduesin e pronës nga e cila burojnë emetimet. Kjo padi reale nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Ligji për të Drejtat Pronësisë (neni 76, parag. 1) ndalon përdorimin e pronës në një mënyrë që shkakton emetime të tepërta indirekte (p.sh., tymi, aroma, zhurma) që prekin të tjerët. Pronarët e pronave të prekura nga këto emetime mund të kërkojnë heqjen e burimeve, kompensimin dhe masat parandaluese.

cili ndiqet përmes kërkesëpadive për kompensim për dëmet e lidhura me ndotjen.²⁰⁴

Edhe në rastet kur burimi i rrezikut apo shqetësimit lind nga kryerja e një veprimtarie me dobi publike, për të cilën është marrë leje nga organi kompetent, mund të kërkohet zbatimi i masave të justifikuar shoqërore për parandalimin ose uljen e dëmit, si dhe kompensimin e të ashtuquajturit dëm të tepërt.²⁰⁵

Një padi mjedisore është kryesisht një instrument parandalues pasi qëllimi i tij është të parandalojë shfaqjen e dëmeve që prekin mjedisin.²⁰⁶ Është konceptuar si një *actio popularis*, duke përdorur formulimin se dëmi kërcënon një numër të pacaktuar njerëzish. Çështjet mund të ngrihen si nga persona fizikë ashtu edhe nga persona juridikë të cilët nuk duhet të kërcënohen drejtpërdrejt nga ky rrezik nëse padia synon mbrojtjen nga dëmi që kërcënon një numër të pacaktuar personash. Prandaj, shoqatat dhe organizatat që merren me mbrojtjen e mjedisit mund të paraqiten si paditëse në padi që kërkojnë heqjen e një burimi rreziku ose kufizimin e aktiviteteve që shkaktojnë dëme të konsiderueshme për një numër të pacaktuar njerëzish. Kur bëhet fjalë për të pandehurin, ai mund të jetë, për shembull, pronar i një objekti ose materiali që kërcënon mjedisin, ose veprimtaria e të cilit çon në rrezikun e dëmtimit të gjerë. Paditësi në një padi mjedisore duhet të provojë se dëmi i mundshëm është i rëndësishëm, pasi LiD nuk mbron nga të gjitha dëmet, por vetëm atë dëm që është *i konsiderueshëm*. Megjithatë, çfarë nënkuptohet saktësisht me standardin ligjor të *dëmit të konsiderueshëm* u lihet gjykatave ta vlerësojnë rast pas rasti, duke e bërë këtë standard të keqpërcaktuar një barrë shtesë për paditësit në vërtetimin e çështjes së tyre.

Në praktikën gjyqësore të BiH-së, padi të tilla nuk gjenden shpesh, edhe në rastet kur ka prova që mund të vërtetojnë ekzistencën e një burimi rreziku si dhe vetë dëmin. Një arsye mund të jetë se procedurat lidhur me ndikimet e aktiviteteve industriale ose të tjera të rrezikshme në mjedis janë të shtrenjta dhe të gjata, pasi ato kërkojnë vlerësime ekspertësh komplekse dhe të gjera.²⁰⁷ Për më tepër, në paditë mjedisore nuk mjafton thjesht të kërkohet largimi i burimit të rrezikut nga i cili kërcënohet dëmi; duhet të propozohen edhe masa specifike për të parandaluar dëmtimin ose shqetësimin, gjë që e bën edhe më të komplikuar procedurën.

Këto korniza ligjore ndonjëherë minohen edhe nga pengesat procedurale, dënimet pamjaftueshmërisht të rënda për shkeljet mjedisore,²⁰⁸ dhe mungesa e rregulloreve të detajuara për

204 Po aty.

205 Konceptet e veprimtarive me dobi publike, justifikimi social i masave dhe dëmi i tepërt nuk janë të përcaktuara qartë dhe vlerësohen rast pas rasti. Për shembull, Gjykata e Lartë e BiH-së merr parasysh faktorë të tillë si nivelet e lejueshme të zhurmës, qëllimin e hapësirës, kohën dhe intensitetin kur përcakton nëse zhurma i kalon kufijtë e pranueshëm. *Shih f. 55: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>.*

206 Neni 156. i LiD lejon padinë mjedisore nëse ngacmimi ose dëmtimi nuk mund të parandalohet me "masa të tjera të përshtatshme". Ligji kërkon që paditësit e mundshëm fillimisht të tentojnë të adresojnë çështjen duke kërkuar nga pala përgjegjëse të largojë burimin e rrezikut ose të ndërpresë veprimtarinë e dëmshme. Nëse këto masa parandaluese nuk merren, gjykata mund t'i urdhërojë ato me shpenzimet e palës përgjegjëse. Prandaj, përpara fillimit të procedurave ligjore, ligji kërkon që paditësit e mundshëm të kërkojnë të parandalojnë dëmin nëpërmjet veprimeve të duhura, duke theksuar preferencën për zgjidhjen e çështjeve jashtë gjykatës kur është e mundur. Megjithatë, dispozita nuk specifikon nëse këto masa janë ligjore apo faktike, gjë që mund të krijojë vështirësi praktike."

207 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit.

208 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://is.gd/yEJIAs>. Raporti i kërimit, Analiza e punës dhe transparenca e inspektimeve mjedisore në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2023, gjendet në: <https://is.gd/pUqzif>.

disa ndikime mjedisore.²⁰⁹

Gjykatat gjithashtu shpesh kanë vështirësi për të vlerësuar shkallën e plotë të dëmit mjedisor, veçanërisht kur ai përfshin ndikime komplekse dhe afatgjata. Në rastet kur shumë subjekte kontribuojnë në dëmtimin mjedisor, vendoset përgjegjësi e përbashkët, por procesi i përcaktimit të përgjegjësisë midis ndotësve mund të jetë kompleks dhe të vonojë riparimin dhe kompensimin.²¹⁰ Nëse dëmi nuk mund të korrigojë me veprim të drejtpërdrejtë, ndotësit duhet të kompensojnë vlerën e plotë të të mirave mjedisore të shkatërruara. Për më tepër, fondet për mbrojtjen e mjedisit janë krijuar për të financuar përpjekjet e rehabilitimit, por këto fonde janë të pashfrytëzuara ose përballen me sfida menaxhimi.²¹¹

Mbrojtja e mjedisit arrihet edhe nëpërmjet ligjit penal, me krime mjedisore të përshkruara në kodet penale të entitetit dhe Kodin Penal të Distriktit Brčko të BiH-së. Megjithatë, këto ligje nuk janë të harmonizuara me njëra-tjetrën dhe janë vetëm pjesërisht të përafuara me Direktivën 2008/99/EC për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, pasi ato nuk parashikojnë të gjitha veprat penale të parashikuara nga Direktiva. Në nivelin shtetëror, nuk ka dispozita penale që trajtojnë në mënyrë specifike krimet mjedisore në mënyrën që ligjet e njëjste e bëjnë këtë. Për më tepër, ato ende nuk janë zbatuar plotësisht në praktikë. Arsyet kryesore të kësaj situatë qëndrojnë në raportimin e rrallë të autorëve të këtyre veprave penale, në faktin se kapacitetet janë të pamjaftueshme dhe autoritetet e entiteteve janë të papërvollë në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave penale, si dhe në ngritjen e akuzave.²¹²

Lidhur me procedurat penale për mbrojtjen e mjedisit, ato janë të përshkruara nga Kodet e Procedurës Penale të RS, FBiH, BDBiH dhe BiH-së. Numri i procedurave të përfunduara ligjore të kryera në bazë të akuzave për krime mjedisore është i papërfillshëm, me vendime gjyqësore që trajtojnë kryesisht format e vogla të veprave penale ose që rezultojnë nga marrëveshjet për pranimin e fajësisë.²¹³

Një rast i tillë ku gjykimi rezultoi nga një marrëveshje për pranimin e fajësisë përfshin përgjegjësinë penale të korporatës.²¹⁴ Ky rast spikat si gjykimi i parë në BiH për ndotjen e mjedisit, ku gjykata shpalli fajtor një person juridik bazuar në prova të shumta. Megjithatë, gjykata vendosi një dënim relativisht të butë edhe pse provat e mbledhura në këtë rast zbuluan shkelje të rënda të

209 Një rast konkret që thekson pengesat procedurale dhe dënimet pamjaftueshmërisht të rënda për shkeljet mjedisore është Vendimi i Gjykatës Kantonale në Široki Brijeg, nr. 63 0 Pr 037620 21 Pžp, datë 11 nëntor 2022. Në këtë rast, kompania publike e energjisë elektrike JP "EP HZHB" dhe një person përgjegjës brenda kompanisë u akuzuan për kundërvajtje sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit të FBiH-së. Dënimet fillestare të vendosura nga gjykata e shkallës së parë ishin dënime me kusht, që do të thotë se gjobat nuk do të zbatoheshin nëse nuk do të kryheshin vepra të reja brenda tetë muajve. Autoriteti i Inspektimit të Federatës apeloj, duke argumentuar se këto dënime ishin shumë të buta, veçanërisht duke pasur parasysh se kompania ishte një shkelës i përsëritur. Megjithatë, edhe pse gjykata e shkallës së dytë vendosi gjoba më të rrepta, dënimet mbetën minimale, duke ilustruar efektin e dobët parandalues të sanksioneve të tilla. Një shembull tjetër përfshin Vendimin e Gjykatës Komunale në Kiseljak, nr. 49 0 K 055363 21 K i datës 17 maj 2021, ku i akuzuari është dënuar me vetëm 1000 BAM gjobë për rrezikim të mjedisit të shkaktuar nga asgjësimi jo i duhur i produkteve të mishit, pavarësisht rrezikut të konsiderueshëm mjedisor që sjellin veprimet.

210 Mrdović, F. Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnjë dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

211 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://is.gd/yEJIAs>. Raporti i kërkimit, Analiza e punës dhe transparenca e inspektimeve mjedisore në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2023, gjendet në: <https://is.gd/pUqzif>.

212 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i Progresit të Mbrojtjes së Mjedisit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

213 Shih fusnotën 40, f. 40.

214 Rasti përfshin Zyrën e Prokurorisë Kantonale të Kantonit të Tuzlës që ka lëshuar një akuzë kundër personit juridik "G" dhe personit përgjegjës të tij, D.G., për veprën penale të Ndotjes së Mjedisit sipas Kodit Penal të FBiH-së. D.G., si drejtor i përgjithshëm i "G", u akuzua se nuk zbatoi masat e nevojshme mbrojtëse të kërkuara nga Ligji i FBiH-së për Mbrojtjen e Mjedisit, gjë që çoi në dëme të rënda mjedisore midis 2012 dhe 2017. Fabrika nën menaxhimin e D.G. nuk investoi në masat e nevojshme mbrojtëse mjedisore, duke çuar në çlirimin e vazhdueshëm të substancave të rrezikshme në ujë, ajër dhe tokë, duke ndikuar rëndë ekosistemin dhe shëndetin e njeriut. Pavarësisht akuzës, D.G. iku jashtë vendit, dhe çështja ndaj tij është ende në proces. Personi juridik "G" pranoi një marrëveshje për pranimin e fajësisë, duke rezultuar në gjobë dhe detyrim për të mbuluar shpenzimet e procedurave penale. *Shih* f. 44: Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>.

standardeve mjedisore nga personi juridik.²¹⁵ Vendimi, i ndikuar nga një marrëveshje për pranimin e fajësisë, nuk përfshinte asnjë kompensim për dëmin mjedisor të shkaktuar, duke theksuar një reagim të dobët ndëshkues ndaj ndikimeve të rënda ekologjike dhe të shëndetit publik. Vendimi nënvizon nevojën për përmirësimin e ndjekjes penale dhe kompensimin më rigoroz të dëmit në raste të tilla, duke pasur parasysh pasojat e rënda të shkeljeve mjedisore. Megjithatë, në lidhje me këtë vendim penal nuk është ngritur asnjë padi individuale për dëmshpërblim.²¹⁶ Arsyet mund t'i atribuohen faktorëve socio-ekonomikë, pasi është një komunitet i vogël ku shumica e popullsisë është e punësuar në këtë fabrikë.²¹⁷

Organet inspektuese luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit. Sipas ligjeve për inspektimet,²¹⁸ ata janë të autorizuar të kryejnë inspektime, të konstatojnë fakte, të shqyrtojnë dokumentet, të marrin në pyetje palët, të nxjerrin urdhra, të sekuestrojnë sende, të vendosin ndalime, të mbyllin objektet dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljeve ligjore dhe dëmtimit mjedisor.²¹⁹ Megjithatë, disa sfida ulin efektivitetin dhe transparencën e punës së organeve inspektuese në fushën e mbrojtjes së mjedisit.²²⁰ Inspektimet mjedisore shpesh janë të kufizuara për shkak të mungesës së burimeve, pajisjeve dhe personelit. Si rezultat, shumë shkelje mbeten të pa adresuara ose sanksionet e vendosura janë minimale, gjë që dobëson efektin parandalues të ligjit.²²¹ Për më tepër, efikasiteti dhe transparenca e tyre zvogëlohen më tej nga rregulloret e vjetruara dhe kufizimet teknike, duke përfshirë mungesën e laboratorëve të akredituar.²²²

Në mosmarrëveshjet administrative, gjykatat përcaktojnë ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet dhe shërbimet administrative dhe personat e tjerë juridikë me autoritet publik, të cilët vendosin për të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë në çështje të veçanta administrative.²²³

Standardi i proporcionalitetit në shqyrtimin gjyqësor është një parim i rëndësishëm ligjor i përdorur në BiH. Mund të mos përmendet në mënyrë eksplicite, por zbatimi i tij është i dukshëm nga analiza e vendimeve. Standardi i «proporcionalitetit» është veçanërisht i rëndësishëm në gjykatat themelore dhe komunale, ku shumica e rasteve gjykohen fillimisht. Megjithatë, zbatimi i tij është shpesh i paqëndrueshëm në gjykata dhe nivele të ndryshme gjyqësore për shkak të faktorëve të

215 Ndotja rezultoi nga dështimi i "G" për të respektuar lejen e tij mjedisore të vitit 2012, e cila kërkonte investime në teknologji për të reduktuar emetimet. "G" i la pas dore këto detyrime, duke çuar në degradim të rëndë mjedisor. Analizat kimike treguan nivele të ndotjes deri në 155,480 herë më të larta se kufijtë ligjorë, me ndikime të rëndësishme shëndetësore në popullatën vendase. Pavarësisht kësaj, gjykata, e ndikuar nga një marrëveshje për pranimin e fajësisë, vendosi vetëm një gjobë prej 100,000 BAM, pa kompensim për dëmin mjedisor, duke nënvizuar papërshtatshmërinë e masave ndëshkuese në këtë rast.

216 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit.

217 Po aty.

218 Ligji për Inspektimet e Republikës Srpska ("Gazeta Zyrtare e RS" nr. 18/2020) dhe Ligji për Inspektimet e Federatës së BiH-së ("Gazeta Zyrtare e FBiH" nr. 73/2014 dhe 19/2017).

219 Masat kundër subjektit të inspektuar mund të jenë financiare ose jofinanciare dhe mund të përfshijnë veprime specifike që njësia ekonomike duhet të kryejë, të përmbahet ose t'i durojë. Nëse inspektori mendon se veprimet e subjektit përbëjnë vepër penale, ai duhet ta denoncojë në prokurorinë kompetente, të bashkëpunojë me institucionet e tjera përkatëse dhe të marrë të gjitha masat e mundshme për ruajtjen e provave.

220 Intervistë me një përfaqësues të gjyqësorit; Raporti i hulumtimit, Analiza e punës dhe transparenca e inspektimeve mjedisore në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2023. Gjetet në: <https://is.gd/pUqzif>.

221 Raporti Hije për periudhën 2022-2023, Kapitulli 27: Vlerësimi i progresit të mbrojtjes së mjedisit në Bosnje dhe Hercegovinë, gjendet në: <https://is.gd/yEJIAs>. Raporti i hulumtimit, Analiza e punës dhe transparenca e inspektimeve mjedisore në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2023. Gjetet në: <https://is.gd/pUqzif>.

222 Po aty.

223 Në këto e gjykatat gjykojnë paditë kundër akteve administrative përfundimtare dhe vendimet e tyre janë të detyrueshme. Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve administrative, gjykatat kanë autoritetin të shqyrtojnë pajtueshmërinë me ligjet procedurale dhe ato materiale. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar vlerësohet në kuadër të objektit të padisë dhe gjykata është e detyruar nga arsyet e paraqitura në padi. Mosmarrëveshja zgjidhet me vendim që mund ta pranojë ose ta rrëzojë padinë si të pabazuar. Nëse vërtetohet, vendimi gjyqësor anulon aktin administrativ dhe zgjidh çështjen administrative, me vendimin gjyqësor që zëvendëson plotësisht aktin e anuluar.

ndryshëm.²²⁴

Organet administrative dhe gjykatat më së shpeshti trajtojnë çështjet që lidhen me mbikëqyrjen inspektuese, vlerësimet e ndikimit në mjedis dhe qasjen në informacion.²²⁵ Organizatat mjedisore luajnë një rol vendimtar në betejat ligjore, duke kontribuar ndjeshëm në mbrojtjen e mjedisit në të gjithë vendin.

Qasja në drejtësi në rastet mjedisore përballet me pengesa të shumta, duke përfshirë sfidat procedurale dhe financiare. Pengesat kryesore përfshijnë procese ligjore komplekse dhe të gjata,²²⁶ mungesën e profesionistëve ligjorë të specializuar në ligjin mjedisor, kostot e larta të procesit gjyqësor dhe mungesën e ndërgjegjësimit publik për të drejtat mjedisore. Palët e interesit kanë vërejtur se numri i kufizuar i avokatëve mjedisorë i përkeqëson këto sfida. Kjo përbën një pengesë të rëndësishme për arritjen e drejtësisë mjedisore. Ndihma juridike është e disponueshme, por jo e shpërndarë në mënyrë uniforme në të gjithë vendin. Sistemi i ndihmës juridike falas në BiH është i fragmentuar me disa zona që kanë krijuar institucione të ndihmës juridike falas dhe të tjerat mbështeten te OJQ-të. Gjithashtu, zbatimi i vendimeve gjyqësore ndryshon dukshëm, kryesisht për shkak të dobësive në kuadrin ligjor dhe koordinimit të pamjaftueshëm institucional. Mungesa e një kuadri ligjor të unifikuar në nivel shtetëror dhe përgjegjësitë e fragmentuara ndërmjet subjekteve rezultojnë në zbatim të pabarabartë të ligjit dhe pengojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore.²²⁷ Koordinimi institucional ndërmjet autoriteteve të ndryshme përgjegjëse për zbatimin e ligjit është problematik, me mungesë të komunikimit dhe koordinimit të qartë në nivele të ndryshme qeveritare që çon në joefikasitet në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Për më tepër, sistemi i pazhvilluar i llogaridhënies ligjore për mbrojtjen e mjedisit e përkeqëson çështjen, pasi nuk ka një politikë të fortë ndëshkuese për të siguruar përputhjen me vendimet e gjykatës.

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar

BiH përballet me disa shqetësime urgjente mjedisore që kanë ndikime të rëndësishme si në mjedis ashtu edhe në grupet e marginalizuara, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe ujit,²²⁸ kapacitetet

224 Gjetjet nga intervista me një përfaqësues të gjyqësorit: Zbatimi i paqëndrueshëm i parimit të proporcionalitetit nëpër gjykata dhe nivele të ndryshme në BiH mund t'i atribuohet disa faktorëve. Gjyqtarët kanë diskrecion të konsiderueshëm në interpretimin dhe zbatimin e proporcionalitetit, duke çuar në rezultate të ndryshme në çështje të ngjashme bazuar në interpretimin personal. Niveli i trajnimit dhe burimeve të disponueshme për gjyqtarët gjithashtu ndryshon ndjeshëm, ku disa gjykata më të ulëta nuk kanë qasje në burimet më të fundit ligjore ose trajnime në nuancat e proporcionalitetit. Mospërputhjet në mënyrën se si gjykatat më të ulëta ndjekin precedentët e vendosur nga gjykatat më të larta ose interpretojnë kuadrin ligjor që rregullon proporcionalitetin mund të rezultojë në vendime të ndryshme midis juridiksioneve. Për më tepër, faktorët e jashtëm si presioni politik, opinioni publik dhe kushtet socio-ekonomike mund të ndikojnë në vendimet gjyqësore, duke kontribuar në mospërputhje në zbatimin e proporcionalitetit. Shembuj të kësaj mospërputhje përfshijnë pabarazitë në dënime, ku vepra të ngjashme marrin dënime të ndryshme dhe vendime të ndryshme për masat parandaluese.

225 Mrdović, F., Sarajevë, 2023, Vështrim i përgjithshëm i praktikës gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, gjendet në: <https://is.gd/R0ssPs>.

226 Raporti i Komisionit Evropian, Bosnjë dhe Hercegovinë 2024, f. 31 gjendet në: <https://tinyurl.com/4nnmk5dy>.

227 Po aty.

228 Ndotja e ajrit në BiH është një problem serioz, duke prekur veçanërisht grupet e marginalizuara si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të papunët dhe familjet me një kryefamiljare (veçanërisht ato të kryesuara nga gratë). Këto grupe kanë më shumë gjasa të përjetojnë varfëri energjetike, duke u mbështetur në lëndë djegëse të lira dhe shumë ndotëse për ngrohje dhe gatim, dhe duke përdorur automjete më të vjetra dhe më ndotëse. Kjo situatë jo vetëm që përkeqëson ndotjen e ajrit, por gjithashtu rrit ndjeshmërinë e tyre ndaj efekteve të dëmshme të tij. Shih <https://is.gd/ykLrZO>.

e kufizuara të menaxhimit të mbetjeve,²²⁹ shpyllëzimin,²³⁰ ndotjen industriale dhe minierat²³¹ dhe zhvillimin e shpejtë të infrastrukturës dhe ndërtimit.²³²

Gratë, njerëzit që jetojnë në varfëri, personat me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe fetare dhe grupe të tjera shoqërisht, ekonomikisht dhe politikisht të marginalizuara të njerëzve në BiH kanë më shumë gjasa të vuajnë nga ndikimet e menjëhershme dhe afatgjata të shkaktuara nga degradimi i mjedisit dhe kanë burime të kufizuara për të përballuar dhe rikuperuar.²³³ Përdorimi i druve të zjarrit për ngrohje është relativisht i zakonshëm në familjet e varfra dhe në zonat rurale në BiH, dhe meqenëse gratë marrin përgjegjësinë kryesore për detyrat shtëpiake, ato janë më të ekspozuara ndaj ndotjes së ajrit të brendshëm nga këto burime.²³⁴ Hidrocentralet shpesh planifikohen ose ndërtohen në komunitete të cenueshëm, shumë në zona rurale dhe ndërtimi mund të ketë ndikim të rëndësishëm në natyrë, qasje në burime dhe mjete jetese.²³⁵ Komunitetet rurale, grupet mjedisore dhe aktivistët kanë udhëhequr përpjekjet për kundërshtimin e hidrocentraleve të vogla në të gjithë BiH-në dhe kanë arritur një fitore të konsiderueshme në vitin 2022 kur Dhoma e Ulët e Parlamentit të FBiH-së votoi për ndryshimin e Ligjit për Energjinë Elektrike për të ndaluar ndërtimin çdo hidrocentrali tjetër të vogël për shkak të shqetësimeve.²³⁶

Gjatë dekadës së fundit, BiH ka përjetuar disa incidente të rëndësishme mjedisore dhe shqetësime të vazhdueshme për ndotjen. Vendi lufton me ndotjen e ajrit, veçanërisht në zonat urbane si Sarajeva, Tuzla dhe Zenica, të cilat renditen ndër më të këqijat në botë gjatë muajve të dimrit.²³⁷ Burimet kryesore përfshijnë aktivitetet industriale si termocentralet me qymyr, ngrohjen e shtëpive duke përdorur qymyr dhe dru me cilësi të ulët dhe emetimet e automjeteve.²³⁸

229 Shumë zona, veçanërisht vendbanimet informale dhe rajonet rurale, kanë mungesë të infrastrukturës së duhur të depozitimit të mbetjeve, duke çuar në hedhje të paligjshme dhe djegie të hapur të mbetjeve. Shih: <https://is.gd/M7xKpR>.

Projekte si iniciativa e Bashkive Zero Waste kanë qenë të suksesshme në rajone të caktuara, duke prezantuar praktika si ndarja e mbetjeve dhe angazhimi i komunitetit për të reduktuar hedhjen e paligjshme, por në përgjithësi, vendi ka një rrugë të gjatë për të bërë në përmirësimin e sistemeve të tij të menaxhimit të mbetjeve. Shih: <https://is.gd/BeuE2U>.

230 Prerjet e paligjshme dhe shpyllëzimi janë shqetësime të rëndësishme në Bosnje dhe Hercegovinë. Pyjet shpesh priten pa plane të duhura ripyllëzimi, duke çuar në erozionin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit. Kjo jo vetëm që ndikon në mjedis, por gjithashtu ndikon në komunitetet lokale që varen nga pyjet për jetesën e tyre. BiH nuk ka një ligj shtetëror për pyjet, as nuk ka një ligj në nivel FBiH që do të rregullonte çështjen e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Ndërkohë, kantonet kanë miratuar rregulloret e tyre ligjore në këtë fushë, me përjashtim të kantonit Hercegovina-Neretva.

231 Kompanitë ndërkombëtare të minierave po investojnë shumë në BiH, veçanërisht në rajone të pasura me minerale. Këto aktivitete shpesh kryhen me mbikëqyrje minimale mjedisore, duke çuar në ndotje të konsiderueshme të rrugëve ujore dhe degradim të tokës. Operacionet e minierave pranë Vareš, për shembull, kanë çuar në ndotje të ujit, duke ndikuar në komunitetet e poshtme si Kakanj. Kjo ndotje prek në mënyrë disproporcionale grupet e marginalizuara dhe të cenueshme që mbështeten në këto burime natyrore për nevojat e tyre të përditshme.

232 Zhvillimi i shpejtë i infrastrukturës në Bosnjë dhe Hercegovinë, i nxitur nga investimet e huaja dhe përpjekjet për integrim në BE, ka çuar në sfida të rëndësishme mjedisore dhe sociale, duke përfshirë shpyllëzimin, shkatërrimin e habitatit dhe ndotjen. Komunitetet e marginalizuara përballen me zhvendosje, rreziqe shëndetësore dhe humbje jetese, të shoqëruara nga rregulloret e dobëta mjedisore dhe pjesëmarrja e kufizuar e publikut.

233 Lehtmets, J. 2021. Rreth vicioz: ndotja e ajrit, varfëria energjetike dhe pabarazia në Bosnje dhe Hercegovinë. SEI. Gjetet në: <https://is.gd/uGobkM>; Banka Botërore. (2021). Profili i rrezikut klimatik: Bosnjë e Hercegovinë. Gjetet në: <https://is.gd/Lg8Ypi>.

234 Eskić-Šihljak, A. dhe Knežević, G. (2022). Raport mbi Hartëzimin e Komponentit Gjiner në të dhëna dhe Legjislacion në fushën e Ndryshimeve Klimatike, Mjedisit dhe Biodiversitetit. Sarajevë: UNDP. Gjetet në: <https://is.gd/jukSs4>.

Përveç kësaj, Ligji i fundit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis garanton që publiku dhe të gjitha palët e interesuara (individët, organizatat e shoqërisë civile etj.) të kenë mundësinë: (i) të marrin pjesë në të gjitha fazat e një procesi VNM; (ii) të paraqesin komente me shkrim; dhe (iii) të marrin pjesë në debatin publik në komunën ku pritet të ndërtohet projekti.²⁹⁴ Gjithashtu, ky ligj garanton në mënyrë specifike që publiku dhe palët e interesuara do të informohen elektronikisht për të gjitha fazat në procesin e VNM-së.²⁹⁵ Në praktikë, MMPHI pretendon se të gjitha palëve të interesuara u jepet mundësia të dëgjohen në lidhje me projektet që do të ndërtohen; por përfaqësuesit e OJQ-ve të intervistuar për këtë raport pohojnë se procedurat e konsultimit nuk janë respektuar dhe se platformat për konsultim kuptimplotë ende nuk janë parashikuar dhe zbatuar.²⁹⁶

Ligji për Ndryshimet Klimatike garanton gjithashtu pjesëmarrjen e publikut, institucioneve lokale, sektorit privat dhe palëve të tjera të interesuara kur qeveria përgatit ose përditëson legjislacionin dhe strategjitë për ndryshimet klimatike.²⁹⁷

Sipas një zyrtari të MMPHI-së, ofrohet mundësia e publikut për tu dëgjuar në lidhje me miratimin e ligjeve, politikave dhe vendimeve të tjera që ndikojnë në mjedis, por ka një numër të ulët të palëve të interesuara që dëshirojnë të komentojnë ose të marrin pjesë në këto procese.²⁹⁸ Nga ana tjetër, aktivistë mjedisorë dhe anëtarë të shoqërisë civile të intervistuar për këtë raport pohojnë se pjesëmarrja publike dhe konsultimi kuptimplotë nuk inkurajohet nga institucionet publike dhe se ata kanë vështirësi të përfshihen në proceset vendimmarrëse.²⁹⁹ Vështirësi të tilla përfshijnë raste kur OJQ-të dhe palët e interesuara nuk ftohen për të marrë pjesë në takimet konsultative; MMPHI-ja nuk publikon dokumentet e VNM-së në platformat e konsultimit siç e kërkon ligji; takime të organizuara si një mjet për “check-the-box” se konsultimi ka ndodhur, ndërkohë që në praktikë pikëpamjet e palëve të interesuara nuk merren parasysh për procesin e vendimmarrjes, etj. Duke pasur parasysh këto mangësi, Avokati i Popullit ka rekomanduar në një nga raportet e tij *Ex-Officio* se pjesëmarrja e publikut në proceset vendimmarrëse mjedisore “duhet të merret seriozisht nga institucionet përgjegjëse”.³⁰⁰

Hapësira qytetare për angazhimin mjedisor po rritet ngadalë, falë disa fitoreve ligjore që u arritën përmes aktivizmit mjedisor. Kjo duket nga numri në rritje i protestave, aktiviteteve dhe përpjekjeve gjyqësore për çështjet mjedisore. Lidhur me këtë, në një intervistë për këtë Raport, znj. Egzona Shala-Kadiu, Drejtoreshë e EcoZ, deklaroi se fitoret e vogla procedurale/juridike janë shumë të rëndësishme për të ruajtur interesin dhe motivimin për të vazhduar betejat e gjata ligjore kundër kompanive të fuqishme, por mungesa e fondeve dhe mungesa e ndihmës juridike për gjykimin e këtyre rasteve zvogëlon mundësinë që ndotësit të mbahen përgjegjës.³⁰¹

3.1.3. Të drejtat e Tubimit dhe Protestës

Neni 43 i Kushtetutës garanton lirinë e tubimeve paqësore, të drejtën për të organizuar protesta dhe demonstrata si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to.³⁰² Kjo e drejtë e veçantë mund të ushtrohet edhe për qëllime mjedisore. Neni 44 i Kushtetutës garanton lirinë e asociimit, e cila përfshin të drejtën e secilit për të krijuar një organizatë (mjedisore) pa marrë asnjë leje dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate (mjedisore).³⁰³ Ka disa shembuj të këtyre të drejtave që

294 Neni 16 i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (2023).

295 Po aty.

296 Intervistë me zyrtarë të MMPHI-së, e mbajtur më 24 korrik 2024; intervistë me znj. Egzona Shala-Kadiu, Drejtoreshë Ekzekutive e EcoZ, e mbajtur më 23 korrik 2024; dhe intervistë me znj. Shpresa Loshaj, aktiviste mjedisore dhe themeluese e OJQ-së “Pishtarët”, e mbajtur më 27 korrik 2024.

297 Neni 34 i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (2024).

298 Intervistë me një zyrtar të MMPHI-së, e mbajtur më 24 korrik 2024.

299 Intervistë me znj. Egzona Shala-Kadiu, Drejtoreshë Ekzekutive e EcoZ, e mbajtur më 23 korrik 2024; dhe intervistë me znj. Shpresa Loshaj, aktiviste mjedisore dhe themeluese e OJQ-së “Pishtarët”, e mbajtur më 27 korrik 2024.

300 Avokati i Popullit i Kosovës*, Raport *Ex-Officio* nr. 365/2018 i datës 3 shkurt 202, i cituar më lart, parag. 98. Nevoja që autoritetet t’i marrin më seriozisht çështjet mjedisore u shpreh edhe në intervistën e mbajtur për qëllime të këtij Raporti me znj. Anita Çavdarbasha, Zëvendëse e Avokatit të Popullit e Kosovës*, më 23 korrik 2024.

301 Intervistë me znj. Egzona Shala-Kadiu, Drejtoreshë Ekzekutive e EcoZ, e mbajtur më 23 korrik 2024.

302 Neni 43 i Kushtetutës.

303 Neni 44 i Kushtetutës.

ushtrihen lirisht në praktikë,³⁰⁴ pa ndonjë pengesë të theksuar nga autoritetet.

Përveç përdorimit të rregullt të së drejtës së tubimit në organizata, një mënyrë interesante në të cilën hapësira qytetare organizohet dhe përditësohet në Kosovë* është përmes një grupi shumë aktiv në Facebook me titull: "Grupi për mbrojtjen e ujërave dhe mjedisit".³⁰⁵ Kjo platformë përdoret nga aktivistë, qytetarë, organizata të shoqërisë civile dhe avokatë të të drejtave të njeriut për të postuar informacione, për të organizuar protesta, për të shfaqur video të shkatërrimit/dëmtimit të mjedisit, për të alarmuar të tjerët për dëmtime të ndryshme mjedisore, për të organizuar evente për pastrimin e aktiviteteve dhe ngjarje të tjera vullnetare.

3.2. E drejta e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre

3.2.1. Qasja në drejtësi

Të drejtat e qasjes në drejtësi dhe në mjete juridike efektive garantohen me Kushtetutë.³⁰⁶ Çdo person fizik ose juridik (duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile) ka të drejtë të përdorë mjete juridike kundër vendimeve administrative dhe gjyqësore që cenojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe ligj.³⁰⁷ Për sa i përket të drejtës ligjore, kjo do të thotë që individët, personat juridikë, komunitetet, organizatat, aktivistët mjedisorë dhe grupet e tjera të shoqërisë civile kanë të drejtë të paraqesin kërkesëpadi mjedisore në gjykata dhe të kërkojnë "mbrojtje gjyqësore" të të drejtave të tyre.³⁰⁸ Nëse një e drejtë mjedisore e garantuar me Kushtetutë, KEDNJ ose me ligj është shkelur, pala e prekur ka të drejtën e një mjeti juridik efektiv.³⁰⁹

Sipas nenit 31.6 të Kushtetutës, "ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi."³¹⁰ Ligji për Ndihmën Juridike Falas konfirmon se ndihma juridike mund të kërkohej për të drejtat mjedisore,³¹¹ por Agjencia për Ndihmë Juridike Falas në Kosovë* ka konfirmuar përmes një përgjigje me shkrim se nuk kanë asnjë rast në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin.³¹²

Individët dhe komunitetet në Kosovë* kanë të drejtë të çojnë në gjykatë aktorët industrialë dhe të korporatave për dëmtim mjedisor. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit ka një kapitull të veçantë ku përmenden detyrimet dhe përgjegjësitë për ndotjen e mjedisit dhe procedurën për marrjen e kompensimit për dëmet.³¹³ Në përputhje me «*parimin ndotësi pagan*», ky ligj parashikon që ndotësi që shkakton dëm mjedisor "do të jetë përgjegjës për dëmin" dhe "do të jetë përgjegjës për vlerësimin dhe eliminimin e dëmit".³¹⁴ Megjithatë, këto dispozita nuk mund të konsiderohen si mjaft efektive duke marrë parasysh numrin e ulët të rasteve ku aktorët e korporatave u paditën me sukses për dëmtim

304 Shih për shembull protestën e fundit të titulluar "Parku Kombëtar Sharr – Pa diga" organizuar nga EcoZ dhe raportuar nga Riverwatch, e qasshme në: <<https://riverwatch.eu/en/balkanrivers/news/kosovo-sharr-national-park-no-dams>>.

305 Shih grupin në Facebook me titull "Grupi për mbrojtjen e ujërave dhe mjedisit".

306 Shih nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës.

307 Neni 32 i Kushtetutës.

308 Nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

309 Neni 54 i Kushtetutës.

310 Neni 31.6 i Kushtetutës.

311 Neni 4 i Ligjit për Ndihmën Juridike Falas (2012), i qasshëm në: <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2803>>. Shih edhe, nenin 6-10 për kushtet se si mund të merret një ndihmë e tillë juridike.

312 Përgjigje me shkrim e marrë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas më 5 gusht 2024, duke iu përgjigjur pyetjes nëse palët e interesuara që plotësojnë kushtet e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas mund të kërkojnë ndihmë juridike falas edhe për rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe mjedisin. Përgjigja e pyetjes ishte pozitive.

313 Shih Kapitullin VIII (nenet 65-72) të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (2009). Përveç kësaj, shih edhe Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023) dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (2010), që gjithashtu ofrojnë një bazë ligjore për t'i mbajtur aktorët e korporatave përgjegjës për dëmet mjedisore.

314 Neni 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (2009).

mjedisor.³¹⁵ Sipas një Raporti të publikuar nga Balkan Insight, në periudhën 2017-2020, mbi një qind kompani “janë dërguar në gjykatë për ndotjen e mjedisit” dhe vetëm «njëzet e katër u gjobitën.»³¹⁶

3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë

Përveç personave fizikë ose juridikë, edhe shoqata ose organizata të shoqërisë civile të cilat “mbrojnë interesat publike” janë të autorizuar për të nisur një procedurë administrative për mbrojtjen e të drejtave mjedisore.³¹⁷ Praktika gjyqësore vendase (pavarësisht disa mospërputhjeve fillestare) konfirmon se organizatat e shoqërisë civile kanë *locus standi* para gjykatave vendase kur ngrenë kërkesëpadi mjedisore.³¹⁸ Vendimet e organeve publike mund të anulohen në procedurë administrative dhe mund të jepen edhe urdhra.

Në procedurën civile, individët ose komunitetet e prekura mund të kërkojnë kompensim financiar për dëmtim personal, dëmtim të pronës ose humbje të tjera që vijnë nga dëmtimi mjedisor. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dallon një parim të veçantë, të referuar si “Parimi i Mbrojtjes së së Drejtave në Gjykatë” - sipas të cilit çdo individ, person juridik apo publiku ka të drejtë të ngrejë një kërkesëpadi ose të kërkojë nga gjykatat vendase ose autoritetet publike që të zbatojnë siç duhet dispozitat e këtij ligji ose aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.³¹⁹ Gjykatat kanë të drejtë të shqyrtojnë çështjet në procedurë civile; të japin urdhra për të ndaluar aktivitetet që shkaktojnë dëme të vazhdueshme ose të pashmangshme mjedisore; dhe të urdhërojnë ndotësit përgjegjës të ndërmarrin veprime të veçanta restauruese.³²⁰ Përveç dëmeve materiale, individët mund të kërkojnë edhe kompensim për dëmet jomateriale, të tilla si ndikimet shëndetësore ose humbja e mjedisit të pastër dhe të sigurt.

Në procedurën penale ka një kapitull të veçantë në Kodin Penal i cili numëron veprat penale kundër mjedisit, kafshëve dhe bimëve.³²¹ Ky Kod penalizon ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e mjedisit; trajtimin e substancave dhe mbetjeve të rrezikshme të paligjshme; ndërtimin e paligjshëm ose funksionimin e paligjshëm të impianteve dhe instalimeve që ndotin mjedisin; dëmtimin e objekteve dhe instalimeve për mbrojtjen e mjedisit; etj.³²² Maksimumi i burgimit për një krim mjedisor është tetë (8) vjet si dhe dënimi që është pjesë e dënimeve penale.³²³ Përveç krimeve mjedisore, disa ligje në Kosovë* parashikojnë kundërvajtje specifike penale lidhur me ndotjen/dëmtimin e mjedisit me gjoba deri në 40,000 EUR.³²⁴

Sa i përket përgjegjësisë penale të korporatës, ekziston një ligj specifik në Kosovë* i cili rregullon përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale,³²⁵ por ka praktikë të kufizuar në këtë fushë. Ka të paktën dy arsye të mundshme (duke mos përfshirë arsyet e tjera) për mungesën e rasteve në

315 Shih për shembull, Balkan Insight, ‘Ujërat e turbullta: Ndotja që po mbyl liqenet dhe lumenjtë e Kosovës* (2020), ku raportohen rastet e gjobave të korporatave, të qasshme në: <<https://balkaninsight.com/2020/07/20/muddy-waters-the-pollution-killing-kosovos-lakes-and-rivers/>>. Shih një rast ku New Co Ferronikel, një korporatë e përfshirë në prodhimin e nikelit, u gjobit me 40,000 euro për ndotjen e mjedisit. Është gjithashtu interesante të theksohet se një markë e madhe e patateve të freskëta në Kosovë* “Vipa Chips” u gjobit me vetëm 500 euro pasi një banor filmoi kamionin e tyre duke i hedhur mbeturinat e patates në lumin Sitnica që ndodhet afër fabrikës së tyre.

316 Po aty, artikulli i Balkan Insight i vitit 2020.

317 Shih nenin 10.2 të Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative (2010), i qasshëm në: <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>>.

318 Shih për shembull rastet e CSL-së (Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike) që konfirmuan gjendjet e CSL dhe të tjera.

319 Neni 6.11 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (2009).

320 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009).

321 Shih Kapitullin XXVII të Kodit Penal të Kosovës* (2019), i qasshëm në: <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>>.

322 Po aty, nenet 338-341.

323 Për një pasqyrë të jurisprudence vendase në çështjet penale që lidhen me dëmtimin/rastet mjedisore, shih publikimin me titull: “Mbrojtja e Mjedisit përmes Ligjit Penal” (2023) me autor Afrim Shala, gjyqtar aktual në detyrë në Gjykatën e Lartë të Kosovës*, i qasshëm në: <<http://jus.igjk.rks-gov.net/844/1/Mbrojtja%20e%20mjedisit%20përmes%20të%20drejtës%20penale%20-%20Afrim%20Shala-.pdf>>.

324 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009); Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (2010); Ligji për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit (2022), etj.

325 Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale (2011), i qasshëm në: <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2766>>.

këtë fushë, përkatësisht mungesën e : (i) njohurive ligjore/procedurale midis publikut të gjerë dhe palëve të prekura në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve juridike për të bërë përgjegjës aktorët/ndotësit e korporatës për dëmtimin mjedisor; (ii) proceseve gjyqësore strategjike nga organizatat mjedisore drejtuar aktorëve/ndotësve të korporatave që shkaktojnë dëme mjedisore (duke pasur parasysh se është e vështirë për individët të luftojnë vetëm betejat ligjore kundër kompanive të mëdha).

Përderisa mjetet juridike solide janë të disponueshme sipas kornizës ligjore të Kosovës*, ka sfida të konsiderueshme lidhur me ekzekutimin, kapacitetin gjyqësor për të vendosur mbi kërkesëpaditë mjedisore dhe aftësinë e avokatëve për të përfaqësuar kërkesëpaditë mjedisore, kohëzgjatjen e procedurave për shkak të mbingarkesës së sistemit gjyqësor, rikthimet e shpeshta të rasteve, mospërputhjet gjyqësore lidhur me arsyetimin dhe interpretimin e dispozitave dhe ligjeve kushtetuese mjedisore ekzistuese, si dhe kostot ligjore që lidhen me procedurat e ndërlikuara gjyqësore.

Në praktikë, efektiviteti i dispozitave kushtetuese mund të vërehet për shembull në: (i) rastin "Parku i aventurave Gërmia" ku aktivistët e shoqërisë civile kanë arritur të ndalojnë me sukses ndërtimin e një parku në një zonë të gjelbër të mbrojtur duke bindur gjykatat vendase që të japin urdhra dhe këto të fundit të konfirmojnë paligjshmërinë e një ndërtimi të tillë në një vendim themeli,³²⁶ dhe (ii) "Rasti i Badovcit" ku presioni nga grupet e shoqërisë civile kontribuoi në anulimin e ndërtimit të planifikuar të vilave në afërsi të një liqeni të mbrojtur në Kosovë*.³²⁷

Megjithatë, ka edhe raste që tregojnë mungesë efektiviteti të dispozitave kushtetuese, si për shembull: (i) mosekzekutimi i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës* për më shumë se trembëdhjetë (13) vjet – rast i cili konstatoi shkeljen e parë të nenit 52 (Përgjegjësia për mjedisin) të Kushtetutës (komentuar më lart); (ii) mosekzekutimi i urdhrave të dhëna nga gjykatat e rregullta në Kosovë* lidhur me hidrocentralet në rajonin e Deçanit;³²⁸ (iii) mungesa e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në lidhje me çështjet mjedisore; (iv) hetime të pamjaftueshme dhe numër i pamjaftueshëm i aktorëve të korporatave që janë shpallur fajtorë për dëmtim mjedisor, etj.

Në lidhje me barrierat praktike për ushtrimin e të drejtave procedurale, dy aktivistë kryesorë mjedisorë u përballën me një Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (PSKPP) pas betejës së tyre ligjore kundër Kelkos Energy, një filial i ofruesit të energjisë me bazë në Austri, Kelag International.³²⁹ Njëri prej aktivistëve, znj. Loshaj kujtoi se kjo padi e pabazë e motivoi edhe më shumë për të vazhduar betejën e saj ligjore kundër hidrocentraleve në vendlindjen e saj Deçan.³³⁰ Pasi vazhdoi aktivizmin dhe protestat e saj, ajo (së bashku me një aktivist tjetër) u padit për 100,000 EUR, një PSKPP klasik i cili u konsiderua si një padi e pabazë nga Amnesty International.³³¹ Strategjia e përdorimit të PSKPP rezultoi kundërproduktive për Kelkos Energy, sepse rasti u bë i famshëm dhe shkaktoi reagime të forta në mesin e organizatave vendase dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjë që rezultoi në tërheqjen e padisë përfundimisht nga Kelkos Energy.

Kjo histori e aktivizmit ka të bëjë me çështjen gjyqësore strategjike kundër Kelkos Energy e cila tani është në pritje për gjykim në Gjykatën Kushtetuese. Në një intervistë për këtë raport, znj.

326 Shih Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, lënda nr. A. nr. 317/2021 e datës 16 prill 2024. Për informacion më të detajuar, shikoni edhe detajet rreth këtij rasti të publikuara nga Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike, të qasshme në: <<https://cslkosovo.org/2024/03/01/leja-mjedisore-per-projektin-parku-i-aventurave-ne-germi/>>.

327 Shih lajmet në lidhje me anulimin e planit për ndërtimin e vilave në liqenin e Badovcit, të qasshme në: <<https://lajmi.net/ndertimet-ne-badovc-pezuллоhet-plani-zhvillimor-komunal/>>.

328 Aktivistët e shoqërisë civile të intervistuar për këtë raport pohojnë se këto vendime nuk kanë qenë efektive duke pasur parasysh se bizneset kanë vazhduar punën e tyre pavarësisht urdhrave. Ata ndaluan vetëm përkohësisht operacionet e tyre.

329 Shpresa Loshaj dhe Adriatik Gacaferri ishin dy aktivistë mjedisorë që u paditën nga Kelkos Energy për gjoja dëmtim të reputacionit të kompanisë.

330 Kosovo* 2.0., 'Shpresa Loshaj: Tani është koha që unë të flas më shumë' (2021), i qasshëm në: <<https://kosovotwopointzero.com/en/shpresa-loshaj-now-is-the-time-for-me-to-speak-up-more/>>.

331 Amnesty International, 'Kosova*: Padia e pabazë kundër aktivistëve mjedisorë triumfoi për lirinë e shprehjes' (2021), e qasshme në: <<https://www.amnesty.org/en/latest/news/2021/10/kosovo-baseless-lawsuits-against-environmental-activists-dropped-in-victory-for-freedom-of-expression/>>.

Shpresa Loshaj u shpreh se: «çështja në Gjykatën Kushtetuese ka potencialin të jetë një rast historik për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, duke motivuar kështu të tjerët që të mbajnë përgjegjësinë ndotësit, duke kërkuar zbatimin e duhur të ligjeve vendase dhe parimeve mjedisore».³³²

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar

4.1. Shqetësimet kryesore kombëtare

Shqetësimi kryesor kombëtar në Kosovë* është ndotja e ajrit,³³³ e cila vazhdon të jetë një kërcënim madhor për shëndetin.³³⁴ Sipas një raporti të Bankës Botërore, ndotja e ajrit në kryeqytetin e Prishtinës *“rivalizon atë të qyteteve të mëdha si Pekini, Mumbai dhe Nju Delhi.”*³³⁵ Mbështetja në qymyrin e linjimit për prodhimin e energjisë elektrike është një kontribuues i madh i emetimeve të dëmshme, të kombinuara me djegien e lëndëve djegëse të ngurta gjatë sezonit të dimrit për qëllime ngrohjeje. Kosova* nuk i përmbahet kufijve të emetimeve dhe nuk e zbaton siç duhet legjislacionin e saj në këtë fushë, duke e bërë atë jo mjaftueshëm efektiv në praktikë.³³⁶ Për shkak të ndotjes së madhe të ajrit, tokës dhe ujit, komuna e Obiliqit dhe zonat përreth, ku ndodhen termocentralet e vjetruara “Kosova A dhe B”, është shpallur si “zonë e rrezikuar mjedisore.”³³⁷

Një tjetër shqetësim i madh kombëtar në Kosovë* është ndotja e ujit dhe mungesa e ujit, e cila kërcënon shëndetin e njeriut dhe biodiversitetin.³³⁸ Ujërat e zeza të patrajtuara, shkarkimet industriale/familjare dhe mungesa e objekteve të trajtimit të ujërave të zeza janë burimet kryesore të ndotjes së ujit.³³⁹ Shqetësimet e tjera kombëtare në Kosovë* lidhen me shpyllëzimin dhe degradimin e tokës përmes prerjeve të paligjshme dhe praktikave të paqëndrueshme të përdorimit të tokës³⁴⁰ dhe menaxhimit të dobët të mbeturinave.³⁴¹

4.2. Incidente ose aksidente të mëdha mjedisore

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton se çfarë përbën një “aksident mjedisor” duke rregulluar gjithashtu procedurën, përgjegjësinë për dëmet, sanksionet dhe masat rehabilituese që duhet të zbatohen nëse ndodhin aksidente të tilla.³⁴² Në vitin 2015, në lumin Morava u shfaq një numër masiv i peshqve të ngordhur. Sipas Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës*, kjo ka ndodhur për shkak të

332 Intervistë me znj. Shpresa Loshaj, aktiviste mjedisore dhe themeluese e OJQ-së “Pishtarët”, e mbajtur më 27 korrik 2024.

333 Shih, Agjencia Evropiane e Mjedisit, ‘Kosova* – Fleta e të dhënave të vendit për ndotjen e ajrit’ (2023), e qasshme në: <<https://www.eea.europa.eu/themes/air/country-fact-sheets/2023-country-fact-sheets/kosovo-air-pollution-country>>. Shih edhe, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës*, ‘Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2023’, i qasshëm në: <<https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20%20vjetor%20per%20cilesi%20te%20ajriti%202023%20-eng.pdf>>.

334 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën* i vitit 2023, f. 115, i qasshëm në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en>.

335 Banka Botërore, ‘Menaxhimi i Ndotjes së Ajrit në Kosovë*’ (2019), i qasshëm në: <https://documents1.worldbank.org/curated/en/214511576520047805/pdf/Air-Pollution-Management-in-Kosovo*.pdf?_gl=1*816utj*_gcl_au*MTE0Nm50TM2OS4xNzI0MzYzMzY3>.

336 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën* (2023), i cituar më lart, f. 115.

337 Shih Ligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe Rreth Saj (2016), i qasshëm në: <<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13214&langid=2>>.

338 Shih, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës*, ‘Raporti i gjendjes së ujit në Kosovë* 2020’ i qasshëm në: <[https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANGLISHT_WEB_uji\(1\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANGLISHT_WEB_uji(1).pdf)>.

339 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën* (2023), i cituar më lart, f. 116.

340 Shih, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës*, ‘Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë* (2022), i qasshëm në: <<https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ANNUAL%20REPORT%20on%20the%20State%20of%20the%20Environment%202022%20ENG%20-%20Final.pdf>>.

341 Shih, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e Kosovës*, ‘Raporti i Menaxhimit të Mbeturive Komunale në Kosovë* (2021), i qasshëm në: <[https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20mbeturinave%20komunale%20per%20viti%202021_%20eng\(1\).pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20i%20mbeturinave%20komunale%20per%20viti%202021_%20eng(1).pdf)>. Shih edhe, Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën* (2023), i cituar më lart, f. 116.

342 Shih nenet 4, 16, 34, 39, 47, 49, 71 dhe 93 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (2009).

“shkarkimit të ujërave të zeza nga familjet dhe industrinë”³⁴³

Incidente të tjera të ngjashme mjedisore ndodhën në vitin 2019 në lumenjtë Lepenc dhe Lumbardh, të cilat çuan në humbjen misterioze të më shumë se 12 tonëve peshq dhe ngritën shqetësime për sigurinë e ujit për banorët dhe kafshët.³⁴⁴ Inspektorët komunalë konstatuan se ngordhja e peshqve në lumin Lepenc ka ardhur *“si pasojë e shkarkimit të lëndëve ndotëse me përmbajtje toksike në dy vendndodhje nga një sipërmarrës privat.”³⁴⁵* Nuk ka të dhëna publike për ndonjë hetim lidhur me ngordhjen e peshkut në lumin Lumbardh. Edhe pse këto incidente kanë çuar në një protestë publike, askush nuk duket se është mbajtur përgjegjës dhe nuk ka informacion të qartë nëse hetimet ligjore specifike janë aktualisht aktive kundër sipërmarrësit privat të identifikuar apo të tjerëve që mund të kenë shkaktuar këto incidente të rënda mjedisore.

5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet

Kosova* ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe ligjore lidhur me të drejtat e njeriut dhe mjedisin. Në nivel kushtetues, duket se nuk ka boshllëqe, ku përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit figuron në një dispozitë të veçantë kushtetuese (neni 52). Në nivelin e ligjeve themelore, Kosova* ka: (i) miratuar Ligjin e saj të parë për Ndryshimet Klimatike në vitin 2024; (ii) ndryshuar legjislacionin e saj për vlerësimin e ndikimit në mjedis duke miratuar një ligj të ri në vitin 2023; dhe (iii) miratuar legjislacionin e ri për mbrojtjen nga ndotja e ajrit në vitin 2022. Ekziston nevoja për të ndryshuar disa pjesë specifike të legjislacionit të cilat konsiderohen të vjetruara dhe jo plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për mjedisin, siç janë ligjet që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe ujërave të Kosovës*.

Për shkak të çështjes së statusit, Kosova* nuk është në gjendje të ratifikojë traktate ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit si Konventa e Aarhusit, Konventa e Tromsø-it apo ndonjë instrument tjetër ndërkombëtar ose i Këshillit të Evropës. Traktati i vetëm i Këshillit të Evropës i cili është drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë* është KEDNJ. Zbatimi i saj, së bashku me efektet *res interpretata* të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sigurohet nëpërmjet përfshirjes vullnetare në Kushtetutë (nenet 22 dhe 53). Mangësia e pamundësisë së ratifikimit të traktateve ndërkombëtare është kompensuar nga përpjekja për të transpozuar parimet ndërkombëtare në legjislacionin e brendshëm pa ratifikuar zyrtarisht traktatet përkatëse ndërkombëtare.

Efektiviteti i kornizës kushtetuese dhe ligjore në Kosovë* reflekton progresin dhe sfidat e vazhdueshme. Ndërsa Kosova* ka miratuar një serë ligjesh dhe politikash që synojnë mbrojtjen e të drejtave mjedisore dhe ka përafruar legjislacionin e saj me standardet e BE-së si pjesë e procesit të saj të integritetit, zbatimi i këtyre ligjeve mbetet i dobët, duke cenuar kështu qëllimin e synuar. Joefektiviteti i legjislacionit vendas vjen për shkak të kombinimit të faktorëve të mëposhtëm:

- (i) kapacitete të pamjaftueshme institucionale në nivelin e organeve qeveritare që janë përgjegjëse për të mbikëqyrur zbatimin e kornizës legjislative
- (ii) mungesa e burimeve financiare për të kryer analizat e nevojshme dhe për të kryer inspektimet dhe mbikëqyrjen e nevojshme
- (iii) koordinimi i dobët ndërmjet autoriteteve qendrore dhe atyre vendore
- (iv) mosndëshkimi i autorëve duke konsideruar se pavarësisht ndalimeve të qarta ligjore, ndotësit vazhdojnë të shkaktojnë dëm mjedisor pa u ndëshkuar në përputhje me rregullat ekzistuese

Në teori, korniza ligjore e Kosovës* mbështet pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, të drejtën e publikut për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe të drejtën për t'u mbledhur dhe protestuar për këto çështje. Ligji i rinovuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkon konsultime publike për projektet madhore që mund të kenë ndikim në komunitete dhe

343 Shih Institutin Demokratik të Kosovës*, Raporti “Lumenjtë e Zi” (2020) i qasshëm në: <<https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/03/22-Lumenjtë-e-zi-te-Kosoves-Raport-04.pdf>>.

344 Po aty, f. 20.

345 Po aty.

mjedis; megjithatë nuk ka shembuj të mjaftueshëm për të treguar se zhvillohen konsultime publike kuptimplote. E drejta e lirisë së tubimit dhe e drejta për të organizuar protesta dhe demonstrata është e garantuar, me shembuj pozitivë ku qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile i kanë ushtruar lirisht këto të drejta.

Sa i përket të drejtës për informim, aktorët e shoqërisë civile ankohen se qasja në dokumente publike nuk ofrohet gjithmonë dhe se duhet të bëjnë kërkesa të përsëritura për qasje në dokumente të cilat duhet të ishin bërë publike nga organet qeveritare. Këta të fundit publikojnë raporte përkatëse që monitorojnë gjendjen e mjedisit, ndotjen e ajrit, ujërat, tokën, menaxhimin e mbetjeve etj., ndonëse jo gjithmonë brenda afatit të përcaktuar me ligj.³⁴⁶ Informacioni mjedisor që duhet të jetë i qashtëm në uebsajtin e organeve qeveritare nuk është gjithmonë i disponueshëm dhe i përditësuar. Ndërsa disa raporte dhe informacione publikohen në të dyja gjuhët zyrtare (shqip dhe serbisht), ka informacione të cilat mungojnë në gjuhën serbe. Informacioni në gjuhët e komuniteteve të tjera në Kosovë* nuk ekzistojnë.

Praktika gjyqësore e gjykatave të rregullta është mjaft e kufizuar në aspektin e të drejtave të njeriut dhe mjedisit. Janë disa raste që tregojnë një interes në rritje të aktivistëve mjedisorë dhe organizatave të shoqërisë civile për të ndjekur rrugë të vështira ligjore për të vënë operatorët e hidrocentraleve përgjegjës për dëmin e shkaktuar mjedisor. Analiza nxjerr në pah mungesën e shfrytëzimit të KEDNJ-së, standardeve të Këshillit të Evropës dhe atyre ndërkombëtare, dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në procesin e gjykimin. Megjithatë, Avokati i Popullit duhet përgëzuar për prirjen e tij më të madhe drejt përdorimit më të gjerë të këtyre standardeve në raportet e tij lidhur me mbrojtjen e lumenjve, menaxhimin e mbetjeve dhe hidrocentralet në Kosovë*.

Më konkretisht, gjendja ekzistuese e praktikës gjyqësore në Kosovë* tregon se:

- (i) ka mungesë të njohurive, ekspertizës dhe përvojës së mjaftueshme në trajtimin e çështjeve mjedisore
- (ii) ka mospërputhje në mënyrën se si gjykatat e ndryshme të rregullta, madje edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë vendosin mbi kërkesëpadi të ngjashme mjedisore në lidhje me të drejtat e njeriut
- (iii) megjithëse legjislacioni i brendshëm ofron mjete juridike të mjaftueshme për të adresuar këto çështje, vështirësitë qëndrojnë në përdorimin praktik të këtyre mjeteve dhe njohuritë e autoriteteve vendase për t'i zbatuar ato në mënyrë korrekte
- (iv) megjithëse ka një interes në rritje midis individëve dhe organizatave të shoqërisë civile për të ndjekur rrugë ligjore në kundërshtimin e projekteve që konsiderohen të dëmshme për komunitetet dhe mjedisin, ekziston ende nevoja për të inkurajuar dhe financuar sektorin e shoqërisë civile në përpjekjen e tij për ndjekjen e proceseve strategjike gjyqësore

Qasja në drejtësi dhe mjetet juridike vendase për të adresuar shqetësimet mjedisore janë të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi. Individët, personat juridikë, komunitetet, organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët mjedisorë kanë të drejtë të paraqesin kërkesëpadi mjedisore në gjykatë dhe të kërkojnë mbrojtjen gjyqësore të këtyre të drejtave, duke përfshirë edhe padinë ndaj aktorëve industrialë dhe të korporatave për dëme (materiale dhe jomateriale). Ndihma juridike falas mund të ofrohet nëse kërkuesit plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Ekzistojnë mjete të ndryshme juridike në dispozicion në procedurat administrative, civile dhe penale. Efektiviteti i tyre nuk është testuar në mënyrë adekuate për shkak të mungesës së proceseve të mjaftueshme gjyqësore; por ka shembuj të mirë që tregojnë interesin e disa gjykatave vendase për të vendosur në favor të këtyre kërkesëpadive, si dhe shembuj që tregojnë joefektivitetin e këtyre mjeteve juridike me mosekzekutimin e urdhrave të dhëna nga gjykatat.

Strategjitë PSKPP janë përdorur nga bizneset në fushën e hidrocentraleve në Kosovë*, në një përpjekje për të heshtur aktivistët e mjedisit. Megjithatë, strategji të tilla kanë dështuar duke e bërë

346 Për shembull, në gusht 2024 rezulton që raporti vjetor i disponueshëm për gjendjen e mjedisit në Kosovë* është i vitit 2022, ndërsa raporti për vitin 2023 ende nuk është publikuar pas miratimit nga Parlamenti.

temën e hidrocentraleve një temë diskutimi publik në mesin e shumë organizatave vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Riverwatch, Amnesty International etj. Kjo ka motivuar grupet e shoqërisë civile që të vazhdojnë betejën ligjore kundër hidrocentraleve të ndryshme në Kosovë*, e cila rezultoi në fitimin e çështjeve gjyqësore dhe një rast potencialisht historik në dorëzim në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim. Të gjitha këto përpjekje po ndihmojnë në gjenerimin e praktikës gjyqësore vendase dhe për të ushtruar presion mbi organet vendimmarrëse për të marrë më seriozisht zbatimin e kornizës legjislative për mjedisin dhe të drejtat e njeriut.

Shqetësimet kryesore kombëtare mjedisore në kontekstin kombëtar përfshijnë: (i) ndotjen e ajrit (tejkalimi i nivelit të ndotësve mbi standardet e pranueshme për shkak të mbështetjes së madhe në qymyrimin e linjimit dhe djegjen e lëndëve djegëse të ngurta për ngrohje); (ii) ndotjen e ujit (ujërave e zeza të patrajtuara, shkarkimet industriale, mungesa e objekteve për trajtimin e ujërave të zeza), dhe (iii) shpyllëzimin dhe degradimin e tokës (prerjet e paligjshme dhe përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve të tokës).

Hapësira qytetare në Kosovë* po rritet ngadalë. Ka një numër në rritje të organizatave të shoqërisë civile të cilat fokusohen në kauzat mjedisore dhe një numër në rritje i aktivistëve mjedisorë që organizojnë protesta dhe përfshihen në kontestimin gjyqësor të praktikave që dëmtojnë mjedisin. Ndërsa ka organizata që janë të përfshira në procese gjyqësore strategjike afatgjata për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, ekziston një hendek i madh për t'u mbuluar duke marrë parasysh numrin e çështjeve mjedisore që mbeten të pakundërshtuara dhe numrin e madh të ndotësve industrialë dhe të korporatave që përfitojnë nga klima ekzistuese e mosndëshkimit.

Rekomandime:

- (1) **Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues** (si Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja) dhe ndryshimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, ujërave dhe natyrës - i cili konsiderohet i vjetruar dhe jo plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare
- (2) **Forcimi i zbatimit të urdhrave** duke rritur transparencën, duke angazhuar mbikëqyrjen publike dhe duke zbatuar me forcë dënimet ligjore për mosrespektimin e urdhrave të gjykatës
- (3) **Rritja e kapaciteteve institucionale** të MMPHI-së, Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës* dhe Inspektoratit të Mjedisit në nivel qendror dhe vendor, për të monitoruar dhe zbatuar në mënyrë efektive ligjet dhe rregulloret mjedisore, përmes: (i) plotësimin të numrit të vendeve të punës që janë planifikuar në organigramën e brendshme, por që aktualisht nuk janë të zëna nga ekspertët e kërkuar; (ii) ofrimit të trajnimeve të përshtatura për ligjet dhe rregulloret në fuqi; (iii) sigurimit të një koordinimi më të mirë ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore të cilat duhet të sigurojnë inspektimin/mbrojtjen e mjedisit
- (4) **Sigurimi i pjesëmarrjes domethënëse dhe transparencës publike** në ligjbërjen dhe proceset vendimmarrëse në lidhje me projektet që kanë një ndikim të madh në mjedis, përmes (i) publikimit të dokumenteve përkatëse të VNM-së në përputhje me ligjin, në lidhje me çdo projekt të planifikuar, duke mundësuar kështu qasje të shpejtë dhe të lehtë në të dhënat/planet/projektet mjedisore; (ii) zhvillimit të platformave të konsultimit online dhe të drejtpërdrejta që sigurojnë një mënyrë të qetë dhe transparente të paraqitjes së komenteve; (iii) sigurimit se konsultimi kuptimplotë i të gjitha palëve përkatëse është bërë përpara se të merret ndonjë vendim, nëpërmjet zbatimit të fuqishëm të legjislacionit në fuqi për pjesëmarrjen e publikut dhe transparencën
- (5) **Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit dhe avokatëve** në funksion të përmirësimit të qasjes në drejtësi, duke ofruar trajnime të përshtatura mbi parimet kyçe mjedisore dhe zbatimin e tyre në praktikë (trajnim për zbatimin e legjislacionit vendas mjedisor, traktatet/parimet ndërkombëtare për mjedisin dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për çështjet mjedisore)

- (6) **Forcimi i kapaciteteve të prokurorëve** për të hetuar dhe paditur autorë të dyshuar të krimeve mjedisore, duke u ofruar atyre trajnime specifike të bazuara në raste praktike, si dhe trajnime mbi parimet kryesore mjedisore dhe zbatimin e tyre në praktikë
- (7) **Promovimi dhe mbështetja e konsistencës gjyqësore** në vendimet e gjyqësorit, duke u ofruar nëpunësve dhe gjyqtarëve të të gjitha niveleve trajnime specifike mbi praktikën gjyqësore ekzistuese vendore në lidhje me rastet e të drejtave të njeriut në mjedis të vendosura nga gjykata të ndryshme themelore në Kosovë*, duke përfshirë Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë
- (8) **Rritja e ndërgjegjësimit për ndihmën juridike** dhe inkurajimi i individëve dhe komuniteteve të prekura (veçanërisht pakicat dhe grupet e cenueshme) që të kërkojnë ndihmë juridike në rastet kur përballen me dëmtim mjedisor, duke i informuar ata për këto të drejta në mënyrë proaktive, duke zhvilluar fushata të drejtuara nga shteti dhe OJQ (media sociale dhe personalisht) që synojnë të informojnë qytetarët për këto të drejta
- (9) **Miratimi i një ligji të ri kundër PSKPP-ve ose parashikimi i ndonjë rregullimi tjetër kundër PSKPP-ve në legjislacionin/rregulloret ekzistuese**, si një mjet për të mbrojtur aktivistët mjedisorë nga paditë e pabaza që synojnë të ndalojnë aktivizmin e tyre mjedisor dhe t'i heshtin ata
- (10) **Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe publikut të gjerë** në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve juridike për t'i mbajtur përgjegjës aktorët/ndotësit e korporatës për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës që shkaktojnë dëme mjedisore dhe ndikojnë në kushtet e jetesës së njerëzve dhe kafshëve njësoj
- (11) **Përmirësimi i zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga Avokati i Popullit** në lidhje me qasjen në informacion dhe rekomandime të tjera në lidhje me çështjet mjedisore të trajtuara nga Avokati i Popullit
- (12) **Përmirësimi i përputhshmërisë ndërmjet ligjeve mjedisore** përmes (i) rritjes së monitorimit dhe mbikëqyrjes së ndotësve industrialë dhe ndotësve të tjerë; (ii) fuqizimit të organeve rregullatore me autoritet, buxhet dhe burime të mjaftueshme për të kryer inspektime dhe për të zbatuar ligjet ekzistuese; (iii) zbatimit të dënimeve për shkeljet dhe sigurimit të qëndrueshmërisë në zbatim për të penguar mospërputhjen dhe për të luftuar mosndëshkimin
- (13) **Mbështetja e shoqërisë civile dhe aktivistëve mjedisorë** përmes ofrimit të mbështetjes ligjore dhe financiare, duke u mundësuar atyre të ndjekin një proces gjyqësor strategjik kundër korporatave/ndotësve të mëdhenj, avokimit dhe monitorimit të pavarur të gjendjes së mjedisit
- (14) **Promovimi i edukimit mjedisor dhe të të drejtave të njeriut** në shkolla dhe universitete
- (15) **Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere publike** për të informuar qytetarët dhe bizneset për ligjet mjedisore, rëndësinë e pjesëmarrjes në konsultime, rëndësinë e respektimit të kërkesave ligjore dhe pasojat e shkeljeve mjedisore

Mal i Zi: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

1. Hyrje

Mali i Zi u bë shtet i pavarur pas referendumit të mbajtur më 21 maj 2006. Në Luksemburg, Mali i Zi nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila hyri në fuqi më 1 maj 2010 pas ratifikimit nga Shtetet Anëtare të BE-së. Pas opinionit pozitiv të Komisionit Evropian, Mali i Zi aplikoi për anëtarësim në BE më 15 dhjetor 2008, ndërsa negociatat me BE-në filluan zyrtarisht më 29 qershor 2012. Më 26 qershor 2024, në Konferencën Ndërqeveritare të mbajtur në Bruksel, Mali i Zi mori një raport pozitiv mbi përmbushjen e piketave të ndërmjetme në fushën e sundimit të ligjit (IBAR).

Në raportin e vendit të vitit 2023 për Malin e Zi, Komisioni Evropian deklaroi se Mali i Zi kishte arritur një përparim të kufizuar në këtë fushë në Kapitullin 27 (Mjedisi dhe ndryshimet klimatike). Progres i kufizuar u arrit gjithashtu në harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së për ujin, mbrojtjen e natyrës dhe ndryshimet klimatike. Nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme kur bëhet fjalë për zbatimin dhe ekzekutimin, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ujit dhe ajrit, mbrojtjes së natyrës dhe ndryshimeve klimatike. Mali i Zi duhet të forcojë dhe përshpejtojë ndjeshëm ambiciet e tij në lidhje me tranzicionin e gjelbër. Në vitin e ardhshëm, Mali i Zi duhet veçanërisht: të intensifikojë punën për zbatimin dhe ekzekutimin në mënyrë që të arrijë standardet përfundimtare në Kapitullin 27, veçanërisht në fushat e ujit, mbrojtjes së natyrës, cilësisë së ajrit, ndotjes industriale dhe ndryshimeve klimatike; të miratojë dhe të fillojë zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave dhe Strategjisë për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit për periudhën 2021-2029; të finalizojë, miratojë dhe fillojë zbatimin e planit kombëtar të energjisë dhe klimës në një mënyrë transparente, në përputhje me objektivin e BE-së për emetimet neto zero deri në vitin 2050 dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.³⁴⁷ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Malin e Zi për vitin 2024 përmban përfundime të ngjashme.³⁴⁸

2. E drejta materiale dhe praktika

2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis

E drejta për një mjedis të shëndetshëm është një degë e veçantë e së drejtës që karakterizohet nga një koncept specifik i rregullimit ligjor, procedurave jostandarde të mbrojtjes dhe personave të veçantë juridikë.³⁴⁹ Në Malin e Zi, ajo ka një strukturë komplekse të brendshme dhe përfshin norma ligjore materiale dhe procedurale që rregullojnë mbrojtjen e saj.

2.1.1. Mbrojtja e mjedisit/të drejtave të njeriut në kushtetutën kombëtare

Sipas Kushtetutës³⁵⁰, Mali i Zi është një shtet ekologjik, i bazuar në sundimin e ligjit.³⁵¹ Ky parim ishte përfshirë edhe në Kushtetutën e Republikës së Malit të Zi të vitit 1992 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 48/92). Deklarata e Shtetit Ekologjik³⁵² prezantoi termin “dinjitet i natyrës”, duke treguar se ligjvënësi kushtetues ka inkorporuar vlerat themelore të shpallura në Konventën për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për

347 Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Malin e Zi për vitin 2023, 8 nëntor 2023, SWD (2023) 694.

348 Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Malin e Zi për vitin 2024, 20 tetor 2024, SWD (2024) 694.

349 Proso, M. (2015), Përgjegjësia civile në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Botimi i Fakultetit të Drejtësisë në Split, 52(3), f. 705-712

350 Neni 1 i Kushtetutës së Malit të Zi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 1/2007 dhe 38/2013).

351 Po aty.

352 Deklarata e Shtetit Ekologjik e Malit të Zi është një dokument historik politik dhe mjedisor që e shpalli Malin e Zi një shtet ekologjik, i miratuar dhe nënshkruar nga Parlamenti i Republikës së Malit të Zi më 20 shtator 1991.

Çështjet Mjedisore (Konventa e Aarhusit) në Kushtetutën e Malit të Zi, shumë kohë para se Mali i Zi ta ratifikonte atë. Kushtetuta e Malit të Zi i garanton të gjithëve të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, për informacion në kohë dhe të plotë për gjendjen e mjedisit, mundësinë e ndikimit në vendimmarrje për çështje të rëndësishme për mjedisin dhe mbrojtjen ligjore të këtyre të drejtave. Të gjithëve, veçanërisht shtetit, u kërkohet të mbrojnë dhe përmirësojnë mjedisin.³⁵³

2.1.2. Pjesë specifike të legjislacionit:

Duke pasur parasysh legjislacionin dhe instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe në veçanti kërkesat e Konventës së Aarhusit, Mali i Zi ka miratuar një kuadër legjislativ gjithëpërfshirës në këtë fushë. Ligji për Mjedisin ("LiM")³⁵⁴, si një "*lex specialis*" në fushën e mbrojtjes së mjedisit, rregullon parimet, instrumentet dhe masat e mbrojtjes së tij si dhe çështje të tjera me rëndësi për mjedisin.³⁵⁵ Përveç këtij ligji, mbrojtja e segmenteve të caktuara të mjedisit rregullohet me ligje të veçanta³⁵⁶

2.1.3. Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare

Mali i Zi është i lidhur me të gjitha traktatet ndërkombëtare universale për të drejtat e njeriut që ishin të detyrueshme për Bashkimin Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë³⁵⁷, ndër të cilat janë Konventa për Diversitetin Biologjik dhe Protokollin i Kartagjenës mbi Biosigurinë) si dhe Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (UNCLOS). Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Mali i Zi ratifikoi Konventën e Aarhusit më 15 korrik 2009. Përveç kësaj, Mali i Zi ishte ndër vendet e para që nënshkroi Konventën e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsø) të 18 qershorit 2009. Traktate të tjera ndërkombëtare që janë ratifikuar janë Konventa Kuadër e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (2006), Protokollin i Kiotos për Konventën Kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 17/2007).³⁵⁸

Duke shpallur parimin kushtetues sipas të cilit traktatet ndërkombëtare dhe rregullat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik, kanë epërsi ndaj legjislacionit të brendshëm dhe janë drejtpërdrejtë të zbatueshme kur bien ndesh me legjislacionin e brendshëm³⁵⁹, Mali i Zi miratoi sistemin juridik monist. Duke garantuar të drejtën për një mjedis të shëndetshëm si një nga të drejtat e njeriut për "të gjithë", kërkesat e Konventës së Aarhusit u transpozuan në sistemin kushtetues malazez dhe Mali i Zi garantoi më shumë të drejta sesa ato të garantuara nga KEDNJ-ja.³⁶⁰

353 Neni 23 i Kushtetutës së Malit të Zi.

354 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 73/19.

355 Neni 1 i LiM-së.

356 Neni 6 i LiM-së. Për ligjet e tjera që janë miratuar në varësi të segmenteve të mbrojtjes së mjedisit, në përputhje me këtë nen, shih Shtojcën (2.1.2.).

357 Pas shpalljes së pavarësisë, Mali i Zi dërgoi një deklaratë për vazhdimësinë e traktateve ndërkombëtare në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. RSFJ-ja tashmë kishte ratifikuar të gjitha traktatet më të rëndësishme universale ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

358 Për marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit që janë ratifikuar nga Mali i Zi, shih Shtojcën (2.1.3.)

359 Neni 9 i Kushtetutës së Malit të Zi.

360 Mali i Zi ratifikoi KEDNJ-në më 26 dhjetor 2003, e cila hyri në fuqi në lidhje me Malin e Zi më 4 mars 2004. KEDNJ nuk garanton të drejtën për mjedisin si të tillë, por shqyrton shkeljet e mundshme të të drejtave të tjera të cilat i garanton, të cilat mund të cenohen drejtpërdrejt ose kërcënohen nga faktorë të ndryshëm që lidhen me mjedisin.

2.2. Si zbatohet në praktikë legjislacioni për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

2.2.1. Analizë e efektivitetit të dispozitave kushtetuese

Me qëllim mbrojtjen e mjedisit në aspektin e tij përmbajtësor, para organeve kompetente shtetërore në Mal të Zi mund të iniciohen lloje të ndryshme procedurash – procedura administrative, civile, penale, kundërvajtëse, tregtare dhe së fundi në Gjykatën Kushtetuese. Secila prej tyre ka rregullat e veta në lidhje me *locus standi* të cilat nuk janë të rregulluara në të njëjtën mënyrë. Procedura për mbrojtjen e mjedisit nuk është e përshkruar si procedurë specifike dhe homogjene në rregulloret malazeze. Konkretisht, Ligji për Mjedisin (LiM) parasheh të drejtën e inicimit të procedurës për rishikimin e vendimeve të marra në fushën e mbrojtjes së mjedisit, si dhe të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatën kompetente në pajtim me “*rregulloret e veçanta*”, megjithëse këto rregullore dhe ligje nuk janë të specifikuar në mënyrë eksplicite dhe varen nga e drejta specifike për t'u mbrojtur.³⁶¹

Duke qenë se Kushtetuta garanton të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, është e mundur të bëhet dallimi midis disa instrumenteve të mbrojtjes ligjore bazuar në faktin nëse mbrojtja e kësaj të drejte kërkohet drejtpërdrejt, apo nëse trajtohet shkelja e një të drejte tjetër të mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNJ, e kërcënuar nga shqetësimi mjedisor. Sfida qëndron në zgjedhjen e një instrumenti prioritar për parandalimin përpara se të ketë nevojë për riparim dhe riintegrim dhe, rrjedhimisht, kompensim për dëmin që rezulton, duke pasur parasysh veçanërisht konceptin e paqartë të “*locus standi*” të bartësve të së drejtës për të paraqitur padi pranë gjykatës kompetente.

Ndryshe nga LiM-ja e mëparshme, e cila parashikonte rregullat ligjore për mbrojtjen e aspektit përmbajtësor të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm si në rastin e shkeljes së të drejtës si të tillë, ashtu edhe në rastin kur një person fizik ose juridik ka pësuar dëme për shkak të degradimit të mjedisit, ligji i ri dhe Ligji për Përgjegjësinë për Dëmtimin Mjedisor nuk i përmbajnë këto dispozita. Heqja e këtyre normave në ligjin e ri krijoi pasiguri juridike, paqartësi dhe paparashikueshmëri lidhur me interpretimin e mjeteve juridike në dispozicion për qytetarët që kërkojnë mbrojtje mjedisore dhe nëse një mbrojtje e tillë është e garantuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë duke pasur parasysh se Ligji për Përgjegjësinë për Dëmtimin Mjedisor shprehimisht thotë se personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk mund të ushtrojnë të drejtën e kompensimit për shkak të dëmtimit mjedisor ose kërcënimit të menjëhershëm të një dëmi të tillë. Gjithashtu, ky ligj nuk përmban një dispozitë që i referohet zbatimit të ndonjë ligji tjetër që mund të përdoret për të mbrojtur aspektin përmbajtësor të së drejtës për mjedisin.

Një analizë e kuadrit normativ dhe mungesa e praktikës gjyqësore në lidhje me aspektin thelbësor të mbrojtjes së mjedisit, ka ngritur disa pyetje të rëndësishme. Para së gjithash, nëse e drejta për një mjedis të shëndetshëm, e garantuar si e tillë me Kushtetutën e Malit të Zi, është vendosur në sistemin legjislativ të Malit të Zi dhe ka zënë rrënjë në praktikë; kush është bartësi i asaj të drejte; cilat janë procedurat për ta mbrojtur atë dhe nëse kompensimi për dëmet që rrjedhin nga cenimi i të drejtës për një mjedis të shëndetshëm mund të konsiderohet si arsye më vete (“*dëm i pastër ekologjik*”) në lidhje me kompensimin e dëmit që vjen nga cenimi i një të drejte tjetër të kërcënuar nga shqetësimet mjedisore. Këto pyetje trajtohen në seksionet e mëposhtme, me një rekomandim për të marrë në konsideratë miratimin e udhëzimeve për të adresuar boshllëqet në këtë fushë.

2.2.2. Praktika dhe vendimet gjyqësore

Gjykatat nuk mbajnë statistika të veçanta të procedurave lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Rastet në të cilat gjykatat vendosnin për padi për dëmshpërblim kundër shtetit, ndërmarrjeve shtetërore dhe personave juridikë thuajse gjithmonë kishin të bënin me shfaqjen e dëmit të zakonshëm ose humbjen e fitimit nga prona si pasojë e ndotjes së mjedisit të shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi. Gjykatat nuk i referohen vendimeve përkatëse të GJEDNJ-së, standardeve ndërkombëtare të vendosura në lidhje me këtë çështje dhe as Konventës së Aarhusit.³⁶²

361 Neni 73 i LiM-së.

362 Si shembull ilustrues, vendimi i Gjykatës së Lartë në Podgoricë, GZ.br.3871/21-15 datë 13 qershor 2023. Për më shumë detaje, shih Shtojcën (2.2.2.), pasi vendimi nuk u publikua në sudovi.me

Sipas informacioneve nga Mbrojtësi i Interesave Juridike Pronësore të Malit të Zi, aktualisht është vetëm një proces para gjykatës në të cilin paditësi ka ngritur padi kundër shtetit për shkelje të vetë të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, si dhe të së drejtës për jetën familjare dhe private e cila shkelet për shkak të ndotjes së padurueshme të ajrit, veçanërisht në periudhën tetor-prill, gjatë sezonit të ngrohjes së banesave. Paditësi përmendi ndotjen e ajrit nga grimcat e mbetura pezull si arsye kryesore për kërkesëpadinë e tij civile. Është procesi i parë që ka nisur shprehimisht për shkeljen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm (shkelje e detyrimit pozitiv të shtetit për të siguruar këtë të drejtë) dhe për një të drejtë tjetër të mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNJ.

Në një rast tjetër, Gjykata e Lartë e Malit të Zi la në fuqi vendimet e niveleve më të ulëta, të cilat rrëzuan kërkesëpadinë e paditësve për dëm material, për shkak të uljes së çmimit të tregut të tokës që ata zotëronin, si rezultat i ndotjes nga "pellgu i llumit të kuq të KAP"³⁶³, duke e konsideruar atë të pabazuar.³⁶⁴ Edhe pse paditësi iu referua veprimtarisë ndotëse të vazhdueshme që është ende në vazhdim dhe e njohur si "njollë e zezë mjedisore", gjykatat e kanë rrëzuar kërkesëpadinë për dëmshpërblim ndaj ndotësit, duke konsideruar se ajo ishte parashkruar. Në lidhje me shtetin, si pale e dytë e paditur, Gjykata e Lartë e rrëzoi kërkesëpadinë e paditësit shumë shkurt si të pabazuar, duke deklaruar se shteti po ndërmerre masat dhe aktivitetet e duhura nëpërmjet autoriteteve të tij për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Gjykata e Lartë nuk iu referua dispozitave përkatëse të Kushtetutës, konventave ndërkombëtare, standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me të drejtën e pronës dhe të drejtën e jetës private dhe familjare (edhe pse janë ngritur nga paditësit), apo praktikës së institucioneve ndërkombëtare që mbikëqyrin zbatimin e tyre, si dhe dispozitave specifike të LiM që ishte në fuqi në atë kohë.³⁶⁵ Pellgu i llumit të kuq të KAP është ende një pikë e zezë mjedisore.³⁶⁶

Praktika e mbrojtjes së kësaj të drejte jetike nuk është krijuar plotësisht. Në këtë aspekt, duhet të konsiderohen edhe trajnimet për përfaqësuesit e gjyqësorit dhe Gjykatës Kushtetuese, duke u fokusuar në identifikimin e përshtatshëm dhe në kohë të çështjeve dhe kontesteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të gjitha segmenteve të mjedisit, si dhe me të drejtat e njeriut në mjedis dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në nivel kombëtar. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet njohjes së detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit në përputhje me parimin e subsidiaritetit në lidhje me konventat ndërkombëtare, si dhe zbatimin e standardeve të tyre.

2.2.3. Mekanizmi për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

Sipas rregullave të Ligjit për Procedurën Civile³⁶⁷, gjykata është e detyruar t'i drejtojë palët në një takim fillestar ndërmjetësues, nëse njëra nga palët është shteti, kryeqyteti ose komuna.³⁶⁸ Megjithatë, ndërmjetësimi është një proces vullnetar.³⁶⁹ Nuk ka asnjë informacion se procedurat e ndërmjetësimit janë zbatuar në mosmarrëveshjet për mbrojtjen e mjedisit.³⁷⁰

363 KAP ishte një fabrikë alumini. Llumi i kuq është një suspension koloidal shumë alkalik, që mbetet pas përpunimit të boksitit në alumin sipas procesit Bayer. Është një nënprodukt që shfaqet gjatë përpunimit të boksitit për të marrë alumin. Mund të përmbajë elementë të ndryshëm toksikë, kështu që asgjësimi i tij është problematik. Gjithashtu, për shkak të mënyrës së përpunimit të boksitit, llumi i kuq i mbetur zakonisht përmban sasi të mëdha grimcash më të vogla se një mikrometër (informacioni gjendet në <https://www.irb.hr/Novosti/Nove-spoznaje-o-ekotoksicnosti-crvenog-mulja>)

364 Vendimi gjendet në <https://sudovi.me/vrhs/odluka/341870>.

365 Shpjegimi i vendimeve gjyqësore reduktohet kryesisht në interpretimin dhe zbatimin e ligjit klasik të detyrimeve në lidhje me rregullat për kompensimin e dëmit, duke mos njohur jo vetëm të drejtën për mjedisin si të tillë, por edhe të drejta të tjera që mund të kërcënohen nga ndotja e mjedisit. Gjykata Kushtetuese, duke vendosur për kërkesëpadinë kushtetuese, e la në fuqi një vendim të tillë të Gjykatës së Lartë pa sqaruar nëse cenohej e drejta për mjedis të shëndetshëm apo e drejta për jetë private, të drejta të cilave u thirrën për zbatim në ankesën kushtetuese.

366 Për më shumë detaje, shih Shtojcën (Seksioni 4).

367 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 047/08 e datës 7 gusht 2008, 004/11 e datës 18 janar 2011, 022/17.

368 Neni 329 parag. 4 Ligji për Procedurën Civile.

369 Neni 10 i Ligjit për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve - palët marrin pjesë vullnetarisht në procesin e ndërmjetësimit.

370 Informacioni i marrë nga drejtori i Agjencisë për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve.

3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore

3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes

3.1.1. Qasja në informacionin mjedisor

Qasja në kohë dhe e plotë në informacion është shumë shpesh një parakusht për të ushtruar të drejtën thelbësore ndaj mjedisit. Kjo është arsyeja pse e drejta për të pasur qasje në informacionin në fushën e mjedisit nuk mund të shihet e izoluar nga e drejta për të filluar më pas procedura të caktuara për rishikimin e vendimeve para organeve kompetente, apo gjykatës, për të mbrojtur aspektin përmbajtësor të kësaj të drejte. Informimi i publikut për mjedisin, pjesëmarrja e publikut dhe e drejta për mbrojtje ligjore rregullohen me LiM. Kështu, ky ligj përcakton qartë se cilat informacione për mjedisin duhet të publikohen si dhe mënyrën se si publikohet ai informacion (përmes databazave elektronike ose përmes mediave). Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit është e detyruar të informojë publikun dhe në veçanti të informojë pa vonesë nëpërmjet mediave elektronike ose me mjete të tjera të përshtatshme, për situata të rrezikshme të menjëhershme për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin. I njëjti detyrim ekziston kur shkelen vlerat kufi të përcaktuara të emetimeve në mjedis. Përveç Agjencisë, edhe ndotësi ka detyrim të informojë publikun në një situatë të tillë.³⁷¹ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit publikon rregullisht informacione në uebsajtin e saj³⁷² në lidhje me vendimet për kërkesa të caktuara, por jo informacione që tregojnë nëse janë bërë ankesa kundër këtyre vendimeve apo rezultatit të tyre. Vendimet publikohen vetëm në mënyrë sporadike kur bëhen njoftime në lidhje me çështje me interes publik.³⁷³

LiM-ja thekson se qasja në informacione për mjedisin sigurohet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin që rregullon qasjen e lirë në informacion. Qasja në informacion në këtë fushë sigurohet në bazë të një kërkesë të paraqitur pranë autoritetit të administratës shtetërore dhe autoritetit të administratës vendore. Kërkesa nuk është e domosdoshme të përfshijë arsyet e kërkimit të informacionit dhe duhet të shqyrtohet brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së saj. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për qasje në informacione rreth mjedisit, mund të parashtrahet ankesë pranë autoritetit kompetent. Kërkesa për qasje në informacion rreth mjedisit nuk mund të refuzohet nëse ajo kërkesë i referohet emetimeve të substancave ndotëse në mjedis.³⁷⁴

Ligji për Qasje të Lirë në Informacion përshkruan se si duhet të paraqiten kërkesat për informacion. Autoriteti që mban informacionin e kërkuar është përgjegjës për të vendosur për këto kërkesa³⁷⁵. Nëse dikush paraqet një kërkesë për qasje ose ripërdorim të informacionit, ata, së bashku me palët e tjera të interesuara, kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtje gjyqësore sipas ligjit që rregullon mosmarrëveshjet administrative. Procedurat ligjore lidhur me kërkesa të tilla trajtohen si urgjente³⁷⁶. Megjithatë, ligji nuk zbatohet për të dhënat e klasifikuara si sekrete sipas ligjeve për informacionin e klasifikuar. Në raste të tilla, gjykata mund të shqyrtojë nëse autoriteti e ka shënuar saktë informacionin si sekret, duke ndjekur rregullat për fshehtësinë e të dhënave³⁷⁷.

Përveç sa më sipër, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis³⁷⁸ parashikon që autoriteti kompetent është i detyruar të sigurojë qasje në dokumentacionin në lidhje me procedurën e kryer të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) sipas kërkesës, përveç dokumenteve të shënuara si konfidenciale sipas ligjit. Si më sipër, informacioni duhet të jepet brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës. Dokumentacioni në lidhje me emetimet e substancave të dëmshme, rreziqet e aksidenteve, rezultatet e monitorimit dhe kontrolli i inspektimit nuk mund të shënohen si konfidenciale ose të

371 Nenet 67 dhe 68 të LiM-së.

372 <https://epa.org.me/obavjestenje-odgovornost/>

373 Shih uebsajtin <https://epa.org.me/2024/08/06/saopstenje-za-javnost-27/>

374 Nenet 66, 69 dhe 70 të LiM-së.

375 Neni 25 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

376 Neni 44 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

377 Neni 1 paragraf 2 pika 2 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion dhe neni 44 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

378 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 40/2011 – ligj të tjera, 59/2011 dhe 52/2016.

kufizuara.³⁷⁹ Në përgjithësi, dispozitat e LiM-së dhe Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion, si dhe ligje të tjera për fusha të veçanta të mjedisit, ofrojnë mbrojtjen e duhur ligjore dhe gjyqësore për qasje në kohë në informacion, veçanërisht në rastin e refuzimit të qasjes në informacion.

Megjithatë, bazuar në një analizë dhe krahasim të detajuar të dispozitave të ligjeve mjedisore dhe ligjeve që janë plotësuese me ligjet e veçanta dhe të përgjithshme në këtë fushë, mund të konkludohet se disa çështje nuk janë plotësisht të harmonizuara dhe i lihet praktikës përcaktimi i disa termave, si p.sh. përcaktimi i personave që preken ose pritet të preken nga vendimarrja në procedurat mjedisore; nëse në rastin e informacionit mjedisor, çdokush ka të drejtën e informacionit³⁸⁰, ose vetëm pala e interesuar³⁸¹, dhe brenda kësaj, nëse vetëm OJQ-të që merren me mbrojtjen e mjedisit apo OJQ-të e angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë “palë të interesuara”. Praktika gjyqësore vendase e disponueshme tregon se, krahas atyre që preken drejtpërdrejt nga vendimet (që kanë një interes të fortë dhe të drejtpërdrejtë, si qytetarët, banorët, komunitetet lokale), OJQ-të që merren me mbrojtjen e mjedisit mund të bëjnë gjithashtu ankesa si palë të interesuara.

Më tej, kur organi kompetent deklaron se nuk posedon informacionin e kërkuar në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion, është e paqartë se çfarë procedure duhet të ndiqet, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se nuk ka asnjë praktikë gjyqësore në dispozicion që adreson këtë çështje.³⁸²

Më tej, korniza normative ekzistuese përballet me sfida në zbatim dhe praktikë, veçanërisht në lidhje me qasjen në informacione të klasifikuara me një nivel të caktuar sekreti. Ka dallime në fushëveprimin, formën dhe mënyrën në të cilën gjykatat kompetente (Gjykatat Administrative dhe e Lartë e Malit të Zi, dhe më pas Gjykata Kushtetuese) janë të autorizuar të shqyrtojnë një vendim që refuzon një kërkesë për qasje të lirë të sekretit të brendshëm dhe nivel të lartë sekreti. Kjo vjen nga hartimi i ligjeve të ndryshme në këtë fushë, të cilat janë jokonsistente dhe ndonjëherë edhe kontradiktore.

Është gjithashtu e dukshme se Gjykata Administrative dhe ajo e Lartë e Malit të Zi, mjaft shpesh, nuk e zbatojnë testin e proporcionalitetit gjatë shqyrtimit të vendimeve të organeve kompetente administrative lidhur me kërkesat për qasje në informacione të shënuara me një nivel të caktuar fshehtësie (edhe pse, për shembull, është shënuar me nivelin më të ulët të fshehtësisë “INTERNAL”). Në veçanti, testi i proporcionalitetit nuk zbatohet kur balancohet fshehtësia e informacionit me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të drejtën e publikut për t'u informuar siç imponohet nga vendimet e shumta të GJEDNJ-së (shih detaje të mëtejshme më poshtë në seksionin që ka të bëjë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar testin e proporcionalitetit në një çështje që ka të bëjë me ndërhyrjen në qasjen e OJQ-ve në informacion për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo kishte të bënte me refuzimin e kërkesave për qasje të lirë në dokumentet që kanë të bëjnë me projektin më të madh strategjik të Malit të Zi – ndërtimin e autostradës Bar-Boljari – ku pjesa më e madhe e dokumentacionit është shënuar me nivelin e fshehtësisë “INTERNAL”.³⁸³ Gjykata Kushtetuese kryesisht i hodhi poshtë ankesat e tilla kushtetuese si të pabaza me shumicë votash. Sa më sipër nënvizon nevojën për trajtime të rregullta të përfaqësuesve të autoriteteve kompetente që vendosin

379 Neni 31 i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor.

380 Në përputhje me rregullat e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

381 Në përputhje me rregullat e LiM-së.

382 Ligji për Qasjen e Lirë në Informacion vetëm në pjesën që rregullon kompetencat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashikon që Këshilli i Agjencisë, për të zgjidhur ankesat dhe për të ushtruar mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e akteve administrative në përgjigje të kërkesave për qasje në informacion, ka të drejtë të kërkojë që inspektimi, i cili është përgjegjës për kontrollin e veprimtarisë së zyrës, të përcaktojë nëse autoriteti posedon informacionin e kërkuar (neni 40).

383 Ndër shumë të tjera, shih Vendimin https://www.ustavisud.me/ustavisud/skladiste/blog_8/objava_78/fajlovi/U_III%20br%20391_21.pdf, dhe Opinionin e Veçantë me Vendimin https://www.ustavisud.me/ustavisud/skladiste/blog_8/objava_78/fajlovi/U_III%20br%20391_21%20IZDVOJENO%20RAZLI%C4%8CITO%20MI%C5%A0LJENJE%20SUDIJA%20SNE%C5%BDANA%20ARMENKO.pdf. Për të kundërtën, shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, në dispozicion në https://www.ustavisud.me/ustavisud/skladiste/blog_8/objava_78/fajlovi/U_III%20br%202109_19.pdf

për kërkesat për qasje të lirë në informacion, dhe përfaqësuesve të gjyqësorit si dhe të Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht në lidhje me zbatimin e standardeve të KEDNJ.

3.1.2. E drejta e tubimit dhe protestës

Neni 52 i Kushtetutës së Malit të Zi mbron të drejtën e lirisë së tubimit dhe Mali i Zi ka miratuar gjithashtu një ligj për tubimet dhe ngjarjet publike.³⁸⁴ Nuk ka asnjë ligj të veçantë që mbron të drejtat e tubimit dhe protestës për mbrojtësit e të drejtave të njeriut në mjedis. Tubimet paqësore dhe protestat që synojnë mbrojtjen e mjedisit njihen si aktivitetet kryesore të sektorit të OJQ-ve dhe shoqërisë civile në këtë fushë. Megjithatë, ka pasur raste kur individëve iu është mohuar e drejta e lirisë së tubimit gjatë protestave publike.

Përtej kufizimeve në tubime paqësore, dekurajimi i shoqërisë civile shtrihet në aktivitete të tjera mjedisore, duke penguar përpjekjet më të gjera për të mbrojtur mjedisin.³⁸⁵

3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre

3.2.1. Qasja në drejtësi

LiM-ja autorizon publikun e interesuar që të fillojë procedurat e rishikimit të vendimeve të organeve publike, si dhe të ankimojë vendimet e autoritetit për çështjet e mbrojtjes së mjedisit dhe të ngrëjë padi në përputhje me rregulloret e veçanta.

Në lidhje me "*locus standi*" ose "*të drejtën për t'u paraqitur në gjykatë*", në mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e aspektit përmbajtësor të të drejtave të njeriut në mjedis, për kërkimin e dëmshpërblimit, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile. Çdo person fizik ose juridik që ka pësuar dëme të caktuara si rezultat i ndotjes së mjedisit mund të nisë këto lloj procedurash.³⁸⁶

Megjithatë, neni i mësipërm i Ligjit për Procedurën Civile lejon edhe ngritjen e padisë nga "*publiku i interesuar*", e cila ka të drejtë të iniciojë procedura sipas LiM-së si rregullim i veçantë (neni 73 i ligjit). Paqartësi në zbatimin e "*locus standi*", mund të lindë nga përkufizimi i ndryshëm brenda LiM-së se kush ka "*të drejtën e qasjes në drejtësi*". Kjo çështje ende nuk është shqyrtuar apo interpretuar nga gjykatat.³⁸⁷

Nuk ka asnjë informacion që tregon se gjykatat janë marrë me çështjen e konfirmimit të së drejtës për padi për "personat e interesuar" në këto procedura. Gjithashtu, termi "publik i interesuar" dhe shkalla në të cilën publiku supozohet të preket nuk është përcaktuar, përveç atyre, të drejtat e tjera të të cilëve ndikohen drejtpërdrejt nga shqetësimi dhe ndotja e mundshme e mjedisit. Ka mospërputhje në lidhje me çështjen *locus standi* në të drejtën dhe praktikën procedurale mjedisore. E drejta për qasje të lirë në informacion sipas Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion i mbulon të gjithë dhe nuk kërkohet të deklarohen arsyet pse nevojiten informacionet. Nga ana tjetër, e drejta për të

384 "Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 052/16 datë 9 gusht 2016

385 Informacioni gjendet në <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/567148/bajceta-mitrovic-i-pajevic-nisu-pocinili-ni-jedno-krivicno-djelo-tokom-performansa-na-zabljaku>. Për më shumë informacion, shih Shtojcën (Seksioni 3.1.) i cili përfshin aspekte të përzgjedhura të intervistës së realizuar për qëllimet e kësaj analize me Drejtorin Ekzekutiv të OJQ-së Shoqata Ekologjike Breznica.

386 Neni 76 parag. 1, 2 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Civile (Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 22/2004, 28/2005 – vendimi i GJK-së dhe 76/2006 dhe Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 47/2015 – ligje të tjera, 48/2015, ..., 34/2019, 42/2019 - korr. dhe 76/2020).

387 Kështu, një nga parimet mbi të cilat bazohet LiM-ja është parimi i "*mbrojtjes së të drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe qasjes në drejtësi*", duke e përcaktuar si më poshtë: "*qytetarët ose grupet e qytetarëve, shoqatat e tyre, organizatat profesionale apo të tjera, kanë mundësinë të ndikojnë në vendimmarrje për çështje me rëndësi për mjedisin dhe mbrojtjen ligjore me autoritetet kompetente dhe para gjykatës*" (neni 5 pika 13 e LiM-së). Nga ana tjetër, neni 73 i të njëjtit ligj i njej të drejtën për të nisur procedurat "*vetëm*" publikut të interesuar, duke e përcaktuar atë si "*publiku që preket ose pritet të preket nga vendimmarrja në çështjet mjedisore, duke përfshirë organizatat joqeveritare të angazhuara në mbrojtjen e mjedisit*" (Neni 7 pika 42 e LiM-së).

filluar procedurat për rishikimin e vendimeve, ankimimin dhe fillimin e procedurës sipas LiM-së i takon një "personi të interesuar". Kjo tregon se është vendosur një kufizim për fillimin e procedurës dhe rishikimin e vendimeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit për ata persona që më parë kanë marrë informacionin sipas Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

Nuk ka asnjë informacion dhe praktikë gjyqësore të disponueshme që tregon se grupe qytetarësh, banorë lokalë apo OJQ që merren me mbrojtjen e mjedisit kanë ngritur padi për mbrojtjen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm pranë gjykatave civile. Si arsye për aktivitet të pamjaftueshëm dhe veprim proaktiv në këtë çështje, përfaqësues të caktuar të OJQ-ve, përmendin rregulla të paqarta dhe interpretime të paparashikueshme të organeve administrative dhe gjykatave në lidhje me njohjen e të drejtës për padi në procedurë civile dhe administrative, pamundësinë e përballimit të shpenzimeve në rastin e humbjes së mosmarrëveshjes³⁸⁸, kompleksiteti i procedurës së provave dhe rrjedhimisht paparashikueshmëria e vetë rezultatit, veçanërisht pasi informacioni që ata marrin në përputhje me qasjen e lirë në informacion është shpesh i pakët, i paplotë dhe ndonjëherë i vonuar. E gjithë kjo i dekurajon anëtarët e «publikut të interesuar» nga kryerja e procedurave për të mbrojtur aspektin thelbësor të kësaj të drejte.³⁸⁹

3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë

Mjetet juridike civile: Të drejtat mjedisore mbrohen përmes padive civile në procesin civil, ku individët ose subjektet bazuar në Kodin e Procedurës Civile, mund të kërkojnë dëmshpërblim sipas legjislacionit civil.

Forma klasike e kompensimit të dëmeve

Sipas parimeve të përgjithshme të përgjegjësisë civile, kushdo që i shkakton dëm tjetrit kërkohet ta shpërblejë atë, përveç rastit kur vërtetohet se dëmi ka ndodhur pa fajin e tij (i njohur si përgjegjësi subjektive ose përgjegjësi e bazuar në faj). Krahas përgjegjësisë subjektive, ekziston edhe përgjegësia objektive, ku personi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga sendet ose aktivitetet që prodhojnë një rrezik të shtuar të dëmtimit të mjedisit, pavarësisht nga fajin. Përgjegësia objektive përdoret më shpesh si bazë për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga shqetësimi ose kërcënimin ndaj mjedisit.

Shteti mund të jetë gjithashtu përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga autoriteti i tij ndaj një pale të tretë gjatë ushtrimit ose në lidhje me ushtrimin e detyrave të tij.³⁹⁰

Për më tepër, sipas rregullave të Ligjit për Detyrimet, "çdo person i interesuar ka të drejtë të ngrëjë padi për pavlefshmërinë e kontratave", «nëse janë në kundërshtim me rregulloret e detyrueshme ose me moralin e shoqërisë», dhe kjo e drejtë «nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit».³⁹¹ Prandaj, "personi i interesuar" në këtë lloj procedure është një standard ligjor, ekzistenca e të cilit shqyrtohet nga gjykata në çdo rast konkret.³⁹²

Miratimi i Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmin Mjedisor vendosi marrëdhënien shtet-operator (ndotës). Rregullon mënyrën dhe procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë për dëmtimin e mjedisit dhe zbatimin e masave parandaluese dhe korigjuese për parandalimin dhe korigjimin e dëmeve në mjedis (neni 1). Personat juridikë dhe fizikë, të cilët me kryerjen e veprimtarive të tyre shkaktojnë dëme ose rrezik të menjëhershëm të dëmtimit të mjedisit, janë përgjegjës për dëmin dhe kërkohet të zbatojnë masa për parandalim dhe rehabilitim në pajtim me këtë ligj (neni 2). U prezantua parimi "ndotësi paguan" i kompensimit të dëmit në mjedis, ku dëmi kompensohet me zbatimin e masave parandaluese dhe rehabilituese (të cilat mund të jenë parësore, plotësuese dhe kompensuese) (neni 3 dhe neni 21 i ligjit).

388 Shih Shtojcën (3.2.1. Nënseksioni 1).

389 Shih Shtojcën (3.2.1. Nënseksioni 2).

390 Neni 166 parag. 1 i Ligjit për Detyrimet.

391 Nenet 107, 101 dhe 108 të Ligjit për Detyrimet.

392 Kjo ngre pyetjen nëse gjykata do të pranojë përkufizimin e termit "publiku i interesuar" të përdorur nga LiM-së ose të vlerësojë ekzistencën e një interesi specifik ligjor dhe të fortë (të mjaftueshëm) për çështje gjyqësore në secilin rast specifik.

Për shkak të mungesës së praktikës gjyqësore apo interpretimit gjyqësor, nuk mund të konkludohet nëse miratimi i këtij ligji përjashton mundësinë që shteti të zhvillojë një procedim të posaçëm civil për dëmshpërblim ndaj personit që ka shkaktuar dëm mjedisor, apo nëse miratimi i këtij ligji e ka njohur shtetin si titullar ekskluziv të së drejtës për mbrojtjen e mjedisit të shëndetshëm.³⁹³

Një proces gjyqësor i veçantë për shkak të «dëmtimit mjedisor» ose «procesit gjyqësor të rëndësishëm mjedisor» - ose «kërkesës për të eliminuar kërcënimin»

Një tjetër mjet juridik i disponueshëm në fushën e mbrojtjes së mjedisit, i inkorporuar në nenin 150 të Ligjit për Detyrimet, lejon "*secilin*" të kërkojë nga tjetri që të largojë një burim rreziku që kërcënon t'i shkaktojë dëme të konsiderueshme atij ose një numri të papërcaktuar personash dhe të përmbahet nga një veprimtari që rezulton në shqetësim ose rrezik dëmtimi, nëse shqetësimi ose humbja që pason është e pamundur të parandalohet me masa adekuate. Paragrafi 2 i të njëjtit nen parashikon se gjykata do të urdhërojë, "*me kërkesë të një personi të interesuar*", të merren masat e duhura për të parandaluar shfaqjen e dëmtimit ose shqetësimit ose për të hequr burimin e rrezikut, në kurriz të pronarit të burimit të rrezikut, nëse ai vetë nuk e bën këtë. Paragrafi 3 kufizon përgjegjësinë për dëmin që ka ndodhur gjatë një veprimtarie me interes të përgjithshëm.³⁹⁴

Mund të konkludohet se ligjvënësi fut në këtë normë të ashtuquajturën "*actio popularis*" duke garantuar të gjithë të drejtën për të kërkuar heqjen e një burimi rreziku që i kërcënon (duke nënkuptuar kështu interesin e drejtpërdrejtë) dhe një numër të pacaktuar personash (që tregon *actio popularis*). Edhe pse GJEDNJ-ja e karakterizoi këtë mjet juridik si bazë ligjore për "dëm mjedisor" për shkak të shkeljes së të drejtës së pronës³⁹⁵, në kornizën kombëtare mund të flitet më tepër për "*proceset gjyqësore civile mjedisore publike*" ose një "*padi kolektive*" të mundshme. Megjithatë, ky koncept është shumë kontradiktor për sa i përket parashikueshmërisë dhe qartësisë. Domethënë, ndonëse në paragrafin e parë kjo e drejtë i garantohet "*secilit*", paragrafi i mëposhtëm parashikon se gjykata me kërkesë të një "personi të interesuar" (pra jo "*secilit*") urdhëron heqjen e burimit të rrezikut, gjë që tregon mospërputhjen e vetë normës juridike. Praktika nuk e ka eliminuar këtë kontradiktë ligjore.

Gjithashtu, norma në vetvete nuk është e qartë nëse parakusht për ngritjen e padisë është marrja e masave të tjera të përshtatshme për të parandaluar shfaqjen e shqetësimit apo dëmtimit në një procedurë tjetër, dhe nëse po, cilat do të ishin ato masa dhe veprime. Meqenëse kjo normë ka qenë pjesë e Ligjit për Detyrimet shumë kohë përpara miratimit të Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmtimin e Mjedisit dhe nuk është e harmonizuar me të, është e paqartë se si do ta interpretojnë gjykatat në procedurat juridike dhe nëse mospërdorimi i instrumenteve të përcaktuara nga ajo procedurë do të jetë arsye për rrëzimin e kërkesëpadisë si të parakohshme.³⁹⁶ Për më tepër, paragrafi 3 i të njëjtit nen kufizon përgjegjësinë për dëmin që ka ndodhur gjatë një veprimtarie me interes të përgjithshëm, për të cilën është marrë leje nga organi kompetent. Parashikohet që në atë rast mund të kërkohet vetëm kompensimi i dëmit që tejkalon kufijtë normalë. Është e paqartë nëse më parë është e nevojshme që "*secili*" që, sipas LiM-së, duhet të jetë "person i interesuar" fillon procedurat për të kundërshtuar këto vendime dhe, lidhur me këtë, sipas cilit kriter bëhet vlerësimi i dëmit "*që i kalon kufijtë normalë*". Prandaj, në këto procedura mund të shtrohet pyetja për ligjshmërinë e një akti të

393 Me miratimin e këtij ligji nuk janë më në fuqi dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën e secilit për të kërkuar kompensim për dëmin në bazë të shkeljes së të drejtës për mjedis të shëndetshëm dhe që ai të ushtrohet sipas rregullave të Ligjit për Detyrimet. Nëse kjo e drejtë u mohohet personave fizikë dhe juridikë, nuk është e qartë nëse shteti tani është bërë pasardhësi universal dhe i vetëm i bartësit të së drejtës për mbrojtjen e një mjedisit të shëndetshëm si i tillë.

394 Neni 150 i Ligjit për Detyrimet.

395 Në rastin *Cokarić k. Kroacisë*, kërkesa nr. 3321/1, datë 19 janar 2006, ky mjet juridik u pranua si bazë ligjore për kompensimin e "dëmtimit mjedisor për shkak të rënies së mundshme të vlerës së pronës" dhe lidhet me interesin dhe të drejtën e drejtpërdrejtë personale të kërkuesit të mbrojtur nga Konventa.

396 Neni 332 parag. 3 i Ligjit Për Procedurën Civile "*Nëse veprimi që është objekt i kërkesëpadisë nuk ka arritur në përfundimin e shqyrtimit kryesor, gjykata do ta refuzojë padinë si të parakohshme*".

caktuar administrativ ose veprimtarisë administrative.³⁹⁷

Prandaj, përkufizimi ligjor “secili” i përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk përputhet me përmbajtjen e tij të mëtejshme dhe zbatimi i tij duket i paparashikueshëm.

Të drejtat e pronësisë

Një nga mjetet e mbrojtjes ligjore në rast të shkeljes së të drejtës së pronësisë për shkak të ndotjes së natyrës është *actio negatoria*, e cila kërkon ndërprerjen e shqetësimit të pajustificuar ose heqjen e shqetësimit që rezulton.³⁹⁸ Një tjetër mjet ligjor mbrojtjeje në dispozicion është e drejta për të ngritur padi për mbrojtjen e të ashtuquajturës “e drejtë e fqinjit” (padi për mbrojtjen nga efektet e dëmshme të emetimeve).³⁹⁹

Në praktikë, ky mjet është përdorur në procedurën në vazhdim para Gjykatës së Shkallës së Parë në Podgoricë, ku Shteti i Malit të Zi paditi një kompani private për ndërhyrje në të drejtat pronësore – *actio negatoria*, duke deklaruar se një ndërhyrje e tillë kishte shkaktuar degradim mjedisor. Shteti nuk kërkoi kompensim për dëmet për shkak të shkeljes së të drejtës materiale për mjedisin, as nuk iu referua ndonjë mase të ndërmarrë më parë në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmtimin e Mjedisit, i cili është *lex specialis* për procedurat për përcaktimin e dëmit. Në ankimim, shteti nuk iu referua standardeve dhe praktikës së GJEDNJ-së dhe as konventave ndërkombëtare. Kërkesa e shtetit për masa të përkohshme u pranua, por më pas u rrëzua pjesërisht me vendimin e shkallës së dytë (shih detaje të mëtejshme në seksionin në lidhje me procedurat pranë Gjykatës Kushtetuese).

Procedurat administrative: Mbrojtja juridike e të drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje sigurohet në procedurën administrative, ku mund të kundërshtohen vendime të ndryshme të organeve kompetente, në përputhje me Ligjin për Procedurën Administrative.⁴⁰⁰ Mali i Zi ka miratuar shumë rregullore të veçanta mjedisore, ku secila prej tyre, sipas fushës së saj të rregullimit, përmban rregulla të veçanta vendimmarrëse. Në disa ligje, dispozitat që i referohen zbatimit të normave përkatëse të Ligjit të Procedurës Administrative për çështje që nuk rregullohen nga ato ligje janë shfuqizuar.⁴⁰¹ Mund të konsiderohet se kjo nuk mund të pengojë të drejtën për të filluar një procedurë rishikimi dhe ankim kundër vendimeve të miratuara në procedurat për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me nenin 4 të Ligjit të Procedurës Administrative.⁴⁰²

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor parashikon se kundër vendimit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit mund të ankimohet në ministrinë kompetente në të tri fazat e procedurës (për nevojën për një vlerësim të ndikimit, përcaktimin e fushës dhe përmbajtjes së studimit dhe dhënien e miratimit të studimeve). Gjithashtu, kundër vendimeve të organeve të qeverisjes vendore mund të bëhet ankim para kryeadministratorit.⁴⁰³ Mosmarrëveshja administrative mund të fillohet kundër një akti administrativ të shkallës së dytë ose një akti tjetër, që do të thotë një vendim i marrë gjatë shqyrtimit të ankesës, ose kundër një akti administrativ të shkallës së parë ose një akt tjetër kur

397 Ligji për Procedurën Civile njehtë ashtuquajturën “pyetje paraprake” (neni 212 parag. 1 pika në lidhje me nenin 14) që mund të nënkuptojë zhvillimin paraprak të procedurës administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative. Nga ana tjetër, në një situatë kur inicohet një procedurë administrative, apo një mosmarrëveshje administrative, organi i së drejtës publike në procedurën administrative dhe Gjykata Administrative kanë kompetencë që ta referojnë palën në një procedurë civile për dëmspërblim (neni 142 i Ligjit për Procedurën Administrative dhe neni 35 parag. 2 i Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative).

398 Neni 126 i Ligjit për Marrëdhëniet Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 19/2009)

399 Neni 266 i Ligjit për Marrëdhëniet Juridike Pronësore (ai njehtë të drejtën për të paditur pronarët e pasurive të paluajtshme të ekspozuara ndaj emetimeve të tepërta, duke i lejuar ata të kërkojnë nga pronari i pasurisë së paluajtshme nga e cila burojnë këto shkarkime, të eliminonjë shkaqet e këtyre emetimeve dhe të kompensojnë dëmin që ata shkaktuan dhe të përmbahen nga aktivitetet që shkaktajnë emetimet e tepërta në pronën e tyre të paluajtshme në të ardhmen, derisa të merren të gjitha masat për parandalimin e tyre).

400 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 56/2014, 20/2015, 40/2016 dhe 37/2017.

401 Neni 26 i Ligjit për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor, i cili i referohej zbatimit të Ligjit të Procedurës Administrative, është shfuqizuar, ashtu si edhe neni 37 i Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmtimin Mjedisor. Në këto ligje, tani nuk parashikohet shprehimisht nëse publiku i interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vendimeve të caktuara të marra në ato procedura.

402 Parashikon se dispozitat e ligjeve të veçanta të cilat, për shkak të karakterit specifik të çështjeve administrative në fusha të caktuara administrative, parashikojnë shmangie të nevojshme nga rregullat e procedurës administrative, nuk mund (...) të ulin nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të palëve të përcaktuara me këtë ligj.

403 Nenet 13 dhe 14 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor.

ankimi nuk lejohet. Ligji parashikon gjithashtu fillimin e një mosmarrëveshjeje administrative në rast të "heshtjes së administratës".

Mosmarrëveshja administrative mund të fillohet me një padi⁴⁰⁴, ku gjykata ka të drejtë të vlerësojë nëse autoriteti administrativ i ka shënuar siç duhet të dhënat e kërkuara si konfidenciale në përputhje me ligjin që rregullon sekretin e të dhënave⁴⁰⁵

Është me rëndësi të theksohet se Ligji për Përgjegjësinë për Dëmin Mjedisor parashikon procedurën për përcaktimin e dëmit mjedisor, të cilën e kryen Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (neni 9 paragrafi 1). Procedura mund të nisët *ex officio* ose me kërkesë të publikut të interesuar, ndërsa çdo person që merr dijeni se ka pasur dëmtim të mjedisit ose se ekziston rrezik i menjëhershëm i dëmtimit të mjedisit, kërkohet të njoftojë menjëherë autoritetin administrativ dhe inspektoratin e tij kompetent (paragrafët 2 dhe 3 të të njëjtit nen). Megjithatë, duke qenë se ishin shfuqizuar dispozitat e mëparshme të cilat i referoheshin zbatimit të Ligjit të Procedurës Administrative për çështjet që nuk rregullohen në mënyrë specifike me këtë ligj (ish-neni 37 i ligjit), mbetet e paqartë nëse palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të marra sipas këtij ligji. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se autoriteti administrativ kërkohet të njoftojë, *ndër të tjera*, kërkuesi për fillimin e procedurës ose refuzimin e arsyetuar të kërkesës, brenda pesë ditëve nga dita e fillimit të procedurës për përcaktimin e dëmit.⁴⁰⁶

Procedura penale dhe kundërvajtëse: Në varësi të kualifikimit të veprës penale në fjalë, ndjekja penale mund të ndërmerret nga një paditës privat ose mund të fillohet *ex officio* për kryerjen e veprës penale kundër mjedisit dhe planifikimit territorial⁴⁰⁷, për të cilat parashikohen gjoba dhe dënime me burg në varësi të natyrës ligjore dhe rëndësisë së veprës. Secili prej ligjeve të veçanta në fushën e mjedisit parashikon rregullat për monitorimin e zbatimit të ligjit në përputhje me Ligjin për Kontrollin Inspektues, kompetencat e inspektorëve dhe dispozitat ndëshkuese (për kundërvajtje) që janë ose gjoba dhe/ose masa mbrojtëse që ndalojnë kryerjen e veprimtarive.⁴⁰⁸

Sipas të dhënave statistikore të vitit 2023, praktika gjyqësore në fushën e përgjegjësisë penale për dëmtimin e mjedisit është ende e nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Numri i personave të denoncuar për krime kundër mjedisit është ulur me 2.59%, ose 385 denoncime (395 persona në vitin 2022, 312 persona në vitin 2021, 376 persona në vitin 2020, 303 persona në vitin 2019). Shumica e kallëzimeve penale kanë të bëjnë me veprën penale të prerjes së pyjeve (96 persona), veprën penale të peshkimit të paligjshëm (17 persona), veprën penale të ndërtimit të paligjshëm të objekteve (226 persona). Shumica e kallëzimeve penale nuk janë pranuar nga Prokuroria e Shtetit, ndërsa me zbatimin e parimit të ndjekjes penale të shtyrë, prokurorët e shtetit kanë zgjidhur 20 çështje⁴⁰⁹.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese: Në procedurën e juridiksionit normativ (vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme), nismën për fillimin e procedurës për vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara e të publikuara, ose rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme me Kushtetutën dhe ligjin, e ka çdo person fizik ose juridik, si dhe organizata, fondacione, grup personash dhe forma të tjera organizimi që nuk kanë statusin e personit juridik, që nuk kanë nevojë të kenë interes të drejtpërdrejtë juridik për paraqitjen e nismës.⁴¹⁰ Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar ose anuluar akte vetëm për shkak të mangësive procedurale në fazën e miratimit të ligjit ose aktit të përgjithshëm, të tilla si probleme lidhur me diskutimin publik, pjesëmarrjen e publikut dhe kërkesa

404 Neni 34 parag. 2 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

405 Neni 44 i Ligjit për Qasje të Lirë në Informacion.

406 Shih op.ct. 4 të Ligjit të Procedurës Administrative.

407 Kapitulli XXV – veprat penale kundër mjedisit dhe planifikimit të territorit (nenet 303-326c).

408 Për shembull, nenet 38-42 të Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmtimin Mjedisor; nenet 32-37 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor; nenet 114-120 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

409 Nuk kemi informacion për arsyet e vendimit të prokurorisë, pasi të njëjtat janë në burimin referues, si të tillë, të marra nga <https://zakoni.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/183/3341-19105-00-72-24-7.pdf>. Të dhëna të tjera janë marrë nga "Raporti hije për Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike", f. 19. Gjetend në https://www.greenhome.co.me/wp-content/uploads/2020/07/ONLINE_Izvjestaj-iz-sjenke-2024-MNE_pages_compressed-1.pdf. Për më shumë detaje, shih Shtojcën I).

410 Për më shumë, shih nenet 54, 55, 56 dhe 67 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 11/05).

të ngjashme. Megjithatë, edhe në ato vendime, Gjykata Kushtetuese nuk i është referuar kërkesave të konventave ndërkombëtare (KEDNJ dhe Konventa e Aarhusit) dhe standardeve të përcaktuara me aplikimin e tyre.

Ligji Për Gjykatën Kushtetuese përcakton se kushdo të cilit i është shkelur e drejta nga një akt individual të formës së prerë ose të detyrueshëm, të miratuar në bazë të një ligji ose rregulloreje tjetër ose nga një akt i përgjithshëm që me vendim të Gjykatës Kushtetuese është konstatuar në kundërshtim me Kushtetutën, me traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të publikuara ose me ligjin, ka të drejtë të kërkojë nga autoriteti kompetent të ndryshojë atë akt individual, nëse ky ndryshim nuk cenon të drejtat e palëve të treta të ndërgjegjshme.⁴¹¹ Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, ankesat kushtetuese shfaqen në mënyrë sporadike për shkak të shkeljes së disa të drejtave të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, por nuk ka vendime specifike të Gjykatës Kushtetuese të bazuara as në aspektin material, as në atë procedural të së drejtës për mjedisin, pra kjo e drejtë nuk është adresuar në mënyrë specifike, dhe ankesat kushtetuese janë shqyrtuar kryesisht nga aspekti i shkeljes së mundshme të së drejtës për gjykim të drejtë, të përmendur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.⁴¹² Gjykata Kushtetuese nuk është marrë në mënyrë specifike me "*locus standi*" për paraqitjen e ankesës kushtetuese për mbrojtjen e mjedisit, pasi vetëm personi të cilit i është shkelur e drejta mund të bëjë ankim kushtetues. Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankesën e Shtetit të Malit të Zi, përfaqësuar nga Mbrojtësi i Interesave Juridike Pronësore, kundër një vendimi të një gjykate më të ulët për dhënien pjesërisht të masës së përkohshme për mbrojtjen e pronës dhe parandalimin e dëmtimit të mjedisit, duke vlerësuar se është një akt procedural që nuk gëzon mbrojtje kushtetuese.⁴¹³

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Mali i Zi përballet me probleme kyçe si menaxhimi i territorit, ndotja e ajrit dhe ujit dhe shkatërrimi i burimeve natyrore nëpërmjet shfrytëzimit dhe përdorimit të paqëndrueshëm. Përveç sa më sipër, Mali i Zi ende përballet me problemin e njollave të zeza ekologjike të pazgjithshme. Në këtë drejtim, është e nevojshme të theksohet se nuk ka informacion të saktë të disponueshëm publikisht për të gjitha aksidentet mjedisore ose shqetësimet kryesore kombëtare në Malin e Zi, duke përfshirë historinë e tyre të mëparshme dhe situatën aktuale. Në Malin e Zi, deri vonë, zyrtarisht kishte katër pika të zeza mjedisore që përfaqësonin depozitimin e mbetjeve të rrezikshme industriale⁴¹⁴: Fabrika e Aluminit në Podgoricë (dy pishina me llum të kuq dhe një landfill i mbeturinave të ngurta), Kantieri i Adriatikut Bijela (Jadransko brodogradilište Bijeltamintedgrit) (Landfilli i hirit dhe skorieve në Maljevc), dhe miniera "Šuplja stijena" (depozita e mbeturinave të Gradacit).⁴¹⁵ Prandaj, është e qartë se këto nuk mbulojnë të gjitha fushat e dëmtimit mjedisor.⁴¹⁶

411 Neni 68 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi.

412 Përrjashtim bën rasti i përshkruar në Shtojcën (3.2.2., nënseksioni 2), në të cilin, duke analizuar shkeljen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese deklaroi se kjo dispozitë kushtetuese është e "natyrës deklarative". Shih edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, U-III nr. 1501/19 e datës 30 qershor 2023. Gjetet në https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/skladiste/blog_8/objava_109/fajlovi/U_III%20br%201501_19.pdf

413 Për më shumë detaje të shpjegimit, shih Shtojcën (3.2.2., nënseksioni 3).

414 Informacioni i Ministrisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit të Malit të Zi, i qasshëm në <https://wapi.gov.me/download-preview/00e4650f-25a0-43c6-a754-de61a1820ab3?version=1.0>,

415 Në këtë drejtim, më 10 tetor 2014, Mali i Zi nënshkroi një marrëveshje huaje për zbatimin e "Projektit të Menaxhimit dhe Pastrimit të Mbetjeve Industriale" me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH). Vlera e kredisë, sipas së cilës fondet mund të lëvrohen deri më 30 qershor 2019, ishte 50 milionë euro. Projekti kishte 2 objektiva: 1) rehabilitimi i vendeve ku ndodhen depozitimet e mbeturinave të rrezikshme industriale, përkatësisht: Fabrika e Aluminit në Podgoricë (2 pishina me llum të kuq dhe një depozitim i mbeturinave të ngurta), Kantieri i Adriatikut Bijela (zhavorri dhe dheu i kontaminuar), Termocentrali i Pljevljas (depoja e hirit dhe skories në Maljevac) dhe miniera «Šuplja stijena» (Suplja stijena) (Depozita e mbeturinave të Gradacit), dhe 2) mbështetje për ndërtimin e një sistemi për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme në të ardhmen në nivel kombëtar. Në këtë analizë ne u përpoqëm të paraqesim çdo pikë të zezë mjedisore apo incident të madh mjedisor, me të dhënat e disponueshme, përmes një këndvështrimi ligjor, në kuptimin e një epilogu ligjor.

416 Shih Shtojcën (Seksioni 4).

5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet

- ▶ Rruga ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mjedis dhe të drejtën thelbësore për një mjedis të shëndetshëm nuk është as e përcaktuar qartë dhe as e parashikueshme. Mbetet e pasigurt nëse vetëm shkëlja e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm përbën bazë për iniciimin e procedurave për dëmshpërblimin e dëmit, apo nëse fillimisht duhet të kryhet një procedurë administrative. Për më tepër, nuk është e qartë se kush e ka të drejtën për të nisur procedura të tilla dhe eventualisht për të kërkuar dëmshpërblim. Një sfidë e veçantë është përkufizimi i «dëmit të konsiderueshëm» në procedurat e mbrojtjes së mjedisit, i cili është një standard ligjor që ende nuk është përcaktuar ose sqaruar. Praktika nuk ka formësuar rregullat, standardet apo kriteret sipas të cilave bëhet vlerësimi kur çështja del përpara gjykatave.
- ▶ Standardet ndërkombëtare zbatohen në mënyrë jo të përshtatshme kur përcaktojnë shkëljen, përgjegjësinë, kompensimin dhe sasinë e dëmit që lidhet me dëmin mjedisor. Gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, nuk i referohen dhe nuk analizojnë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së apo të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe standardet mjedisore që këto kanë vendosur në vendimet e tyre (në procedurën pranë Gjykatës Kushtetuese nuk është respektuar zbatimi i testit të proporcionalitetit).
- ▶ Nuk ka një regjim ligjor specifik për procedurat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe rregullat e shpenzimeve në këto procedura nuk janë të ndryshme nga ato në fusha të tjera.
- ▶ OJQ-të dhe publiku i interesuar përballen me sfida të shumta në angazhimin me çështjet mjedisore, duke përfshirë informacionin e paplotë, vështirësinë në sfidimin e zbulimit të të dhënave të identifikuara si «sekret», pamundësinë për të marrë të dhënat e kërkuara për shkak se autoritetet nuk i kanë ato në posedim, mungesën e përgjigjes nga qeveria dhe organet administrative, procedurat e zgjatura pranë Gjykatës Administrative, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe moszbatimin të testit të proporcionalitetit nga këto organe. Kjo ka efekt frenues ose parandalues ndaj OJQ-ve dhe anëtarëve të interesuar të publikut.

Rekomandime

- ▶ Nevojitet një shqyrtim, analizë, rishikim dhe harmonizim gjithëpërfshirës, qoftë normativisht ose me interpretim në praktikë, të të gjitha ligjeve që rregullojnë aspekte individuale të mjedisit. Në këtë drejtim, duhet të merret në konsideratë mundësia e kodifikimit të zonës së mbrojtjes së mjedisit - duke trajtuar si aspektet thelbësore ashtu edhe ato procedurale, me rregulla të qarta në lidhje me *locus standi*, bazat e përgjegjësisë, instrumentet e mbrojtjes, si në rastin e parandalimit, rehabilitimit, ashtu edhe në rastin e dëmshpërblimit. Kjo mund të përfshijë integrimin e mbrojtjes së mjedisit si një fushë më vete brenda Kodit Civil, i cili aktualisht është në kodifikim.
- ▶ Të merret në konsideratë ndryshimi i Ligjit për Procedurat Civile në lidhje me çështjet mjedisore për të siguruar që secila palë të përballojë shpenzimet e veta, ose kostot të vlerësohen sipas parimit të drejtësisë me kriteret të përcaktuara qartë, me të cilat gjykatat vlerësojnë se çfarë është e drejtë
- ▶ Të merret parasysh zbatimi i trajnimeve për gjyqësorin dhe Gjykatën Kushtetuese si dhe për avokatët dhe anëtarët e publikut (përfshirë OJQ-të përkatëse që merren me të drejtat mjedisore) për identifikimin adekuat dhe në kohë të çështjeve dhe mosmarrëveshjeve në lidhje me mbrojtjen e të gjitha segmenteve të mjedisit, si dhe të drejtat e njeriut në mjedis dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në nivel kombëtar.
- ▶ Të merret parasysh parashikimi (si normativ ashtu edhe në praktikë) i një përkufizimi të «interesit të mjaftueshëm, d.m.th. “publiku preket ose supozohet të jetë i prekur” në vendimmarrje në fushën e mjedisit, me synimin për t'i ofruar publikut të interesuar mbrojtje të gjerë ligjore brenda objektit të Konventës së Aarhusit (që është edhe kërkesë e saj).
- ▶ Të merret parasysh miratimi i udhëzimeve (siç është një manual) për qytetarët, publikun e interesuar dhe OJQ-të e përfshira në mbrojtjen e mjedisit për të adresuar boshllëqet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në mjedis. Kjo duhet të shpjegojë në mënyrë të qartë dhe

të parashikueshme rrugët ligjore dhe instrumentet ligjore të mbrojtjes (krahas sfidave të mundshme me të cilat mund të përballen nëse vendosin të iniciojnë procedura).

► Të rriten kapacitetet administrative të autoriteteve qendrore dhe vendore duke siguruar trajnime për zyrtarët në autoritetet publike mbi *ndër të tjera* ligjet dhe rregulloret në fuqi, zbatimin e dispozitave të lirisë së informacionit, duke theksuar zbatimin e vazhdueshëm të parimit të interesit publik për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.

6. Shtojcë

Sesioni 2.1.

2.1.2.

Në përputhje me nenin 6 të LiM-së dhe në varësi të fushës së mbrojtjes së mjedisit, janë miratuar një sërë ligjesh:

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 75/18), Ligji për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 80/05, Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 59/11, 52/16), Ligji për Përgjegjësinë për Dëmtimin Mjedisor (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 55/16), Ligji për Shkarkimet Industriale (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 17/19), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 54/16, 18/19), Ligji për Mbrojtjen e Ajrit (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 25/10, 43/15, 73/19), Ligji për Ujërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi nr. 27/07, Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 32/11, 47/11, 48/15...84/18), Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 73/2019), Ligji për Mbrojtjen e Detit nga Ndotja nga Anijet (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 20/11, 26/2011, 27/2014), Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 54/16 dhe 18/2019), Ligji për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 74/2010, 40/2011), Ligji për Shërbimin Gjeologjik (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 28/93, 27/94, 42/94 dhe 26/07), Ligji për Kimikatet (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 51/2017), Ligji për Menaxhimin e Mbeturinave (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 34/2024), Ligji për Mbrojtjen nga Efektet Negative të Ndryshimeve Klimatike (Gazeta zyrtare e Malit të Zi nr. 73/19), Ligji për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues dhe Siguria nga Rrezatimi (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 58/09, 40/2011), Ligji për Zhurmën Mjedisore (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 28/2011, 28/2012, 1/2014, 2/2018), Ligji për Qasje të Lirë në Informacion (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 44/2012 dhe 30/2017) dhe shumë ligje të tjera.

2.1.3.

Marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit gjenden në uebsajtin e mëposhtëm: <https://www.gov.me/clanak/119719-zakonaska-regulativa-iz-oblasti-zivotne-sredine>

Sesioni 2.2.

2.2.2.

Në këtë çështje lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë në Podgoricë, Gž.br.3871/21-15 -, pas anulimit të mëparshëm të vendimit, ku të paditur ishin Shteti i Malit të Zi, Komuna e Danilovgradit dhe Elektroprivreda (Kompania Elektroenergjetike e Malit të Zi) (çështja ka vazhduar për 8 vjet), Gjykata e Lartë në Podgoricë ka rrëzuar vendimin e shkallës së parë me të cilën është pranuar kërkesa e paditësit dhe përfundimisht e ka refuzuar atë. Paditësi ka qenë pronar i një pasurie të paluajtshme, i cili ka pretenduar se ka pësuar dëme materiale, nga fitimi i humbur i shkaktuar nga reduktimi i mundësisë së prodhimit bujqësor në tokën në pronësi të tij, për periudhën 2012-2018. Kërkesa u bazua në kërkesëpadinë se parcelat e tij, të cilat ndodhen në fushën e Bjelopavliqit, midis lumit Zeta dhe rrugës Nikshiq-Podgoricë, janë të ekspozuara ndaj përmbytjeve periodike çdo vit, të cilat shkaktohen nga prurja e pakontrolluar e ujit nga lumi Zeta, e shkaktuar nga ndërtimi i liqeneve artificiale në Nikshiq dhe Hidrocentrali Peruçicë dhe HEC-i Sllap, të cilat ndryshuan regjimin e ujit, dhe nga mosmarrja e masave për zhvillimin e shtratit të lumit Zeta dhe mbrojtjen e tij nga efektet e dëmshme të ujit nga i pandehuri që menaxhon ujërat me rëndësi për Malin e Zi.

Kërkesëpadia u rrëzua, sipas dispozitave të Ligjit për Ujërat, sepse nuk u konstatua se ka pasur veprimtari dhe sjellje të pahijshme dhe të paligjshme të të paditurit dhe as moszbatim të ligjit, ndonjë rregulloreje tjetër apo aktit të përgjithshëm.

Sesioni 3.1.

Sipas të dhënave të marra gjatë një interviste me drejtorin e OJQ-së Shoqata Ekologjike "Breznica", në Malin Zi janë 12,351 OJQ, me rreth 6,000 OJQ aktive. Përfitues të projekteve për mbrojtjen e mjedisit janë edhe OJQ të caktuara që nuk janë ekskluzivisht të regjistruara si OJQ që merren me mbrojtjen e mjedisit, por edhe ato që merren me aktivitete që lidhen me "zhvillimin e qëndrueshëm".⁴¹⁷

Efekti frenues – Gjatë 11 viteve të fundit, 109 raste janë iniciuar kundër tij duke synuar luftën kundër aktivizimit të tij mjedisor dhe duke synuar të heshtin përpjekjet e tij. Ai është përballur me persekutim të vazhdueshëm. Për shembull, gjatë festimit të 30 vjetorit nga shpallja e Malit të Zi shtet ekologjik, ai u burgos, pasi mbante një pankartë me shkrimin "30 vjet nga shpallja dhe jemi vetëm në fillim".⁴¹⁸

Sipas të intervistuarit, qasja në informacion në fushën e mbrojtjes së mjedisit është shumë sfiduese. Ekzistojnë çështje të shumta, duke përfshirë kërkesat pa përgjigje dhe kostot e larta (kostot e kopjimit, tarifat e apelimit, etj.). Autoritetet shpesh pretendojnë se informacioni i kërkuar nuk është në posedim të tyre, ose nuk ia përcjellin atë institucionit kompetent etj.

Ai gjithashtu theksoi se edhe me marrjen e informacionit, qytetarët nuk vijnë më tej procedurat, ndërsa OJQ-të që merren me mbrojtjen e mjedisit nuk kanë kapacitete profesionale dhe as financiare për të iniciuar procedurën, duke vënë në pah çështjen e efikasitetit të gjykatave. Ai vuri në dukje shembullin e helmimit të peshkut në Çehotinë, që rezultoi në mosndëshkimin e autorëve për shkak se prokurori kompetent i shtetit e pushoi çështjen.

Sesioni 3.2.

3.2.1. Nënseksioni 1 Kostot e procedurave të mbrojtjes së mjedisit

LiM-ja nuk parashikon rregulla të veçanta për kostot e procedurës, por tregon se kërkesa për qasje të lirë në informacione mjedisore duhet të vendoset në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacion. Sa i përket shpenzimeve në procedurën administrative, përveç atyre që kanë të bëjnë me të drejtën për qasje të lirë në informacion, Ligji për Procedurën Administrative parashikon parimin e ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, pa vonesë dhe me sa më pak kosto, si një nga parimet bazë të procedurës administrative.⁴¹⁹ Procedura administrative parashikon gjithashtu mundësinë e përjashtimit nga pagesa e shpenzimeve, në rast se pala nuk mund t'i përballojë ato pa dëmtuar jetesën e tij të nevojshme, ose jetesën e nevojshme të familjes së tij. I huaji mund të përjashtohet nga pagesa e shpenzimeve kur kjo parashikohet nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe nëse nuk ka një marrëveshje të tillë, me kushtin e reciprocitetit.

Në mosmarrëveshjet administrative, nëse gjykata vendos në seancë dëgjimore, zbatohen rregullat e ligjit që rregullon procedurën civile për sa i përket shpenzimeve, pasi Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi ka shfuqizuar dnenin 39 paragrafi 1 i Ligjit për Mosmarrëveshjet Administrative, i cili parashikonte se në mosmarrëveshjet administrative secila palë i përballon shpenzimet e veta, nëse gjykata vendos në seancë të mbyllur.⁴²⁰ Kështu, në procedurën civile, secila palë përballon shpenzimet

417 Intervista është realizuar me Milorad Mitroviq, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së Shoqata Ekologjike "Breznica".

418 Sipas një deklarate të lëshuar nga Prokuroria Themelore në Pljevlje, Prokurori Themelor i Shtetit ka konstatuar se aktivistët e Shoqatës Ekologjike të Breznicës, të përfshirë në performancën e djeshme në Zhabljak, nuk kanë kryer ndonjë vepër penale që mund të ndiqen penalisht *ex officio*."

419 Neni 10 Ligji për Procedurën Administrative.

420 Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, UI br. 44/20, 11/23 dhe 31/23. Gjetet në: <https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/objava/blog/4/objava/204-odluka-ustavnog-suda-crne-gore-o-ukidanju-odredba-clana-39-stav-1-zakona-o-upravnom-sporu-sluzbeni-list-crne-gore-broj-54-16-u-i-br-44-20-11-23-i-31-23>

e procedurës që ka shkaktuar me veprimet e veta⁴²¹, por pala që humbet në proces gjyqësor në tërësi kërkohet të kompensojë palën kundërshtare dhe ndërhyrësin e saj për shpenzimet e tyre. Nëse pala ka sukses pjesërisht në mosmarrëveshje, gjykata, duke marrë parasysh suksesin e arritur, mund të përcaktojë që secila palë i përballon shpenzimet e veta ose që njëra palë të kompensojë palën tjetër dhe ndërhyrësin për një pjesë proporcionale të shpenzimeve. Gjykata mund të vendosë që njëra palë t'i kompensojë të gjitha shpenzimet e bëra nga pala kundërshtare dhe ndërhyrësi i saj, nëse pala kundërshtare ka fituar shumicën e kërkesëpadisë së saj dhe nuk ka pasur shpenzime të veçanta për shkak të pjesës që ka humbur. Kur prokurori i shtetit merr pjesë si palë në procedurë, ai ka të drejtën e kompensimit të shpenzimeve në pajtim me këtë ligj, por jo të drejtën e shpërblimit.⁴²² Dispozitat e këtij ligji për shpenzimet e procedurës vlejnë edhe për palët e përfaqësuar nga Mbrojtësi i Interesave Juridike Pronësore të Malit të Zi, përkatësisht organi kompetent komunal. Në rastin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, shpenzimet e procedurës përfshijnë shumën e shpenzimeve që do t'i jepeshin palës si shpërblim i avokatit.⁴²³

Procedurat para Gjykatës Kushtetuese janë pa pagesë dhe Gjykata Kushtetuese nuk cakton shpenzimet.⁴²⁴ Megjithatë, Ligji për Profesionin e Avokatit⁴²⁵ dhe për Tarifa e Avokatit⁴²⁶ rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet porositësit dhe avokatit.

Nëseksioni 2

Për qëllime të Analizës, ne kemi përdorur kryesisht bazën e të dhënave që përmban praktikën gjyqësore, e cila është e postuar në uebsajtin sudovi.me. Për praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar në uebsajtin Ustavnisud.me, vendimet e përzgjedhura të kësaj gjykate mund të gjenden në faqen kryesore. Sa i përket intervistave të realizuara, ato janë përdorur për të sqaruar zbrazëtirat e mundshme ligjore në ligje dhe për të shpjeguar arsyet e mungesës së praktikës gjyqësore për çështje të caktuara në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut. Kërkesat për intervista janë bërë me telefon përmes përfaqësuesve përkatës të aktorëve përkatës, përfaqësues të shoqërisë civile duke përfshirë OJQ-të, të cilët kanë dashur të mbeten anonimë, ndërsa një përfaqësues i OJQ-së ka dhënë intervistën e tij për qëllimet e kësaj analize, e cila është paraqitur më tej në këtë Shtojcë. Gjithashtu janë zhvilluar intervista me përfaqësues të gjykatave, përfaqësuesin ligjor të shtetit – Mbrojtësi i Interesave Juridike Pronësore, Qendra për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Gjykata Kushtetuese. Asnjë kërkesë zyrtare për qasje në informacion nuk është përcjellë, pasi ato janë konsideruar të panevojshme gjatë intervistave joformale me përfaqësuesit përkatës, të cilat në thelb ishin të panevojshme pasi analiza e kornizës normative në fakt tregoi paqartësi, mungesë transparence dhe mospërputhje në rregullimin e mekanizmave të caktuar të mbrojtjes së mjedisit.

3.2.2.

Nëseksioni 1

«Raporti hije» gjendet në

https://www.greenhome.co.me/wp-content/uploads/2020/07/ONLINE_Izvjestaj-iz-sjenke-2024-MNE_pages_compressed-1.pdf.

Raporti i shtatë hije i Koalicionit 27 mbi progresin në Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike mbulon periudhën nga qershori 2023 deri në maj 2024. Raporti hije synon të paraqesë një pamje të përgjithshme të progresit të Malit të Zi në procesin e anëtarësimit në BE për periudhën nga qershori 2023 deri në maj 2024, në drejtim të përmirësimit të situatës në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Ky raport trajton dhjetë fusha tematike sipas Kapitullit 27 dhe i referohet zbatimit të angazhimeve të mbetura nga Strategjia Kombëtare, të cilat tani janë pjesë integrale e Planit të Veprimit për të përmbushur standardet përfundimtare në Kapitullin 27 – Mjedisi dhe

421 Neni 150 i Ligjit për Procedurën Civile.

422 Neni 152a i Ligjit për Procedurën Civile.

423 Neni 152b i Ligjit për Procedurën Civile.

424 Neni 53 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 11/2015).

425 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 079/06, Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 073/10.

426 Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 79/2017.

Ndryshimet Klimatike. Ky raport vlerëson aktivitetet e zbatuara të institucioneve përkatëse në këtë fushë dhe jep rekomandime për forcimin e procesit të transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit të BE-së të mbuluar në Kapitullin 27. Ky dokument tenton të sqarojë problemet thelbësore në nënfusha të caktuara dhe nxjerr në pah nevojën për zgjidhjen e tyre gjatë procesit të negociatave.

Nëseksioni 2

Një rast ilustrues që nuk njohu ekskluzivitetin e të drejtës kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm është vendimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me ankesën kushtetuese të paraqitur kundër vendimit të Gjykatës së Lartë të Malit të Zi, Rish. IP br. 192/18, datë 22 janar 2019⁴²⁷. Padiësit ishin pronarë të parcelës, e cila gjendet në komunën kadastrale të Nikshiqit, dhe prona ndodhet në afërsi të të paditurës Zheljezara AD Nikshiq, në një distancë prej disa qindra metrash nga furra e fabrikës së çelikut. Sipas padiësve, prona e tyre është ekspozuar për një kohë të gjatë ndaj sasive të mëdha pluhuri, tymi, gazra të ndryshëm dhe erë e padurueshme, të cilat janë helmuese, dhe për këtë, shëndeti i padiësve dhe familjarëve të tyre është në rrezik për shkak të efekteve të substancave toksike, pasi i pandehuri i tretë nuk ka filtra të përshtatshëm për filtrimin e tymit dhe mbeturinave, gjë që bën që ujërat e zeza të derdhen në shtratin e lumit Bistrica. Përgjegjësia e të paditurve bazohet në LiM, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Gjykata Kushtetuese, në rrëzimin e ankimit kushtetues⁴²⁸ vlerësoi se përgjegjësia e të paditurit të parë nuk mund të rrjedhë nga neni 23 i Kushtetutës. Më tej thuhet se kjo dispozitë kushtetuese, e cila garanton të drejtën për një mjedis të shëndetshëm për këdo, është e një natyre të përgjithshme dhe deklarative.

Nëseksioni 3

Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi, U-III br. 213/23 e datës 12 prill 2023. Nga arsyetimi:

“Meqenëse Gjykata Themelore në Podgoricë, mbi ankimin e paraqitur kundër vendimit të shkallës së parë të së njëjtës gjykatë, me të cilin caktohet një masë e përkohshme, vendosi miratimin e ankimit të të paditurit, duke rrëzuar vendimin e shkallës së parë, dhe vendimi i tillë përbën një vendim të natyrës procedurale, i cili nuk vendos për një të drejtë apo detyrim të padiësit, rezulton se vendimi i kontestuar i Gjykatës Themelore në Podgoricë nuk përbën akt juridik individual ndaj të cilit Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të ofruar mbrojtje kushtetuese për shkak të shkeljes së pretenduar të nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.”

Sesioni 4:

Nuk ka informacion të saktë për të gjitha pikat e zeza mjedisore dhe incidentet mjedisore në Mal të Zi, as në planin historik dhe as në gjendjen aktuale. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e temës, është e rëndësishme të theksohet se ajo kërkon punë kërkimore shkencore, për të cilën është i nevojshëm një konsultim shumëdimensional, duke përfshirë punime shkencore në fushën e ekologjisë, raporte zyrtare të Qeverisë së Malit të Zi dhe organeve shtetërore të Malit të Zi, si dhe punime referuese të gazetarisë hulumtuese dhe të OJQ-ve që merren me fushën e mbrojtjes së mjedisit. Përfundimisht, ky raport synon të paraqesë çdo pikë të zezë mjedisore apo incident të madh mjedisor, me të dhënat e disponueshme, përmes një lenteje ligjore, për sa i përket analizës së përcaktimit ligjor të tij. Prandaj, është e qartë se jo të gjitha incidentet mjedisore do të shterohen në shembujt e përmendur dhe as nuk do të jetë e mundur.

a. Ndotja industriale

Në Malin e Zi, deri vonë, zyrtarisht kishte katër pika të zeza mjedisore që përfaqësonin depozitimet e mbetjeve të rrezikshme industriale⁴²⁹: Fabrika e Aluminit në Podgoricë (Kombinat

427 Vendimi gjendet në <https://sudovi.me/vrhs/odluka/328154>

428 U-III br. 971/19 e datës 2 mars 2023.

429 Informacioni i Ministrisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit të Malit të Zi, konsultuar në <https://wapi.gov.me/download-preview/00e4650f-25a0-43c6-a754-de61a1820ab3?version=1.0>,

Aluminijuma Podgorica)⁴³⁰ (dy pishina me llum të kuq dhe një depozitë e mbeturinave të ngurta)⁴³¹ Kantieri i Adriatikut Bijela (Jadransko brodogradilište Bijeltamintedgrit) (Landfilli i hirit dhe skorieve në Maljevc), dhe miniera “Šuplja stijena” (depozitimi i mbeturinave të Gradacit).

Në këtë drejtim, më 10 tetor 2014, Mali i Zi nënshkroi një marrëveshje huaje për zbatimin e “Projektit të Menaxhimit dhe Pastrimit të Mbetjeve Industriale” me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH). Vlera e kredisë, sipas së cilës fondet mund të tërhiqeshin deri më 30 qershor 2019, ishte 50 milionë euro. Projekti kishte dy objektiva: 1) rehabilitimi i vendeve ku ndodhen depozitimet e mbeturinave të rrezikshme industriale, përkatësisht: Fabrika e aluminit në Podgoricë (2 pishina me llum të kuq dhe një depozitë e mbeturinave të ngurta), Kantieri i Adriatikut Bijela (zhavorri dhe dheu i kontaminuar), Termocentrali i Pljevljas (landfilli i hirit dhe skories në Maljevac) dhe miniera “Šuplja stijena” (Suplja stijena) (Depozitimi i mbeturinave të Gradacit), dhe 2) mbështetje për ndërtimin e një sistemi për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme në të ardhmen në nivel kombëtar.

Sasi të mëdha të mbeturinave industriale janë rezultat i proceseve të prodhimit të termocentralit “Pljevlja”, impiantit të flotacionit të minierës së plumbit dhe zinkut “Šuplja Stijena” në Gradac dhe Shula, impiantit të përpunimit të drurit “Vektra Jakić” dhe impianteve të tjera të përpunimit të drurit, funksionimi i kaldajave të qytetit dhe objekteve të tjera të rëndësishme industriale në Pljevlja.⁴³²

Sipas njoftimit të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, të datës 26 korrik 2023, në lidhje me pikat e zeza mjedisore të sipërpërmendura të Malit të Zi, sasia e fundit e tokës së kontaminuar, pra 6,769.71 ton, që janë mbi kriteret e eksportit, janë eksportuar nga vendndodhja e kantierit detar Bijela për në Belgjikë, ndërsa aktivitetet e mbetura në lidhje me eksportin e qeseve të kontaminuara, për të cilat është siguruar leja për import në Portugali, janë duke u zhvilluar. Pritet që edhe ky aktivitet të realizohet me sukses, i cili do të përfundojë zyrtarisht projektin e rehabilitimit të lokacionit të kantierit detar Bijela. Puna për rehabilitimin e pellgut të flotacionit të mbetjeve “Gradac” dhe landfillit të hirit dhe skories “Maljevac” (d.m.th. rikultivimi i Kasetës II, zhvendosja e përroit të Paleskit, rehabilitimi i rrëshqitjes së dheut, ndërtimi i një rezervuari të ri sedimentimi dhe rehabilitimi i hapave 4 dhe 5) u përfunduan në gjysmën e dytë të 2021.⁴³³ Nga pikat e zeza mjedisore të përmendura, pellgu i llumit të kuq të KAP-it është ende zyrtarisht “i zi”, edhe pse landfilli i hirit dhe skories në lokacionin “Maljevac” në fakt ishte rehabilituar pjesërisht në periudhën paraprake.

Lidhur me rehabilitimin e njollës së zezë të pishinës së llumit të kuq të KAP⁴³⁴, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka nxjerrë vendim për fillimin e procedurës lidhur me kërcënimin e menjëhershëm të dëmtimit të mjedisit dhe ka urdhëruar operatorin që me shpenzimet e veta të zbatojë masa specifike të mbrojtjes dhe restaurimit në përputhje me Planin e Mbrojtjes, sipas Ligjit për Mbrojtjen dhe Restaurimin. Meqenëse operatori nuk ka dorëzuar plan për zbatimin e masave specifike parandaluese, apo nuk ka informuar Agjencinë për masat parandaluese të ndërmarra, Agjencia e ka informuar operatorin në prill të vitit 2022 se do të veprojë në përputhje me nenin 16 paragrafi 7 të Ligjit për Përgjegjësinë për Dëmtimin e Mjedisit, d.m.th. do të fillojë zbatimin e

430 Në vijim “KAP”. KAP ndodhet në pjesën e mesme të Rrafshit të Zetës mbi depozitime të gjera dhe shumë të përshkueshme kuaternare. Kushtet natyrore dhe vendndodhja e KAP përcaktojnë mundësinë e ndikimit të mbetjeve të tij në ujërat nëntokësore. Në KAP ekziston një landfill i mbeturinave të ngurta, e cila është në përdorim që nga viti 1971.

431 Ky gjigant industrial është një nga ndotësit më të mëdhenj në Podgoricë. Pishina e saj me llum të kuq është një problem serioz mjedisor.

432 Raporti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor për ndryshime në Planin Territorial-Urbanistik të Komunës së Pljevljes, Podgoricë, i datës 10 dhjetor 2023, f. 154.

433 Raporti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor për ndryshime në Planin Territorial-Urbanistik të Komunës së Pljevljes, Podgoricë, i datës 10 dhjetor 2023, f. 167.

434 Pishinat e llumit të kuq të ish-Uzinës së Aluminit janë problemi më i madh mjedisor në Malin e Zi, por ato janë në pronësi private që nga viti 2015, fillimisht nga biznesmeni ukrainas dhe më pas nga një kompani e vogël për blerjen e mbetjeve nga Berane “Weg Kolektor”. Në nëntë vitet e fundit, asgjë thelbësore nuk është bërë për zgjidhjen e këtij problemi, megjithëse Banka Botërore ka qenë e interesuar për financimin e rehabilitimit ekologjik të tij që nga viti 2014. Inspektori i Mjedisit në vitet e fundit ka vendosur disa gjopa ndaj pronarëve për rrezikim të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve, ndërsa vitin e kaluar Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka bërë kallëzim penal ndaj pronarit aktual të “Weg Kolektor”.

masave parandaluese me shpenzimet e operatorit. Së fundi, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit ka bërë kallëzim penal në datën 15 shkurt 2023 kundër WEG Kolektor dhe personit përgjegjës në këtë person juridik.⁴³⁵

Në informacionet e fundit lidhur me problemin e llumit të kuq të raportuar nga mediat në Malin e Zi thuhet se me kërkesë të komunës së Zetës është duke u bërë inventarizimi i dëmeve nga pellgu i llumit të kuq.⁴³⁶

Në Raportin e shtatë në Hije për Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, “Një pikë progresi në detin e detyrimeve”, i cili mbulon periudhën nga qershori 2023 deri në maj 2024⁴³⁷, thuhet se jo të gjitha pikat e zëza mjedisore janë korigjuar, as pas tetë vitesh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Huasë me Bankën Botërore për “Projektin e Menaxhimit dhe Pastrimit të Mbetjeve Industriale – IWMCP”, kjo për shkak të problemit aktual mjedisor të Landfillit të Uzinës së Çelikut – Halda dhe Pishina e Llumit të Kuq në KAP). Landfilli i fabrikës së çelikut Halda është përmendur gjithashtu në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Strategjik në Mjedis për amendimet e Planit Territorial-Urbanistik të Komunës së Nikshiqit⁴³⁸, së bashku me zonat urbane të qytetit të Nikshiqit me zonat më të kërcënuara për mjedisin (“pikat e nxehta”), rrethinat e Uzinës së Çelikut, landfillit të Haldës, stacionit të transferimit të Boksitit, zonave të minierave të hapura të boksitit, impiantit të asfaltit, venddepozitimit të mbeturinave të qytetit të Budoshit, pjesë të Bistricës, Graçanicës dhe Zetasë me rrjedha ujore të klasit IV, etj.

Për sa i përket përgjegjësisë civile për dëmtimin mjedisor, për pellgun e llumit të kuq nuk ka një vendim gjyqësor. Shih shembullin e cituar në Analizë (vendimi i Gjykatës së Lartë të Malit të Zi, Rish. Ip. 59/2019, i datës 2 prill 2019).

Termocentrali i Pljevljes⁴³⁹ është një tjetër çështje mjedisore prioritare, e cila kërkon një qasje më urgjente.⁴⁴⁰ Kjo për shkak se problemi i ndotjes së ajrit është një nga problemet më të mëdha, duke pasur parasysh se sipas vlerësimeve të fundit të Agjencisë Evropiane për Mbrojtjen e Mjedisit, ai kontribuon në vdekjen e parakohshme të rreth 1,200 njerëzve në vit në Malin e Zi, nga të cilët ndikimi më i madh i atribuohet grimcave PM.⁴⁴¹

Në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale, Termocentrali i Pljevljes i nënshtrohet

435 Informacioni i konsultuar në <https://www.vijesti.me/vijesti/ekonomija/708107/crveni-mulj-privatna-imovina-drzavni-problem-tuzilastvo-istrazuje-ugrozavanje-sredine-i-zdravlja-ljudi>,

436 <https://www.dan.co.me/vijesti/drustvo/popisju-stetu-od-bazena-crvenog-mulja-5252700>,

437 Ky raport u përgatit si pjesë e projektit të titulluar “Përmirësimi i Angazhimit Mjedisor të OSHC-ve sipas kornizës së anëtarësimit në BE (4E)” financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Administratës Publike, Shoqërisë Digjitale dhe Medias. Përmbajtja e Raportit është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve (CZIP) dhe partnerëve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin e BE-së. Koalicioni 27 është një rrjet joformal i organizatave joqeveritare që u themelua me qëllim monitorimin e procesit të harmonizimit dhe aplikimit të politikave në negociatat e anëtarësimit midis Malit të Zi dhe BE-së, si dhe propozimin e zgjidhjeve që do të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Anëtarët e Koalicionit 27 janë: Avlija, Centre for Protection and Study of Birds, Centre for Ecological Initiatives, Da zaživi selo, Society of Young Ecologists Nikšić, Dr. Martin Schneider-Jacoby, Green home, Mans, Medcem, Mogul, Natura, Naša akcija, Sjeverna zemlja, Zero waste Montenegro dhe Wildlife Montenegro.

438 Raporti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor për ndryshime në Planin Territorial-Urbanistik të Komunës së Nikshiqit, Ministria e Ekologjisë, Planifikimit të Territorit dhe Urbanizmit, Podgoricë, shkurt 2023.

439 “TC Pljevlja”.

440 Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm deri në vitin 2030, theksohet se, nga pikëpamja ekotoksikologjike, qyteti i Pljevljes është pika më e zezë mjedisore. Të dhënat për gjendjen e mjedisit tregojnë se uji, ajri, toka dhe peizazhi janë të degraduara për shkak të ndikimit të drejtpërdrejtë të burimeve të shumta të ndotjes¹⁴⁴, ndaj të cilave popullsia është e ekspozuar drejtpërdrejt. Ky është kryesisht rezultat i zhvillimit industrial dhe urban të planifikuar keq dhe të kontrolluar në mënyrë të pamjaftueshme. Dëmet më të mëdha janë shkaktuar nga ndikimi i operacioneve teknologjike në minierën e qymyrit, termocentralin, “Vektra Jakiq”, landfillin e skorieve dhe hirit në Maljevac, sistemin e transportit dhe landfillin e mbeturinave dhe mbetjeve në Jagnjilo. Përveç sa më sipër, burimet kryesore të emetimeve të substancave ndotëse (grimcat lundruese, PM10 dhe PM2.5 dhe hidrokarburet poliaromatike – PAH në to) përfaqësohen nga shumë kaldaja dhe furra individuale.

441 Në Podgoricë, më 16 shkurt 2024, OJQ Green Home organizoi konferencën me titull “Ndotja e ajrit në Mal të Zi”, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve, organizatave joqeveritare dhe mediave. Dr. Borko Bajić, në emër të Institutit të Shëndetit Publik të Malit të Zi, i kujtoi audiencës se ndotja e ajrit është një nga rreziqet më serioze për shëndetin e njerëzve dhe se sipas vlerësimeve të fundit të Agjencisë Evropiane për Mbrojtjen e Mjedisit, ndotja e ajrit në Mal të Zi kontribuon në vdekjen e parakohshme të rreth 1200 banorëve në vit, nga të cilët ndikimin më të madh i atribuohet grimcave PM.

funksionimit të kufizuar sipas Direktivës së Impiantit të Madh me Djegie, e cila ka hyrë në fuqi në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë më 1 janar 2018. Që atëherë deri në fund të vitit 2023, termocentrali lejohet të funksionojë për maksimum 20,000 orë. Pas kësaj, ai ose duhet të mbyllet përgjithmonë ose të ripërshatet për të përmbushur Aneksin V, Pjesa II e Direktivës për Emetimet Industriale. Kuota e orëve të termocentralit u shterua në fund të vitit 2021 dhe termocentrali funksionon ilegalisht për të tretin vit radhazi që nga ajo kohë. Deri në vitin 2023 kishte përdorur mbi 34,412 orë (14,000 orë më shumë se sa lejohej).

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nisi një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundër Malit të Zi, por termocentrali është ende në punë. Projekti i planifikuar i modernizimit është i pasigurt, jo transparent dhe me dy vite vonesë dhe publikut nuk iu dha asnjëherë një justifikim ekonomik për projektin. Kostoja e projektit është rritur gjithashtu që nga tenderi, gjë që mbështet shqetësimet e ngritura nga ofertuesit e pasuksesshëm në atë kohë. Në prill të vitit 2021, Ministria e Investimeve Kapitale kërkoi nga prokurori publik që të hetojë rastin, por EPCG vazhdoi me investimin pa pritur rezultatet e hetimit. Një hap serioz mbrapa pasoi në dhjetor 2022, kur Qeveria dhe Kuvendi miratuan ndryshimet në Ligjin për Emetimet Industriale, të cilat lejuan funksionimin e termocentralit deri në përfundimin e negociatave inekzistente për zgjatjen e funksionimit të Termocentralit të Pljevljes dhe përfundimin e padisë së Komunitetit të Energjisë kundër Malit të Zi.⁴⁴² Pas 20 mijë orësh, Agjencia e Mjedisit nisi procedurën e tërheqjes së lejes së integruar për Termocentralin e Pljevljes në vitin 2021, por Qeveria mori vendim për ndalimin e kësaj procedure, prandaj termocentrali i Pljevljes ka shkelur kërkesat ligjore që atëherë, duke funksionuar pa një leje të integruar të vlefshme.⁴⁴³

Rekomandimi nga raporti i mësipërm “Një pikë progresi në një det detyrimesh” ishte fillimi i një zgjidhjeje me Komunitetin e Energjisë për përshpejtimin e procedurës së kundërvajtjes dhe gjatësinë për operimin jashtë orarit në termocentralin Pljevlja. Raporti bën thirrje që Mali i Zi të sjellë menjëherë termocentralin me qymyr në Pljevlja në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, të publikojë një studim fizibiliteti për projektin e planifikuar të modernizimit dhe të publikojë rezultatet e hetimit të prokurorit publik në procesin e tenderimit.

Sipas konkluzioneve të Qeverisë së Malit të Zi, në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 2023, ka miratuar Vendimin për përcaktimin e interesit publik për realizimin e projektit të titulluar “Ngruhja qendrore e Pljevljes, drejt Pljevljes së pastër dhe të ngrohtë”. Më 1 korrik 2024, Qeveria e Malit të Zi mbajti një takim me përfaqësues të misionit të Bankës Botërore (BB) dhe me përfaqësues të palëve të interesuara (Zyra për Zhvillim të Qëndrueshëm në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë, ministritë përkatëse të turizmit, ekologjisë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe zhvillimit të veriut dhe energjisë dhe minierave, si dhe Zyra e UNDP-së në Mal të Zi) mbi aktivitetet e ardhshme në fushën e tranzicionit të drejtë të rajonit të qymyrit Pljevlja; u prezantua gjithashtu instrumenti LURA (Vlerësimi i ripërdorimit të tokës dhe pasurive), i cili i referohet vlerësimit të përdorimit të ardhshëm të tokave dhe asetëve minerare.⁴⁴⁴

Mali i Zi është me vite vonesë në miratimin dhe përditësimin e Strategjisë së tij për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit me një plan veprimi, dhe në këtë mënyrë ndërmarrjen e rregullt të masave për reduktimin e ndotjes kombëtare të ajrit, veçanërisht në zonat ku janë tejkuluar vlerat kufitare të BE-së për cilësinë e ajrit. Vonësia të tilla ekzistojnë gjithashtu në krijimin ose përditësimin e planeve të cilësisë së ajrit, siç parashikohet nga Direktiva për cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajër

442 Milica Kandić, me mbështetjen e Koalicionit 27, Një pikë progresi në një det detyrimesh, Raporti hije për Kapitullin 27 – Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, për periudhën nga qershori 2023 deri në maj 2024, f. 71 dhe 71.

443 Në Konkluzionin e Qeverisë së Malit të Zi, numri: 04-2389/2, të datës 20 maj 2021, Qeveria miratoi Informacionin për procedurat e nisura për rishikimin dhe tërheqjen e lejes së integruar për TC “Pljevlja” nga Agjencia për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit dhe deklaroi se deri në përfundimin e procedurave të nisura të negociatave të Ministrisë së Investimeve Kapitale të Malit të Zi me Komunitetin e Energjisë si çështje e mëparshme ligjore, është e nevojshme të ndërpriten të gjitha procedurat e nisura për tërheqjen dhe rishikimin e lejes së integruar, për shkak të dëmeve të pamatshme në sektorin energjetik dhe në shtetin e Malit të Zi. Në të njëjtin konkluzion, Ministria e Ekologjisë, Planifikimit të Territorit dhe Urbanizimit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit kanë për detyrë të veprojnë në përputhje me pikën paraprake të këtij Konkluzioni (që ka të bëjë me ndërprerjen e procedurave tashmë të filluara).

444 <https://www.gov.me/clanak/odrzan-sastanak-misije-svjetske-banke-sa-predstavnicima-zainteresovanih-strana-natemu-pravedne-tranzicije-u-pljevljima-2>,

më të pastër për Evropën (Direktiva 2008/50/EC). Drafti i Strategjisë së Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit për periudhën 2021-2029 ka marrë një opinion pozitiv nga Komisioni Evropian dhe, sipas raporteve të mëparshme duhet t'i dërgohej Qeverisë për miratim në vitin 2023. Kjo ende nuk është bërë.⁴⁴⁵

Të gjitha mediat në Malin e Zi raportuan se padia e parë është ngritur kundër shtetit të Malit të Zi për shkak të ndotjes së ajrit në Pljevlja dhe se shumë qytetarë të Pljevljas kanë paralajmëruar se do të padisin shtetin. Çështja është në gjykim.

b. Vendet e depozitimit të mbeturinave

Përveç dy landfillleve sanitare për depozitimin e mbeturinave komunale në Podgoricë (Livada) dhe Ulqin (Mozhura), pothuajse çdo qytet në Malin e Zi ka një vend depozitimi të paligjshëm të mbeturinave, duke ushtruar presion të madh mbi mjedisin. Ekzistojnë 19 depozitime të kontrolluara të mbeturinave në Mal të Zi, 2 prej të cilave janë të destinuara vetëm për depozitimin e mbeturinave të ndërtimit (lokacioni Dragalj në Kotorr dhe lokacioni Brajići në Budvë). Nga 17 vendet e tjera të kontrolluara të depozitimit të mbeturinave, 8 janë nën një lloj kontrolli, pra janë të rrethuara dhe mbeturinat e depozituara janë pjesërisht të niveluara. Nga tetë lokacionet e kontrolluara të depozitimit të mbeturinave, dy ishin projektuar që të kishin gardhe dhe porta, dhe disa punë ndërtimore u kryen në to para depozitimit të mbetjeve, si përgatitja e argjinaturës, ndërtimi i rrugëve të qasjes dhe të ngjashme. Këto dy depozitime të kontrolluara të mbeturinave ndodhen në Nikshiq (vendndodhja Mislov Do) dhe Andrijeva (vendndodhja Sutjeska). Sipas Ministrisë së Ekologjisë, Planifikimit të Territorit dhe Urbanizmit⁴⁴⁶, ka 334 depozitime të pakontrolluara të mbeturinave në Malin e Zi.⁴⁴⁷

Parlamenti i 28-të i Malit të Zi, në seancën e dytë të sesionit së parë të rregullt (pranverë) në vitin 2024, miratoi Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave, më 4 prill 2024, i cili u botua në Gazetën Zyrtare të Malit të Zi nr. 34/2024, datë 12 prill 2024 dhe hyri në fuqi më 20 prill 2024.

Më 26 korrik 2024, Agjencia për Mbrojtjen Mjedisore lëshoi një deklaratë se është krijuar një sistem monitorimi i mbetjeve dhe një regjistër i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve. Këta mekanizma lejojnë kontroll dhe menaxhim më të mirë të çështjeve mjedisore, gjë që është thelbësore për procesin e integritimit evropian.⁴⁴⁸

c. Ujërat e zeza

Menaxhimi i sistemit të ujërave të zeza në Malin e Zi është joefikas; megjithëse niveli i konformitetit të rregulloreve kombëtare në fushën e ujërave të zeza me rregulloret e BE-së është i lartë, mbi 96 për qind, zbatimi i këtyre rregulloreve në praktikë gjithashtu nuk është adekuat. Kapacitetet e qeverisjes vendore për të ngritur dhe mbajtur në mënyrë të pavarur një sistem efikas të menaxhimit të ujërave të zeza janë gjithashtu të diskutueshme, siç theksohet në auditimin e suksesshëm "Eficienca e Menaxhimit të Sistemit të Ujërave të Zeza" nga Institucioni i Kontrollit të Shtetit (IKSH). Auditimi i referohet Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave (MBPMU), Ministrisë së Ekologjisë, Planifikimit të Territorit dhe Urbanizmit, Autoritetit të Ujit, Kryeqytetit të Podgoricës dhe komunave të Danilovgradit, Bijelo Polje, Berane, Pljevlja, Budva, Bar dhe Herceg Novi, si dhe kompanitë e ujit në ato komuna, Ndërmarrja për Ndërtimin e Infrastrukturës së Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Komunën e Herceg Novit dhe Drejtoria për Çështje të Inspektimit. Për të përmirësuar menaxhimin e sistemit të ujërave të zeza, Kontrolli i Shtetit dha 37 rekomandime. Auditimi mbulon ujërat e zeza komunale të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Ujërave të Zeza Komunale. Ujërat e zeza komunale që mbulohen nga ai ligj, shpjegon IKSH, janë ujërat e zeza nga banesat ose përzierje e atij uji me ujërat e zeza industriale dhe/ose ujërat e zeza të stuhive. Administrata e Ujërave nuk ka përgatitur dhe MBPMU nuk ka miratuar një Plan Operativ për mbrojtjen e ujërave nga ndotja aksidentale për ujërat me rëndësi për Malin e Zi. Gjithashtu, vetëqeverisjet vendore nuk kanë miratuar Plan Operativ për mbrojtjen e ujërave nga ndotja aksidentale për ujërat me rëndësi lokale.

445 Milica Kandić, me mbështetjen e Koalicionit 27, Një pikë progresi në një det detyrimesh, Raporti hije për Kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, për periudhën nga qershori 2023 deri në maj 2024, f. 30.

446 "MMPHI".

447 Plani Shtetëror i Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2023-2028, f. 42 dhe 43.

448 Krijohet sistemi i monitorimit të mbeturinave dhe regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (epa.org.me) <https://epa.org.me/2024/07/26/uspostavljen-sistem-za-pracenje-otpada-i-registar-ispustanja-i-prenosa-zagadivaca/>,

d. Uji - Ndotja e lumenjve dhe liqeve: Tara, Moraça, Zeta, Çehotina

Incidentet mjedisore janë një temë e mbuluar gjerësisht në media, duke përfshirë ndotjen e lumit Tara⁴⁴⁹ për shkak të ndërtimit të autostradës Bar-Boljari⁴⁵⁰, ndotjen e lumit Moraça⁴⁵¹ dhe liqenit të Shkodrës⁴⁵², burimi Bolje Sestre⁴⁵³, lumi Zeta⁴⁵⁴ si dhe lumenjtë Lim dhe Çehotina⁴⁵⁵.

Në Raportin e fundit mbi Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis për ndryshimet në Planin Territorial-Urbanistik të Komunës së Pljevljës⁴⁵⁶, plani parashikon zgjidhjen e problemit të përroit të ndotur Mjednički, i cili është nga ana tjetër një nga shkaktarët më të mëdhenj të ndotjes së lumit Çehotina dhe ekosistemit të tij. Mediat në Malin e Zi raportuan edhe lajmin për një incident mjedisor – shkarkimin e substancave toksike nga termocentrali i Pljevljas në lumin Çehotina. Më 4 korrik 2019, rezervat e peshkut në lumenjtë Vezišnica dhe Çehotina ngordhi si pasojë e këtij incidenti. Më 25 shtator u ngrit një akuzë në Gjykatën Themelore në Pljevlja kundër katër personave përgjegjës për termocentralin Pljevlja, për shkarkimin e substancave toksike në lumin Çehotina, e cila shkaktoi vdekjen e rezervave të peshkut në lumenjtë Vezišnica dhe Çehotina. Pushimi i ndjekjes penale është raportuar nga mediat malazeze, duke thënë se kjo ka ndodhur për shkak të dëshmisë së ekspertes S.D., në gjetjet e së cilës është bazuar akuzat, duke deklaruar në gjykim se nuk i qëndronte plotësisht konstatimeve të saj për shkaqet që çuan në ngordhjen e një sasie të madhe peshku.⁴⁵⁷

Kompania kineze China Road and Bridge Corporation, CRBC, nuk e riparoj dëmtimin e shtratit dhe brigjeve të lumit Tara në Mateshevë, megjithëse iu kërkua ta bënte këtë më së voni deri në korrik 2022, tregoi analiza e BIRN.⁴⁵⁸ Për shkak të shkatërrimit të rezervave të peshkut në Tarë, pas padisë së Klubit të Peshkimit Sportiv “Tara dhe Moraça”, Gjykata Themelore në Podgoricë urdhëroi CRBC-në, në nëntor të vitit 2021, që t’u paguajë rreth 200 mijë euro dëmshpërblim peshkatarëve. Pas ankimit të kompanisë kineze, Gjykata e Lartë anuloi vendimin e shkallës së parë, në janar 2022. Avokati Vladimir Čadenović, i cili përfaqëson SFC “Tara dhe Moraça”, pohon se pritet një ekspertizë ekonomike dhe financiare, pas së cilës duhet të përcaktohet shuma e saktë e dëmit të shkaktuar nga CRBC.

Gjykatat e Malit të Zi i shpallën fajtorë dhe gjobitën personat juridikë, si dhe individët brenda tyre, për veprën e përmendur në nenin 35 paragrafi 1 pika 2 dhe paragrafi 2 lidhur me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor.⁴⁵⁹

Në Raportin e Vlerësimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis të ndryshimeve në zonën industriale të DUP – KAP Podgoricë, i shtatorit 2019, përmendet problemi i ndotjes së lumit Moraça. Gjendja ekzistuese e objekteve industriale brenda objektit të planit është krejtësisht e papranueshme nga pikëpamja mjedisore. I gjithë uji i grumbulluar i stuhive nga terrenet e KAP-it dhe uji nga ftohja e pajisjes futen në kanalin e ujërave të zeza nga KAP. Uji nga kanali derdhet në lumin Moraça. Ndikim negativ në cilësinë e ujërave nëntokësore kanë edhe ujërat alkaline me origjinë nga pishinat me llum të kuq, landfillet e mbeturinave të ngurta dhe larja e ujërave të stuhive nga toka e ndotur në zonën e KAP.

449 Lumi Tara është në Listën e Trashëgimisë Kulturore Botërore të UNESCO-s që nga viti 1977.

450 <https://www.cdm.me/hronika/zbog-zagadenja-tare-formiranja-dva-predmeta/>,

451 Sipas Raportit për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis të ndryshimeve në DUP, zona industriale e DUP KAP Podgoricë, të shtatorit 2019, i gjithë uji i grumbulluar i stuhisë nga terreni i KAP-it dhe uji nga ftohja e pajisjes futen në kanalin e ujërave të zeza nga KAP. Uji nga kanali derdhet në lumin Moraça.

452 Shfrytëzimi i zhavorrit dhe rërës ka pasoja afatgjata të dëmshme për regjimin ujor të lumit Moraça.

453 <https://www.cdm.me/drustvo/regionalni-vodovod-agencija-i-uprava-neshvatljivim-odlukama-trajno-ugrozili-izvoriste-bolje-sestre/>,

454 <https://www.vijesti.me/vijesti/drustvo/423008/novo-zagadenje-zete-je-ekoloski-kriminal>,

455 <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-reka-lim-deponija-smece-ekologija/32240769.html>,

456 Raporti për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit Mjedisor për ndryshime në Planin Territorial-Urbanistik të Komunës së Pljevljes, Podgoricë, i datës 10 dhjetor 2023, f. 162.

457 Informacioni i aksesuar në <https://www.vijesti.me/vijesti/crna-hronika/504667/slucaj-pomora-ribe-tuzilac-odustao-od-krivcnog-gonjenja-epcg-i-rukovodilaca-u-te-pljevlja>,

458 Në tekstin «Lavdia e vjetër e «Lotit të Evropës» nuk mund të rikthehet», nga BIRN, e datës 10 janar 2024, u njoftua se analiza e BIRN tregoi se kompania kineze China Road and Bridge Corporation, CRBC, nuk e riparoj dëmtimin e shtratit dhe brigjeve të lumit Tara në Mateshevë, megjithëse iu kërkua ta bënin këtë më së voni deri në korrik 2022.

459 Vendimi <https://www.gov.me/dokumenta/e030db2d-3d1a-45e9-ba39-ce783166cbb2>, i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje të Malit të Zi, PŽP.br.1675/20-2, i datës 13 nëntor 2020.

e. Shfrytëzimi i zhavorrit

Në mbledhjen e mbajtur më 3 gusht 2022, Qeveria e Malit të Zi urdhëroi Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave që të formojë një ekip ndërinstitucional për të ndërmarrë veprime specifike ligjore për vlerësimin e shfrytëzimit të zhavorrit dhe rërës. Gjithashtu, në Konkluzionin nga mbledhja e 15-të, Qeveria ka ngarkuar Ministrinë e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që çdo tremujor të raportojë në Qeveri për rezultatet e arritura në luftën kundër shfrytëzimit të paligjshëm të zhavorrit dhe rërës nga rrjedhat ujore. Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka formuar një Ekip Operacional Ndërinstitucional, detyra e të cilit është të monitorojë situatën në të gjitha rrjedhat ujore dhe të propozojë masat e duhura me administratën shtetërore.

Në raportin e Inspektoratit të Ujërave të datës 27 janar 2023 thuhet se Administrata për Çështje të Inspektimit ka ngritur 32 kallëzime penale gjatë dy viteve të fundit për shfrytëzim të paligjshëm të zhavorrit. Thuhet se në vitin 2022 janë ngritur 13 kallëzime penale, një shifër më e ulët se në vitin 2021 kur janë ngritur 19 kallëzime ndaj kompanive apo individëve. Nga dokumenti shihet se vendet ku është kryer shfrytëzimi janë lumenjtë Moraça, Tara, Cijevna, Lim dhe Grnçar. Gjithashtu, Inspektorati i Ujërave ka dorëzuar 19 kallëzime në lidhje me shfrytëzimin e zhavorrit në periudhën korrik 2021 deri më 26 janar 2023 në Drejtorinë e Policisë – Departamenti për Luftimin e Krimin Ekonomik, për të vlerësuar, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore të Shtetit, nëse ka elemente të veprës penale për t'u ndjekur penalisht *ex officio*.

Maqedoni e Veriut: Studim bazë i legjislacionit, politikave dhe praktikës për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

1. Hyrje

Republika e Maqedonisë së Veriut është një demokraci parlamentare që nga viti 1991. Parlamenti në vitin 1998 krijoi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit si pjesë e Qeverisë, e cila ka kompetencë themelore në monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe natyrës dhe masave për mbrojtjen dhe promovimin e tyre.⁴⁶⁰

Mbrojtja e mjedisit është fuqimisht e inkuorporuar në vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 8, i cili shtjellohet më tej në seksionin 2.1.⁴⁶¹

Nga viti 1991 deri në vitin 2001, mbrojtja e mjedisit ishte vetëm në kompetencë të Qeverisë, gjegjësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit, por pas miratimit të Amendamentit XVII, kompetenca për mbrojtjen e mjedisit u nda në mes të Qeverisë si organ qendror ekzekutiv dhe komunave si pjesë e vetëqeverisjes lokale.⁴⁶²

Megjithë rëndësinë e lartë që i kushtohet mjedisit në Kushtetutë, gjendja në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe natyrës në Maqedoninë e Veriut mbetet ende në nivel të ulët. Ky është rezultat i faktorëve në vijim:

1. mungesa e kapaciteteve institucionale të shtetit për të përmbushur kompetencat e veta në mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit
2. mungesa e qasjes strategjike dhe konsistencës në zhvillimin e mekanizmave dhe kapaciteteve për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit
3. mungesa e mjeteve financiare të akorduara nga buxheti i shtetit për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit
4. përgjegjësitë e ndara për mbrojtjen e mjedisit në mes të pushtetit qendror dhe vetëqeverisjes vendore

Faktorët e mësipërm kanë rezultuar, për shembull, në dështimin e miratimit të një Plani Kombëtar për Cilësinë e Ajrit që nga viti 2018. Kjo nga ana tjetër ka kontribuar që qytetet e mëdha nga Maqedonia e Veriut të jenë në mesin e 30 qyteteve në mbarë botën me ajrin më të ndotur.⁴⁶³

Qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë të prekur drejtpërdrejt nga situata e mësipërme, veçanërisht në dekadën e fundit. Megjithatë, vetëm Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë aktive për të reaguar dhe për të iniciuar lloje të ndryshme aktiviteteve për t'i bërë presion Qeverisë dhe komunave që të ndërmarrin masa për parandalimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. OSHC-të gjithashtu kanë filluar raste para institucioneve dhe gjykatave kombëtare, duke përdorur mekanizmat ligjorë në dispozicion, pa asnjë dobi. Ata kanë pasur sukses të konsiderueshëm në parandalimin e financimit për ndërtimin e hidrocentraleve në pjesën perëndimore të Maqedonisë së Veriut, Boshkov Most dhe Lukovo Pol. Përafërsisht, 100,000 qytetarë maqedonas nënshkruan peticionet⁴⁶⁴ kundër këtyre projekteve, me qëllimin e vetëm të mbrojtjes së Parkut Kombëtar të Mavrovës dhe biodiversitetit në atë rajon, duke përfshirë edhe rrëqebullin maqedonas.⁴⁶⁵

460 Ligji për Ndryshimet dhe Amandamentet e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 63/98).

461 Neni 8 rreshti 10 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspix

462 <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/Odluka%20za%20proglasuvanje%20na%20amandmanite%20IV-XVIII%20na%20Ustavot%20na%20RM.pdf>

463 IQAir, renditja e qyteteve kryesore, gjendet në: <https://www.iqair.com/world-air-quality-ranking>, [Aksesuar më 10 janar 2025].

464 <https://makfax.com.mk/zanimlivosti/ekologija/recisi-100-000-potpisnici-na-peticijata-za-spas-na-mavrovo/>

465 <https://www.radiomof.mk/po-tragite-na-lisa-i-filipche-balkanskite-risovi-koi-obedinija-tri-drzhavi/>

Në Raportin e Progresit për vitin 2024, Komisioni Evropian vuri në dukje se Maqedonia e Veriut nuk është plotësisht në përputhje me Direktivat e BE-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), duke mos treguar përparim në periudhën e fundit. Për më tepër, sfidat lindin për shkak të mungesës së stafit të specializuar dhe kapaciteteve të dobëta institucionale, duke çuar në kontroll të dobët të cilësisë në vlerësimet mjedisore dhe miratimin e projekteve të infrastrukturës pa konsideratë të plotë mjedisore. Që nga miratimi i Ligjit për Inspektimin në prill të vitit 2022, nuk ka filluar asnjë reformë për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit mjedisor. Maqedonia e Veriut duhet të krijojë një kornizë të fortë institucionale për planifikim të koordinuar dhe strategjik mjedisor dhe të sigurojë transparencë dhe pajtueshmëri me direktivat e VNM/VSM. Për më tepër, duhet të sigurohet përafrimi i plotë me Direktivat e BE-së për përgjegjësinë mjedisore dhe krimin. Qendra Aarhus nuk është plotësisht funksionale, ofron informacion të vjetruar dhe qasja në drejtësi dhe informacion publik për çështjet mjedisore është e dobët. Së fundi, vendi duhet të sigurojë që monitorimi mjedisor të plotësojë standardet e BE-së.⁴⁶⁶

2. E drejta materiale dhe praktika

2.1. Ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në mjedis

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (1991)

Siç u përmend më lart, neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut prezanton një vlerë të veçantë themelore që lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e mjedisit - planifikimin e duhur urban dhe rural për promovimin e një mjedisi të shëndetshëm njerëzor, si dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.⁴⁶⁷

Kjo vlerë themelore zhvillohet më tej sipas nenit 43 të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore nënkaptullit i seksionit për liritë dhe të drejtat, si e drejtë për një mjedis të shëndetshëm. Neni 43 garanton, nga njëra anë, të drejtën për një mjedis të shëndetshëm për çdo person dhe nga ana tjetër, përcakton një detyrim për të gjithë për të promovuar dhe mbrojtur mjedisin dhe për shtetin (d.m.th. Republikën) të sigurojë të gjitha kushtet për ushtrimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis të shëndetshëm.⁴⁶⁸ Kushtetuta parashikon më tej mbrojtje shtesë të mjedisit në nenin 55, ku përcakton kufizimet mbi lirinë e tregut dhe sipërmarrjes me qëllim të mbrojtjes së Republikës, mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit ose shëndetit publik.⁴⁶⁹

Pas ndryshimeve në Kushtetutë në vitin 2001, mbrojtja dhe promovimi i mjedisit iu kaluan edhe njësisive të vetëqeverisjes vendore. Amendamentet përshkruajnë kompetenca të reja për autoritetet vendore, të cilat lejojnë qytetarët drejtpërdrejt dhe nëpërmjet përfaqësuesve "të marrin pjesë në vendimmarrje për çështje me rëndësi lokale, veçanërisht në fushat e shërbimeve publike (. . .), mbrojtjes së mjedisit dhe fusha të tjera të përcaktuara me ligj."⁴⁷⁰

466 *Raporti i Komisionit Evropian, Maqedonia e Veriut 2024*, Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, 30 tetor 2024, SWD(2024) 693 final, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2024_en

467 Neni 8 rreshti 10 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspix

468 Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspix

469 Neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspix

470 Amendamenti XVII i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspix

Kushtetuta ofron baza të qëndrueshme përvendosjen e mekanizmave dhe procedurave të mëtejshme për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe natyrës në Maqedoninë e Veriut që duhet të vendosen me ligj.

Ligji për Mjedisin (2005)

Ligji i 2005 për Mjedisin promovon parimet e mbrojtjes së mjedisit⁴⁷¹ dhe përcakton objektivat kryesore (shih Shtojcën II të këtij Studimi).⁴⁷² Ai mundëson qasje të plotë në informacione për vendimet në lidhje me mjedisin dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse, si dhe sigurimin e zbatimit të parimit të proporcionalitetit kur peshohet zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit. Për shembull, ai përcakton një kërkesë që ndotësit të kompensojnë kostot e rehabilitimit të ndotjes dhe të rivendosë mjedisin sa më afër që të jetë e mundur në gjendjen e tij përpara dëmit të shkaktuar.

Ligji për Mjedisin ka një qasje gjithëpërfshirëse në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë për dëmtimin e mjedisit. Mbrojtja e mjedisit bazohet në monitorimin, planifikimin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Përgjegjësia për dëmet e shkaktuara në mjedis rregullohet veçmas dhe Ligji parashikon sanksionimin duke vendosur kundërvajtje të ndara në tri kategori me gjoha që variojnë nga 50 euro deri në 200,000 euro.

Kodi Penal (1996)

Kodi aktual penal parashikon 12 vepra penale që lidhen me mjedisin dhe natyrën⁴⁷³, duke përfshirë ekocidin e parashikuar me ndryshimet e fundit të vitit 2023.⁴⁷⁴

Kodi Penal vazhdon të zgjerojë mbrojtjen e mjedisit, duke u përshtatur me tendencat moderne ligjore dhe nevojën për të luftuar krimin mjedisor.

Ligji për Kundërvajtje Penale (2019)

Ligji për Kundërvajtjet Penale është miratuar në vitin 2019⁴⁷⁵ dhe rregullon kërkesat dhe kushtet për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes penale dhe parashikon sanksionet për kundërvajtjet penale. Ligji për Kundërvajtjet Penale parashikon dënime më të larta për kundërvajtjet mjedisore në krahasim me kundërvajtjet tjera, duke parashikuar gjoha që janë njëzet herë më të larta se gjohat e përcaktuara në fusha të tjera. Afati i parashkrimit për kundërvajtjet penale që kanë të bëjnë me mjedisin është pesëvjeçar për fillimin e procedurës së kundërvajtjes penale mjedisore dhe dhjetë vjet për zhvillimin e procedurës. Llojet e procedurave për kundërvajtje penale janë shpjeguar në Shtojcën III.

Ligji për Procedurën Civile (2005) dhe Ligji për Detyrimet (2001)

Ligji për Procedurën Civile i vitit 2005 rregullon mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet themelore të individëve dhe qytetarëve. Sipas Shoqatës së Juristëve

471 Parimet janë: Parimi 'ndotësi paguan', Parimi i proporcionalitetit dhe Parimi i parandalimit dhe Parimi i pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në informacion.

472 Neni 4 i Ligjit për Mjedisin <https://www.moep.gov.mk/wp-content/uploads/2014/09/Закон%20за%20животната%20средина%20консолидирани%20текст%2019.07.2013.pdf>

473 Kodi Penal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/96).

474 Hapësira e politikës sanksionuese në lidhje me krimet kundër mjedisit shtrihet nga një gjobë deri në një dënim të përjetshëm në rast të kryerjes së krimit Ecocide.

475 Ligji për Kundërvajtje Penale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 253/23)

të Rinj Maqedonas⁴⁷⁶, e cila ka dorëzuar disa çështje para gjykatave të rregullta, gjyqtarët e së drejtës civile (përfshirë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) kanë krijuar një jurisprudencë të mospranimit të rasteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen individuale dhe kolektive të mjedisit të paraqitura nga qytetarët dhe OSHC-të.

Ligji për Detyrimet i vitit 2001⁴⁷⁷ rregullon marrëdhëniet kontraktore, detyrimet, kompensimin por edhe mbrojtjen e të drejtave personale⁴⁷⁸ të të gjithë personave fizik dhe juridik në Maqedoninë e Veriut. Sipas fushëveprimit të tij, ai duhet të jetë një bazë ligjore e vlefshme për mbrojtjen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, sipas jurisprudencës së GJEDNJ.⁴⁷⁹ Ligji për Detyrimet gjithashtu parashikon kompensim në rast të shkeljes së të drejtave personale si dëm jopasuror dhe kompensim të drejtë, si dhe mundësinë e marrjes së një urdhri gjyqësor për ndërprerjen e veprimtarisë që cenon të drejtat e mbrojtura. Megjithatë, praktika gjyqësore për këtë çështje ndryshon, siç shtjellohet në nënseksionin 2 paragrafi 3.

Ligji për Inspektimin e Mjedisit (2022)

Ligji për Inspektimin e Mjedisit⁴⁸⁰ është akti i fundit legjislativ i miratuar lidhur me mbrojtjen e mjedisit në Maqedoninë e Veriut. Ky ligj rregullon organizimin e Inspektoratit të Mjedisit si institucioni i vetëm për monitorimin e gjendjes së mjedisit, kryerjen e inspektimeve dhe vendosjen e sanksioneve për ndotësit, zbatimin e parimeve, planifikimin, të drejtat dhe detyrat e inspektorëve, ngritjen e qendrës informative dhe raportimin. Inspektoriati i Mjedisit është organi publik kyç për monitorimin e gjendjes së mjedisit në Maqedoninë e Veriut, parandalimin e dëmeve, identifikimin e dëmit të shkaktuar, kryerjen e procedurës kundërvajtëse dhe vendosjen e gjobav. Inspektoriati i Mjedisit është e vetmja pikë institucionale ku qytetarët informojnë apo regjistrojnë çdo dëmtim të mjedisit për veprime të mëtejshme dhe identifikimin e autorit.

Dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara

Pas pavarësisë së saj në 1991, Maqedonia e Veriut përfshiu një dispozitë të re për mbrojtjen e mjedisit si një e drejtë e njeriut në Kushtetutën e saj. Pas kësaj, Qeveria u bë nënshkruese e dokumenteve dhe konventave kryesore ligjore ndërkombëtare që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit dhe natyrës. Për shembull, Qeveria dhe Parlamenti i Maqedonisë së Veriut nënshkruan dhe ratifikuan Konventën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar në vitin 1991, Konventa e Bazelit për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre në vitin 1997, Konventa e Aarhusit për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasjen në Drejtësi për Çështjet Mjedisore në vitin 1999, Konventa Kornizë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në vitin 1997, Protokollin e Kiotos në vitin 2004, Marrëveshja e Parisit në vitin 2017, Amendamenti i Dohas në Protokollin e Kiotos në vitin 2019 dhe të tjera. Qeveria dhe Kuvendi i Maqedonisë së Veriut kanë nënshkruar dhe ratifikuar pothuajse të gjitha traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës, atmosferës, ndryshimeve klimatike, kimikateve, mbeturinave, tokës dhe aksidenteve industriale.

476 <http://myla.org/en/>

477 Ligji për Detyrimet, neni 9, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 18/2001, 04/2002, 05/2003, 84/2008, 81/2009, 161/2009 dhe 123/13 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21)

478 Të drejtat personale sipas këtij ligji janë e drejta për jetën, shëndetin fizik dhe mendor, nderin, reputacionin, dinjitetin, emrin personal, jetën private dhe familjare, lirinë, krijimtarinë intelektuale dhe të drejta të tjera personale.

479 Avokati Aleksandar Godjo, Intervistë nga 3 gusht 2024.

480 Ligji për Inspektimin Mjedisor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 99/22).

Nënshkrimi dhe ratifikimi i këtyre traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare krijoi vullnetin politik për t'i inkorporuar ato në sistemin juridik kombëtar, kryesisht përmes legjislationit.

Në të njëjtën kohë, Maqedonia e Veriut në aspiratat e saj për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian, është në proces të harmonizimit me *Acquis Communautaire* e Bashkimit Evropian, duke përfshirë Kapitullin 27 mbi Mjedisin. Në këtë proces të harmonizimit, Maqedonia e Veriut transpozoi rreth 100 direktiva dhe rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në legjislationin kombëtar për mjedisin.⁴⁸¹

2.2. Si zbatohet në praktikë legjislationi për të drejtat e njeriut dhe mjedisin

Mbrojtja kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është mbrojtëse e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në sistemin juridik.⁴⁸² Që nga viti 1991, Gjykata Kushtetuese në mbrojtjen kushtetuese ka një rol të dyfishtë. Së pari, si pjesë e kompetencës së saj të përgjithshme, Gjykata vlerëson kushtetutshmërinë e akteve të përgjithshme juridike si ligjet, urdhëresat, vendimet, rregulloret dhe planet. Çdokush mund të paraqesë një iniciativë për iniciimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së një rregulloreje ose akti tjetër të përgjithshëm.⁴⁸³ Së dyti, Gjykata po siguron mbrojtje kushtetuese për një sërë lirish dhe të drejtash themelore të individëve, përkatësisht lirinë e mendimit, organizimit dhe tubimit, lirinë e shprehjes dhe ndalimin e diskriminimit.

Sa i përket nenit 43 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka zhvilluar një praktikë më së shumti në vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislationit në lidhje me mjedisin⁴⁸⁴ dhe Planeve të Detajuara Urbanistike (PDU), të miratuara nga këshillat bashkiakë për urbanizimin e seksioneve të territorit të komunës. Për shembull, Gjykata Kushtetuese e anuloi DUP-in për malin Vodno, i cili parashikonte prerje të sasive të konsiderueshme të pyjeve në malin Vodno në Shkup, kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut, me qëllim ndërtimin urban të ndërtesave.⁴⁸⁵ Mirëpo, edhe në këtë praktikë ka kufizime, sepse Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm mangësitë procedurale dhe jo përmbajtësore të DUP-ve. Me fjalë të tjera, ai vlerëson procesin me të cilin DUP-të miratohen nga këshillat komunalë pa e vlerësuar përputhshmërinë e tyre me Planet e Përgjithshme Urbane ose Planin e Territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dokumente për një nivel më të lartë të hierarkisë ligjore në planifikimin territorial dhe urban.⁴⁸⁶

Në praktikë, Gjykata Kushtetuese fillimisht vendos masa të përkohshme (nëse e kërkon kërkuesi i iniciativës) për ndërprerjen e zbatimit të DUP-ve të kontestuara dhe më pas vendos për rastin. Këto vendime kanë efekt të kufizuar për shkak se Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm aspektet procedurale të DUP-së. Si rrjedhojë, edhe nëse Gjykata Kushtetuese e anulon DUP-në, këshillat komunalë mund të miratojnë të njëjtin DUP përmes procedurës së saktë ligjore pa asnjë pasojë. Efekti real i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese me të cilat

481 Informacioni i siguruar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit,

482 Neni 108 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut https://www.sobranie.mk/the-constitution-of-the-republic-of-macedonia-ns_article-constitution-of-the-republic-of-north-macedonia.nspx

483 Neni 15 i Rregullores së Punës i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut https://ustavensud.mk/?page_id=4605

484 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese U.nr. 152/2005-1 datë 28 shtator 2006 <https://ustavensud.mk/?p=9102>

485 <https://ustavensud.mk/%d0%bf%d0%be%d0%b4%d0%bd%d0%be%d1%81%d0%b8%d1%82%d0%b5%d0%bb/%d0%b3%d1%80%d0%b0%d1%93%d0%b0%d0%bd%d0%b8/%d0%a3-%d0%b1%d1%80-802021-1/>

486 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese U.nr. 172/2010-1 datë 23 mars 2011 <https://ustavensud.mk/?p=10484>

anulohet DUP-ja e kontestuar është që të ofrohet mundësia e përfshirjes së mëtejshme dhe më të madhe të publikut në procedurat për miratimin e DUP-së së re.⁴⁸⁷ Megjithatë, edhe në rastet e pjesëmarrjes së plotë të publikut, në praktikë ka ndikim të kufizuar në DUP-të e reja.

Sipas Kushtetutës, mjedisi përfshin planifikimin e territorit, si dhe dimensionin e tij njerëzor. Kjo i jep Gjykatës Kushtetuese një hapësirë të gjerë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve normative. Këtu përfshihen rastet të cilat, në përputhje me nenin 55 paragrafi 3 i Kushtetutës, kufizojnë lirinë e tregut dhe të sipërmarrjes me qëllim të ruajtjes së mjedisit. Neni 55 mund të jetë gjithashtu një bazë për të vlerësuar nëse ligjet që kanë të bëjnë me tregtinë, biznesin dhe ekonominë që nuk përfshijnë kufizime të bazuara në mbrojtjen e mjedisit duhet të përfshijnë kufizime të tilla për të siguruar kushtetutshmërinë e tyre.

Mbrojtja në të drejtën penale

Sistemi i drejtësisë penale i Maqedonisë së Veriut siguron mbrojtje gjithëpërfshirëse të mjedisit dhe natyrës përmes institucioneve të zbatimit të ligjit, si Ministria e Brendshme dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, si dhe Prokuroria Publike.

Ligji për Policinë dhe Punët e Brendshme, që rregullon punën e forcave policore, nuk parashikon krijimin e një departamenti të posaçëm në kuadër të Ministrisë së Brendshme për luftën kundër krimit mjedisor.

Ligji i Prokurorisë Publike ofron kompetencë të dyfishtë për shërbimin e prokurorisë publike për hetimin e krimeve mjedisore. Që nga miratimi i ligjit në vitin 2020, Prokuroria Themelore Publike për Luftën e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit nuk ka dorëzuar asnjë rast në Gjykatën Themelore Penale në Shkup, e cila është e vetmja gjykatë kompetente për procedimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sipas prokurorisë, mungesa e hetimeve dhe ndjekjeve penale të krimeve mjedisore është rezultat i drejtpërdrejtë i mungesës së kapaciteteve institucionale dhe mjeteve financiare si dhe mungesës së vullnetit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar me vendet e tjera, edhe pse shumica e hetimeve kanë pasur elemente rajonale apo ndërkombëtare.

Në katër vitet e fundit, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka iniciuar disa hetime. Asnjë prej tyre nuk është dërguar në Gjykatën Themelore Penale Shkup, gjykatë kompetente për rastet e krimit të organizuar.

Numri i çështjeve penale në lidhje me drejtësinë mjedisore është shumë i ulët. Në përgjithësi, në katër vitet e fundit, gjyqësori maqedonas ka dhënë përafërsisht 242 vendime të formës së prerë⁴⁸⁸ në procedurë penale, duke dënuar përafërsisht 280 persona, me këto sanksione: dënime të dhëna - gjopa dhe burgim (101); sanksione alternative (172), dhe masë sigurie (1).⁴⁸⁹ Ndjekja penale e krimeve kundër mjedisit në raport me totalin e krimeve të kryera në gjashtë deri në shtatë vitet e fundit nuk është më shumë se një për qind, gjë që tregon se ka një numër të madh krimesh të pazbuluara dhe të papërpunuara.⁴⁹⁰ Numri i ulët i rasteve është rezultat i mungesës së kapaciteteve të policisë dhe prokurorisë për të iniciuar procedurat për krimet mjedisore. Shumica e këtyre krimeve janë të paramenduara, por disa prej tyre ndodhin nga pakujdesia, gjë që sanksionohet edhe nga Kodi Penal.

487 Avokati Aleksandar Godjo, Intervistë e mbajtur më 3 gusht 2024.

488 Informacioni i marrë nga Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

489 https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Sudstvo__ObvinetiOsudeniStoriteli/275_SK2_Mk_T13_ml.px/table/tableViewLayout1/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef

490 Gordana Lazhetic, Profesoreshë e së Drejtës Procedurale Penale në Fakultetin e Drejtësisë Iustinianus Primus, Universiteti Sts. Cyril dhe Methodius, intervistë e mbajtur më 1 gusht 2024.

Megjithatë, edhe me nivelin ekzistues të ekspertizës, ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve, policia dhe prokuroria publike, përkatësisht institucionet e drejtësisë penale janë mekanizmi ligjor më efikas dhe efektiv për të luftuar krimin mjedisor në Maqedoninë e Veriut.

Inspektorët shtetërorë ose vendorë të mjedisit ose përfaqësues të institucioneve të tjera (Policia Pyjore që është pjesë e Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujit) zakonisht iniciojnë çështje penale, të cilat hetohen më tej nga policia dhe prokuroria publike.

Kundërvajtjet

Ligji për Mjedisin dhe legjislacioni tjetër mjedisor përcaktojnë listën e kundërvajtjeve penale dhe procedurave kundërvajtëse në rast të shkeljes së dispozitave të tij mjedisore. Me qëllim të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit mund të ngrëjë komision për kundërvajtjet penale. Vendimet e komisioneve për kundërvajtjet penale i nënshtrohen mjeteve juridike para gjykatave kombëtare.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe inspektorët mjedisorë të autorizuar vendorë monitorojnë zbatimin e legjislacionit dhe kryejnë inspektime në nivel kombëtar dhe vendor. Nëse konstatojnë parregullsi apo shkelje, me ligj janë të detyruar t'i propozojnë kundërvajtësit procedurën e zgjidhjes, duke lëshuar urdhërpagesë për kundërvajtjen penale para se ta dërgojnë rastin në gjykatë. Përveç kësaj, shteti dhe inspektorët e autorizuar mund t'i ofrojnë kundërvajtësit zgjidhje dhe të arrijnë marrëveshje me të cilën autori i veprës penale duhet të paguajë gjobën, tarifat e tjera ose të korrigjojë dëmin e shkaktuar.⁴⁹¹

Inspektorati kombëtar i mjedisit në tre vitet e fundit ka kryer 4894 inspektime ku janë evidentuar 999 parregullsi dhe kanë filluar rreth 100 procedime kundërvajtëse me gjoba në shumën mbi 1,000,000 euro.⁴⁹²

Në këtë periudhë, 285 qytetarë janë kontaktuar me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit për evidentimin e parregullsive në lidhje me ligjet mjedisore, duke kërkuar inspektime nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit në 61 raste dhe nga inspektorët e autorizuar lokal në 224 raste.⁴⁹³

Për informacion më të detajuar, ju lutemi shihni Shtojcën V.

Mbrojtja në të drejtën civile

Sistemi ligjor maqedonas ofron mbrojtje juridike civile përmes legjislacionit për procedurat gjyqësore që përfshin çështjet mjedisore, veçanërisht në lidhje me kërkesëpaditë për kompensim. Mbrojtja e së drejtës civile sigurohet nga ligjet procedurale civile, kryesisht nga Ligji për Procedurën Gjyqësore. Shih Shtojcën VI.

Megjithatë, praktika gjyqësore tregon se pothuajse të gjitha kërkesëpaditë për mbrojtje civile janë refuzuar. Gjykata më së shpeshti në vendimet e saj i referohet nenit 15 pika 1 dhe 2 të Kodit Civil kur vendos rrëzimin e padisë. Kjo për faktin se gjyqtarët e së drejtës civile nuk e njohin të drejtën kushtetuese për një mjedis të shëndoshë si një të drejtë që përfshihet në fushën e zbatimit të procedurës gjyqësore, pra të drejtës civile.⁴⁹⁴ Në disa raste civile, të paraqitura nga individë ose nga OSHC, në lidhje me ndotjen e ajrit dhe ndotjen e shkaktuar nga depozitimet (landfillet e parregullta),

491 Elena Mujoska Trpevska, Studiuse e Lartë, Akademia Maqedonase për Shkenca dhe Arte, intervistë e mbajtur më 1 gusht 2024.

492 <https://www.sei.gov.mk/dokumenti/shest-mesechni-izveshtai/>

493 Po aty.

494 Profesoreshë Milica Shutova, Departamenti i së Drejtës Civile, Universiteti Goce Delçev, Intervistë nga 1 gusht 2024.

Gjykata Themelore Civile Shkup⁴⁹⁵ dhe Gjykata Themelore e Strugës⁴⁹⁶ rrëzuan paditë për shkak të moskompetencës. Këto raste janë konfirmuar nga Gjykata e Apelit të Shkupit⁴⁹⁷ dhe Manastirit⁴⁹⁸, ndërsa Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁴⁹⁹ ka konfirmuar rastin P4 nr. 578/19 të Gjykatës Themelore Civile Shkup. Si iniciatorë të çështjeve gjyqësore, OSHC-të kombëtare identifikuan se gjykatat kombëtare nuk janë angazhuar në mbrojtjen e mjedisit⁵⁰⁰ dhe as nuk kanë njohur të drejtën për një mjedis të shëndetshëm të garantuar me Kushtetutë për t'u mbrojtur me të drejtën civile.⁵⁰¹

Nëse marrim në konsideratë praktikën ekzistuese gjyqësore, është e qartë se praktika gjyqësore dhe jurisprudenca në trajtimin e çështjeve të të drejtave mjedisore në procedurat civile është shumë e dobët. Numri i çështjeve është dukshëm i vogël dhe vërehet se gjykata në shumicën e rasteve e rrëzon kërkesëpadinë.

Në pjesën arsyetuese të vendimeve, gjykatat theksuan se paditësit në padi kërkojnë vërtetimin e fakteve dhe jo mbrojtjen e të drejtave.⁵⁰² Praktika ekzistuese në të gjitha nivelet e gjykatave, përfshirë Gjykatën e Lartë, është një tregues se gjyqtarët e së drejtës civile nuk janë të hapur për të ofruar mbrojtje më të gjerë gjyqësore të të drejtave të njeriut të individëve dhe grupeve, duke përfshirë të drejtën e garantuar me kushtetutë për një mjedis të shëndetshëm. Në veçanti, ata nuk e identifikojnë dhe njohin të drejtën për një mjedis të shëndetshëm si një e drejtë individuale e përcaktuar nga ligji për detyrimet, i cili është baza ligjore për paraqitjen e rasteve në gjykatë. Kjo i pengon qytetarët, grupet dhe OSHC-të që të paraqesin rastet në lidhje me të drejtën për një mjedis të shëndetshëm para gjykatave civile.

Kjo pengesë mund të shmanget duke miratuar ligjin e ri për procedurat civile, i cili është në Parlament që nga viti 2020. Ky ligj procedural do të prezantojë një lloj të ri padie të quajtur "Padi për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive", e cila do të përfshijë mbrojtjen e mjedisit.⁵⁰³

Mbrojtja e së drejtës administrative

E drejta administrative në Maqedoninë e Veriut është një nga segmentet ligjore që rregullon mbrojtjen e mjedisit në procedurat administrative. Shih Shtojcën VII për fushëveprimin e mbrojtjes të parashikuar me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Mbrojtja gjyqësore në çështjet administrative rregullohet me Ligjin për Mosmarrëveshjet Administrative⁵⁰⁴ i miratuar në vitin 2019, i cili ka hyrë në fuqi në maj 2020. Sipas këtij ligji, gjykatat administrative të specializuara janë Gjykata Administrative në shkallën e parë dhe Gjykata e Lartë Administrative në shkallën e dytë. Ky ligj nuk parashikon procedurë të specializuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut siç e parashikon Ligji i mëparshëm për Mosmarrëveshjet Administrative të vitit 2006.

Në janar 2020, një OSHC vendase, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike⁵⁰⁵, mbështeti 12 çështje⁵⁰⁶ të dorëzuara nga qytetarë nga komuna të ndryshme në Gjykatën Administrative kundër Kryeministrit të Qeverisë, Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit të Territorit dhe Drejtorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, për mbrojtje nga një veprim

495 Rasti P4 nr. 578/19 i Gjykatës Themelore Civile Shkup.

496 Rasti P1 6/21 i Gjykatës Themelore Strugë.

497 Rasti GZH-507/21 i Gjykatës së Apelit Shkup.

498 Rasti TSZH-59/22 i Gjykatës së Apelit Manastir.

499 Rasti Rev2 nr. 85/2022 i Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

500 Profesoreshë Milica Shutova, Departamenti i së Drejtës Civile, Universiteti Goce Delçev, Intervistë nga 1 gusht 2024.

501 Bojan Trpeski, Menaxher i projektit në Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas, Intervistë e mbajtur më 22 korrik 2024.

502 Profesoreshë Milica Shutova, Departamenti i së Drejtës Civile, Universiteti Goce Dellçev, Intervistë nga 1 gusht 2024.

503 Neni 509 dhe 510 i Projektligjit për Procedurën Gjyqësore.https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=58350

504 Ligji për Mosmarrëveshjet Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19).

505 <https://cpia.mk/en/>

506 Për detaje të mëtejshme shih Aneksin I.

i kundërligjshëm, i.e. mospërbushja e një detyrimi ligjor nga një zyrtar. Zyrtarët dhe organet e mësipërme shtetërore nuk kanë arritur t'u ofrojnë palëve paditëse gëzimin e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, për shkak se nuk kanë respektuar detyrimet dhe standardet ligjore të përcaktuara në Ligjin për Cilësinë e Ajrit të Ambientit, të garantuara me të drejtën kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm. Veprimi i kundërligjshëm zbatohet për territorin e secilës bashki, ku banojnë apo punojnë paditësit. Këto çështje u rrëzuan dy herë nga Gjykata e Lartë, pas së cilës Gjykata e Lartë konfirmoi shtatë vendimet refuzuese të Gjykatës Administrative. Ekipi ligjor paraqiti një mocion në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për harmonizimin e praktikës gjyqësore, duke pasur parasysh se i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë ndryshoi praktikën gjyqësore duke vendosur për këtë çështje, pra të njëjtën çështje juridike për herë të tretë.

Në seancën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të mbajtur më 8 tetor 2024, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë mbajtën një qëndrim unifikues lidhur me ndotjen e ajrit në Maqedoninë e Veriut. Ai përcaktoi se e drejta e garantuar me Kushtetutë për një mjedis të shëndetshëm është një e drejtë individuale e qytetarëve të cilët kanë të drejtë të kërkojnë nga shteti miratimin e dokumenteve bazë të planifikimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Më tej, Gjykata përcakton se e drejta për një mjedis të shëndetshëm mund të cenohet nga veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve publikë. Në lidhje me mbrojtjen juridike, Gjykata përcakton se qytetarët kanë të drejtë të përdorin procedurat e mosmarrëveshjeve administrative për të mbrojtur të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Ky vendimi i Gjykatës së Lartë është i pari në të cilin ajo përcakton një detyrim pozitiv për shtetin për të siguruar mbrojtjen ligjore të së drejtës për një mjedis të shëndetshëm.⁵⁰⁷

Çështjet e sipërpërmendura janë iniciuar në përputhje me Kapitullin VII Dispozitat e veçanta për Ligjin për Mosmarrëveshjet Administrative nga viti 2006⁵⁰⁸ i cili ishte në fuqi deri në maj 2020. Ligji aktual për Mosmarrëveshjet Administrative i vitit 2019 ofron mbrojtje më të kufizuar se Ligji i vitit 2006. Ligji aktual lejon vetëm kundërshtimin e aktit të një institucioni përkatës, por jo kundërshtimin e një sjelljeje apo veprimi, siç është dështimi i miratimit të një Strategjie për ajër të pastër apo dokumenteve të ngjashme strategjike, siç ishte rasti me Ligjin e 2006-ës. Ky kufizim parandalon mbrojtjen e plotë në rastet e shkeljes ose mosrespektimit të të drejtave individuale kushtetuese, përfshirë të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, gjë që krijon një hendek ligjor në mbrojtjen e plotë gjyqësore të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Ndryshimi i këtij ligji është iniciuar nga Ministria e Drejtësisë për faktin se sipas ligjit të mëparshëm procedurat gjyqësore kanë qenë të gjata dhe vendimet kanë pasur një efekt të vogël. Ligji i ri kufizon kohëzgjatjen e procedurave deri në nëntë muaj dhe ofron mundësinë që gjyqtarët të vendosin gjoba për moszbatimin e vendimeve të tyre.

2.2.3. Mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve

Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve është një nga mekanizmat më të rinj të prezantuar në Maqedoninë e Veriut, me ligjin e parë që u miratua në vitin 2013. Ligji aktual për Ndërmjetësimin nga viti 2021⁵⁰⁹ e vendos ndërmjetësimin si një nga llojet e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë edhe me mosmarrëveshjet në çështjet mjedisore.⁵¹⁰

507 <http://www.vsrn.mk/wps/portal/vsrn/sud/vesti>

508 Ligji për Mosmarrëveshjet Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/06 dhe nr. 150/10).

509 Ligji për Procedurën e Ndërmjetësimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 294/21).

510 Neni 1 i Ligji për Procedurën e Ndërmjetësimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 294/21).

Kjo kompetencë e ndërmjetësuesve nuk është zbatuar në praktikë, për faktin se nuk ka pasur kërkesa për ndërmjetësim për çështjet mjedisore.⁵¹¹ Ky është rezultat i nivelit të ulët të zbatimit të ndërmjetësimit në Maqedoninë e Veriut dhe mungesës së njohurive dhe vetëdijes se ndërmjetësimi mund të përdoret si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve në çështjet mjedisore.

3. Ligji dhe praktika procedurale mjedisore

3.1. Të drejtat mjedisore të informacionit dhe pjesëmarrjes

Qasja në informacion është një nga të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Neni 16 thotë se “garantohet qasje e lirë në informacion dhe liria e marrjes dhe transmetimit të informacionit”.

E drejta kushtetuese për qasje në informacion zbatohet më tej me Ligjin për Mjedisin, i cili parashikon status të veçantë për qasje në informacion, duke e përcaktuar këtë të drejtë si një nga parimet e tij. Në lidhje me dispozitën për qasje në informacion, ju lutemi shihni Shtojcën VIII.

Në vitin 2019, OSHC Milieukontakt Macedonia⁵¹² themeloi Qendrën Aarhus në Maqedoninë e Veriut. Fokusi i Qendrës Aarhus është të sigurojë zbatimin e Konventës së Aarhusit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁵¹³ Themelimi dhe funksionimi i Qendrës Aarhus u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup. Në vitin 2022, Qendra Aarhus përgatiti një raport vjetor për zbatimin e Konventës së Aarhusit në nivel lokal, konkretisht nga komunat në Maqedoninë e Veriut. Sipas këtij Raporti, monitorimi i ueb faqeve të 80 komunave – 79 plus Qytetit të Shkupit, në vitin 2022 zbuloi se publikohen 56% të informacioneve relevante për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje në nivelin vendor, që përfshin mjedisin, urbanizmin, zhvillimin ekonomik lokal, pjesëmarrjen e të rinjve, forumet dhe buxhetimin e përgjegjshëm, krahasuar me 44% të informacionit të papublikuar.⁵¹⁴ Qendra Aarhus është ende aktive dhe monitoron segmente të caktuara të informacionit nga vetëqeverisja vendore.

Sa i përket gjuhës së informacionit të publikuar, pothuajse të gjitha informacionet janë dhënë në gjuhën maqedonase dhe shqipe në uebfaqet e institucioneve shtetërore. Ka edhe përjashtime, ndërsa disa nga ueb faqet janë vetëm në gjuhën maqedonase dhe angleze, në komunat ku popullsia më e madhe është maqedonase, ose shqip dhe anglisht në komunat ku popullsia më e madhe është shqiptare.

Mekanizmi themelor ligjor për qasje në informacion⁵¹⁵ në Maqedoninë e Veriut është Ligji për Qasje të Lirë në Informacionin me Karakter Publik të vitit 2019.⁵¹⁶

Ligji për Mjedisin rregullon të drejtën për pjesëmarrje dhe të drejtën për informim, duke ndjekur parimin e pjesëmarrjes së publikut dhe qasjes në informacion (neni 17). Ky ligj e detyron Qeverinë dhe organet tjera publike që të lejojnë pjesëmarrjen e publikut në procesin e përgatitjes së ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera ligjore por edhe në procedurën e përgatitjes së dokumenteve për miratim, dhe hartimit të rregulloreve.

511 Ndërmjetësimi si procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve deri më tani, nga ndërmjetësit e intervistuar, asnjëherë nuk është zbatuar në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga diskriminimi dhe në procedurat ndaj autorëve në moshë madhore të krimeve - <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/%D0%90%D0%9D%D0%90%D0%9B%D0%98%D0%97%D0%90-%D0%97%D0%90-%D0%9F%D0%A0%D0%98%D0%9C%D0%95%D0%9D%D0%90-%D0%9D%D0%90-%D0%9C%D0%95%D0%94%D0%98%D0%88%D0%90%D0%A6%D0%98%D0%88%D0%90%D0%A2%D0%90.pdf>

512 <https://milieukontakt.mk/>

513 https://arhus.mk/?page_id=805

514 Aleksandra Shackarska, Milieukontakt Maqedoni, intervistë e mbajtur më 26 korrik 2024.

515 Ligji për Qasje të Lirë në Informacionin me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/2019).

516 Ligji rregullon kushtet, mënyrën dhe procedurën e ushtrimit të së drejtës për qasje të lirë në informacionet publike që posedojnë poseduesit e informacionit. Organi kompetent për monitorimin e zbatimit të ligjit, publikimin e listës së poseduesve të informacionit, zhvillimin e politikave për qasje në informacion, zhvillimin e procedurës ankimore kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për informacione publike është Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin Publik.

Në praktikë, dhënia e informacionit dhe pjesëmarrja e publikut në proceset që lidhen me mjedisin, respektohen vetëm formalisht nga autoritetet kompetente shtetërore dhe vendore. Zakonisht, ky informacion nuk ka shtrirje të gjerë pasi autoritetet shtetërore publikojnë informacion në uebsajtet e tyre. Si rezultat, qasja në informacion dhe pjesëmarrja e publikut varet nga qasshmëria e uebsajteve. Disa nga organet publike apo bashkitë nuk janë plotësisht transparente dhe nuk publikojnë informacione me interes publik ose kur publikohet një informacion i tillë nuk gjendet lehtë nga qytetarët dhe palët e interesuara.⁵¹⁷

Ekziston gjithashtu një praktikë pozitive e pjesëmarrjes së publikut në hartimin e projektligjeve dhe pjesëmarrjes në debate publike. Në procesin e hartimit të Ligjit për Inspektimin Mjedisor, publiku u përfshi duke shpërndarë projektligjin si dhe duke organizuar debate publike rreth tij.⁵¹⁸ Publiku pati mundësinë të jepte komente për draftin në portalin zyrtar ENER (www.ener.gov.mk), dhe në fund të kohës për dhënien e komenteve, të gjitha komentet i janë dorëzuar institucioneve kompetente si pjesë e projektligjit.

3.1.1. Të drejtat e tubimit dhe protestës

E drejta për tubim dhe protestë është gjithashtu një nga të drejtat e garantuara me kushtetutë në Maqedoninë e Veriut. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se “qytetarët kanë të drejtë të mbledhen në mënyrë paqësore dhe të shprehin protestën publike pa njoftim paraprak ose pa leje të posaçme. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të kufizohet vetëm gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose të luftës.” Kjo dispozitë kushtetuese u zbatua më tej me Ligjin për Organizimin Publik të vitit 1995⁵¹⁹. Ligji përcakton mënyrën e tubimit dhe protestës paqësore dhe përcakton kufizimet për kufizimin e këtyre të drejtave dhe përkufizon tubimin publik duke përcaktuar madhësinë e grupit (së paku 20 individë).

Praktika e deritanishme ka treguar se të drejtat e tubimit dhe protestës respektohen plotësisht në Maqedoninë e Veriut. Ka pasur shumë pak raste kur policia ka kufizuar tubimin publik dhe protestën e qytetarëve, p.sh. kufizimet janë vendosur vetëm kur janë plotësuar kushtet ligjore për kufizim.

Vitet e fundit ka pasur protesta për mbrojtjen e liqenit të Ohrit, me thirrje për mbylljen e depozitimeve të egra, masa kundër ndotjes së ajrit në qytetet kryesore dhe protesta kundër hapjes së minierave në territorin e Maqedonisë së Veriut. Këto protesta u organizuan nga iniciativa qytetare apo OSHC mjedisore. Shumica e këtyre protestave patën pak ndikim, përveç rasteve të hapjes së minierave. Në këto raste, qeveria në dy raste ka anuluar dhënien e koncesioneve minerare.

3.2. Të drejtat e qasjes në drejtësi, mjetet juridike dhe efektiviteti i tyre

3.2.1. Qasja në drejtësi

Sistemi juridik i Maqedonisë ofron mjete juridike me legjislacion procedural në katër fusha të ndryshme juridike: kushtetuese, penale dhe penale-kundërvajtëse, civile, administrative dhe administrative-kundërvajtëse. Nga pikëpamja procedurale, çdo procedurë ka kërkesa të ndryshme për paraqitjen e një çështjeje për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në praktikë, nuk ka barriera specifike për qasjen në drejtësi. Shpenzimet e procedurave gjyqësore ndryshojnë, kështu që fillimi dhe zhvillimi i disa prej procedurave janë pa pagesë (kushtetuese, shumica administrative, penale, kundërvajtëse). Tarifat dhe shpenzimet gjyqësore janë të detyrueshme në rastet e procedurave civile dhe mosmarrëveshjeve administrative. Për procedurën civile, Ligji për Tarifat Gjyqësore përcakton shumën sipas vlerës së padisë, por për

517 Aleksandra Shackarska, Milieukontakt Maqedoni, intervistë e mbajtur më 26 korrik 2024.

518 Nikola Jovanovski, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore, intervistë e mbajtur më 24 korrik 2024.

519 Ligji për Tubimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 55/95, 19/06, 66/07 dhe 152/15 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 31/20).

konfliktet administrative caktohen tarifat gjyqësore fikse, pavarësisht nga objekti apo vlera e padisë. Kodi Tarifor i Dhomës së Avokatëve të Maqedonisë përcakton tarifat e avokatit.⁵²⁰

Ka avokatë dhe ekspertë ligjorë që mbështesin OSHC-të në paraqitjen e rasteve për sigurimin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. OSHC-të përmes projekteve apo programeve të ndryshme, në shumicën e rasteve i mbështesin financiarisht këto çështje. Pengesat kryesore në këto çështje janë: mungesa e mjeteve financiare për marrjen e ekspertizës për vlerësimin e niveleve të ndotjes, dëmtimit mjedisor dhe kompensimit. Përveç kësaj, në Maqedoninë e Veriut ka shumë pak institucione që janë të pajisura dhe me përvojë për të kryer mjekësi ligjore ose për t'u angazhuar si dëshmitarë ekspertë në procedurat gjyqësore.⁵²¹

Ministria e Drejtësisë ofron ndihmë juridike falas, siç përcaktohet me Ligjin për Ndihmën Juridike Falas nga viti 2019 për individët që kanë nevojë për ndihmë juridike. Për qëllimin e këtij ligji, ju lutemi shihni Shtojcën IX.

Rastet e iniciuara përgjithësisht sfidojnë sjelljen e institucioneve dhe organeve shtetërore apo vendore. Ka shumë pak çështje kundër korporatave.⁵²² Numri i ulët i çështjeve ndaj korporatave është rezultat i mungesës së mjeteve financiare për dërgimin e çështjeve në gjykatat kombëtare, për mjekësinë ligjore dhe tarifat e gjykatës së lartë dhe avokatit, sepse paditësit në të gjitha rastet kanë qenë shtetas ose OSHC.

3.2.2. Qasja në mjete juridike dhe efektiviteti i tyre në praktikë

Mjetet juridike në procedurat administrative, gjyqësore dhe ato kushtetuese janë efektive, duke marrë parasysh efektin e tyre juridik në sjelljen ose vendimin e rishikuar. Nëse organi publik në procedurën administrative, ose gjykatat në procedurë gjyqësore konstatojnë parregullsi ose shkelje të të drejtave të njeriut, veprimet e shqyrtuara anulohen. Ka një ndryshim midis efektit të vendimeve të gjykatave penale dhe civile në krahasim me organet publike administrative dhe gjykatat administrative. Efekti i grupit të parë, penal dhe civil është përfundimtar; megjithatë kjo nuk ndodh me vendimet e organeve administrative dhe gjykatave administrative, efekti i të cilave varet nga vullneti i organit publik, vendimi i të cilit është anuluar.⁵²³ Ligji për Mosmarrëveshjet Administrative nga viti 2019 ka sjellë dispozita të cilat përcaktojnë sanksionet e vendosura nga gjykatat administrative në rastet kur një organ publik nuk respekton standardet e përcaktuara në vendimet e gjykatave administrative. Deri më tani, gjykatat administrative nuk i kanë përdorur këto dispozita për të vendosur sanksione ndaj organeve publike.

Gjithashtu, mosekzekutimi i vendimit të gjykatës është vepër penale sipas Kodit Penal. Në lidhje me politikën e sanksionimit penal, Kodi Penal parashikon një gamë dënimesh me burgim, nga burgiminjë vit deri në burgim të përjetshëm në rastin e Ecocidit. Megjithatë, gjykatat vendosin kryesisht gjopa për krimet mjedisore.⁵²⁴ Deri më sot nuk ka pasur asnjë rast të regjistruar për Ecocid.

Mbrojtja administrative e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm është e vogël ose nuk ekziston, duke marrë parasysh konstatimet e gjykatës administrative dhe Gjykatës së Lartë në rastet e ndotjes së ajrit. Në këto raste gjykatat nuk e kanë përdorur parimin e proporcionalitetit, që është praktikë e zakonshme në punën e organeve të administratës publike dhe gjykatave, sepse ato nuk kanë vendosur mbi themelin e çështjes.⁵²⁵

520 Avokati Aleksandar Godjo, Intervistë nga 3 gusht 2024.

521 Bojan Trpeski, Menaxher i projektit në Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas, Intervistë e mbajtur më 22 korrik 2024.

522 <https://svedok.mk/mk/record.php?id=1275>

523 Zharko Aleksov, PhD, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore, intervistë e mbajtur më 26 korrik 2024.

524 Gordana Lazhetic, Profesoreshë e së Drejtës Procedurale Penale në Fakultetin Juridik Iustinianus Primus, Universiteti Sts. Cyril dhe Methodius, intervistë e mbajtur më 1 gusht 2024.

525 Konstantin Bitrakov, Profesor Asistent i së Drejtës Administrative në Fakultetin Juridik Iustinianus Primus, Universiteti Sts. Cyril dhe Methodius, intervistë e mbajtur më 24 korrik 2024.

4. Shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin kombëtar

Maqedonia e Veriut është përballur me probleme të ndryshme serioze mjedisore gjatë dekadave të fundit. Çështja kryesore mjedisore për qytetarët maqedonas është ndotja e ajrit, pasi ajo ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe cilësinë e jetës së tyre. Disa qytete në Maqedoninë e Veriut janë vazhdimisht në indeksin e cilësisë së ajrit (ICA), si qytete me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit në rajon, Evropë dhe globalisht.⁵²⁶

Një tjetër çështje kyçe mjedisore është depozitimi i vjetër i Lindanit në ish-Fabrikën Kimike OHIS. Qeveria, e vetëdijshme për nivelin e lartë të rrezikut nga kjo çështje, kërkoi mbështetje ndërkombëtare për asgjësimin e rreth 63,000 tonë Lindan jashtë vendit për përpunim të mëtejshëm dhe asgjësim përfundimtar duke përdorur teknikat më të mira në dispozicion, të cilat nuk janë të disponueshme në Maqedoninë e Veriut. Ky aktivitet mbështetet nga UNIDO dhe zbatohet nga UNOPS.

Si rezultat i ndryshimeve klimatike, të cilat sjellin temperatura shumë të larta gjatë muajve të verës, Maqedonia e Veriut po përballet me shpërthimin e zjarreve në pyje, më i madhi në dekadën e fundit. Në vitin 2024, Maqedonia e Veriut kërkoi mbështetje të madhe ajrore për luftimin e zjarreve në pyje, duke thirrur mekanizmin e NATO-s. Kjo çështje mjedisore është me rrezik të lartë jo vetëm për popullsinë, por edhe për pyjet dhe tokat bujqësore si dhe për cilësinë e ajrit.⁵²⁷

Në vitin 2021 dhe 2022, Komisioni për Mbrojtjen e Diskriminimit identifikoi diskriminim ndaj pakicave lokale turke në Radovish⁵²⁸, një pakicë lokale rome në Kavadarci⁵²⁹ dhe në Prilep⁵³⁰, për shkak se komuna nuk ka ndërtuar ujësjellës dhe kanalizim për të siguruar ujë të pastër. Komisioni ka detyruar komunat që të ndalojnë diskriminimin dhe të ofrojnë qasje në ujë të pastër brenda një periudhe 6 mujore. Sipas Komisionit, komuna e Kavadarci ka ndërmarrë aktivitete për zbatimin e gjetjeve të Komisionit, duke e lidhur vendbanimin rom me sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

5. Përmbledhja përfundimtare dhe rekomandimet

Sistemi juridik në Maqedoninë e Veriut ofron një kornizë të qartë formale ligjore, por nuk arrin të sigurojë plotësisht mekanizma efektivë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtën për mjedis të shëndetshëm, në procedurat penale, kundërvajtëse dhe administrative, siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm. Mbrojtja nga ligji civil duket se është edhe më pak efikase dhe efektive, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave mjedisore. Kjo vjen si rezultat i mungesës së ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe publikut, si dhe profesionistëve ligjorë dhe komunitetit ligjor për mundësinë e mbrojtjes së të drejtave mjedisore.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit është pika qendrore institucionale për mbrojtjen e të drejtës për një mjedis të shëndetshëm, sepse është institucioni më relevant duke marrë parasysh ekspertizën dhe kompetencat e tij. Inspektorati është shumë efikas në monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe inicimin e procedurave në përgjigje të dëmtimit mjedisor.

Gjyqësori është ende në një nivel shumë bazik në kuptimin e të drejtave mjedisore dhe identifikimin e rasteve të dëmtimit mjedisor⁵³¹. Shumica e prokurorëve dhe gjyqtarëve publikë nuk kanë njohje mbi praktikën gjyqësore ndërkombëtare dhe zhvillimet në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mjedisit, sepse ata nuk ndjekin jurisprudencën e gjykatave dhe organeve ndërkombëtare. Për më tepër, ka shumë të ngjarë që ata nuk janë plotësisht të pajisur për të hetuar krimet mjedisore për shkak të mungesës së pajisjeve teknike, burimeve njerëzore të specializuara

526 <https://www.iqair.com/north-macedonia>

527 Ana Colovic Leshovska, EKO SVEST, intervistë e mbajtur më 5 gusht 2024

528 <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2022/10/08-242-%D0%BE%D0%B4-28.07.22-%D1%83%D1%82%D0%B2%D1%80%D0%B4%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

529 <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2022/10/0802-120-od-19.04.22-utvrdena-diskriminacija.pdf>

530 https://www.errc.org/uploads/upload_en/file/5414_file1_naredba-za-vlastite-da-obezbedat-voda-za-romskite-zaednici-vo-prilep.pdf

531 Për detaje të mëtejshme shih Aneks IV.

dhe njohurive për këto çështje. Megjithatë, sistemi i drejtësisë penale ka krijuar një praktikë solide për mbrojtjen e të drejtave mjedisore në sistemin gjyqësor në Maqedoninë e Veriut. Ky është rezultat i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës, inspektorëve aktivë të mjedisit dhe ankesave të paraqitura nga qytetarët dhe OSHC-të.

9. Është e nevojshme të rritet kapaciteti administrativ i autoriteteve qendrore dhe vendore, veçanërisht në Agjencinë Serbe për Mbrojtjen e Mjedisit dhe inspektoratet e mjedisit. Është e nevojshme të zhvillohen trajnime për punonjësit e autoriteteve publike që kryejnë detyra për mbrojtjen e mjedisit, për të gjitha aspektet e ushtrimit të së drejtës për qasje në informacionin mjedisor, përfshirë detyrimin për zbatimin e testit të interesit publik në rast të kufizimeve të të drejtave, si dhe për praktikën e Komisionerit në lidhje me këto kufizime

614 Kriteret përkatëse mund të përfshijnë pozicionin ligjor të përfaqësuesit të interesit kolektiv, faktin që është një shoqatë mjedisore me statusin ligjor të një subjekti të mbrojtjes së mjedisit sipas ligjit kombëtar ose ndërkombëtar, fakti që është një organizatë jofitimprurëse me vlerë të ulët pronësie dhe sistem financimi projektësh, etj.

6. Shtojcë

Shtojca I

E drejta për gëzimin paqësor të pronësisë në praktikën gjyqësore kombëtare

Në një çështje, pronari i një trualli që ndodhet në një zonë të shpallur rezervë natyrore me Dekret kërkoi kompensim të barabartë me vlerën e tregut të parcelës në fjalë. Pronari besonte se miratimi i Dekretit rezultoi në shpronësim *de facto* të ngastrës së tij të tokës, pa zbatimin e Ligjit për Shpronësim. Qëndrimi fillestar i gjykatës ishte se ngastra e tokës ishte pjesë e një rezerve të veçantë natyrore jashtë zonës së ndërtimit. Ngastra ndodhej në një ligatinë dhe, sipas disa ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, aktivitetet bujqësore nuk janë të mundshme në një terren të tillë. Gjykata mori gjithashtu në shqyrtim edhe dëmshpërblimin e parashikuar në ligj për mohimin ose kufizimin e të drejtës së paditësit për të përdorur tokën dhe ndalimin e vendosur ndaj tij. Për më tepër, gjykata vuri në dukje se paditësi nuk ka ofruar prova që tregonin se ai nuk ishte në gjendje të ushtronte tagret e pronësisë që rrjedhin nga e drejta e tij të pronësisë mbi atë tokë. Një mënyrë tjetër që gjykata të merrte në konsideratë ligjshmërinë dhe legjitimitetin e ndërhyrjes në të drejtat pronësore të paditësit dhe ekuilibrin e drejtë (proporcionalitetin) ishte nën dritën e vendimit të GJEDNJ-së të cilës i referohet paditësi (*Matos e Silva LDA et al. k. Portugalisë* dhe *Elia S. r.l k. Italisë* - vendim i datës 16 shtator 1996 dhe 2 gusht 2001). Në vijim të këtij hapi, gjykata arriti në përfundimin se vendimet e mësipërme nuk mund të zbatoheshin në këtë rast, "pasi ato vendime theksojnë pasigurinë e kërkuesve lidhur me pasurinë e tyre për shkak të disa akteve të autoriteteve publike". Në këtë rast nuk ka një paqartësi të tillë, sepse "toka në pronësi të paditësit është pa dyshim pjesë e një rezervati të veçantë natyror dhe shfrytëzimi i saj është i kufizuar në masën e përcaktuar me ligj dhe rregullore". Nisur nga kjo, kërkesa e paditësit është rrëzuar.⁶¹⁵ Ky rast vë në pah rëndësinë e të kuptuarit të bazës së të drejtës për gëzimin paqësor të pronësisë dhe kufizimet e mundshme të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit.

E drejta për një gjykim të drejtë në praktikën gjyqësore kombëtare

Praktika e GJEDNJ-së kishte një rol të rëndësishëm në përgjigjen e pyetjes nëse një OJQ mjedisore mund të ketë statusin e palës në një mosmarrëveshje administrative. Ajo ofroi gjithashtu udhëzime për pyetjen nëse një status i tillë është i lidhur me përfshirjen paraprake të OJQ-së në një vlerësim të ndikimit në mjedis dhe nëse legjitimiteti i saj ndryshon kur paraqet një padi kundër një leje ndërtimi për një projekt që nuk kërkohet me ligj për t'iu nënshtruar një vlerësimi të ndikimit në mjedis. Kjo është e dukshme nga vendimi i Gjykatës Administrative, dy vendime të Gjykatës së Lartë dhe vendimi i Gjykatës më të Lartë lidhur me pjesëmarrjen e shoqatave në mbrojtjen e mjedisit dhe bazën e të drejtës për një proces të drejtë.

Pas ndryshimeve të prezantuara në vitin 2016 nga GAPA e re, legjitimiteti u jepet personave dhe shoqatave të qytetarëve që merren me mbrojtjen, përmirësimin dhe promovimin e mbrojtjes së mjedisit, si mbrojtës të interesave kolektive dhe më të gjera publike, duke supozuar se kanë interes ligjor për të marrë pjesë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit (GAPA, nen. 44, parag. 3.). Një nga çështjet e para ku një shoqatë mjedisore njihet si palë në një procedurë, në bazë të GAPA-s është çështja e ndërtimit të teleferikut në parkun Kalemegdan.⁶¹⁶ Në atë rast, një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit ka ngritur padi me pretendimin se leja për punë përgatitore është lëshuar në mënyrë të paligjshme dhe se autoriteti publik ka autorizuar punimet e ndërtimit pa një vendim për Studimin për VNM. Gjykata Administrative konkludoi brenda dy ditësh se punimet e ndërtimit mund të shkaktojnë dëme të pakthyeshme në trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, interesa publike që do

615 Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kasacionit Rish. 3985/2021 i datës 21 prill 2023.

616 Vendim i Gjykatës Administrative, datë 19.04.2019.

të ishte e vështirë të riparoheshin. Për rrjedhojë, gjykata vendosi pezullimin e të gjitha punimeve në projektin e teleferikut deri në vendimin përfundimtar për ligjshmërinë e lejes së ndërtimit. Gjykata Administrative ka shqyrtuar më parë ankesën për mungesën e identifikimit aktiv nga ana e paditësit, duke iu referuar nenit 142, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Serbisë, dhe në përputhje me Rekomandimin R (2004) 20 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtare në kontrollin gjyqësor të akteve administrative (Rekomandimi Rec (2004) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative) i datës 15 dhjetor 2004 dhe praktika e GJEDNJ-së (L'Erabliere k. Belgjikës, kërkesa nr. 49230/07, vendimi i datës 24 shkurt 2009).

Gjykata e Lartë, në vijim të ankimimit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative, ka konstatuar se konkluzioni i Gjykatës Administrative se paditësi duhej të bënte padi në këtë mosmarrëveshje administrative, ishte i saktë, por për arsye të ndryshme nga ato të renditura në shpjegimin e vendimit të kundërshtuar. Në vendimin Uzp 132/2021 të datës 17 mars 2023, Gjykata e Lartë vlerësoi se shoqatat për mbrojtjen e mjedisit nuk kanë të drejtë të drejtpërdrejtë të ngrenë padi në një mosmarrëveshje administrative kundër një vendimi për leje ndërtimi. Kjo vlen edhe për rastet që kanë të bëjnë me lejen e ndërtimit për një projekt për të cilin është përcaktuar se duhet të bëhet një vlerësim i ndikimit në mjedis. Edhe pse nuk ka të drejtë të drejtpërdrejtë për të ngritur padi, Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit mund të fitojë legjitimitetin aktiv në një mosmarrëveshje administrative kundër lejes së ndërtimit, kur bëhet fjalë për një projekt për të cilin është përcaktuar nevoja për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në mbështetje të këtij qëndrimi, u vu në dukje se «GJEDNJ-ja veprimi ngjashëm në çështjen, të cilës i referohet edhe Gjykata Administrative, L'Elablière ASBL k. Belgjikës, kërkesa nr. 49230/07, datë 24 shkurt 2009, paragrafi 29, kur i njohu të drejtën e qasjes në gjykatën administrative një shoqate jofitimprurëse, veprimtaria e së cilës synonte mbrojtjen e mjedisit në disa bashki të Belgjikës dhe me rastin e kontestimit të ligjshmërisë së lejes për ndërtimin e objekteve të grumbullimit të mbetjeve.

Legjitimiteti i shoqatës për mbrojtjen e mjedisit përcaktohet në çdo rast konkret, duke u nisur nga përcaktimi nëse ka një lidhje juridikisht relevante të paditësit, konkretisht interesit në mbrojtjen e të cilit ai angazhohet, me objektin e vendimmarrjes së aktit administrativ, dhe duke marrë parasysh nëse me shfrytëzimin e lejes së kontestuar të ndërtimit ka pasur shkelje të interesit që paditësi si shoqatë synon ta mbrojë, përkatësisht interesin e mbrojtjes së mjedisit dhe nëse është bazuar në Ligjin për Planifikimin dhe Ndërtimin, i cili është zbatuar për dhënien e lejes kontestuese të ndërtimit.⁶¹⁷

Duke u mbështetur në arsyetimin e përcaktuar në vendimin Uzp 132/2021 të datës 17 mars 2023, vendimi i Gjykatës së Lartë në një rast tjetër ofron udhëzime të rëndësishme për pozitën ligjore të OJQ-ve mjedisore në mosmarrëveshjet administrative. Në atë rast, Gjykata dallon nëse pëlqimi për një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis kërkohet gjatë fazës së lejes së ndërtimit ose mund të shtyhet në një fazë të mëvonshme, si para fillimit të ndërtimit. Ai gjithashtu thekson se pjesëmarrja në procesin e VNM-së është njëkohësisht një e drejtë dhe një detyrim i publikut, duke sugjeruar që përfshirja paraprake e një OJQ-je në procedurat administrative mund të bëhet një kriter kyç për përcaktimin e legjitimitetit të saj në çështjet e ardhshme.⁶¹⁸

Në praktikë hasim edhe raste kur kompanitë dënohen me gjobë për ndërtim pa leje. Duke vendosur për padinë e dy shoqatave mjedisore, në shtator të vitit 2024, Gjykata Tregtare nxori një vendim me të cilin dënoi kompaninë që merret me kërkimin dhe shfrytëzimin e mineralit të bakrit për ndërtimin e një objekti minerar (mbetje flotacioni), duke pasur parasysh se ndërtimi pa leje është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe Ligjit për kërkimet minerare dhe gjeologjike. Kompania është dënuar me dy milionë dinarë gjobë, ndërsa personi përgjegjës me 150,000 dinarë. Dënimi i parashikuar me ligj për ndërtimin e objekteve minerare dhe kryerjen e punëve minerare pa miratim është prej 1,500,000 deri në tre milionë dinarë.

E drejta për një mjet efektiv juridik dhe praktika gjyqësore kombëtare

617 <https://www.vrh.sud.rs/sr-lat/uzp-1322021-41271>

618 Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 41/2023, datë 8 gusht 2023.

Për herë të parë në praktikën gjyqësore serbe, së fundi u mor një vendim mbi një kërkesëpadi *actio popularis*, si rezultat i nevojës për të rishikuar rolin e mbrojtësve të interesave kolektive dhe më të gjera të publikut dhe legjitimitetin e tyre në qasjen në drejtësinë mjedisore. Megjithëse kërkesëpadi *actio popularis*, e disponueshme për të gjithë për t'u përdorur kur kërkohet eliminimi i një burimi rreziku që kërcënon dëme të konsiderueshme, ishte parashikuar në Ligjin e Kontratave dhe Detyrimeve të Serbisë i vitit 1978, ajo u përdor vetëm 44 vjet më vonë, në shtator 2022, kur për herë të parë Gjykata e Lartë nxorri një vendim i cili pranoi kërkesëpadinë dhe miratoi *locus standi* për një organizatë joqeveritare mjedisore. Vendimi mori formë të prerë në gusht 2023.⁶¹⁹

Një organizatë joqeveritare mjedisore ngriti një padi për të eliminuar rrezikun e dëmtimit. Pyetja që kishte një rol vendimtar në vendimin e gjykatës, për sa i përket zbatimit të *actio popularis*, ishte nëse padia ishte instrumenti i vetëm i mbrojtjes juridike me të cilin mund të ushtrohet e drejta për mjet efektiv juridik në përputhje me nenin 13 të KEDNJ-së apo mund të korrigojeshin lëshimet që çuan në moszbatimin e Planit Kombëtar të Reduktimit të Emisioneve (PKRE) me masa të tjera të përshtatshme? Duke analizuar ligjin pozitiv, Gjykata e Lartë konstatoi se Ligji për Mbrojtjen e Ajrit, i cili rregullon kuadrin ligjor në lidhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregulloreve të miratuara për zbatimin e tij, nuk parashikon penalitete për shkeljet e PKRE-së, as inspektim të zbatimit të tij, çka përjashton edhe mundësinë e fillimit të inspektimeve të jashtëzakonshme. Prandaj, argumenti ishte se “në procedurën civile, është gjykata ajo që vendos nëse PKRE është zbatuar siç duhet dhe është shkelur e drejta e jetës si dhe e drejta e jetës private dhe familjare, e garantuar nga KEDNJ-ja. Gjykata e Lartë pranoi kërkesëpadinë dhe urdhëroi të pandehurin që «të koordinojë aktivitetet e tij operative me kuadrin normativ dhe t'i operojë aktivitetet e tij në një mënyrë që të mos rrezikojë jetën dhe shëndetin e njerëzve».⁶²⁰

Gjykata e Lartë mori në shqyrtim edhe legjitimitetin e një OJQ-je mjedisore. Përveç dispozitave të legjislacionit vendas, Gjykata ka marrë në konsideratë edhe standardet e shprehura në nëntë vendime të GJEDNJ-së. A do të jetë rasti i parë i suksesshëm i *actio popularis* që hap derën e zbatimit më të gjerë të këtij veprimi kur nuk ekziston mundësia e aplikimit të një mjeti tjetër juridik? A do të vendosë gjykata për ekzistencën e masave të tjera relevante duke shqyrtuar praktikën e GJEDNJ-së kur bëhet fjalë për të drejtën për një mjet efektiv juridik? Suksesi i padisë *actio popularis* a do ti hapë rrugën zhvillimit e çështjeve gjyqësore për klimën në Serbi? Këto janë çështjet që do të trajtohen në të ardhmen nëpërmjet interpretimit evolucionar dhe inovativ të dispozitave të së drejtës vendase dhe të dispozitave të KEDNJ-së.

E drejta për jetë në praktikën gjyqësore kombëtare

Edhe pse vendimi nuk i referohet praktikës përkatëse të GJEDNJ-së, në një rast nga praktika e Gjykatës Themelore arsyetimi i vendimit i referohet raportit mes cilësisë së ujit të pijshëm dhe të drejtës për jetë.⁶²¹ Rasti në fjalë shqyrtoi zbatimin e parimit “përdoruesi paguan” në ligjin e furnizimit me ujë të pijshëm. Me atë rast u shtrua pyetja nëse shfrytëzuesi i shërbimit komunal të furnizimit me ujë të pijshëm mund të kërkojë ulje të faturës nëse uji nuk është i cilësisë së duhur. Në arsyetimin e vendimit, në të cilin gjykata ka konstatuar se uji i cilësisë së pijshëm nuk u është furnizuar përdoruesve dhe për këtë arsye, ndërmarrja e furnizimit nuk ka pasur të drejtë për të faturuar shërbimin, thuhet se kur bëhet fjalë për furnizimin me ujë të pijshëm, ai është “produkt ushqimor me rëndësi jetike për realizimin e nevojave jetësore të personave fizikë në një vend. Uji është një nga kushtet më të rëndësishme për mbijetesën dhe jetën e njeriut në Tokë. Ai zë një vend të veçantë midis faktorëve të shumtë mjedisorë, të domosdoshëm për jetën dhe shëndetin e njeriut. Uji luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën e njeriut”.

619 Vendimi i Gjykatës më të Lartë nr. 181/21, datë 22 shtator 2022.

620 *Po aty*.

621 Vendimi i Gjykatës Themelore në Vrbas, P. 372/2019, i datës 5 qershor 2017.

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare (cilësia e jetës private dhe familjare) në praktikën gjyqësore kombëtare

Në një çështje, mosveprimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili ka sjellë efekte të dëmshme për shkak të nivelit të palejuar të zhurmës në zonat e banuara, është trajtuar në lidhje shkakësore me dëmet jomateriale të shkaktuara nga shkelja e të drejtave personale.⁶²² Rasti ka nisur si kundërpërgjigje ndaj padisë së banorëve të një rruge, të cilët janë ekspozuar ndaj zhurmës së tepërt nga ambientet e hotelierisë, të cilët kanë kërkuar kompensimin e dëmeve jomateriale për shkak të dhimbjeve mendore të shkaktuara nga cenimi i të drejtave personale. Padia është ngritur ndaj qytetit që ka shkaktuar dëmin nga mosveprimi, pasi nuk ka marrë asnjë masë për uljen e nivelit të zhurmës në kufirin e vlerave të lejuara. Qiramarrësit u ekspozuan ndaj niveleve të zhurmës që tejkalonin kufijtë e lejuar të vlerave në mënyrë të vazhdueshme, për më shumë se dy vjet.

Ekspozimi ndaj zhurmës uli cilësinë e jetës së tyre të përditshme, duke u kërcënuar kështu e drejta e tyre për respektimin e banesës dhe dinjitetit të tyre. Niveli i matur i zhurmës kishte një ndikim negativ në shëndet. Është marrë parasysh niveli i shkeljes së të drejtave, kohëzgjatja e ekspozimit ndaj zhurmës dhe ndryshimet në jetën e përditshme (disa persona të ekspozuar ndaj zhurmës u strehuan për të shpëtuar nga zhurma në pjesë të banesës që nuk janë të destinuara për pushim dhe nuk mund të ajrosen, ndërsa të tjerë e kanë përjetuar shqetësimin nga zhurma në vendin e punës). Vlerësimi ka marrë parasysh edhe praktikën e GJEDNJ-së. Në arsyetimin e vendimit, thuhet se e drejta e një personi për respektimin e banesës së tij, si një hapësirë ku zhvillohet jeta private dhe familjare, përfshin jo vetëm të drejtën e hapësirës fizike, por edhe të cilësisë së gëzimit të asaj hapësire, pra të drejtën për gëzimin e qetë të hapësirës, e cila rrjedh nga praktika e analizuar e GJEDNJ-së. Prandaj, u arrit në përfundimin se shkelja e të drejtës për respektimin e banesës përfshin si shkeljet që vijnë nga dëmtimi fizik (p.sh. hyrja e paautorizuar në shtëpi) dhe ato që nuk janë fizike (p.sh. zhurma, erërat e pakëndshme, emetimet). Duke marrë parasysh rrethanat e përmendura, gjykata konstatoi se paditësit kishin të drejtën për kompensim monetar për dëmet jomateriale.

Liria e shprehjes në praktikën gjyqësore kombëtare

Pikëpamjet mbi marrëdhëniet ndërmjet lirisë së tubimit, lirisë së shprehjes dhe të drejtës për gëzim paqësor të pronës në çështjet mjedisore janë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme nga praktika e GJEDNJ-së. Ne gjetëm një shembull në vendimin e Gjykatës Themelore, në të cilën gjykata shqyrtoi nëse protestuesit ndërhyjnë në pronësinë e paditësit duke hequr një gardh me tela, duke hyrë në një pronë dhe duke vazhduar me aktivitetet e protestës së tyre.⁶²³ Duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, gjykata konstatoi se prerja e gardhit « ishte synuar si një mesazh simbolik » që tregonte se një gardh ishte ngritur në një shteg malor të shënuar përmes një Parku Kombëtar që është një e mirë publike dhe nuk mund të rrethohet. Për të vlerësuar nëse të paditurit kanë vepruar në mënyrë të paligjshme gjatë prerjes së gardhit dhe hyrjes në parcelë, gjykata mori si pikënisje analizën e praktikës së GJEDNJ-së në lidhje me zbatimin e nenit 10 të KEDNJ-së për standardet e mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe kufizimet e saj. Praktika e analizuar i referohet natyrës juridike të mënyrës së shprehjes së ideve, dhe përcaktimit të dallimit ndërmjet veprimeve të dënueshme të protestës dhe atyre që paraqesin shkelje të ligjit penal; liria e fjalës si ftesë për diskutim, duke vënë në dukje një problem në ushtrimin e pushtetit, duke informuar publikun; dhe, së fundi, në balancimin e të drejtave konkurruese (e drejta për lirinë e shprehjes dhe e drejta e pronës). Opinione të shprehura në praktikën e GJEDNJ-së dhe analizën e pikëpamjeve të shprehura në më shumë se 15 raste të paraqitura në atë gjykatë luajtën një rol kyç në rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar nga gjykata.⁶²⁴

622 Vendimi i Gjykatës së Parë Themelore të Beogradit, 56 P nr. 20265/2020 i datës 30 mars 2021.

623 Vendimi i Gjykatës Themelore të Novi Sadit P. 51978/2021 i datës 23 dhjetorit 2022.

624 Argumentimi thotë: "Megjithëse praktika gjyqësore nuk është një burim formal i ligjit, praktika e GJEDNJ-së udhëzon gjykatën në zbatimin e ligjit pozitiv ndaj fakteve, me synimin për të përfaqësuar një korrigjim të praktikës vendore".

Shtojca II

Po zhvillohen rregulla kundër praktikave mashtruese të biznesit, si dhe për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, e drejta për informacion në kohë dhe të plotë për gjendjen e mjedisit dhe ndikimin që mallrat dhe shërbimet kanë në zhvillimin e qëndrueshëm bëhet një e drejtë themelore e konsumatorit.⁶²⁵ Kërkesa për mbrojtjen e interesit kolektiv të konsumatorëve mund të bëhet nga shoqatat ose sindikatat e krijuara me qëllim mbrojtjen e konsumatorit, të cilat kanë statusin e palës në procedurë.⁶²⁶ Në praktikën ekzistuese, nuk ka shembuj të marrjes së mbrojtjes së interesit kolektiv të konsumatorëve si bazë për qasjen në informacionin mjedisor. Duke pasur parasysh interesin në rritje të publikut për ndikimin e mallrave dhe shërbimeve në mjedis dhe ndryshimet klimatike, përfshirja e shoqatave dhe sindikatave të konsumatorëve në procedurat e të drejtave të konsumatorëve si rezultat i marrjes së informacionit të paligjshëm ose të pasaktë mbi rreziqet mjedisore dhe klimatike, mund të kontribuojë në zbatimin e mëtejshëm të shtyllave të Konventës së Aarhusit.

Në të njëjtën kohë, ndryshimet në Ligjin për Kontabilitetin parashikojnë detyrimin e raportimit jo-financiar, që do të thotë se raportet vjetore të kompanisë janë të detyruara të përfshijnë një raport jofinanciar që përmban informacionin e nevojshëm për të kuptuar zhvillimin, rezultatet e biznesit dhe pozicionin e personit juridik, si dhe rezultatet e aktiviteteve të tij që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, çështjet sociale dhe menaxheriale, luftën kundër korrupsionit dhe çështje që lidhen me korrupsionin. Detyrimi për raportimin jofinanciar zbatohet për personat e mëdhenj juridikë që janë shoqëri me interes publik që tejkalojnë kriteret e një numri mesatar prej 500 punonjësish gjatë vitit të biznesit, të vërejtura në datën e bilancit.⁶²⁷

Shtojca III

Në dhjetor 2009, Serbia aplikoi për anëtarësim në BE. Në vitin 2011, Parlamenti Evropian ratifikoi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Serbisë. Grupi IV - Agjenda e Gjellbër dhe lidhja e qëndrueshme u hap për negociata në dhjetor 2021. Pozicioni i përbashkët i Bashkimit Evropian për Kapitullin 27 përcakton 8 standarde përmbyllëse.⁶²⁸ Me Pozicionin Negociues, i cili ka hyrë në fuqi që nga 1 qershor 2019, pranohet *acquis* mjedisore. Kjo do të thotë se Serbia ka shprehur gatishmërinë e saj për të transpozuar dhe zbatuar *acquis* ligjore brenda kornizës së Kapitullit 27, deri në datën e anëtarësimit në BE. Përfshirjet mund të zbatohen vetëm për disa kërkesa për periudha kalimtare që do të përcaktohen në rrjedhën e mëtejshme të negociatave. Periudhat dhe përfshirjet kalimtare duhet të kufizohen si në shtrirje ashtu edhe në kohëzgjatje.⁶²⁹

Në vitin 2006, Serbia miratoi Ligjin për Ratifikimin e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë. Ky ishte traktati i parë i nënshkruar ndërmjet Serbisë dhe BE-së, i cili krijoi bazën për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë në territorin e Evropës Juglindore dhe lidhjen e tij me tregun

625 Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, Gazeta Zyrtare e RS, 88/21, neni 2 parag. 1 pika. 3. E drejta e konsumatorit për t'u informuar përfshin, për shembull, të drejtën për t'u informuar në mënyrë aktive nëse ofrohet një shërbim riparimi dhe brenda asaj periudhe është e garantuar, dhe nëse produkti është më i qëndrueshëm dhe me karakteristika të tilla që mund të zgjasë më gjatë, nëse burimet nga burimet e ripërtëritshme ose një sasi më e vogël energjie dhe uji janë përdorur në prodhim, nëse produkti mund të ripërdoret ose riciklohet pas përdorimit, nëse procesi i prodhimit zvogëlon sasinë e GS dhe nëse përdorimi i tij çliron një sasi më të vogël të GS, nëse prodhimi ose përdorimi i një produkti ose ofrimi i një shërbimi ka një ndikim më të favorshëm në ndryshimet klimatike dhe masat me të cilat ndikimet e dëmshme reduktohen dhe reflektohen në ndikime të tilla, etj.

626 Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, neni 174.

627 Ligji për Kontabilitetin, Gazeta Zyrtare e RS, nr. 73 e 11 tetorit 2019, 44 e 29 prillit 2021 - ligji i shtetit, neni 37 dhe 38.

628 Pozicioni i përbashkët i Bashkimit Evropian, gjendet në: https://www.mei.gov.rs/upload/documents/pristupni_pregovori/pregovaracke_pozicije/27_eu_common_position.pdf

629 Bogojevic, S., & Drenovak-Ivanovic, M. (2019). Mbrojtja e mjedisit përmes prizmit të zgjerimit: koha për reflektim. *Rishikimi i ligjit të tregut të përbashkët*, 56(4).

energjetik të BE-së.⁶³⁰ Në nëntor 2020, Serbia nënshkroi Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, e cila identifikoi pesë sektorë që kanë nevojë për reforma për të siguruar një bazë institucionale për një tranzicion të gjellbër.

Sipas Kushtetutës së Serbisë, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare paraqesin pjesë përbërëse të rendit juridik të Republikës së Serbisë dhe si të tilla janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Traktatet ndërkombëtare të ratifikuara duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.⁶³¹ Nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, u zhvilluan konventa ndërkombëtare për mjedisin që përcaktojnë të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, parimet, supozimet materiale dhe procedurale që përbëjnë bazën e tij, si dhe konventa kushtuar çështjeve të veçanta si përgjegjësia civile dhe penale për dëmtimin e mjedisit, standardet e sigurisë për transportimin e substancave të rrezikshme dhe mbeturinave të rrezikshme, etj. të cilat i ka nënshkruar dhe ratifikuar Serbia.

Konventa e Aarhusit është bërë pjesë e sistemit juridik të Serbisë përmes miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Konventës për Qasje në Informacion, Pjesëmarrje Publike në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi për Çështjet Mjedisore në maj 2009.⁶³² Edhe pse legjislativi në Serbi, para ratifikimit të Konventës së Aarhusit, tregonte deri diku realizimin e ideve të promovuara prej saj, ratifikimi ofroi një mundësi formale për zbatimin e vazhdueshëm të të drejtave të Konventës. Aspekte të ndryshme të Konventës së Aarhusit mbulohen nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligji për Amendamentet e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për VNM dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit për VNM, Ligjit për Vlerësimin Strategjik të Ndikimit në Mjedis dhe Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes së Mjedisit, Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione me Rëndësi Publike. Marrëveshja e parë ndërkombëtare detyruese e debatuar nën kujdesin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të lidhur kushtet mjedisore dhe shëndetin e njeriut që Serbia ka ratifikuar është Protokollin e UNECE mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Konventës Espoo (Kiev, 2003).⁶³³

Serbia ka nënshkruar Konventën e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (CETS nr. 205), Konventën e Tromsø, e cila ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2020, por ende nuk e ka ratifikuar atë.⁶³⁴

Serbia është palë e *Konventës Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike* dhe ka ratifikuar Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshjen e Parisit.⁶³⁵

Nën kujdesin e Këshillit të Evropës, u miratuan disa konventa që rregullojnë pozicionin e shoqatave dhe organizatave mjedisore si bartëse të interesave kolektive. Midis tyre është Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër Evropiane dhe Habiteteve Natyrore (Konventa e Bernës).⁶³⁶

630 Duke miratuar Ligjin për Ratifikimin e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (Gazeta Zyrtare e RS, nr. 62/06), Republika e Serbisë mori përsipër të transpozojë dhe zbatojë *acquis* mjedisore, i cili i detyron anëtarët e Komunitetit të Energjisë, ndër të tjera, me rregullat për vlerësimin e ndikimit (Direktiva 2014/52/EU) dhe rregullat për kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha me djegie (Direktiva 2001/80/EC).

631 *Kushtetuta e Republikës së Serbisë*, neni 16. Në vendimin e saj UŽ-11320/2021, Gjykata Kushtetuese e Serbisë deklaroi se gjykatat duhet të interpretojnë dispozitat e Ligjit (në këtë rast të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm) në përputhje me KEDNJ-në, si dhe praktikën dhe qëndrimet e GJEDNJ-së.

632 *Ligji për Ratifikimin e Konventës për Qasjen në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi për Çështjet e Mjedisit*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë, nr. 38/09. Në Preambulën e Konventës së Aarhus-it, mbrojtja adekuatë e mjedisit përcaktohet si e drejtë themelore e njeriut dhe institutet e rregulluara prej saj janë baza e së drejtës së çdo personi për të jetuar në një mjedis që i përgjigjet shëndetit dhe mirëqenies së tij dhe detyrës për të mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin.

633 *Ligji për Ratifikimin e Protokollit të VSM të Konventës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar*, Gazeta Zyrtare e RS – Kontratave ndërkombëtare, nr. 1/2010.

634 https://www.coe.int/sr-RS/web/belgrade/news/-/asset_publisher/tM7Uo4CVRhTF/content/ratification-of-the-troms-convention-by-serbia-essential-for-better-access-to-official-documents-say-participants-of-event-in-belgrade

635 *Ligji për ratifikimin e Protokollit të Kiotos në Konventën Kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike*, Gazeta Zyrtare e RS, nr. 88/2007. *Ligji për Ratifikimin e Amendamentit të Dohas në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike*, Gazeta Zyrtare e RS, nr. 2/17 Ligji për Konfirmimin e Marrëveshjes së Parisit, Gazeta Zyrtare e RS, nr. 4/2017.

636 *Konventa për Ruajtjen e Kafshëve të Egra Evropiane dhe Habiteteve Natyrore*, ETS nr. 104, 1982.

Duke e ratifikuar atë, Serbia mori përsipër t'u garantojë shoqatave dhe organizatave mjedisore të drejtën për të paraqitur ankesa në lidhje me shkeljet e mundshme të dispozitave të Konventës së Bernës.⁶³⁷

637 Ligji për Ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër Evropiane dhe Habiteteve Natyrore. Gazeta Zyrtare e RS - Marrëveshjet Ndërkombëtare, nr. 102/07.

Rekomandimet e përgjithshme

1. Përmbledhje e pozicionit në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore, bazuar në studimet bazë kombëtare

Gjashtë raporte të analizës bazë u përgatitën mbi bazën e një metodologjie të përbashkët, lidhur me legjislacionin vendas, praktikën gjyqësore dhe politikën në lidhje me të drejtat e njeriut dhe çështjet mjedisore respektivisht në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Metodologjia përfshin një përmbledhje të përgjithshme të ligjeve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe mjedisin (që mbulon mbrojtjen mjedisore thelbësore dhe procedurale), së bashku me një vlerësim se sa efektive kanë qenë këto në praktikë dhe një analizë nëse/si janë zbatuar për shqetësimet kryesore mjedisore në kontekstin e tyre kombëtar. Qëllimi kryesor i raporteve ishte vlerësimi i efektivitetit të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit lidhur me të drejtat e njeriut në çdo vend, përmes identifikimit të praktikave të mira, boshllëqeve, sfidave dhe nevojave për ngritjen e kapaciteteve.

Ndërsa raportet kombëtare bazë paraqesin një peizazh të larmishëm në disa aspekte, ka gjithashtu të përbashkëta të qarta në të gjithë rajonin. Për shembull, të gjitha juridiksionet e anketuara po ndjekin anëtarësimin në BE dhe janë në faza të ndryshme të harmonizimit të legjislacionit të tyre vendas me *acquis* të BE-së. Në një numër juridiksionesh, korniza ligjore duket zyrtarisht se mbron mjedisin dhe të drejtat e njeriut, por këto mbrojtje nuk janë zbatuar dhe ekzekutuar siç duhet.

Në disa juridiksione, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është përdorur për të forcuar rezultatet mjedisore në procedurat ligjore. Në Serbi, referencat në një praktikë të tillë gjyqësore duket se janë të lidhura me ofrimin e trajnimit ligjor. Nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, një trajnim i tillë mund të zgjerohet, si dhe të shtrihet në të gjithë rajonin. Në juridiksione të tjera, njohja e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është shumë e kufizuar dhe/ose vendimet e gjykatave nuk janë të harmonizuara. Për shembull, në Kosovë*, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së referohet rrallë dhe në Shqipëri mungesa e referencës së drejtpërdrejtë ndaj mjedisit në KEDNJ është përdorur nga gjyqtarët për të mbështetur një qasje të dobët ligjore në nivel vendor. Në disa juridiksione, marrja e masave të përkohshme për të parandaluar dëmtimin mjedisor gjatë shqyrtimit të një çështjeje, siç shihet, për shembull, në Mal të Zi, përfaqëson një praktikë të mirë që juridiksionet e tjera duhet të përpiqen ta ndjekin.

Njëlloj, në disa juridiksione, të drejtat e protestës dhe tubimit mjedisor respektohen dhe zbatohen, në të tjera ato po përballen me kufizime në rritje, ose njohuritë e publikut për çështjet mjedisore janë shumë të kufizuara për të mundësuar përdorimin e këtyre të drejtave. Raportet gjithashtu përmendin shpesh vështirësi në marrjen e informacionit të përshtatshëm rreth problemeve mjedisore dhe vendimmarrjes. Megjithatë, ka shembuj pozitivë të angazhimit dhe veprimtimit publik, për shembull protestat e suksesshme kundër ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në Bosnje dhe Hercegovinë. Përveç kësaj, ka shembuj të vendimeve të rëndësishme gjyqësore për çështjet mjedisore. Për shembull, në një Opinion të Përgjithshëm të kohëve të fundit, Gjykata e Lartë e Maqedonisë së Veriut konstatoi se Qeverisë i kërkohej të miratonte plane për përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas DMSH-së. Ky opinion ka të ngjarë të luajë një rol të rëndësishëm në formësimin e politikave dhe jurisprudencës në lidhje me cilësinë e ajrit. Megjithatë, ka edhe shembuj shqetësues të dobësimin të mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë legjislacionin për zonat e mbrojtura në Shqipëri dhe ligjet për pjesëmarrjen e komunitetit në aktivitetet e kërkimit të mineraleve në Bosnje dhe Hercegovinë. Për më tepër, disa nga analizat tregojnë se krimet mjedisore nuk raportohen dhe ndiqen penalisht.

Studimet bazë identifikojnë gjithashtu një sërë sfidash të përbashkëta mjedisore në të gjithë rajonin. Këto përfshijnë ndotjen e ajrit dhe ujit, hidrocentralet, zhvillimin në zonat e mbrojtura dhe kërkimin e mineraleve. Shqetësime të tilla mund të përfitojnë nga shqyrtimi i përbashkët dhe shkëmbimi i njohurive.

2. Rekomandime të përgjithshme

2.1. Mbrojtja thelbësore

- Nëse nuk është realizuar akoma, duhet siguar që e drejta për një mjedis të shëndetshëm (DMSH) - duke përfshirë të drejtat e qasjes në informacion, pjesëmarrjen dhe qasjen në drejtësi dhe mjete juridike në çështjet mjedisore - të mbrohet në mënyrë të shprehur në kushtetutat vendase dhe legjislacionin mbështetës.
- Nëse nuk është realizuar akoma, duhet siguar që Gjykatat Kushtetuese të kenë juridiksion të plotë mbi çështjet që kanë të bëjnë me DMSH-në dhe shqetësime të tjera të lidhura me të drejtat e njeriut dhe mjedisin.
- Të sigurohet zbatimi në çështjet ligjore i parimeve mjedisore të përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare dhe të BE-së. Këtu përfshihet parimi i parandalimit - i cili parashikon se në situatat kur ka mungesë sigurie shkencore për rrezikun e dëmtimit mjedisor, megjithatë duhet të ndërmerren veprime për të shmangur një dëm të tillë - dhe parimi ndotësi paguan, i cili përcakton që përgjegjësit për dëmtimin mjedisor duhet të paguajnë kostot e tij.⁶³⁸
- Të zbatohet parimi i mosregresionit në legjislacionin mjedisor, në mënyrë që nivelet ekzistuese të mbrojtjes së mjedisit në legjislacionin vendas të mos dobësohen.⁶³⁹
- Të sigurohet që ligjet kombëtare të jenë plotësisht në përputhje me ligjin dhe politikën mjedisore evropiane dhe ndërkombëtare, së bashku me legjislacionin përkatës për të drejtat e njeriut. Çdo boshllëk në këtë fushë duhet të adresohet duke rishikuar legjislacionin ekzistues ose duke zbatuar legjislacionin e ri sipas nevojës.
- Të forcohet koherenca dhe konsistenca në zbatimin e ligjit mjedisor në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke harmonizuar ligjet e ndryshme ose kontradiktore në favor të rezultateve më të forta mjedisore dhe të të drejtave të njeriut.
- Të sigurohet që të drejtat e njeriut dhe detyrimet mjedisore të drejtojnë vendimet në lidhje me zhvillimin ekonomik, për të siguar një tranzicion të drejtë drejt një shoqërie të drejtë, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.⁶⁴⁰
- Duke pasur parasysh faktin se GJEDNJ-ja nuk e mbron drejtpërdrejt DMSH-në, Këshilli i Evropës duhet marrë në konsideratë nxjerrja e udhëzimeve se si jurisprudenca e tij mund të ndihmojë në zbatimin dhe mbështetjen e dispozitave kushtetuese që përmbajnë shprehimisht të drejta dhe/ose detyra për mbrojtjen e mjedisit.

2.2. Të drejtat procedurale

- Si rekomandim i përgjithshëm në kontekstin e të drejtave të qasjes në informacion dhe pjesëmarrjes, duhet të hartohet një listë kontrolli për të udhëzuar institucionet se si t'i zbatojnë plotësisht këto të drejta.

638 Shih p.sh. https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/precautionary-principle.html#:~:text=The%20precautionary%20principle%20is%20an,should%20not%20be%20carried%20out;https://environment.ec.europa.eu/economy-and-finance/ensuring-polluters-pay_en

639 Shih p.sh. <https://www.taylorfrancis.com/chapters/edit/10.4324/9780367816681-83/principle-non-regression-lynda-collins>.

640 Shih p.sh. <https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/issues/climatechange/information-materials/key-messages-hr-a-just-trans.pdf>.

2.2.1. Qasja në informacion

- Të sigurohet që autoritetet publike të ofrojnë në mënyrë proaktive të gjithë informacionin përkatës në lidhje me ligjin, politikat, planet dhe projektet mjedisore në uebsajtet e tyre.
- Të sigurohet që publiku të jetë i informuar në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur për projektet dhe zhvillimet specifike të propozuara, duke përfshirë mediat elektronike dhe vendore.
- Të sigurohet që anëtarët e publikut pa qasje në pajisjet e internetit të jenë ende në gjendje të kenë qasje në informacionin mjedisor, duke përfshirë projektet e propozuara dhe zhvillimet që mund të ndikojnë tek ata.
- Të sigurohet që çdo kufizim në disponueshmërinë e informacionit mjedisor është rreptësisht i kufizuar, me arsye të qarta për refuzim; se ekziston një e drejtë efektive e ankimit kundër refuzimeve për të dhënë informacion dhe se autoritetet publike zbatojnë urdhrat për të zbuluar informacionin e fshehur.
- Të zhvillohen platforma që lejojnë qasje të lehtë në të dhënat/planet mjedisore, vlerësimet e ndikimit dhe vendimet e marra nga autoritetet përgjegjëse.
- Të mbështeten organet e pavarura të medias dhe të sigurohet që gazetarët dhe personeli tjetër i medias të jenë në gjendje të raportojnë për çështje mjedisore pa u përballur me frikësimin ose ngacmimin.

2.2.2. Pjesëmarrja e publikut

- Të lehtësohet pjesëmarrja kuptimplote e publikut në programet mjedisore dhe proceset e vendimmarrjes, veçanërisht në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Vlerësimet Strategjike Mjedisore (VSM). Të sigurohet që konsultimet me publikun të kryhen gjerësisht (duke u fokusuar në grupet më të prekura) dhe në kohën e duhur. Këto konsultime duhet të bazohen në të gjithë informacionin përkatës, të paraqitur në gjuhë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, dhe duhet ti lejojnë publikut kohë të mjaftueshme për të dhënë komente kuptimplote dhe të informuara gjatë një periudhe të arsyeshme konsultimi. Të sigurohet, me prova, që rezultatet e këtyre konsultimeve të jenë marrë parasysh në vendimmarrjen përfundimtare për çështje të tilla.
- Të drejtat e pjesëmarrjes/konsultimit të publikut në formulimin e ligjit dhe politikës mjedisore duhet të mbrohen në legjislacion kur ky kjo nuk është realizuar akoma. Të drejta të tilla duhet të zbatohen plotësisht, me dëshmi se si rezultatet e konsultimeve janë marrë parasysh në përgatitjen e legjislacionit dhe politikës së tillë.

2.2.3. Qasja në drejtësi dhe mjete juridike

- Të sigurohet që ekzistojnë mjete juridike efektive vendase që ofrojnë qasje në drejtësi dhe kompensim për viktimat e dëmtimit mjedisor.
- Të sigurohet që gjykatat vendase të zbatojnë një përkufizim të gjerë të «interesit të mjaftueshëm», «publik i prekur» etj kur shqyrtojnë çështjen e legjitimitetit/locus standi në çështjet mjedisore me interes publik.
- Të sigurohet që vendimet në rastet mjedisore të bazohen në hetime adekuate dhe të përshtatshme, duke përfshirë bashkëpunimin dhe koordinimin me organet e tjera publike sipas nevojës, si dhe duke identifikuar nëse janë marrë të gjitha lejet përkatëse mjedisore.
- Të sigurohet që vendimet në çështjet mjedisore të jenë të arsyetuara mirë dhe të

balancojnë në mënyrë të përshtatshme interesat e ndryshme që merren parasysh, duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

- Të sigurohet që ndihma ligjore të jetë e disponueshme për sfidat ligjore mjedisore. Çdo kosto ligjore në ngritjen e çështjeve mjedisore duhet të jetë e kufizuar dhe e përcaktuar qartë, për të pasqyruar natyrën e interesit publik të sfidave mjedisore dhe për të shmangur shndërrimin e tyre në pengesë për qasjen në drejtësi.
- Të eksplorohej më tej përdorimin i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) si një formë e mundshme e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mjedisore, në rastet e duhura.
- Të sigurohet zhvillimi dhe zbatimi i ligjeve që parandalojnë ngacmimin, frikësimin dhe dhunën kundër aktivistëve mjedisorë dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në mjedis (MDNJM), duke përfshirë mekanizmat e reagimit të shpejtë dhe fondet e ndihmës ligjore sipas nevojës.
- Të sigurohet që aktivistët mjedisorë dhe MDNJM-të të kenë mbrojtje ligjore kundër padive PSKPP, duke përfshirë ndërgjegjësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të publikut në mesin e MDNJM-ve dhe OSHC-ve, trajnimin e gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë publikë sipas nevojës dhe zhvillimin e mekanizmave për mbrojtjen e MDNJM.
- Të sigurohet zbatimi i vendimeve në favor të paditësve mjedisorë.

2.3. Kapaciteti institucional

- Të përmirësohen proceset e shkëmbimit të informacionit dhe të koordinimit për çështjet mjedisore si horizontalisht (në fusha dhe tema të ndryshme të qeverisjes) dhe vertikalisht (në nivel vendor dhe kombëtar). Kjo mund të përfshijë zhvillimin e një platforme online për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet departamenteve dhe ndërmjet niveleve qendrore dhe vendore të qeverisjes.
- Të forcohet zbatimi i legjislationit mjedisor, duke ofruar trajnime për të drejtat dhe detyrat ligjore. Një trajnim i tillë duhet të ketë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të fokusohet në zbatimin praktik të së drejtës mjedisore vendase, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe të ligjit përkatës për të drejtat e njeriut, me fokus në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Trajnimi duhet të përfshijë module për përgjigjen ndaj kërkesave për lirinë e informacionit, sigurimin e pjesëmarrjes së publikut dhe sigurimin e qasjes në drejtësi dhe mjete juridike, sipas rastit. Trajnimi në veçanti duhet të synojë:
 - o Nxënësit e shkollave, për t'u mundësuar të kuptojnë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimet e degradimit të mjedisit.
 - o Universitetet, veçanërisht shkollat juridike, me module të detyrueshme për mbrojtjen e mjedisit. Mund të jetë gjithashtu e dobishme të mbështetet ngritja e «klinikave të së drejtës mjedisore», duke u mundësuar studentëve të zbatojnë njohuritë e tyre ligjore në çështje praktike.
 - o Gjyqtarët, prokurorët publikë, avokatët, shërbimet policore (të përshtatura për fushat e tyre specifike të mbikëqyrjes dhe praktikës) përmes qendrave/akademive përkatëse të trajnimit.
 - o Zyrtarët qeveritarë dhe administrativë në nivel vendor dhe kombëtar.
- Të kryhen fushata të ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore, nëpërmjet agjencive qeveritare dhe OSHC-ve. Këto duhet të përfshijnë prodhimin e udhëzimeve/doracakëve, në mënyrë që anëtarët e publikut - dhe në veçanti grupet e marginalizuara - të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre mjedisore dhe disponueshmërinë e ndihmës juridike ose formave të tjera të ndihmës sipas nevojës.

- Të sigurohet financimi, stafi dhe burime të tjera të përshtatshme për agjencitë mjedisore, inspektoratet dhe organet e tjera publike përkatëse (p.sh. policia, prokurorët, gjyqësori) që të jenë në gjendje të zbatojnë dhe ekzekutojnë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut ndaj ligjit mjedisor.
- Të merren parasysh mësimi i ndërsjellë dhe shkëmbimi ndër-vendas, si brenda rajonit të Evropës Juglindore ashtu edhe jashtë tij, për të shkëmbyer praktikat e mira dhe për të adresuar sfidat. Kjo mund të trajtojë zonat me shqetësim të përbashkët në të gjithë rajonin, duke përfshirë ndotjen e ajrit dhe ujit, hidrocentralet, zhvillimin në zonat e mbrojtura, kërkimin e mineraleve dhe krimin mjedisor.

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.